

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

RAPORT VJETOR

**Gjëndja e Sektorit të Energjisë dhe
Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2019**

Tiranë, 2020

Përmbajtja

Fjala e Kryetarit të Entit Rregullator të Energjisë	9
Hyrje	13
1. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE	26
1.1 STRUKTURA E SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK	26
1.2 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE	29
1.2.1 Prodhimi total i energjisë elektrike për vitin 2019.....	29
1.2.2 Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese publike për vitin 2019	32
1.2.3 Realizimi i Treguesve të Prodhimit dhe Menaxhimi i Rezervës Hidrike.	39
1.2.4 Gjendja e TEC-it Vlorë.....	40
1.2.5 Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese private të pavarura dhe ato me përparësi	41
1.2.6 Prodhimi nga centralet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2019	42
1.2.7 Prodhimi i energjisë elektrike sipas rrjetit ku janë lidhur centralet prodhuese	44
1.3 TRANSMETIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE	47
1.3.1 Bilanci energjistik.....	47
1.3.2 Veprimtaria e OST sh.a.....	50
1.3.2.1 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit	50
1.3.2.2. Investimet në Sistemin e Transmetimit nga OST sha gjatë vitit 2019.	54
1.3.3 Gjendja e Përgjithshme e Sistemit Eelektroenergjetik referuar raportimit të OST sh.a, në zbatim të nenit 25, pika 2 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar	56
1.4 SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE	74
1.4.1 Veprimtaria e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.).....	74
1.4.2 Konsumi i Energjisë Elektrike	76
1.4.3 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike.....	78
1.4.4 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike	80
1.4.5 Treguesit e energjisë elektrike së furnizuar, shitur dhe humbur për çdo zonë dhe agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. gjatë vitit 2019	83
1.4.6 Efektiviteti i shitjes së energjisë elektrike.....	90
1.4.7 Asetet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.....	97
1.4.8 Investimet në Sistemin e Shpërndarjes nga OSHEE sh.a. gjatë vitit 2019.	97
2. TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE.....	98
2.1 MONITORIMI I VEPRIMTARIVE NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE	100

2.1.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike	100
2.1.2 Monitorime Specifike nga informacionet periodike të OST sh.a.....	102
2.1.3 Monitorime të tjera të lidhura me veprimtarinë e të licencuarvë në sektorin e energjisë elektrike	105
2.1.4 Transaksionet e kryera nga KESH sh.a, OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. në Treg të hapur (parregulluar) gjatë vitit 2019.	107
2.2 Regjistri i Pjesëmarrësve të rregjistruar në tregun e energjisë elektrike gjatë vitit 2019.	109
3. LICENCIMI DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË TË LICENCUARËVE NË SEKTORIN E ENERJISË	110
3.1 Licencimet dhe Kërkesat e Trajtuara gjatë vitit 2019.	110
3.2 Mbikqyrja e të licencuarve gjatë vitit 2019.....	116
3.3 Certifikimet	117
3.4 Programi i Pajtushmërisë për OST e energjisë elektrike.....	118
4. AKTIVITETI I ERE-s NË FUSHËN E RREGULLIMIT TË TARIFAVE DHE ÇMIMEVE TË ENERJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR	119
4.1 Shqyrtimi i aplikimeve për miratimin e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror në aktivitetet e lartpërmendura:.....	119
4.1.1 Lidhur me aplikimin e shoqërisë OST sha për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020.....	119
4.1.2 Lidhur me vendimarrjen e Bordit të ERE-s për miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe çmimeve me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundor që furnizohen nga FSHU për vitin 2020.....	120
4.1.3 Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror, deri më datë 31.12.2019.....	122
4.1.4 Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 60, datë 15.04.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a” për vitin 2020... 123	
4.1.5 Në lidhje me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2019	123
4.1.6 Miratimi i çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020	124
4.1.7 Mbi përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2019.....	127
4.1.8 Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW dhe era me fuqi të instaluar deri 3 MW për vitin 2018.	130

4.1.9 Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2MW dhe era me fuqi të instaluar deri në 3MW për vitin 2019.	130
4.2 Ndryshimi i metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 144, datë 25.06.2018.	131
4.3 Fillimi i procedurës për miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës të shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”	132
4.4 Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite	133
4.5 Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2019	134
5. RREGULLIMI I SEKTORIT TË GAZIT NATYROR.....	136
5.1 Projekti TAP, (Trans Adriatic Pipeline).....	136
5.2 Aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria dhe Këshilli i Ministrave për sektorin e Gazit Natyror.	148
5.3 Aktet nënligjore të miratuara nga ERE gjatë vitit 2019 për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e Gazit Natyror.	149
5.4 Veprimtaria e ALBGAS për vitin 2019.	153
5.5 Disa Probleme për të Ardhmen në Sektorin e Gazit Natyror	156
6. MBI RAPORTIMIN E ERE-S NË LIDHJE ME ZBATIMIN DHE NDJEKJEN E PLOTËSIMIT TË REKOMANDIMEVE TË “REZOLUTËS SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË PËR VITIN 2018”.....	157
7. AKTIVITETI I ERE-S NË ZHVILLIMIN E LEGJISLACIONIT SEKONNDAR DHE NDRYSHIMET E TJERA LIGJORE TË NDODHURA GJATË VITIT 2019	174
7.1 Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të përshtatjes së tyre me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar. ..	174
7.2 Proçeset gjyqësore në të cilat ERE ka qënë palë gjatë vitit 2019	181
7.2.1 ERE në Cilësinë e Palës së Paditur në proçeset gjyqësore.....	181
7.2.2 ERE në Cilësinë e Palës së Tretë në proçeset gjyqësore në kuadër zbatimit të kompetencave ligjore.	182
7.3 Zhvillimi i seancave Dëgjimore në ERE.....	183
8. VEPRIMTARIA E ERE-S NË FUSHËN E MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE MBIKQYRJES SË STANDARTEVE.....	183
8.1. Cilësia dhe niveli i mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike	189

8.2. Cilësia e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike	191
9. AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ERE-s	192
9.1 Marrëdhëniet Ndërkombëtare.	192
9.2 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare.	192
9.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s.	194
10. STRUKTURA E ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË DHE ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE	195
11. ADMINISTRIMI I BURIMEVE FINANCIARE TË ERE-S GJATË VITIT 2019	198
SHTOJCA 1 Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare	201
SHTOJCA 2 Raporti i Performancës	219
SHTOJCA 3 Regjistri i Vendimeve të ERE-s gjatë vitit 2019	222

TABELA E FIGURAVE

Figura 1 Skema e Sistemit Elektroenergjetik (Burimi: ERE)	27
Figura 2 Skema e Fluksit të Energjisë dhe Tregtar (Burimi: ERE)	28
Figura 3 Të dhëna mbi prodhuesit për vitin 2019.	30
Figura 4 Prodhimi neto vendas për vitin 2019.	30
Figura 5 Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2019 (MWh).....	31
Figura 6 Prodhimi mujor vendas për vitin 2019 krahasuar me mesataren e periudhës 2009-2019	31
Figura 7 Prodhimi neto vendas historik për periudhën 2009-2019.....	32
Figura 8 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.).....	33
Figura 9 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (Burimi: OST sh.a.).....	33
Figura 10 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2019 (Burimi: KESH sh.a. , OST sh.a.).....	34
Figura 11 Shkarkimet e ujit pa prodhim energjie nga HEC-et e KESH sh.a gjatë vitit 2019.....	35
Figura 12 Shkarkimet e Ujit nga H/C-et e Kaskadës së Drinit (2002-2019) (Burimi: KESH sh.a).....	35
Figura 13 Niveli i Liqenit të Fierzës gjatë vitit 2019 (m).	36
Figura 14 Niveli i Liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2019.....	36
Figura 15 Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2019.....	37

Figura 16 Prurjet mesatare mujore (m ³ /sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2019 krahasuar me mesataren historike.	38
Figura 17 Rezerva Energjetike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2019 (Burimi: KESH sha).....	38
Figura 18 Konsumi specifik i Ujit në HEC-et e KESH sh.a.	40
Figura 19 Shfrytëzimi i Kapacitetit gjenerues të Centraleve.	40
Figura 20 Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi dhe ato të pavarur për vitin 2019.	41
Figura 21 Të dhëna mbi prodhuesit e pavarur për vitin 2019.	41
Figura 22 Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi për vitin 2019.....	41
Figura 23 Impiantet fotovoltaikë të hyrë në prodhim gjatë vitit 2019.	42
Figura 24 Prodhimi nga Impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2019.	43
Figura 25 Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2019.	44
Figura 26 Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2019.	46
Figura 27 Bilanci Energjetik i OST sh.a për vitin 2019 krahasuar me atë të viteve 2015-2018 (GWh). ...	48
Figura 28 Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik shqiptar për vitin 2019.	49
Figura 29 Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë.	51
Figura 30 Harta e Sistemit të Transmetimit Shqiptar.....	52
Figura 31 Skema njëpolare e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar në nivelin 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV.....	53
Figura 32 Asetet kryesore të Sistemit të Transmetimit.....	54
Figura 33 Situata e Investimeve në Sistemin e Transmetimit nga OST sha gjatë vitit 2019.	55
Figura 34 Skema e vlerësimit të Gjendjes së sistemit dhe rivendosja me gjendje normale operimi.	58
Figura 35 Të dhënat për balancën në sistemin energjetik për periudhën 2020 – 2024.	66
Figura 36 Parashikimi afatgjatë i kërkesës për energji elektrike për periudhën 2020 – 2039 sipas secilit skenar.	67
Figura 37 Parashikimi afatgjatë i kërkesës për energji elektrike për periudhën 2020 – 2039.	68
Figura 38 Parashikimi i kërkesës për energji elektrike, mbulimi i saj nëpërmjet prodhimit vendas dhe importit për pesë vitet e ardhshme, 2020-2024.	72
Figura 39 Treguesit kryesorë të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSHEE sh.a. gjatë vitit 2019.....	75
Figura 40 Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike ndër vite.	76
Figura 41 Kontributet e prodhimit neto vendas dhe balancës Import-Eksport në konsumin total të Energjisë Elektrike në Shqipëri.....	76
Figura 42 Komponentët për mbulimin e konsumit dhe komponentët e konsumit të energjisë elektrike të siguruar për vitet 2018 – 2019	77

Figura 43 Komponentët për mbulimin e konsumit dhe komponentët e konsumit të energjisë elektrike të siguruar për vitet 2018 – 2019.	77
Figura 44 Numri i Klientëve të OSHEE sh.a 2019.	78
Figura 45 Shpërndarja e numrit të Klientëve 2019 sipas kategorive (%).	78
Figura 46 Raportet e Faturimit sipas Kategorive të Klientëve 2019.	79
Figura 47 Klientët Familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite.	79
Figura 48 Konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2019.	80
Figura 49 Profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2019.	81
Figura 50 Profili dhe piku i ngarkesës në dhjetor 2019 (MW).	81
Figura 51 Profili dhe minimumi i ngarkesës në tetor 2019 (MW).	82
Figura 52 Të dhënat mbi peshën specifike të konsumit të energjisë elektrike në treg të liberalizuar për vitin 2019, krahasuar me të dhënat e vitit 2018.	82
Figura 53 Grafiku mbi peshën specifike të konsumit të energjisë elektrike në treg të liberalizuar për vitin 2019, krahasuar me të dhënat e vitit 2018.	83
Figura 54 Të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo Agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. gjatë vitit 2019.	84
Figura 55 Shpërndarja e Furnizimit me Energji Elektrike sipas Drejtorive rajonale (%).	85
Figura 56 Shpërndarja e Humbjeve të Energjisë Elektrike sipas Drejtorive rajonale (%).	85
Figura 57 Humbjet mujore dhe mesatare në sistemin e shpërndarjes krahasuar me targetin e humbjeve të energjisë elektrike sipas VKM nr.253, datë 24.04.2019 (%).	86
Figura 58 Sasia në Furnizim dhe Humbje të Energjisë Elektrike në Rajonet dhe Agjencitë e Rrjetit të Shpërndarjes (Burimi: OSHEE sh.a).	87
Figura 59 Treguesit nga operatorët kryesorë të sistemit Elektroenergjetik në Shqipëri 2019.	88
Figura 60 Bilanci Energjetik viti 2019.	89
Figura 61 Të dhëna të tregut të energjisë elektrike për vitin 2019 në raport me energjinë elektrike të konsumuar në Shqipëri.	90
Figura 62 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2019.	91
Figura 63 – Grafiku i Humbjeve Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2019.	91
Figura 64 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2019.	92
Figura 65 Niveli i Arkëtimeve Mujore në periudhën 2011-2019.	93
Figura 66 Ecuria e treguesve të efektivitetit të shitjes së Operatorit të Shpërndarjes (%).	94
Figura 67 Efektiviteti i shitjeve të OSHEE 2009-2019 (Burimi: OSHEE sh.a).	95
Figura 68 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së futur në sistemin Elektroenergjetik kundrejt konsumit. .	96
Figura 69 Faturimi/Arkëtimi 2002-2019 me TVSH (Burimi: OSHEE sh.a).	96
Figura 70 Të dhëna mbi asetet kryesorë të OSHEE (Burimi: OSHEE).	97

Figura 71 Të dhëna mbi Investimet në Sistemin e Shpërndarjes nga OSHEE sh.a. gjatë vitit 2019. (Burimi: OSHEE).....	98
Figura 72 Të dhëna mbi Ankandet e Alokimit të Kapaciteteve në Sistemin e Transmetimit gjatë vitit 2019.....	102
Figura 73 Disbalancat totale për vitin 2019 (MWh), Burimi OST sh.a.	104
Figura 74 Transaksionet e kryera gjatë vitit 2019 nga KESH sh.a. ; OSHEE sh.a. dhe OST sh.a.	108
Figura 75 Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite (Burimi: OST sh.a.).....	108
Figura 76 Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2019.	109
Figura 77 Subjektet e licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2019	112
Figura 78 Subjektet e licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për vitin 2019.	113
Figura 79 Subjektet e licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për vitin 2019.	114
Figura 80 Subjektet e licencuar në aktivitetet e gazit natyror për vitin 2019.....	115
Figura 81 Tabela e Tarifave dhe Çmimeve të lëna në fuqi për vitin 2020.....	122
Figura 82 Ecuria e çmimeve të miratuara për Prodhuesit me Përparësi.	124
Figura 83 Ecuria e çmimeve të miratuara për Prodhuesit me Përparësi ndër vite.	125
Figura 84 Të ardhurat nga prodhuesit me përparësi (Burimi OSHEE sh.a.)	125
Figura 85 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE për vitin 2019 (Burimi: OSHEE sh.a., ERE).	126
Figura 86 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE për vitin 2018 (Burimi: OSHEE sh.a., ERE)	127
Figura 87 Krahasimi i çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitet 2018-2019	128
Figura 88 Kurba levizëse e çmimit maksimal të blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE sh.a. për këtë kategori klientësh për vitet 2018 – 2019.....	128
Figura 89 Kurba levizëse e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, të miratuar nga ERE për vitet 2018 – 2019.	129
Figura 90 Tarifat dhe Çmimet e miratuara nga ERE për periudhën 2008 – 2019.	133
Figura 91 Çmimi mesatar i realizuar (Burimi ERE, OSHEE sh.a.).....	134
Figura 92 Çmimi i realizuar për kategoritë e klientëve (Burimi ERE, OSHEE)	134
Figura 93 Çmimet e energjisë elektrike të klientëve jofamiljarë në vendet e rajonit sipas raportimit më të fundit të EUROSTAT për vitin 2019 (Burimi EUROSTAT)	135
Figura 94 Çmimet e energjisë elektrike të klientëve familjarë në vendet e rajonit sipas raportimit më të fundit të EUROSTAT për vitin 2019 (Burimi EUROSTAT)	135
Figura 95 Pikat e ndërlidhjes me projektin TAP.....	136
Figura 96 Rrjeti i transmetimit të gazit në Ballkan.....	137

Figura 97 Aksionerët e kompanisë TAP.	138
Figura 98 Ankesat e trajtuara nga shoqëria OSHEE sh.a për vitin 2019.	187
Figura 99 Ankesat e trajtuara nga ERE për vitin 2019.	188
Figura 100 Përgjigjet e OSHEE sh.a lidhur me ankesat e paraqitura në ERE për vitin 2019.	189
Figura 101 Treguesit e Kritereve Standarde të Performancës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit për vitin 2019.	190
Figura 102 Treguesit e Kritereve Standarde të Performancës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2019, krahasuar me treguesit e vitit 2018.	191
Figura 103 Struktura Organizative e Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 78, datë 28.04.2020.	196

Fjala e Kryetarit të Entit Rregullator të Energjisë

I Nderuar Zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Deputetë,

Në emër të Entit Rregullator të Energjisë, ju paraqes Raportin Vjetor mbi situatën e Sektorit të Energjisë dhe veprimtaritë e ERE-s për vitin 2019.

Në këtë raport kemi synuar të japim një pasqyrë të plotë dhe sa më të detajuar mbi gjëndjen në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror në vendin tonë, si dhe vështirësitë, sfidat apo dhe arritjet me të cilat këta sektorë janë përballur përgjatë vitit 2019. Po ashtu pjesë përbërëse e këtij raporti është dhe një informacion i përditësuar mbi aktivitetin e shoqërive, të cilat operojnë në këta dy sektorë të rëndësishëm.

Theksoj se viti 2019 dhe fillimi i vitit 2020 sikurse jemi fatkeqësisht dëshmitarë të gjithë, ka qënë i mbushur me sfida të veçanta sociale. Këto sfida kanë patur ndikimin e tyre përse i takon funksionimit normal të ERE-s në përmbushje të detyrave që dalin, pasi Sektori i Energjisë është ndër sektorët jetikë të vendit.

Në këtë prizëm, nga ana jonë janë bërë dhe ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për funksionimin e punës së rregullatorit dhe të operatorëve të sistemit në aktivitetet jetike të vendit, gjithashtu dhe në krijimin e kushteve të furnizimit me cilësi dhe vazhdimësi të konsumatorëve. Gjykoj se ja kemi arritur më së miri këtij qëllimi. ERE ka ndërmarrë vendime, të cilat kanë mundësuar mbarvajtjen e punës në përputhje me direktivat kryesore për parandalimin e përhapjes së pandemisë dhe ruajtjes së distancimit social të punonjësve.

Të nderuar Deputetë,

Gjatë vitit 2019, Sektori i Energjisë ka patur një qëndrueshmëri përse i takon aktivitetit të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, duke mbajtur dhe ruajtur parametra të qëndrueshëm operimi.

Megjithatë, mbetet akoma për të bërë në drejtim të diversifikimit të burimeve gjeneruese, adresimit të çështjeve si dhe zgjidhjeve sa më efçente në drejtim të mbështetjes së zhvillimit të burimeve gjeneruese të rinovueshme apo dhe shlyerjes së detyrimeve financiare.

Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike, i realizuar nga impiantet e gjenerimit që kanë hyrë në prodhim vetëm gjatë vitit 2019, zë rreth 1.6% të prodhimit total të energjisë elektrike për këtë vit, që është një vlerë e kënaqshme krahasuar me ecurinë e parashikuar të rritjes së kërkesës së energjisë elektrike në vitet në vijim.

Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet private ka qënë gjatë vitit të kaluar në vlerën prej 2,226 GWh, e cila zë mbi 43%, të të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vënd, shifër që është rritur nga viti në vit dhe do të vazhdojë me rritje në vitet në vijim..

Po ashtu edhe Sektori i Gazit Natyror shënoi zhvillime efikase në strukturimin e tij dhe funksionimin normal, ku një rol të rëndësishëm luan ecuria e investimit të projektit TAP brënda afateve të përcaktuara për vënien në operim të tij.

Në vijim të procedurave të certifikimit e më tej të licensimit të shoqërisë Albgaz sh.a., është punuar gjerësisht me këtë të fundit në kuadër të implementimit të Vendimeve të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë (PHLG) të Komunitetit të Energjisë në këtë sektor të rëndësishëm.

Enti Rregullator i Energjisë ka zhvilluar veprimtarinë e tij mbështetur në Ligjin Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.

Realizimi i pavarësisë organizative dhe funksionale të institucionit, duke marrë masat për zbatimin e strukturës organizative të ERE-s gjatë vitit 2019, me punësimin e një stafi profesional të kualifikuar, që ti bëjë ballë si sfidave të sektorit dhe angazhimeve në kuadër të integritimit në tregun rajonal e më gjerë.

Në kuadër të objektivave për bashkëpunimin dhe kualifikimin e punonjësve të ERE-s, përgjatë vitit 2019, përmes eksperiencave më të mira në nivel ndërkombëtar është vazhduar puna dhe bashkëpunimi me Këshillin Evropian të Rregullatorëve të Energjisë, Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë, Shoqatën e Rregullatorëve të Mesdheut; janë nënshkruar memorandumet e bashkëpunimit me Entet Rregullator të Kosovës dhe Malit të Zi; si dhe bashkëpunimi në krijimin e Forumit të Rregullatorëve të Ballkanit, me pjesëmarrjen e Rregullatorëve të Bullgarisë, Serbisë, Malit të Zi, Bosnje dhe Herzegovinës, Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, ku ERE ka kontribuar dhe do të vazhdoi të kontriboi në mënyrë aktive.

Puna jonë ka patur dhe do ketë si qëllim kryesor zhvillimet në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror në përputhje me kërkesat rregullore dhe legjislative, të cilat duhet të përputhen plotësisht me ato të BE-së.

Këto zhvillime kërkojnë që ERE të zhvillohet si një institucion me kapacitete teknike të mjaftueshme dhe ekspertizën e nevojshme, për t’u përballur me sfidat e sektorit në Shqipëri e më gjerë; si dhe rritjen e rolit tonë aktiv në institucionet ndërkombëtare, duke marrë kryesimin e disa prej grupeve të punës së tyre.

Në një analizë të disa treguesve kryesorë të sistemit energjitik gjatë vitit 2019, të tillë si prodhimi i Energjisë Elektrike, duhet thënë se viti 2019 ka shënuar një ulje si rezultat i vitit relativisht jo të mirë hidrik, që ka çuar në ulje të prodhimit total të energjisë elektrike në vend, duke mundësuar realizimin e përmbushjes së kërkesës nëpërmjet shtimit të importit, për të mundësuar furnizimin pa ndërpreje të energjisë elektrike. Ky fakt ka ndikuar dhe në rritjen e kostove financiare për tu përballuar nga ana e shoqërive të ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik.

Ndër të dhënat kryesore mund të përmëndim

- (i) Gjatë vitit 2019 janë shtuar gjithsej 36 centrale, me një fuqi totale të instaluar prej 74.3 MW dhe me një prodhim të përgjithshëm prej 83,158 MWh;
- (ii) Prodhimi i përgjithshëm i vendit ka qënë në nivelin 5.2 TWh, me një ulje prej rreth 40% krahasuar me vitin 2018, i cili duhet thënë se ka qënë një vit me prodhimin më të madh të realizuar që nga viti 1985. Ndërkohë që importi i energjisë elektrike ka qënë në vlerat 2.4 TWh;
- (iii) Gati 57% e këtij prodhimi është prodhuar nga Shoqëria Publike e gjenerimit, pjesa tjetër prej 43% është prodhuar nga centralet private konçesionare ose jo;

- (iv) Humbjet në sistemin e shpërndarjes së Energjisë Elektrike kanë qënë në nivelin 21.79%, duke shënuar ulje të nivelit të humbjeve krahasuar me vlerën prej 23.96% të vitit 2018;
- (v) Përgjatë vitit 2019 është vënë re gjithashtu një rritje e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike. Këtë vit kanë prodhuar energji elektrike 8 centrale fotovoltaike, me fuqi totale të instaluar prej rreth 15 MW. Sasia totale e prodhimit të realizuar nga këto centrale për vitin 2019 është në vlerat e gati 23,000 MWh;
- (vi) Kërkesa për energji elektrike në vitin 2019 arriti në vlerën prej 7,612 GWh., me një ulje të lehtë të konsumit të energjisë elektrike në vend me 26,767 MWh krahasuar me kërkesën për vitin 2018.

Zonja dhe Zotërinj,

ERE, ka patur si mision kryesor kryerjen e shërbimeve të sigurta dhe të besueshme për klientët, bazuar në kosto sa më të drejta dhe të arsyeshme për të licensuarit. Sa më sipër është reflektuar në vendimarrjet për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike.

Në fushën e Gazit natyror ka vazhduar bashkëpunimi i frytshëm me dy Entet Rregullator në të cilat kalon projekti TAP, përkatësisht Greqisë dhe Italisë.

Duke konsideruar që, ende mbetet për tu punuar në drejtim të kuadrit rregullator, me aktet nënligjore të përcaktuara në ligjet që rregullojnë Sektorin e Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, për vitin që vjen objektivat e ERE-s do të vijnë të orientohen drejt plotësimit të legjislacionit me aktet përkatëse, e lidhur ngushtë kjo edhe me përgatitjen për implementimin e katër paketave legjislative, atë të paketës për Energjinë e Pastër, monitorimin e liberalizimit të mëtejshëm të tregut të Energjisë Elektrike dhe të operimit të Bursës së Energjisë Elektrike, në drejtim të zbatjes së efekteve tek klientët fundorë në fillimet e operimit të tij, ndarjen funksionale të operatorit të sistemit të shpërndarjes në përputhje me detyrimet ligjore dhe angazhimet ndërkombëtare si dhe zhvillimi më tej i kuadrit Rregullator për Sektorin e Gazit Natyror, si një mundësi që i jepet vendit tonë nga përfundimi i projektit TAP.

Në këtë prizëm, ERE është tërësisht e angazhuar për një bashkëpunim edhe më të ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vienë, si një ndër partnerët kryesorë në përpilimin e legjislacionit primar dhe sekondar, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës, si dhe të gjithë aktorët e tjerë të Sektorit Energjetik në vend e më gjerë. Ky bashkëpunim gjykoj se është thelbësor për zhvillimin e këtij Sektori në të ardhmen dhe përballimit të sfidave, që na dalin përpara në kuadër dhe të bashkimit me Tregjet Rajonale, në kuadër të angazhimeve të ndërmarra tashmë nga ana e Qeverisë Shqiptare në këtë drejtim.

Megjithë arritjet apo përmirësimet e përshkruara në këtë raport, puna jonë në vijim do të fokusohet ndër të tjera dhe në çështjet që lidhen me; (i) Miratimi dhe zbatimi i Rregullores së Transparencës dhe Integritetit të Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT), (ii) Monitorimi i implementimit të ndarjes funksionale dhe organizative të OSHEE, (iii) Zbatimi i planit strategjik për reformat në Sektorin Elektroenergjetik, (iv) Impakti i Burimeve të Rinovueshme në treg, (v) Miratimi dhe zbatimi i strategjisë për infrastrukturën kritike në Sektorin e Energjisë, (vi) Paketa e Energjisë së Pastër, (vii) Zbatimi i mekanizmit të Tregut të Balancimit dhe garantimi i shërbimeve ndihmëse, (viii) Platforma Online e Krahasimit të Çmimeve të Furnizuesve, (ix) Vijimi i punës për krijimin e Tregut të Përbashkët të Energjisë Elektrike me Kosovën dhe në rajon, (x) Liberalizimi i mëtejshëm i tregut të Energjisë Elektrike dhe krijimi i Bursës së Energjisë, (xi) Krijimi i Tregut të Garancive të Origjinës, (xii) Studimi i zgjidhjeve dhe përgatitja e propozimeve përkatëse për shuarjen e detyrimeve reciproke.

Vendosja dhe arritja e objektivave të mësipërme, mendoj se do të duan ndër të tjera një angazhim maksimal të stafit të ERE-s dhe një bashkëpunim me të gjithë aktorët e Sektorit në një periudhë afatmesme të ecurisë së institucionit tonë.

Një vënd të rëndësishëm dhe prioritar ka patur në punën tonë dhe transparenca e Sektorit, për këtë jemi munduar dhe besoj se ja kemi arritur të krijojmë kushte për rritjen e transparencës për të mundësuar ekuilibrimin e interesave të klientëve fundorë, kompanive publike si dhe investitorëve privatë në sektorët e rregulluar nga ana jonë.

Në kuadër të transparencës, ky Raport Vjetor, si gjithmonë, do të jetë në dispozicion të të gjithë institucioneve, investitorëve por edhe konsumatorëve që janë të interesuar, në faqen zyrtare të ERE-s në internet dhe një kopje e përmbledhur do të publikohet dhe shpërndahet nga ana jonë si për palët e interesuara brënda vendit ashtu dhe për Entet Rregullator të vëndeve të tjera.

Dëshiroj së fundmi, të falenderoj me këtë rast Bordin dhe të gjithë stafin e ERE-s si dhe të gjitha Insitucionet përkatëse për mbështetjen dhe bashkëpunimin; në menyrë të veçantë Kuvendin e Shqipërisë por edhe konsumatorët shqiptarë , të cilët në çdo rast mendoj se kanë patur akses të sigurt në praktikat e shqyrtuara dhe miratuara nga ana jonë edhe përgjatë këtyre kohëve të vështira për të gjithë shoqërinë tonë. Kjo gjë që është adresuar edhe nëpërmjet shoqatave për mbrojtjen e konsumatorit si dhe bashkëpunimin konstant me Autoritetin e Konkurrencës, dhe shpreh bindjen për vazhdimin e këtij bashkëpunimi të frytshëm edhe në të ardhmen.

Këto janë shkurtimisht disa nga drejtimet kryesorë të aktivitetit dhe punës së Entit Rregullator të Energjisë gjatë vitit 2019, në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror.

Me konsideratë dhe respekt

KRYETARI
Petrit AHMETI



Hyrje

Vështrim i përgjithshëm mbi Sektorin e Energjisë

Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror, i cili funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore të miratuara në zbatim të tyre.

ERE ushtron aktivitetin e saj me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimeve të pjestarëve të tregut për furnizimin me energji, me cilësi dhe me kosto sa më të ulët të klientëve. ERE, duke marrë në konsideratë interesat dhe të drejtat e klientëve, sigurinë dhe cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, kryen liçensimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektor, monitoron tregun e energjisë elektrike, harton kuadrin rregullator, shqyrton në përputhje me metodologjitë respektive aplikimet e tarifave dhe çmimeve, e nëpërmjet autoritetit vendimmarrës të saj, dhe në zbatim të ligjit, vepron rast pas rasti duke e shprehur vullnetin nëpërmjet vendimeve të Bordit.

Bordi i ERE-s, është organi vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ERE-s. Bordi i ERE-s përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtarë, të cilët emërohen në detyrë nga Kuvendi i Shqipërisë me një mandat 5 vjeçar.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit “Për Sektorin e Gazit Natyror” është përgatitur ky raport mbi “Gjendjen e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtarinë e ERE-s gjatë vitit 2019”, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Në këtë raport janë paraqitur në mënyrë të detajuar të dhëna mbi ecurinë e Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror për vitin 2019, si dhe krahasimet e treguesve të këtij viti me vitet parardhës.

Përsa i takon prodhimin të Energjisë Elektrike, vlen për tu thënë se siç mund të konstatohet, Viti 2019 ka qënë një vit hidrologjik jo i mirë, për më tepër krahasuar dhe me vitin 2018, i cili përbënte një rekord në rritjen e prodhimin të energjisë elektrike nga burimet e vendit. Kjo për faktin se, prurjet e ujit në basenet e impianteve kryesor të prodhimin të energjisë elektrike kanë qënë në tërësinë e tyre nën mesataren shumë vjeçare të tyre. Është vërejtur se, prurjet mesatare të ujit në basenet e HEC-eve, administruar nga ana e KESH sh.a., rezultuan në 119 m³/s, ose 34% më pak se mesatarja shumëvjeçare, duke filluar prej vitit 1991.

Kjo ka ndikuar gjithashtu në prodhimin neto vjetor të energjisë elektrike, i cili në vendin tonë për vitin 2019 ka qënë në sasinë 5,206 GWh, duke shënuar një rënie krahasuar me mesataren e prodhimin të energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2019, e cila është në vlerat 5,892 GWh, pra për vitin 2019 prodhimi i energjisë elektrike rezulton rreth 11.6% më i ulët se mesatarja e prodhimin për periudhën dhjetë vjeçare. Gjithashtu, krahasuar me sasinë e energjisë elektrike prej 8,552 GWh të prodhuar gjatë vitit 2018, prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2019 rezulton të jetë 3,346 GWh më pak ose gati 40% më i ulët.

Ky vit, jo i mirë hidrologjik, shkaktoi realizimin e një importi të konsiderueshëm të energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës dhe furnizimin e pa ndërprerë të klientëve në vend. Balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për Vitin 2019 ishte import neto në sasinë prej 2,406 GWh, e cila është mbi 30% të vlerës totale të konsumit, duke rezultuar një ndër vitet me import më të madh

gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, ndërkohë që në të njëjtën kohë për Vitin 2018 vendi jonë kishte një balancë neto eksporti në sasinë prej 913 GWh.

Prodhimi i energjisë elektrike në 5,206 GWh u realizua nga centralet në zotërim të kompanisë publike të gjenerimit KESH sh.a., në sasinë prej 2,979 GWh ose gati 57 % të të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë. Pjesa tjetër e prodhimit prej 2,226 GWh u prodhuan nga centralet e tjera, e cila zë mbi 43%, të të gjithë prodhimit të energjisë elektrike. Siç vërehet dhe nga këto shifra, pjesa e prodhimit, që realizohet nga prodhuesit e pavarur privatë të energjisë elektrike, vjenë duke u rritur nga viti në vit. Nëse për Vitin 2018 kjo vlerë rezultonte se ishte vetëm 31.6%, për Vitin 2019 kjo shifër ka shkuar në gati 43 % e gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vend, duke rritur peshën e këtyre prodhuesve në treg, i cili është një ogur mjaft i mirë për vijimin e këtij procesi edhe në të ardhmen. Përsa i takon shtimit të kapaciteteve gjeneruese dhe me ngritjen e Bursës së Energjisë Elektrike nëpërmjet kontratave për diferencë, do të optimizohet dhe efekti financiar i tyre në klientët e sistemit elektroenergjetik.

Përgjatë vitit 2019, kanë hyrë në prodhim gjithsej 36 centrale me një fuqi totale të instaluar prej 74.3 MW, të cilët kanë prodhuar gjatë vitit 2019 sasinë prej rreth 83,158 MWh. Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike i realizuar nga impiantet e gjenerimit që kanë hyrë në prodhim vetëm gjatë vitit 2019, zë rreth 1.6 % të prodhimit total të energjisë elektrike për këtë vit, që është një vlerë e kënaqshme krahasuar me ecurinë e parashikuar të rritjes së kërkesës së energjisë elektrike në vitet në vijim.

Përgjatë vitit 2019, është vërejtuar gjithashtu një rritje e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaik. Këtë vit kanë prodhuar energji elektrike 8 centrale fotovoltaik me fuqi totale të instaluar prej 15 MW. Prodhimi i realizuar nga këto centrale për vitin 2019 arrin në 22,190 MWh, ndërkohë që për vitin 2018 kishim në operim vetëm një central prodhim të energjisë elektrike nga impiant fotovoltaik, ai i UKKO (Ujësjellës Kanalizimet Korçë) sh.a. me kapacitet të instaluar prej rreth 1 MW, që ka prodhuar energji elektrike nga impianti në fjalë për nevojat e tij të furnizimit.

Kërkesa për energji elektrike në vitin 2019 arriti në vlerën prej 7,612 GWh. Krahasuar me Vitin 2018 vërehet një ulje e lehtë e konsumit të energjisë elektrike në vend me 26,767 MWh krahasuar me kërkesën e cila për vitin 2018 ishte në vlerat prej 7,638 GWh. Ulja e kërkesës e vërejtuar përgjatë këtij viti, e cila duhet thënë se është vënë re dhe më parë, ka të bëjë kryesisht me ndryshimet klimatike, efciensën energjetike apo dhe vazhdimin e masave për uljen e vjedhjes së energjisë elektrike.

Në këtë prizëm, humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes për vitin 2019, arrijnë në vlerat 21.79%, duke shënuar ulje të nivelit të humbjeve krahasuar me vlerën prej 23.96% të vitit 2018 me rreth 2.17 %. Niveli i humbjeve të energjisë elektrike vijon të ketë një rënie nga viti në vit, fakt ky që tregon për rritjen e performancës dhe efikasitetit të masave të marra në sektor, si nga Operatori ashtu dhe nga Ministria e linjës.

Për vitin 2019, humbjet totale të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe të transmetimit janë në vlerat 1,651 GWh. Krahasuar me vitin 2018 kemi një ulje të humbjeve totale të energjisë elektrike me 134 GWh.

Niveli total i arkëtimeve për vitin 2019 është në vlerat prej 98.4% kundrejt energjisë elektrike të faturuar tek klientet, një shifër mjaft e mirë kjo, që tregon për stabilitetin e operatorit në këtë fushë.

Struktura e klientëve të energjisë elektrike edhe për vitin 2019 është kryesisht e përqëndruar tek klientët familjarë. Klientët familjarë zënë rreth 86% të numrit total të klientëve të energjisë

elektrike në vend. Në pjesën e konsumit të energjisë elektrike klientët familjarë për vitin 2019 zënë rreth 36.1% të konsumit të përgjithshëm.

Shpërndarja e vlerës së faturimit të energjisë elektrike për vitin 2019 në klientët e furnizuar nga Shërbimi Universal rezulton të jetë në vlerat prej 48% për klientët familjar, 38% klientët privatë, dhe pjesa tjetër prej 14% klientët buxhetorë dhe jo buxhetorë, duhet thënë se klientët buxhetorë dhe jo buxhetorë vazhdojnë të jenë problem përsa i takon pagesave të faturave të Energjisë Elektrike, duke akumuluar një borxh për OSHEE sh.a. dhe duke krijuar edhe gjate këtij viti vështirësi financiare për këtë të fundit.

Përsa i takon çmimeve të klientëve fundorë të furnizuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal përgjatë vitit 2019, nuk pati rritje të tyre dhe tarifat e tyre apo dhe tarifat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit kanë mbetur në fuqi ato të vitit 2018.

Përsa i takon klientëve, të cilët janë furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, si rrjedhojë e mosdaljes së tyre në treg të lirë megjithë krijimin e kushteve teknike dhe ligjore për këtë dalje, çmimi mesatar i Furnizimit të Mundësisë së Fundit për vitin 2019 ka qënë në vlerën mesatare prej 14.17 Lekë/kWh, një rritje prej gati 2.1 Lekë/kWh krahasuar me çmimin mesatar të vitit 2018 ose një rritje prej gati 17%.

Viti 2019 në përgjithësi, nuk ka patur ndryshime të tarifave apo çmimeve, përveç rënies së çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuesve me përparësi të energjisë, me vlerën prej 8.4582 Lekë/kWh, si rezultat i rënies së çmimit të tregut në rajon, i cili shërben si referencë për përcaktimin e këtij çmimi si dhe çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2MW.

Në kuadër të mbrojtjes së klientëve, si një ndër detyrat kryesore të rregullatorit, është monitoruar implementimi i planit të masave për OSHEE sh.a, të miratuar në shtator të vitit 2018, apo edhe ndjekja e proceseve gjyqësore në cilësinë e palës së tretë, në paditë e konsumatorëve ndaj OSHEE sh.a., si dhe janë trajtuar me transparencë ankesat në kuadër të kushteve të përgjithshme të furnizimit apo ankesave të tjera që lidhen me klientët. Po ashtu në këtë kuadër, janë miratuar një sërë aktesh që lidhen drejtpërdrejtë me klientin, si udhëzimi për lidhjet e reja në sistemin e Shpërndarjes etj.

Në Sektorin e Gazit Natyror, viti 2019 ka qënë një vit ku ka vijuar puna për ndërtimin e gazsjellësit TAP. Ecuria e plotë deri në fund të dhjetorit 2019 e realizimit të projektit ishte rreth 97% e të gjithë projektit. Pjesa dërrmuese e punëve të ndërtimit në vend ka përfunduar dhe stafi i projektit në vend po përqendrohet në përfundimin dhe vendosjen në funksion të aktiviteteve në përgatitje të futjes së gazit natyror.

ERE me Vendimin Nr. 15, datë 31.01.2019, liçensoi në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, Trans Adriatic Pipeline AG Albania, për një afat 25 vjeçar, nga data e fillimit të operimit. Liçensimi në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror reflekton kërkesat e nenit 4, pika 50; nenit 22, pika 2 gërma “a” dhe nenit 35 të Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar.

TAP aktualisht po bashkëpunon ngushtë me ERE-n për miratimin e Kodit të Rrjetit të Gazit natyror, i cili ka për qëllim të drejtojë operimin e sistemit të transportit të TAP. TAP e ka paraqitur Kodin e tij të Rrjetit tek Autoritetet Rregullatore të vëndeve në të cilët kalon gazsjellsi TAP për miratim, aktualisht po vazhdon shqyrtimi i këtij kodi edhe nga të dy rregullatorët e tjerë, me të cilët kemi pasur deri më tani një bashkëpunim të shkëlqyer.

Pavarsisht arritjeve dhe performancës së mirë të Sektorit të Energjisë Elektrike dhe në planin e përgatitjes së legjislacionit sekondar dhe rregullator, përfshirë sektorin e gazit natyror për vitin 2019, vlen të theksohet se ndër fushat të cilat duhet të jenë ndër objektivat kryesor të punës së ERE-s për vitin që vjenë vlersojmë:

- **Miratimi dhe zbatimi i Rregullores së Transparencës dhe Integritetit të Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)**

Rregullorja REMIT, e cila është transpozim i rregullores Nr.1227/2011 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, vendos theksin në rritjen e transparencës dhe ruajtjen e integritetit të tregut me shumicë të energjisë elektrike si në vend ashtu dhe në rajon. Rritja e transparencës dhe monitorimi i Rregullatorëve në këtë treg, i cili hap pas hapi po hapet tashmë, do të nxisë konkurrencën e ndershme të të gjithë pjesmarrësve të tregut dhe për rrjedhojë do të sjellë përfitime për klientët fundor të energjisë. Është e rëndësishme që konsumatorët dhe pjestarët e tjerë të tregut të energjisë elektrike dhe të gazit natyror të krijojnë dhe të kenë besim në integritetin e tregut, në mënyrë që çmimet e vendosura në tregun me shumicë të energjise të jenë derivat i një procesi të drejtë, konkurrues, dhe transparent dhe të drejtohen nga praktika të biznesit të mirë dhe kushtet të mirpërcaktuara. Në këtë kontekst, do të mund të monitorohen nga ana e Rregullatorëve dhe Bordit të rregullatorëve të vëndeve të traktatit ECRB dhe eliminohen abuzimet e mundëshme në tregun me shumicë të energjisë, të cilat sjellin kosto të shtuara për klientët.

Rregullorja në fjalë, e cila përdoret prej shumë vitesh në vëndet e EU-se, duke filluar nga mesi i vitit 2010, pas miratimit nga ana e ERE-s, do të jetë e zbatueshme dhe për Shqipërinë dhe vëndet e rajonit, në kuadër të Traktatit të energjisë. Në të vendosen kushte për monitorimin e sjelljes së operatorëve të tregut, duke monitoruar dhe ndaluar abuzimet e mundëshme me tregun nga ana e kompanive që zotërojnë monopolin, si nga ana e gjenerimit ashtu dhe nga ajo e konsumit për të parandaluar deformimin e çmimeve për klientët. Për të mundësuar transpozimin e saj dhe implementimin, po punohet në bashkëpunim me Sekretariatit e Energjisë në Vjenë dhe Rregullatorët e rajonit. Rregullorja po ashtu mundëson mbrojtjen e operatorëve të tregut të energjisë elektrike Shqiptare, nga sjellja e padrejtë e mundëshme në vëndet e tjera të rajonit, duke i dhënë mundësi trajtimit të problematikës së ngritur në rang rajonal dhe monitorimit të mëtejshëm nga ana e Rregullatorëve.

ERE, me Vendimin Nr. 203 datë 12.12.2019, miratoi Rregullat për monitorimin e tregut të Energjisë Elektrike, si një hap i parë i përcaktimit të detajuar të mënyrës dhe proçdurave që do të ndiqen nga ERE-s për monitorimin e funksionimit të Tregut të Energjisë Elektrike në vëndin tonë. Impementimi i plotë i rregullores së monitorimit të tregut dhe REMIT do të jetë një sfidë jo vetëm për Rregullatorin, por për gjithë pjesmarrësit e tregut të energjisë elektrike në vëndin tonë, gjatë krijimit të Bursës së Energjisë Elektrike. Në të njëjtën kohë Rregullorja do të krijojë kushte për transparencën në zgjerimin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

- **Monitorimi i implementimit të ndarjes funksionale dhe organizative e OSHEE**

Ndërmarrja e masave të nevojshme për implementimin dhe monitorimin e ndarjes së OSHEE sh.a., në kuadër të shoqërive të reja të krijuara sipas parashikimeve të Ligjit të Sektorit të Energjisë Elektrike, proces i cili ka filluar qysh nga 1 janari i vitit 2020 dhe që duhet të shoqërohet me ndarjen funksionale dhe organizative, si dhe llogarive dhe kostove midis Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, duke mundësuar shërbim të sigurtë, transparent dhe me cilësi të klientëve fundorë, do të jetë në fokusin e punës në vitin në vijim.

Për këtë një bashkërendim i duhur me Ministrinë e Linjës, në rolin e pronarit, palët e interesit si dhe aktorët ndërkombëtarë si Sekretariati i Energjisë në Vienë vlerësohet mëse i domosdoshëm për funksionimin në vijësi të këtij procesi të rëndësishëm. Në këtë prizëm është i rëndësishëm dhe përpilimi dhe miratimi i programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

- **Zbatimi i Planit strategjik për reformat në sektorin elektroenergjetik**

Zbatimi i planit të masave miratuar me VKM-në Nr.742, dt. 12/12/2018 “Për miratimin e planit strategjik për reformimin e Sektorit të Energjisë në Shqipëri”, i cili hap prespektivën dhe mundësinë e pranimit të ofertës publike për OSHEE-në, mbetet një ndër detyrat kryesore në të cilat ERE është tërësisht e angazhuar. Nëpërmjet vendosjes së targetave për zbatimin e këtij plani, sipas detyrave të vendosura në VKM, nga ana e ERE-s në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë si dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, monitorohen periodikisht nëpërmjet “Komitetit Drejtues” të ngritur në këtë kontekst, arritjet e targetave dhe zbatimi i planit të masave nga të gjitha palët.

- **Impakti i Burimeve të Rinovueshme në treg**

Rritja e numrit të impakteve të prodhimit të Energjisë Elektrike nga burimet e rinovueshme si centralet fotovoltaike, hidro apo dhe kërkesat për ndërtimin e atyre me erë, ka sjellë si prerogative përgatitjen e kuadrit ligjor dhe rregullator për absorbimin e tyre si dhe uljen e kostove apo dhe shpërndarjen e drejtë të tyre tek të gjithë klientët, jo vetëm ata fundorë.

Në këtë prizëm bashkëpunimi me Ministrinë e Linjës si dhe me aktorët e tjerë të rëndësishëm të sektorit, për përgatitjen e këtij kuadri Ligjor dhe metodologjisë së përlllogaritjes së çmimit të tyre, duke marrë në konsideratë dhe krijimin e Bursës së Energjisë Elektrike gjatë vitit 2020, do të marrë vëmendjen e duhur nga ana jonë. Ku një pjesë e veçantë do të kushtohet të drejtave dhe detyrimeve të operatorëve ndaj prosumersave, kërkesat e të cilëve kanë ardhur duke u rritur përgjatë vitit 2019.

- **Miratimi dhe zbatimi i strategjisë për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë, në përputhje me direktivën e BE-së “Mbi sigurinë e sistemit dhe sistemeve informatike”.**

BE ka miratuar Direktivën Nr. 2016/1148 “Mbi Sigurinë e Sistemit dhe Sistemeve Informatike” (NIS) e njohur ndryshe dhe si Direktiva mbi Cybersecurity. Duke qënë se zbatimi i kësaj direktive është i një rëndësie të veçantë për Komunitetin e Traktatit të Energjisë së Vendeve të Evropës Juglindore, pjesë e së cilës është dhe Shqipëria, nga ana e Sekretariatit të Energjisë, po ashtu dhe nga ana e USAID me ndihmën e NARUC, janë duke u zhvilluar me Rregullatorët dhe Operatorët

Rajonal dhe ato të Detit të Zi, të cilët kanë pasur eksperiencën në këtë drejtim, grupe pune për mbledhjen e informacioneve lidhur me masat e marra dhe përpilimin e strategjive kombëtare për zbatimin e kësaj direktive.

Në përputhje me detyrat e vendosura në Rezolutën e Kuvendit për veprimtarinë e ERE për Vitin 2018, Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 235 datë 20.12.2019 vendosi mbi fillimin e procedurave për miratimin e “Strategjisë për infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë elektrike”, e cila është në procesin e miratimit, pas konsultimit dhe me komentet e përcjella nga ana e USAID. Hartimi dhe zbatimi i një rregulloreje sa më të plotë mbi sigurinë kibernetike në infrastrukturën sensitive në sektorin e energjisë është një element që do të ndikojë në rritjen e sigurisë së operimit të sektorit në përgjithësi dhe sistemit elektroenergjetik në veçanti. Kompanitë publike të gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike kanë në funksion struktura sensitive të tilla si sistemi SCADA, për të cilat aktualisht aplikojnë disa standarte të sigurisë kibernetike. Miratimi dhe zbatimi i një strategjie për sektorin e energjisë do të përcaktonte kritere dhe standarte të mjaftueshme për të gjithë subjektet dhe do të krijonte kushte për një kordinim më të mirë në drejtim të ruajtjes së sigurisë dhe integritetit të sistemit elektroenergjetik Shqiptarë.

- **Paketa e Energjisë së Pastër.**

Paketa e Energjisë së Pastër është miratuar tashmë me Direktivat e BE-së, e cila së shpejti do të jetë e detyrueshme dhe për vendin tonë, sipas parashikimeve dhe detyrimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Paketa e katërt energjetike, e ashtuquajtuara Paketa e Energjisë së Pastër, ka në fokus kryesor të drejtat e klientëve, nëpërmjet vendosjes së këtyre të fundit tashmë jo vetëm si konsumatorë të mirëfilltë, por duke i bërë pjesë përbërës të tregut.

Nëpërmjet parashikimeve, të cilat lidhen me rolin e tyre në treg si prosumers apo dhe nëpërmjet krijimit të komuniteteve energjetike, të cilat përmbledhin në to vetëprodhues, klientë, prosumersa etj., i jepet një përmasë tjetër tashmë klientëve.

Në po këtë prizëm paketa përcakton më tej rolet e Operatorëve të Transmetimit dhe atyre të shpërndarjes, si dhe operatorëve të bursave energjetike në Evropë, duke mbështetur më tej bashkimet e tregjeve të një dite më parë apo dhe atyre intraday, por duke përcaktuar po ashtu detyrime ndaj operatorëve për të qënë më të fokusuar në drejtim të tregut përsa i takon operimit ndërkufitar, ndër të tjera në bashkëpunimin ndërkufitar të shërbimeve ndihmëse dhe krijimit të një tregu ndërkufitar të balancimit.

Duke qënë se paketa në fjalë do të jetë shumë shpejt e zbatueshme dhe në vendin tonë, nga ana e Rregullatorit, deri në hyrjen në fuqi të këtij legjislacioni, do të kihet në vëmendje miratimi i akteve të cilat të mos bien ndesh ose të jenë mundësisht sa më afër këtij legjislacioni si dhe përgatitja për zbatimin e tij në vijim.

- **Zbatimi i Mekanizmit të Tregut të Balancimit dhe Garantimi i Shërbimeve Ndihmëse**

Për të mundësuar operimin e një tregu të liberalizuar dhe funksional të energjisë elektrike, është e domosdoshme krijimi i tregut të balancimit dhe shërbimeve ndihmëse bazuar në praktikën më të mira Evropiane, duke mundësuar dhënien e shërbimit nga prodhuesit në baza tregu, për të reflektuar në mënyrë sa më efektive dhe reale kostot e këtij shërbimi. Po ashtu ky do të shërbejë dhe për disiplinimin e operatorëve të tregut gjatë operimit në sistem.

Ngritja e një tregu të tillë është domosdoshmëri dhe kusht për funksionimin e bursës së Energjisë Elektrike në vend. Një treg i tillë si bashkimi apo dhe tregtimi në tregjet rajonale do të mundësonte dhe përfitime financiare për gjeneruesit e energjisë elektrike në vendin tonë në përgjithësi dhe të

kompanisë publike KESH sh.a. në veçanti, duke parë teknologjinë e centraleve, duke qënë ndër të vetmit në rajon të cilët kanë mundësi teknike operimi në këtë treg. Po ashtu vënia në operim e HEC Moglicë sëbashku me HEC-e të tjera rrit oportunitetin dhe konkurrencën për ofrimin e këtij shërbimi jo vetëm në vendin tonë, por edhe në rajon.

Tregu në fjalë do të mundësojë po ashtu dhe trajtimin e barabartë të prodhuesve të energjisë elektrike të cilët me funksionimin e treut sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjive nga burime të rinovueshme” do të jenë palë përgjegjëse balancuese dhe do të marrin detyrimet që rjedhin nga krijimi i këtij tregu, ku roli i ERE-s nuk do të jetë vetëm për miratimin e rregullave të tregut të balancimit, por dhe më tej në monitorimin e zbatimit të tyre nga ana e OST.

• **Platforma Online e Krahasimit të Çmimeve të Furnizuesve**

Me hapjen dhe liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, për të mundësuar marrjen e një informacioni nga ana e klientëve lidhur me çmimet e energjisë elektrike të ofruar nga ana e furnizuesve të ndryshëm, privatë apo publikë, me financim dhe mbështetje të USAID, është menduar ofrimi në faqen e internetit të ERE-s së një platforme ku furnizuesit do të bëjnë publike çmimet e ofruara për klientët si dhe një sërë të dhënash të tjera.

Qëllimi kryesor i krijimit të Platformës Online të Krahasimit të Çmimeve është të ndihmojë klientët në zgjedhjen e furnizuesit të energjisë elektrike në mënyrë transparente dhe ti bëjë ata me dije cilat janë çmimet që ofrohen. Platforma u mundëson klientëve të krahasojnë ofertat e mundshme nga furnizuesit me pakicë të energjisë elektrike, si dhe të marrin informacion të qartë, gjithë përfshirës dhe të përditësuar për çmimet e energjisë elektrike, kohë zgjatjen e kontratës së furnizimit, faturimin dhe shërbime të tjera në lidhje me furnizimin me energji elektrike apo dhe mundësinë e zgjedhjes së energjisë së pastër.

Platforma ofron informacione të tjera të dobishme për klientët, në mënyrë që të kuptojnë më mirë se si funksionon tregu i energjisë elektrike, cilat janë të drejtat dhe detyrimet e tyre, etj.

Implementimi i kesaj platforme krijon kushte më të mira dhe ofron transparencë për daljen në treg të klientëve fundor të energjisë elektrike. Kjo platforme do të jetë një vlerë e shtuar në rritjen e cilësisë dhe të konkurrencës në treg.

Platforma është implementuar tashmë në disa vende të rajonit dhe është mbështetur nga shoqatat e konsumatorëve dhe të furnizuesve në rajon. Me mbështetjen e USAID, platforma synohet të vihet në funksion brënda vitit 2020.

• **Vijimi i Proceseve të Punës për Krijimin e Tregut të Përbashkët të Energjisë Elektrike**

Tregu i përbashkët Shqipëri - Kosovë është një ndër hapat e nevojshëm për krijimin e tregut rajonal të energjisë elektrike. Krijimi i këtij tregu do të përmirësojë sigurinë e furnizimit me energji elektrike për dy vëndet tona, duke marrë në konsideratë faktin se dy vëndet tona kanë sisteme komplementare të prodhimit të enegjisë elektrike. Prodhuesit e energjisë elektrike të cilët kanë Hidrocentrale me basën dhe vecanerisht kompania publike KESH sh.a. mund të relizojnë ofrimin e shërbimit të balancimit dhe të shërbimeve ndihmëse jo vetëm për dy vëndet tona por edhe më gjerë. Pjesëmarrja në tregun e balancimit dhe të shërbimeve ndihmëse do të sjell përfitime më të medha dhe optimizim të shfrytëzimit për këto prodhues të energjisë elektrike.

Integrimi i tregjeve ndikon ndjeshëm në rritjen e konkurrencës së shitjes së energjisë elektrike në tregun me shumicë, dhe për rrjedhojë mund të sjellë dhe ulje të çmimeve të energjisë elektrike në tregun me pakicë. Në mënyrë që të vijohet me integrimin e tregjeve ndërmjet vendeve tona, është e nevojshme vijimi i harmonizimit të legjislacionit dhe të akeve rregullatorë sekondarë në mënyrë që të eliminohen pengesat që mund të dalin në këtë drejtim.

Në këtë kuadër me ndihmën po ashtu të USAID, grupet e punës tashmë të ngritura me përbërjen e Ministrive, rregullatorëve apo dhe Operatorëve të Sistemit janë duke punuar në këtë drejtim. Po ashtu operimi i të dy sistemeve, si një zonë e vetme kontrolli sipas marrëveshjes së nënshkruar tashmë në fund të vitit 2019 ndërmjet dy operatorëve të sistemit, me bekimin dhe të të dy rregullatorëve, është një hap i rëndësishëm në drejtim të bashkimit të tregjeve dhe optimizimit të kapaciteteve të interkonjeksionit.

Në po këtë kuadër bashkimi i tregjeve të energjisë elektrike me Malin e Zi, Serbinë dhe Italinë është ndër projektet që po ndiqet në bashkëpunim dhe me Sekretariatit e Energjisë në Vienë dhe do ti shërbejë bashkimit të tregjeve të Evropës Juglindore me tregjet e BE-së. Grupet e punës të ngritura tashmë midis TSO-ve, Rregullatorëve dhe Bursave të Energjisë Elektrike janë duke vijuar punën për përpilimin e studimin, për rishikimin e legjislacionit primar dhe sekondar për mundësimin e bashkimit të këtyre tregjeve si dhe hapave që duhen ndërmarrë për funksionimin e tij. Projekti është më tej interes për operatorët e tregut në vëndin tonë, pasi me vënien në punë të linjës nënujore midis Italisë dhe malit të zi, e cila është tashmë operative prej fundit të vitit 2019, krijohen mundësira për tregtimin e energjisë elektrike në vendet e BE-së, fakt që do të shërbejë në optimizimin e portofolit të tyre.

• **Liberalizimi i mëtejshëm i tregut të Energjisë Elektrike dhe Krijimi i Bursës së Energjisë**

Janë hedhur hapa konkrete për liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, sa i përket krijimit të kushteve teknike dhe të kuadrit nënligjor e rregullator për daljen në treg të hapur edhe për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilët dalin në treg të lirë në Mars të vitit 2020 dhe nga kjo datë nuk mund të furnizohen më nga ana e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, me përjashtim të rrethanave që lidhen me kërkesat e Nenit 86 të ligjit të sektorit të Energjisë Elektrike. Në këtë prizëm gjatë vitit 2020 do të vijohet me plotësimin e kushteve për daljen në treg të klientëve të lidhur në tensionet 20, 10 dhe 6 kV, për të vijuar më tej me klientët e lidhur në tension të ulët.

Po ashtu me daljen e VKM-së Nr. 609 dt. 11.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes së pjesmarrësve në Operatorin e Tregut” janë përmbushur tashmë kushtet ligjore për fillimin e procesit të krijimit dhe operimit funksional të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe procedura e përzgjedhjes së aksionerëve të bursës. Nga ana tjetër kriterët e vendosura, të cilat përcaktojnë se, në operimin e Bursës do të kontraktohet një ofrues shërbimi me eksperiencë ndërkombëtare në këtë fushë, do ti japë reputacion kësaj të fundit për të ofruar operatorë tregu cilësor.

Krijimi dhe operimi i bursës do ti japë mundësi si operatorëve të tregut, prodhuesve, furnizuesve, tregtarëve ashtu dhe klientëve të kenë një çmim referues mbi të cilin mund të operojnë si dhe hap mundësinë e operatorëve të tregjeve fqinje për të operuar në tregun Shqiptar.

Në këtë prizëm, për të mundësuar njohjen e bursës së re, që do të krijohet në komitetet e bursave të vendeve të BE-së, Bordi i ERE me Vendimin Nr. 240, datë 23.12.2019, në mbështetje të Neneve 16 dhe 57 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, VKM Nr. 322, datë 15.05.2019 “Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së

kapitalit të Operatorit të Tregut”, filloi procedurën për miratimin e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të energjisë elektrike (NEMO) dhe rolet dhe përgjegjësitë e NEMO- s dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të energjisë në Tregun e Bashkuar. Proçedurë kjo e finalizuar me miratimin e kësaj rregullore me Vendimin Nr.40 datë 06.03.2020.

- **Montorimi dhe përditësimi i zbatimit të planit të masave për OSHEE për mbrojtjen e konsumatorit**

Një vëmendje e caktuar i duhet kushtuar implementimit të planit të masave për OSHEE sh.a. në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit si dhe azhurnimit të tij në funksion të problematikave që kanë dalë përgjatë zbatimit të tij në terren, duke u fokusuar në zgjidhjen e ankesave të klientëve në një kohë sa më të shkurtër dhe me përgjegjësi të plotë si dhe duke konsideruar realizimin tanimë të ndarjes ligjore të Oshee sh.a..

Krijimi i një platforme të përbashkët me FSHU-në, e cila do të mundësonte ndjekjen në mënyrë reale të ecurisë së ankesave/kërkesave, si dhe monitorimin e tyre nga ERE për të cilën ka pasur një angazhim të USAID për mundësinë e financimit të saj dhe hapat e mëtejshëm të implementimit janë duke u trajtuar nga ana jonë në bashkëpunim dhe me FSHU-në.

- **Krijimi i tregut të Garancive të Origjinës**

Në funksion të zhvillimit dhe shfrytëzimit me efikasitet të burimeve energjitike të rinovueshme, është e nevojshme dhe krijimi i një tregu funksional të garancive të origjinës. Në këtë kontekst ERE ka miratuar tashmë Rregulloren e veçantë mbi lëshimin e këtyre garancive, e cila synon përcaktimin e një sistemi të saktë, të besueshëm e të mbrojtur për lëshimin, procedurat e transferimit dhe revokimin e garancive të origjinës. Qëllimi i kësaj rregullore është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent, për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, të cilët paraqesin në ERE aplikimin për Garancinë e Origjinës ose që janë subjekt i transferimit apo revokimit të saj.

Garancia e Origjinës është një dokument, i cili ka funksion të vetëm që t’i provojë konsumatorit përfundimtar se një pjesë ose e gjithë sasia e dhënë e energjisë së konsumuar prej tij është prodhuar prej burimeve të rinovueshme.

Krijimi i këtij tregu të garancive të origjinës do të rriste vlerën e investimeve të bëra në vendin tonë, për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme si dhe mundësinë e njohjes së tyre në vendet fqinje duke marrë parasysh edhe orientimin e politikave në nivel kombëtar, por edhe të atyre të Bashkimit Evropian.

- **Studimi i zgjidhjeve dhe përgatitja e propozimeve përkatëse për shuarjen e detyrimeve reciproke**

Aktualisht detyrimet e prapambetura financiare midis operatorëve publik të sektorit të Energjisë Elektrike kanë marrë përmasa të mëdha, sidomos faktit që viti që lamë pas ishte një vit i vështirë hidrologjik, kjo vlen dhe për detyrimet që klientët, kryesisht ata buxhetorë kanë në drejtim të OSHEE group për faturat e Energjisë Elektrike, duke e vënë këtë të fundit në një situatë të vështirë financiare. Zgjidhja përfundimtare e tyre dhe gjetja e rrugëve dhe mënyrave për moskrijimin e tyre

në të ardhmen me mbështetjen dhe të Minitrisë së Linjës si dhe asaj të Financave dhe Ekonomisë dhe Këshillit të Ministrave është mëse e domosdoshme dhe mbetet problematike.

Në përputhje me zhvillimet e tregut të energjisë dhe legjislacionit që rregullon këtë sektor, puna e ERE-s do të fokusohet gjithashtu në drejtim të:

- shqyrtimit dhe analizimit me rigozitet dhe duke balancuar interesat e palëve të interesit dhe aplikuesve, të aplikimeve për tarifë, i operatorëve të transmetimit, shpërndarjes dhe gazit natyror apo dhe furnizimit të shërbimit universal dhe furnizimit të mundësisë së fundit;
- shqyrtimit dhe analizimit të planeve të investimit si dhe monitorimi i zbatimit të tyre për të orientuar investime të kujdesëshme në sektor, në përputhje me parimin e koston më të ulët, efikasitet dhe gjëndjes financiare të shoqërive publike;
- Sigurimin e informacion dhe raportimeve periodike pranë Kuvendit, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe siç përcaktuar në rezolutën respektive apo aktet e tjera të këtij të fundit;
- plotësimin e kuadrit ligjor me legjislacionin sekondar në funksion të Vendimeve të Këshillit të Ministrave në zbatim të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike”, ndryshimeve që ligji ka pasur apo që priten të ketë si dhe krijimin e terrenit të përshtatshëm për ngritjen dhe zhvillimin e sektorit të gazit natyror ERE, për përafrimin e kuadrit ligjor me legjislacionin europian si dhe lehtësimin e procedurave për ushtrimin e këtij aktiviteti;
- monitorimi i zbatimit të legjislacionit në fuqi nga ana e të licencuarve, duke evidentuar nevojën për ndërhyrje në kuadrin rregullator në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së të licencuarve, në kushte jodiskriminuese e transparente, por duke qënë njëkohësisht i gatshëm për të tuteluar në çdo rast të drejtat e klientëve të energjisë elektrike;
- angazhimin e një bashkëpunimi të vazhdueshëm me të gjithë pjesëmarrësit e tregut dhe grupet e interesit me qëllim adresimin dhe gjetjen e zgjidhjeve që balancojnë, për aq sa është e mundur interesat e palëve në proceset vendimmarrëse të ERE;
- vijimin i lehtësimit të procedurave të licencimit të pjesëmarrësve të tregut në përputhje me Rregulloren e licencimit e miratuar tashmë, për njohjen reciproke të licencave në vendet e traktatit të energjisë;
- bashkëpunimi me institucionet e tjera vendimmarrëse në vend, në kuadër të implementimit të kushteve të çertifikimit të operatorëve të transmetimit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror;
- bashkëpunimi në nivel rajonal dhe në kuadër të organizmave rregullator ndërkombëtarë ku aderojmë, duke rritur rolin aktiv në to;
- vijimi i projekteve të përbashkëta, të tillë si vijimi i punës në kuadër të, fazës së tretë të projektit KEP (Know-How Exchange Program) kushtuar shkëmbimit të aftësive rregullatore drejt zonës ballkanike, i cili ka vijuar gjatë vitit 2019 dhe do të shtrihet dhe me Bullgarinë dhe Maqedoninë e Veriut përgjatë vitit 2020.

MBI REKOMANDIMET E PROGRESRAPORTIT TË BE.

ERE ka informuar periodikisht, në kuadër të raportimeve për Nënkomitetin e Transportit, Mjedisit, Energjisë dhe Zhvillimit rajonal, lidhur me rekomandimet e progresraportit të BE për vitin 2019 si më poshtë

Për ndarjen e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes:

Në përfundim të periudhës tranzitore prej 12 muajsh, në fund të vitit 2019, të miratuar nga ERE, për bërjen efektive të transferimit të licencës, për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSHEE tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a dhe transferimin e licencës për furnizimin e energjisë elektrike dhe detyrimin të shërbimit universal për furnizimin me energji elektrike nga OSHEE tek “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a, nga data 1 janar 2020, shoqëritë e krijuara nga OSHEE, ushtrojnë të ndara në përputhje me licencat e dhëna aktivitetet e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, furnizimit dhe detyrimin të shërbimit universal për furnizimin me energji elektrike të klientëve.

GAZI: Ndarja e OST – Ndjekja e çertifikimit të kompanisë Albgaz

1. Bordi i ERE miratoi me Vendimin Nr. 221 datë 20.12.2019 “Mbi disa ndryshime në Vendimin e Bordit të ERE Nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz sh.a.” të ndryshuar”.
Sipas këtij Vendimi, ERE miratoi
 - Të shfuqizojë pikën 2 të Vendimit të Bordit të ERE Nr. 63, datë 23.04.2019;
 - Të shtyjë afatin për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën 3 të Vendimit të Bordit të ERE Nr. 63, datë 23.04.2019 deri në 20.06.2020;
 - Të shtyjë afatin për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën 4 të Vendimit të Bordit të ERE Nr. 63, datë 23.04.2019 deri në 20.12.2020;
 - Albgaz sh.a të paraqesë në ERE deklaratat e audituesve financiarë dhe pasqyrat financiare të shoqërisë çdo vit ushtrimor.
 - Albgaz sh.a. të marrë masa brenda datës 20.06.2020 lidhur me zbatimin e ndarjes së pronësisë në përputhje me parashikimet e Nenit 36 pika 2 gërma “a” dhe “b” të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar;
 - Nëse ndarja e pronësisë së Albgaz sh.a. nuk është bërë sipas Nenit 36 pika 2 gërma “a” dhe “b” të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, brenda datës 20.06.2020, ERE ka të drejtë të rishikojë Vendimin Nr.179, datë 08.11.2017, “Për çertifikimin e shoqërisë “Operatori I Kombinuar i Gazit Natyror” Albgaz sh.a

Ky vendim është marrë pasi është vlerësuar që shoqëria Albgaz sh.a ka ndjekur vazhdimisht procedurat e kërkuara dhe ka njoftuar ERE-n lidhur me masat e ndërmarra nën tagrin e saj për përmbushjen e kushteve të përcaktuara tek vendimi i çertifikimit. Konkretisht, Albgaz ka raportuar në ERE se deri më tani ka plotësuar kushtet e përcaktuara në vendimin e çertifikimit, si më poshtë vijon:

2. Kushtin për raportimin çdo muaj në ERE procedurën për regjistrimin e aseteve të transmetimit dhe përfundimin e kësaj procedure, ku nëpërmjet shkresës Nr. 51 Prot, datë 17.05.2019, shoqëria Albgaz sh.a ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar, në të cilin rezulton se ky kusht është plotësuar tërësisht nga shoqëria.

3. Kushtin për Pavarësinë e Auditueseve Financiarë, i cili nënkupton që audituesi financiar nuk mund të jetë i njëjti subjekt që kryen detyra ose kryen auditimin e ndërmarrjeve/sipërmarrjeve që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror. Për sa më sipër, shoqëria Albgaz sh.a., ka përcjellë pasqyrat financiare të vitit 2018, së bashku me deklaratat e audituesve financiarë, të cilët janë të ndryshëm nga ata të emëruar e që kryejnë këtë veprimtari për Albpetrol sh.a.
4. Pjesërisht kushtin lidhur me caktimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë subjekt i miratimit nga ERE, si dhe hartimin dhe dorëzimin në ERE të raportit të përcaktuar sipas Programit të Përputhshmërisë rregullatore. Në vijim të përcaktimit të Zyrtarit të Përputhshmërisë, miratuar nga ERE, shoqëria Albgaz sh.a ka bërë me dije ERE-n se Programi i përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror” është miratuar nga Këshilli mbikëqyrës i shoqërisë me Vendimin nr.18, datë 04.11.2019, por gjatë vendimmarrjes së ERE nuk ishte plotësuar kushti mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë Albgaz sh.a, siç përcaktuar në pikën 2 të vendimit të lartpërmendur, ku citohet se ai hyn në fuqi pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme.

Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike

Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, klientët e energjisë elektrike të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, deri në fund të muajit Mars 2020 kanë përfunduar procesin e daljes në tregun e liberalizuar të energjisë dhe nuk do të mund të furnizohen më nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Nga ky proces, përjashtohen subjektet e përcaktuara në pikën 4.2 të Nenit 5 të “Kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, miratuar me VKM Nr. 244, datë 30.03.2016, e ndryshuar, ku përcaktohet se: *“për qëllime të interesit publik, Furnizuesi i Shërbimit Universal, në kuadër të shërbimit publik, siguron pa ndërprerje furnizimin e klientëve si më poshtë.*

- *Subjektet shtetërore që sigurojnë shërbimin e shëndetit publik (spitalet dhe qendrat e emergjencës);*
- *Shoqëri që sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve;*
- *Institucionet shtetërore të ekzekutimit të vendimeve penale dhe institucionet shtetërore”.*

Mbështetja e burimeve të rinovueshme të energjisë, në kuadër të diversifikimit të burimeve të prodhimit të energjisë elektrike

Në zbatim të detyrimeve që burojnë nga përcaktimet e ligjit nr. 7/2017 “Per nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE gjatë vitit 2019 ka miratuar çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, në përputhje me “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të miratuar me Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 687, datë 22.11.2017, si dhe ka miratuar çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhura nga centralet fotovoltaike për vitin 2018.

Gjithashtu, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga përcaktimet e Ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe në kuadër të promovimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, Enti Rregullator i Energjisë:

- Me Vendimin e Bordit Nr. 229, datë 20.12.2019, ka miratuar “Rregulloren për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”;
- Me Vendimin e Bordit Nr. 234, datë 20.12.2019, ka miratuar disa shtesa në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin Nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin Nr. 177, datë 08.11.2016 të bordit të ERE-s, si aneks 3 “Tarifat për lidhjet e reja me sistemin e shpërndarjes e vetëprodhuesve të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total të instaluar deri në 500 kwp” për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total deri në 500 kW.

1. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

1.1 STRUKTURA E SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK

Sistemi elektroenergetik në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga: prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja e Energjisë Elektrike me qëllim furnizimin e klientëve. Secili nga këto aktivitete ushtrohet nga subjekte të licencuara në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar. Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëritë publike KESH sh.a. dhe Hec Lanabregas sh.a. me 100% të aksioneve shtetërore, si dhe nga subjektet private të licencuara në këte aktivitete. Transmetimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a, e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore, e licencuar për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Shpërndarja e energjisë elektrike realizohet nga shoqëria “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a, e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore, e licencuar për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Në figurat e mëposhtëme paraqitet Skema e Sistemit Elektroenergetik Shqiptar si dhe Skema e Fluksit të Energjisë Elektrike dhe Tregtare

SKEMA E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK




Figura 1 Skema e Sistemit Elektroenergjetik (Burimi: ERE)




Figura 2 Skema e Fluksit të Energjisë dhe Tregtar (Burimi: ERE)

1.2 PRODHIMI I ENERGISË ELEKTRIKE

Prodhimi i Energjisë Elektrike në vendin tonë realizohet si një aktivitet i licensuar nga ERE, bazuar në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Aktualisht prodhimi i energjise elektrike përbëhet nga dy komponent kryesor. Prodhimi që realizohet nga Shoqëria publike KESH sh.a. dhe prodhimi që realizohet nga subjektet e tjera të licensuara për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

KESH sh.a. është shoqëria më e madhe prodhuese e energjisë elektrike në Shqipëri, me kapital tërësisht shtetëror. KESH sh.a. është e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për furnizimin me Energji Elektrike të Furnizuesit Universal sh.a. dhe mbulimin e humbjeve të Energjisë Elektrike në rrjetin e Shpërndarjes, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 244 datë 30.03.2016, e ndryshuar.

Shoqëritë e tjera prodhuese të energjisë elektrike janë subjekte private, të tilla si prodhuesit me përparësi dhe ato të pavarur të energjisë elektrike, si dhe HEC Lanabregas. Këto subjekte të licensuara në vite nga ERE shfrytëzojnë centralet ekzistuese apo të reja, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të koncesionit apo kontratave për shfrytëzimin dhe administrimin e impianteve prodhuese të Energjisë Elektrike. Këto kontrata janë të nënshkruara me Qeverinë Shqiptare si dhe Autoritete të tjera përgjegjëse të përcaktuara me ligj, po ashtu dhe disa prej centraleve prodhuese që operohen në kuadër të marrëveshjeve të privatizimit. Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i instaluar në vendin tonë deri në 31 Dhjetor 2019 është 2,275 MW. Ky kapacitet ka pasur një nivel rritje në vitin 2019 prej 71MW, krahasuar me vitin 2018.

Kapaciteti total prodhues i energjise elektrike i kompanisë publike KESH sh.a. është 1448 MW dhe përbën rreth 63.47% të fuqisë totale të instaluar në vendin tonë.

Kapaciteti total i instaluar i prodhuesve të tjerë të energjisë elektrike është 827 MW dhe përbën rreth 36.53% të fuqisë totale të instaluar në vendin tonë.

1.2.1 Prodhimi total i energjisë elektrike për vitin 2019

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2019 është **5,206,043** MWh.

2,979,252 MWh u prodhua nga centralet në zotërim të kompanisë publike KESH sh.a.

2,226,794 MWh u prodhua nga centralet e tjera.

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a. zë 57.3 % të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë dhe prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë zë 42.7%.

Centralet e prodhimit të energjisë elektrike janë të lidhura si në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike ashtu dhe në rrjetin e shpërndarjes. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2019 është rreth **1,995** MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë **4,537,484** MWh. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2019 është rreth **280** MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë **668,562** MWh.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT 2019		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar	Prodhimi 2019
P.Pub	Prodhues Publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit Publik)	Lidhur në OST	1	4	1,448	2,979,252
P.Pav	Prodhues të Pavarur	Lidhur në OST	3	7	252	741,595
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OST	28	45	295	816,637
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	100	137	265	646,366
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	8	8	15	22,196
			140	201	2,275	5,206,046

Figura 3 Të dhëna mbi prodhuesit për vitin 2019.

Në figurën më poshtë paraqitet prodhimi neto vendas për Vitin 2019 duke evidentuar kontributin në prodhimin e energjise elektrike të KESH sh.a., si prodhuesi i vetëm publik si dhe kontributet e prodhuesve të tjerë Privat/me Koncesion. Prodhimi i realizuar nga kompania publike KESH sh.a., vazhdon të ketë peshën kryesore në prodhimin vendas dhe për Vitin 2019.

PRODHIMI NETO VENDAS 2019 (MWh)	2019
Hec-et e lidhur në rrjetin e OSHEE	612,995
Hec-et e lidhur në rrjetin e OST	625,142
HEC Lanabregas	33,368
Prodhimi Neto Kurum	330,742
HEC Ashta	191,495
HEC Peshqesh	91,100
HEC FANGU	166,396
HEC Banje	153,357
Centrale Fotovoltaikë	22,196
Prodhimi Neto KESH.	2,979,252
TOTAL VENDAS 2019	5,206,043

Burimi OST sh.a




Figura 4 Prodhimi neto vendas për vitin 2019.




Figura 5 Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2019 (MWh)

Figurat më poshtë paraqesin krahasimin e prodhimit mujor neto pergjatë vitit 2019 me mesataren e prodhimit të periudhës 2009 – 2019.




Figura 6 Prodhimi mujor vendas për vitin 2019 krahasuar me mesataren e periudhës 2009-2019




Figura 7 Prodhimi neto vendas historik për periudhën 2009-2019

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend rezulton se viti 2019 me sasinë e prodhuar prej 5,206 GWh, ka shënuar një rënie krahasuar me mesatarën e prodhimit të energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2019. Mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2019 është 5,892 GWh. Prodhimi i realizuar për Vitin 2019 rezulton rreth 11.6 % më i ulët se mesatarja e prodhimit për periudhën 2009 – 2019.

Prodhimi maksimal mujor i energjisë elektrike për Vitin 2019, është shënuar në muajin Dhjetor me sasinë **769,297 MWh**. Ky prodhim është realizuar nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a. në masën deri 56.4 %. Prodhimi mujor minimal i energjisë elektrike gjatë Vitit 2019 është realizuar në muajin Tetor në sasinë **256,425 MWh**.

Në grafik vihet re se Viti 2019 konsiderohet si një vit jo i mirë hidrologjik, kjo për faktin se pavarësisht rritjes së kapaciteteve prodhuese përgjatë Vitit 2019, prodhimi i energjisë elektrike për këtë vit ka rezultuar në sasinë **5,206 GWh**, pra 686 GWh më pak se prodhimi mesatar i energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2019. Duke marrë në konsideratë faktin se vendi ynë e bazon prodhimin e energjisë elektrike kryesisht në burimet hidrike, në vitet jo të mira hidrologjik ku futet edhe Viti 2019 prodhimi i energjisë elektrike është më i ulët se mesatarja shumë vjeçare në periudhën 2009 – 2019.

1.2.2 Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese publike për vitin 2019

Prodhimi publik i energjisë elektrike kryhet nga shoqëria aksionere KESH sh.a. me 100% të aksioneve shtetërore. Shoqëria KESH sh.a ka në zotërim tre hidrocentralet e kaskadës së Lumit Drin si dhe termocentralin e Vlorës. Përbërja e grupit të centraleve të zotëruara nga KESH sh.a dhe fuqia e instaluar e secilit prej tyre, të cilët realizojnë prodhimin publik është paraqitur në tabelë.

Karakteristikat e Centralit	Centralet Prodhuese Publike			
	HEC Fierzë	HEC Koman	HEC V.Dejës	TEC Vlorë
Nr. Agregateve.	4	4	5	2
Fuqia e Agregateve. MW	125	150	50	70 + 28
Fuqia Instaluar e centralit MW	500	600	250	98
Fuqia Totale MW	1,448			

Figura 8 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.)

Fuqia e përgjithshme e instaluar në zotërim nga KESH sh.a., arrin në 1,448 MW, nga të cilat fuqia e instaluar e HEC-ve në kaskadën e lumit Drin është 1,350 MW dhe e TEC Vlorë 98 MW.

Prodhimi neto nga centralet prodhuese të KESH sh.a për Vitin 2019 rezulton të jetë 2,979,252 MWh, e cila përbën 57.3% të prodhimit neto total vendas përgjatë këtij viti. Ky prodhim është realizuar në masën 1 415 GWh nga HEC Koman, 845 GWh nga HEC Fierza dhe 727 GWh nga HEC Vau i Dejës.




Figura 9 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (Burimi: OST sh.a.)

Prodhimi maksimal i enegjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a. për periudhën 2009 – 2019 është arritur në vitin 2010 në sasinë 7 014 GWh. Prodhimi i energjisë elektrike i vitit 2010 është 2.3 herë më i lartë se prodhimi i energjisë elektrike i arritur në vitin 2019 i cili rezulton në sasinë 2 987 GWh. Ky tregues, paraqet në mënyrë të qartë shkallën e lartë të riskut hidrologjik në

stabilitetin e prodhimit të Energjisë Elektrike në vendin tonë, i cili e bazon prodhimin e energjisë elektrike kryesisht në burime hidrike.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të detajuar prodhimi mujor i energjisë elektrike nga hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin në administrim të KESH sh.a.




Figura 10 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2019 (Burimi: KESH sh.a. , OST sh.a.).

Prodhimi maksimal i KESH sh.a. është regjistruar në muajin Dhjetor në sasinë 434,747 MWh dhe minimal në muajin Prill në sasinë 96,609 MWh.

Sipas raportimeve të KESH sh.a., shfrytëzimi i rezervës hidroenergjetike ka qenë në kushte optimale. Koeficientët e ngarkimit të agregatëve të paraqitur në tabelën e mëposhtme për vitin 2019 në përqindje janë më të lartë për të tre HEC-et në kaskadën e lumit Drin krahasuar me mesataren shumëvjeçare për secilin HEC.

Ngarkesa e Agregateve	HEC Fierze	HEC Koman	HEC V.Dejes
Mesatare në (%) per vitin 2019	89	79	86.1
Mestarja Shumevjeçare (%)	85	77	85

Figura më poshtë tregon shkarkimet nga hidrocentralet gjatë vitit 2019.

DERDHJET E UJIT NGA H/C-et E KASKADËS SË DRINIT GJATË VITIT 2019 (MILION M3)												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
FIERZË	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
KOMAN	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	24
VAU DEJËS	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Figura 11 Shkarkimet e ujit pa prodhim energjie nga HEC-et e KESH sh.a gjatë vitit 2019.

Shkarkimet e ujit pa prodhim energjie nga HEC-et e kaskadës së lumit Drin rezultojnë në vlera minimale dhe kanë ndodhur vetëm gjatë muajit dhjetor 2019. Kjo periudhë ka qenë e karakterizuar nga prurjet e mëdha të ujit në basenin e HEC Koman (basen me kapacitet rezervues të vogël) dhe në zbatim të Rregullores së Shkarkimit të Plotave, në kushtet e ngarkimit maksimal të njësive prodhuese në HEC Koman, është realizuar shkarkimi i ujit pa prodhim energjie.

Në figurën 12, janë paraqitur në mënyrë grafike shkarkimet e ujit nga HEC-et e KESH sh.a në Kaskadën e lumit Drin, për secilin vit në periudhën 2002 - 2019.




Figura 12 Shkarkimet e Ujit nga H/C-et e Kaskadës së Drinit (2002-2019) (Burimi: KESH sh.a).

Më poshtë paraqitet niveli në metra i Liqenit të Fierzës për vitin 2019 në fund të çdo muaji.




Figura 13 Niveli i Liqenit të Fierzës gjatë vitit 2019 (m).

Baseni i HEC-it të Fierzës funksionon si rregullator vjetor i rezervës hidrike të lumit Drin, çka ndikon drejtpërdrejtë në shfrytëzimin e gjithë kaskadës mbi lumin Drin.

Të dhënat historike mbi nivelin e liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2019 paraqiten më poshtë duke evidentuar kuotat minimale dhe kuotat maksimale.

NIVELI FIERZES 1991-2019												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1991	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1992	278.0	274.1	268.0	278.8	281.0	279.6	275.2	268.7	263.9	271.4	281.9	280.6
1993	275.2	265.3	264.7	278.5	280.5	277.3	271.0	261.1	253.6	249.9	255.6	270.2
1994	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1995	253.8	260.3	262.5	275.3	289.0	288.7	284.5	282.2	288.2	283.8	279.9	287.5
1996	287.1	288.7	286.5	294.7	295.8	293.1	287.6	282.2	285.1	284.3	289.2	291.3
1997	289.4	284.5	281.7	285.2	294.1	292.0	287.0	280.0	272.9	272.4	270.8	277.2
1998	273.7	270.0	265.2	278.9	288.1	287.4	281.8	277.6	276.0	277.1	279.0	277.1
1999	272.7	275.6	281.5	290.5	295.9	293.3	288.3	279.5	271.0	257.6	263.6	276.9
2000	276.4	276.7	276.8	286.9	286.6	280.1	273.5	267.5	261.6	248.4	249.3	252.1
2001	253.6	258.2	275.1	282.9	287.6	283.8	273.7	271.1	269.2	263.6	263.2	252.1
2002	245.3	247.1	252.6	264.0	268.6	271.3	270.1	267.8	274.3	286.1	285.3	284.0
2003	291.1	289.5	286.3	287.0	292.3	290.3	285.9	280.8	276.0	282.6	285.6	283.3
2004	284.7	290.8	293.4	296.0	296.2	296.2	293.1	286.3	281.1	280.0	286.1	288.0
2005	281.2	281.5	293.3	296.1	295.6	294.1	286.7	277.2	266.5	256.9	253.6	279.0
2006	283.5	288.6	294.4	295.9	296.5	295.9	293.8	290.2	285.3	278.7	266.2	256.2
2007	256.1	263.7	272.0	276.8	276.8	274.8	268.5	263.6	261.8	261.1	275.8	282.1
2008	285.1	289.7	290.9	295.5	295.3	295.7	294.3	288.6	283.9	280.9	285.2	286.5
2009	283.6	281.8	283.4	292.5	293.7	292.4	288.0	281.2	276.2	271.6	266.3	280.1
2010	290.1	289.2	293.9	296.0	296.3	294.4	291.8	288.6	284.9	285.2	284.3	287.5
2011	281.6	274.4	275.0	276.6	281.0	286.1	284.7	279.0	273.9	268.2	261.6	264.5
2012	265.8	267.7	262.0	280.2	293.4	294.4	288.4	280.4	261.4	261.6	269.0	276.6
2013	278.3	281.5	294.8	296.9	296.9	294.2	289.7	283.6	280.8	281.4	282.5	276.1
2014	275.1	277.5	274.6	285.3	292.9	294.9	291.7	286.8	285.5	285.0	284.8	286.3
2015	288.7	289.4	292.2	296.3	296.1	293.3	287.5	280.1	272.1	275.4	278.9	275.9
2016	289.9	292.4	291.8	296.5	296.2	295.6	290.5	285.4	283.3	288.4	288.9	281.6
2017	271.5	277.7	280.9	278.7	281.6	272.4	270.2	268.0	271.0	264.6	269.6	289.9
2018	289.7	292.0	295.0	296.5	296.4	296.0	294.0	287.5	277.9	270.2	266.5	267.3
2019	267.3	268.2	272.7	279.9	289.9	292.7	287.6	278.5	274.2	268.6	273.2	275.6
2019	267.3	268.2	272.7	279.9	289.9	292.7	287.6	278.5	274.2	268.6	273.2	275.6
Mesatarja	274.8	276.2	278.9	286.0	290.2	289.0	284.7	279.3	275.5	273.8	275.3	278.2
Minimumi	245.3	247.1	252.6	264.0	268.6	271.3	270.1	261.1	253.6	248.4	249.3	252.1
Maksimumi	291.1	292.4	294.4	296.9	296.9	296.2	294.3	291.5	289.4	288.3	289.2	288.0

Figura 14 Niveli i Liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2019.

Më poshtë paraqitet grafikisht niveli i ujit në metra në rezervuarin e Fierzës për çdo muaj të vitit 2019, krahasuar me nivelet mesatare historike mujore për periudhën 1991– 2019.




Figura 15 Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2019.

Siç shihet,deri në muajin Maj 2019, niveli i ujit në liqenin e Fierzës ka qenë më i ulët krahasuar me nivelin mesatar historik. Në vijim niveli i ujit në liqenin e Fierzës për një periudhë dy mujore Qershor – Korrik ka qenë pak më i lartë se mesatarja shumëvjeçare duke arritur në muajin Gusht gati sa niveli mesatar dhe më pas deri në muajin Dhjetor ky nivel ka qenë nën mesataren shumëvjeçare.

Në Figurën në vijim paraqiten prurjet mesatare për vitin 2019 në Liqenin e Fierzës krahasuar me prurjet mesatare historike për çdo muaj.




Figura 16 Prurjet mesatare mujore (m³/sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2019 krahasuar me mesataren historike.

Gjatë vitit 2019 prurjet e ujit janë përgjithësisht nën mesataren historike (ku më të lartat rezultojnë në muajin Maj me rreth 221 m³/sek).

Në grafikun e figurës që vijon është paraqitur shfrytëzimi i rezervës hidroenergjetike në Kaskadën e lumit Drinit gjatë vitit 2019.




Figura 17 Rezerva Energjetike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2019 (Burimi: KESH sha).

Rezerva hidroenergjitike e kaskadës së lumit Drin administrohet nga KESH sh.a. bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Optimizim i portofolit të KESH sh.a., dhe të sektorit në përgjithësi.
- Operim në nivele optimale të HEC-it dhe shfrytëzimin sa më të mirë të baseneve.
- Operim sipas përcaktimeve të rregullores së sigurisë së digave.
- Të gjenerojë në mënyrë të qëndrueshme e me cilësi, duke garantuar furnizim me energji elektrike të sigurt dhe me kosto sa më të ulët të konsumatorëve fundorë.
- Të ofrojë në kohën dhe masën e duhur shërbimet ndihmëse, për të garantuar operim të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit elektroenergjitik.

1.2.3 Realizimi i Treguesve të Prodhimit dhe Menaxhimi i Rezervës Hidrike.

KESH sh.a. gjatë vitit 2019 ka menaxhuar rezervën hidrike në përmbushje të detyrimit për furnizimin me Energji Elektrike për Furnizuesin e Shërbimit Universal sh.a., si dhe ofrimin e shërbimeve ndihmëse dhe energjisë për balancimin e Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar.

Prurjet mesatare në liqenet e HEC-eve, administruar nga KESH sh.a., rezultuan 119 m³/s, ose 34% më pak se mesatarja shumëvjeçare. Ndodhur në kushte të vështira hidrike KESH planifikoi programe prodhimi të tilla, që garantuan administrim të kujdesshëm të rezervës energjitike.

Për arsye të kërkesës së lartë për energji elektrike, në Janar dhe Shkurt 2019, KESH sh.a., gjeneroi 544 GWh, duke ruajtur të paprekur rezervën energjitike të kaskadës në lumin Drin. Gjenerimi nga HEC-et e kaskadës u ulën ndjeshëm në periudhën Mars - Qershor 2019 (639 GWh), për rrjedhojë rezerva energjitike e kaskadës shënoi një rritje graduale nga 454 GWh në fillim të muajit Mars duke shkuar në 1239 GWh në fund të muajit Qershor. Kjo rezervë energjitike bëri të mundur furnizimin në nivele të larta në periudhën e verës Korrik – Shtator (950 GWh) kur dhe konsumi i energjisë elektrike është i rritur për shkak të sezonit turistik.

Për shkak të një periudhe të gjatë pa reshje në pellgun ujë mbledhës të lumit Drin, në Tetor dhe Nëntor 2019, KESH sh.a. gjeneroi në total 439 GWh, nga të cilat, rreth 290 GWh u realizuan nga administrimi i prurjeve në kaskadë dhe rreth 149 GWh nga rezerva energjitike.

Përmirësimi i situatës hidrike në kaskadë në muajin Dhjetor (prurjet në HEC-in Fierzë 180m³/s dhe HEC-in Koman 178 m³/s), ndikuan në rritjen e gjenerimit në 390 GWh, duke plotësuar një pjesë të madhe të furnizimit me energji elektrike për nevojat e konsumatorëve fundorë si dhe duke rritur ndjeshëm rezervën energjitike me rreth 120 GWh.

Në tërësi administrimi i rezervës energjitike nga KESH arriti të garantojë:

- Ruajtjen e një raporti sa më të përshtatshëm import/prodhim vendi, duke rritur sigurinë e operimit të sistemit elektroenergjitik.
- Rritjen e sigurisë së furnizimit të pandërprerë me energji elektrike.
- Ofrimin në kohë dhe në cilësinë e duhur të shërbimeve ndihmëse.

Sipas informacioneve të KESH sh.a, më poshtë paraqiten zhvillimet në menaxhimin e situatave të krijuara gjatë vitit 2019.

KONSUMI SPECIFIK I UJIT NE m ³ /kWh NGA HEC-et E KESH sh.a TE KASKADES SE DRINIT GJATE VITIT 2019													
HEC		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qeshor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Fierze	(2019 (m ³ /kWh)	4.50	4.30	4.41	4.09	3.62	3.54	3.63	3.75	4.04	4.24	4.19	4.11
	Mest.sh.vjecare	4.07	4.08	3.98	3.82	3.63	3.61	3.72	3.90	4.07	4.20	4.22	4.11
Koman	(2019 (m ³ /kWh)	4.21	4.22	4.15	4.22	4.21	4.14	4.11	4.27	4.19	4.16	4.08	4.26
	Mest.sh.vjecare	4.22	4.22	4.22	4.20	4.19	4.18	4.18	4.18	4.19	4.20	4.22	4.22
V.Dejes	(2019 (m ³ /kWh)	8.53	8.50	8.48	8.50	8.41	8.47	8.50	8.53	8.52	8.56	8.52	8.51
	Mest.sh.vjecare	8.59	8.59	8.49	8.43	8.42	8.44	8.43	8.44	8.46	8.47	8.49	8.55

Figura 18 Konsumi specifik i Ujit në HEC-et e KESH sh.a..

TE DHENAT PER SHFRYTEZIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PER VITIN 2019						
HEC	Viti	Prodhimi (MWh)	Fuqia mes.lejuar per Agregat (MW)	Koef.mes.ngark.Agregati (%)	Ore Pune gjithsej	Koef.mes.shfryt z. Agregatit (%)
Fierze	2019	849,696	104.4	89.00	9,121	0.26
Koman		1,426,928	148.4	79.00	12,081	0.34
Vau Dejes		733,214	46.9	86.10	18,182	0.42

Figura 19 Shfrytëzimi i Kapacitetit gjenerues të Centraleve.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se koeficientët e shfrytëzimit për vitin 2019 kanë qënë mbi mesataren shumëvjeçare për të tre HEC-et e kaskadës së lumit Drin.

1.2.4 Gjendja e TEC-it Vlorë.

Shoqëria KESH sh.a. është aksionere e vetme e shoqërisë Termocentrali Vlorë sh.a. (TEC Vlora sh.a.), shoqëri kjo e cila ka në administrim asetin gjenerues TEC Vlora.

Përgjatë vitit 2019, shoqëria TEC Vlora sh.a., ka ushtruar veprimtarinë e saj në lidhje me konservimin e asetit gjenerues i cili nuk është në gjendje pune për shkak të defektit të shfaqur në sistemin e ftohjes që nga viti 2012.

Ndërkohë, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, më datë 28.12.2018, u bë shpallje publike për oferta për konçesionin me objekt “Për rehabilitimin dhe vënien në punë të Termocentralit të Vlorës si dhe të ndërtimit të tubacionit Fier-Vlorë të furnizimit me gaz të TEC-it, të formës R.O.O.T.”.

Proçeduara kishte si autoritet kontraktor Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila organizoi edhe garën për kalimin në konçesion të këtij aseti gjenerues.

Proçedura në fjalë është në fazë vlerësimi nga Autoriteti Kontraktor.

Meqë TEC Vlora sh.a. ndodhet në kushte konservimi, konsumi vetjak i TEC Vlorës garantohej nëpërmjet linjës së furnizimit 220 kV, N/Stacioni Babicë dhe mbulohet nga KESH sh.a.,

1.2.5 Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese private të pavarura dhe ato me përparësi

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga centralet prodhuese private për vitin 2019 është 2,226,794 MWh ose 42.7% e prodhimit total vendas.

Për vitin 2019, numri i centraleve prodhuese private të cilat kanë prodhuar energji elektrike është 197, ku 7 prej tyre janë prodhues të pavarur të cilët zotërohen nga 3 subjekte të licënuara, kurse pjesa tjetër prej 190 centrale janë prodhues me përparësi të energjisë elektrike të cilët zotërohen nga 136 subjekte të licënuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike. Në total, kapaciteti i instaluar i centraleve prodhuese private është 827 MW, ku kapaciteti i instaluar i centraleve të prodhuesve të pavarur është 252 MW, kurse 575 MW i përket centraleve të prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.

Të dhënat mbi grupimet e prodhuesve, janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur më poshtë.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT ME PËRPARËSI DHE ATO TË PAVARUR 2019		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2019 (MWh)
P.Pav	Prodhues të Pavarur	Lidhur në OST	3	7	252	741,595
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OST	28	45	295	816,637
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	100	137	265	646,366
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	8	8	15	22,196
			139	197	827	2,226,794

Figura 20 Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi dhe ato të pavarur për vitin 2019.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT E PAVARUR 2019					
	HECET DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	2019
P.Pa	Hec "Ulez" me fuqi 25,2 MW	25.200	"Kurum Internationa l" sh.a.	110 kV	330,742
P.Pa	Hec "Shkopet" me fuqi 24 MW	24.000		110 kV	
P.Pa	Hec "Bistrica 1" me fuqi 22,5Mw	22.500		110 kV	
P.Pa	Hec "Bistrica 2" me fuqi 5 Mw	5.000		110 kV	
P.Pa	Hec "Peshqesh" me fuqi 27,94 MW,;	27.940	"Ayen As Energji" sha	220 kV	91,100
P.Pa	Hec "Fangu" me fuqi 74.6 MW,;	74.600	"Devoll	220 kV	166,396
P.Pa	Hec "Banje" me fuqi 73 MW	73.000		110 kV	153,357
		252.240			741,595

Figura 21 Të dhëna mbi prodhuesit e pavarur për vitin 2019.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT ME PËRPARËSI 2019		Rrjeti	Numri	Numri	Kapaciteti instaluar	Prodhimi 2019
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OST	28	45	295	816,637
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	100	137	265	646,366
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	8	8	15	22,196
			136			1,485,199

Figura 22 Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi për vitin 2019.

Gjatë vitit 2019 kanë hyrë në prodhim subjektet e mëposhtme, të cilat realizojnë prodhim të energjisë elektrike nga centrale fotovoltaikë.

TË DHËNA TË VIITIT 2019 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)				
	CENTRAL FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA
PPE	Seman – 2	2	“SEMAN2SUN” sh.p.k	35 kV
PPE	Topojë	1.998	“SONNE” sh.p.k	35 kV
PPE	Topojë 2	1.998	“AED SOLAR” sh.p.k	35 kV
PPE	Topojë (Sheq Marinas)	2	“AGE SUNPOWER” sh.p.k	35 kV
PPE	Topojë (Sheq Marinas) 2	2	“SEMAN SUNPOWER” sh.p.k	35 kV
PPE	Seman Isolar	2	SEMANISOLAR sh.p.k	35 kV
PPE	Plug, Lushnje	2	“AEE” sh.p.k	10 kv

Figura 23 Impiantet fotovoltaikë të hyrë në prodhim gjatë vitit 2019.

1.2.6 Prodhimi nga centralet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2019

Prodhimi vjetor neto i energjisë elektrike nga impiantet të cilat kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2019 paraqitet në Figurën në vijim. Siç shihet përgjatë vitit 2019 kanë hyrë në prodhim gjithsej 36 impiante me një fuqi të instaluar prej 74.3 MW, të cilët kanë prodhuar gjatë vitit 2019 sasinë prej 83,158 MWh. Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2019 zë rreth 1.6 % të prodhimit total vendas të energjisë elektrike për këtë vit.

PRODHUES QË KANË HYRË NË PRODHIM GJATË VITIT 2019 (MWh)																	
Hec-e të Lidhur në rrjetin e Transmetimit			JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	2019		
Hec Lashkiza 1	4.076	HEC Lashkiza shpk	110 kV	-	-	-	151	505	232	37	(6)	8	23	292	900	2,141	
Hec Lashkiza 2	0.882		110 kV														
Hec Seta 1+2	7.454	"Hydro Seta" sh.p.k	110 kV														
Hec Seta 3	2.722		110 kV														
Hec Seta 4	4.724		110 kV	-			132	2,394	2,228	79	(16)	48	122	3,808	5,873	14,667	
HEC Darsi 1	2.24	"Henz Energy" shpk	110 kV														
HEC Darsi 2	7.663		110 kV	0	0	0	0	2,815	2,251	227	43	406	759	4,643	4,974	16,116	
HEC Darsi 3	1.066		110 kV														
HEC Slabinje 2C/341	3.400	"Power Elektrik Slabinje" shpk	110 kV	-	-	-	-	-	-	-	-	0	0	0	5	5	
	34.227															32,929	
Hec-e të reja të Lidhur në rrjetin e Shpërndarjes			JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	2019		
Hec Razdoli	0.765	Hidro Vizion shpk (I pa licens)	35kV	-	35	144	317	395	132	34	7	10	28	298	276	1,676	
Hec Dragostunje	3.1	"HEC-i Dragostunje" shpk	35kV	560	746	987	1,749	2,873	1,009	-	-	206		1,652	2,433	12,214	
Hec Stebleve	3.4	"PURE ENERGY STEBLEVA" shpk	35kV	-	3	93	204	370	112	-	-	-		132	464	1,380	
Hec Zerec 1	0.55	"EnRel Hydro" shpk	35kV	-	-	-	846	688	332	98	45	36	27	391	730	3,195	
Hec Zerec 2	1.315																
Hec Shëngjon 1	0.651	"EDIANI" sh.p.k.	35kV	-	10	-	96	220	224	43	10	6	6	98	274	987	
Hec Shëngjon 2	0.356																
Hec Blaç	1.3	"BLAC ENERGY" sh.p.k	35kV	-	-	-	164	167	104	20	13	5	7	182	216	878	
Hec Qarrishtë	0.3	"IDI-2005" SHPK	35kV	-	-	-	-	34	111	-	-	-		154	208	507	
Hec Vendresh	0.456	"HP VENDRESH ENERGY" SHPK	35kV	-	-	-	-	-	7	-	-	-		16	38	60	
HEC "Antena"	1.105	"DERBLE" shpk	35kV	-	-	-	-	-	217	-	-	27	16	464	434	1,158	
HEC "Kamenicë"	0.973	HP Kamenica shpk	10	-	-	-	-	-	-	-	64	44	49	345	530	1,031	
HEC "Qytezë"	0.9	Muso hec Qytezë	10	-	-	-	-	-	-	-	4	14	24	148	310	499	
Hec Marjan Gura e Ves	0.63	Marituda Shpk	10	-	-	-	-	-	-	62	20	9	4	102	225	421	
Hec Skatinë	2.677	Skatina Hec Shpk	10	-	-	-	-	-	-	32	18	12	14	192	560	828	
Hec Kaparjel	0.2	ABV Konstruktion	10	-	-	-	-	-	-	-	33	9	9	42	53	147	
Hec Letaj	0.54	Asi-Tre										10	129	171	310		
Hec Nice	2.133	MP-HEC												145	145		
Hec Meshurdhe	1.8	SIMA-Com												795	795		
Hec Thanez	1.95	AFRIMI K											828	975	1,803		
	25															28,033	
PRODHIMI GJATEVITIT 2019 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHURA NË RRJETIN E SHPËRNDARJES (MWh)																	
CENTRAL FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	2019	
UKKO (pa sistemuame sistem)	1.000	"UKKO" sha (Ujjetell.Kanal.Korce)															
Seman - 2	2	"SEMAN2SUN" sh.p.k	35 kV	262	183	376	354	383	422	452	452	340	307	154	156	3,840	
Topojë	1.998	"SONNE" sh.p.k	35 kV	271	236	375	352	382	441	450	447	337	306	153	156	3,905	
Topojë 2	1.998	"AED SOLAR" sh.p.k	35 kV	270	194	374	351	380	439	450	450	338	306	153	157	3,862	
Topojë (Sheq Marinas)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	273	236	375	351	380	439	449	449	338	306	152	156	3,903	
Topojë (Sheq Marinas) 2	2	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	236	238	380	355	384	423	455	455	342	309	155	159	3,891	
Seman Isolar	2	SEMANISOLAR sh.p.k	35 kV	-	-	-	-	-	-	-	-	247	344	176	185	953	
Plug, Lushnje	2	"AEE" sh.p.k	10 kv	-	-	-	-	-	282	350	350	281	279	145	158	1,844	
	14.996															22,196	
TË RINJ 2019	74.324															83,158	

* Shifrat në kllapa të prodhimit paraqesin konsum neto të centraleve prodhuese

Figura 24 Prodhimi nga Impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2019.

1.2.7 Prodhimi i energjisë elektrike sipas rrjetit ku janë lidhur centrale prodhuese

Fuqia e instaluar e centraleve të lidhur në sistemin e transmetimit për vitin 2019 është 1 995 MWh. Prodhimi total i energjisë elektrike nga këto centrale është 4 537 484. Prodhimi i detajuar për secilin nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2019 paraqitet në tabelën në vijim:

PRODHIMI GJATE VITIT 2019 NGA CENTRALET E LIDHURA NE RRJETIN E TRANSMETIMIT (MWh)					
	EMËRTIMI I CENTRALIT PRODHUES	KAPACITETI INSTALUAR (MW)	SHOQËRIA	LIDHJA	2019
P.Pub	HEC "Fierze"	500.000		220 kV	
P.Pub	HEC "Koman"	600.000	"KESH" sha	220 kV	2,979,252
P.Pub	HEC "V. Dejes"	250.000		220 kV	
P.Pub	Tec Vlora	98.000	"KESH" sha	220 kV	
P.Pav	HEC "Ulez"	25.200	"Kurum International" sh.a.	110 kV	330,742
P.Pav	HEC "Shkopet"	24.000		110 kV	
P.Pav	HEC "Bistrica 1"	22.500		110 kV	
P.Pav	HEC "Bistrica 2"	5.000		110 kV	
P.Pav	HEC "Peshqesh"	27.940	"Ayen As Energji" sha	220 kV	91,100
P.Pav	HEC "Fangu"	74.600		220 kV	166,396
P.Pav	HEC "Banje"	73.000	"Devoll Hydropower" sha	110 kV	153,357
PPE	HEC "Ashta"	48.200	"Energji Ashta" shpk	110 kV	191,495
PPE	HEC "Bishnica 2"	2.500	"HEC Bishnica 1,2" shpk	110 kV	9,045
PPE	HEC "Dardhe"	5.800	"Wenerg" shpk	110 kV	
PPE	HEC "Truen"	2.500	"TRUEN" shpk	110 kV	12,756
PPE	HEC "Temove"	0.921	"TEODORI 2003" shpk	110 kV	5,293
PPE	HEC "Gjorice"	29.610	"DITEKO" shpk	110 kV	99,035
PPE	HEC "Sllabinje"	10.400	"Power Elektrik Slabinje" shpk	110 kV	40,396
PPE	HEC Slabinje	3.400	"Power Elektrik Slabinje" shpk	110 kV	5
PPE	HEC "Bele 1"	5.000	"Euron Energy" shpk		
PPE	HEC "Topojan 2"	5.800			
PPE	HEC "Bele 2"	11.000	"Alb-Energy" shpk	110 kV	109,787
PPE	HEC "Topojan 1"	2.900			
PPE	HEC "Orgjost I Ri"	4.800	"Energai" shpk		
PPE	HEC "Cerunje-1"	2.300			
PPE	HEC "Cerunje-2"	2.800	"Energy partners AI" shpk		15,649
PPE	HEC "Rrupe"	3.600			
PPE	HEC "Rapuni 1,2"	8.100	"C & S Construction Energy" shpk	110 kV	28,406
PPE	HEC "Rapuni 3,4"	8.850	"C & S Energy" shpk	110 kV	26,899
PPE	HEC "Llapaj"	13.620	"Gjo.Spa.POWER" shpk	110 kV	45,110
PPE	HEC "Lengarice"	8.940	"Lengarica & Energy" shpk	110 kV	26,597
PPE	HEC "Lura 1"	6.540		110 kV	
PPE	HEC "Lura 2"	4.020	"Erdat Lura" shpk	110 kV	34,265
PPE	HEC "Lura 3"	5.660		110 kV	
PPE	HEC "Malla"	5.455	"Gjure Rec" shpk	110 kV	11,621
PPE	HEC Prella	14.970	"Prella Energji"	110 kV	31,597
PPE	HEC Cemerica 1	0.88		110 kV	
PPE	HEC Cemerica 2	1.08	"REJ ENERGY" shpk	110 kV	14,540
PPE	HEC Cemerica 3	2.1		110 kV	
PPE	HEC TUÇ	4.47	MC Inerte Lumzi	110 kV	25,751
PPE	HEC Lumzi	11		110 kV	
PPE	HEC Denas	14.5	"Denas Power" shpk	110 kV	30,258
PPE	Llënga 1	1.73		110 kV	
PPE	Llënga 2	0.3	"HEC LLËNGË" sh.p.k	110 kV	8,224
PPE	Llënga 3	1.5		110 kV	
PPE	HEC Shpella Poshte 2	2.3	Liria Energji shpk	110 kV	8,884
PPE	HEC Germani 1	4.8		110 kV	
PPE	HEC Germani 2	1.5	SA'GA-MAT shpk	110 kV	8,101
PPE	HEC Lashkiza 1	4.076		110 kV	
PPE	HEC Lashkiza 2	0.882	HEC Lashkiza shpk	110 kV	2,141
PPE	HEC Seta 1+2	7.454		110 kV	
PPE	HEC Seta 3	2.722	"Hydro Seta" sh.p.k	110 kV	14,667
PPE	HEC Seta 4	4.724		110 kV	
PPE	HEC Darsi 1	2.24		110 kV	
PPE	HEC Darsi 2	7.663	"Henz Energy" shpk	110 kV	16,116
PPE	HEC Darsi 3	1.066		110 kV	
		1,995			4,537,484

Figura 25 Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2019.

Fuqia e instaluar e centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes është 280 MW. Kjo fuqi e instaluar e centraleve në rrjetin e shpërndarjes përbëhet nga 265 MW fuqi e instaluar në burime Hidrike dhe 15 MW fuqi e instaluar në impiante fotovoltaike. Prodhimi i realizuar nga centralet hidrike të lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2019 është në sasinë 646 366 MWh, ndërsa prodhimi i realizuar nga impiantet fotovoltaike është në sasinë 22 190 MWh. Në mënyrë të detajuar prodhimi i tyre paraqitet në tabelën në vijim:

PPE	HEC" Fterra"	1.080	"Hidro Borshi" shpk	35kV	7,481
PPE	HEC" Ostren i Vogel"	0.320	"Lu & Co Eco Energy" shpk	10kV	499
PPE	HEC" KozeI"	0.500		10kV	1,349
PPE	HEC" Helmes 1"	0.800	"E.T.H.H. "shpk	10kV	2,371
PPE	HEC" Helmes 2"	0.500		10kV	1,249
PPE	HEC" Qafezeze"	0.400	"Caushi Energji" shpk	10kV	2,876
PPE	HEC" Trebisht"	1.775	"SA.GLE.Kompani" shpk	10kV	2,214
PPE	HEC" Mollaj"	0.600	"Energji Xhaci" shpk	10kV	1,010
PPE	HEC" Tucep"	0.400	"Tucep" shpk	10kV	2,327
PPE	HEC" Treska4"	3.600		35kV	10,404
PPE	HEC" Treska3"	0.300	"Hec-Treske" shpk	35kV	1,334
PPE	HEC" Treska 2T"	0.620		35kV	2,512
PPE	HEC" Sotire 1 & 2"	2.200	"Hidro Energy Sotire" shpk	35kV	5,102
PPE	HEC" Shutine"	2.400	"Shutina energji" shpk	10kV	3,001
PPE	HEC" Cekrez 1,2"	0.660	"Zall Herr Energji 2011" shpk	6kV	4,281
PPE	HEC" Qarr"	1.000	"Hec Qarr & Kaltanj" shpk	35kV	4,809
PPE	HEC" Bisak"	1.300	"Bardhjana" shpk	6kV	3,371
PPE	HEC" Shales"	1.080		35kV	1,261
PPE	HEC" Strelce"	1.174	"Gjoka Konstruksion Energji" shpk	35kV	4,542
PPE	HEC " Shpelle"	0.400	"Sarolli" sh.p.k	10kV	1,331
PPE	HEC " Bicaj"	3.100	"EN-KU" sh.p.k	10kV	-
PPE	HEC " Leskovik 1"	1.072		10kV	390
PPE	HEC " Leskovik 2"	1.100	"Maksi Elektrik" sh.p.k	10kV	514
PPE	HEC " Orenjë"	0.875	"Juana" sh.p.k	10kV	781
PPE	HEC " Tamarë"	0.750	"WTS Energji" shpk	10kV	395
PPE	HEC " Benë"	1.000	"Marjakaj" shpk	6kV	1,449
PPE	HEC " Vithkuq"	2.715	"Favina 1" shpk	35/10kV	11,087
PPE	HEC " Selce"	1.600	"Selca Energji" shpk	10kV	4,819
PPE	HEC" Kumbull- Merkurth"	0.830	"DN & NAT Energy" shpk	6kV	1,725
PPE	HEC " Sasaj"	8.600	"Ergo – Sas" shpk	35kV	22,939
PPE	HEC " Tervol"	10.600	"Hec i Tervolit" shpk	35kV	31,510
PPE	HEC " Radove"	2.500	"MTC Energy" shpk	10kV	8,032
PPE	HEC" Gurshpat 1"	0.840		10kV	2,374
PPE	HEC" Gurshpat 2"	0.830	"Gurshpat Energy" shpk	10kV	3,231
PPE	HEC" Bistrica 3"	1.570	"Bistrica 3 Energy" shpk	6kV	8,081
PPE	HEC" Hurdhas 1"	1.710	"Komp Energji" shpk	6kV	5,988
PPE	HEC" Perrollaj"	0.500	"Fatlum" shpk	10kV	278
PPE	HEC" Koxheraj"	0.620	"Koxherri Energji" shpk	10kV	1,393
PPE	HEC" Kacni"	3.870	"Kisi-Bio-Energji" shpk	20kV	3,939
PPE	HEC" Lena 1"	1.950		35kV	
PPE	HEC" Lena 2"	2.300	"Gama Energy" shpk	35kV	7,266
PPE	HEC" Lena 2A"	0.250		35kV	
PPE	HEC " Driza"	3.408	"Mesopotam Energy" shpk	35kV	2,474
PPE	HEC Strelca 1,2,3	5.349	"Strelca Energy" shpk	35kV	13,355
PPE	HEC " Ujanik 2"	2.500	"HP Ujaniku Energy" shpk	35kV	5,466
PPE	HEC " Nishove"	1.360	"Nishova Energy" shpk	35kV	897
PPE	HEC " Shtika"	1.300	"Perparimi SK" shpk	10kV	2,098
PPE	HEC " Ballenje"	1.900	"Ballenja Power Martanesh" shpk	35kV	3,618
PPE	HEC Gavran 1	0.998	"Gavran Energy" shpk	35kV	2,276
PPE	HEC Gavran 2	1.215	"Gavran Energy" shpk	35kV	1,892
PPE	HEC Kasollet e Selces 1	4.000	"Xhango Energji" shpk	35kV	8,591
PPE	HEC Holta Kabash	2.200		35kV	
PPE	HEC Holta Poroçan	3.300	HEC Kabash Poroçan shpk	35kV	10,480
PPE	HEC Lusën 1	0.315	"Eurobiznes" shpk	35kV	194
PPE	HEC Ura e Fanit	1.000	"Ayen As Energji" sha	35kV	4,905
PPE	HEC Gorice	1.747	"THE BLUE STAR" sh.p.k	35kV	3,763
PPE	HEC Kabash 1&2	5.800	"Univers Energji" shpk	35kV	2,310
PPE	HEC "Tucep 2"	1.7	"DUKA T2" shpk	35kV	1,611
PPE	HEC Dobrenje Tomorrice	2.4	DAAB Energy Group shpk	35kV	3,294

PPE	HEC Razdoll	0.765	Hidro Vizion shpk (I pa licens nga ERE)	35kV	1,676
PPE	HEC Dragostunje	3.1	"HEC-i Dragostunje" shpk	35kV	12,214
PPE	HEC Stebleve	3.4	"PURE ENERGY STEBLEVA" shpk	35kV	1,380
PPE	HEC Zerec 1	0.55	"EnRel Hydro" shpk	35kV	3,195
PPE	HEC Zerec 2	1.315			
PPE	HEC Shëngjon 1	0.651	"EDIANI" sh.p.k.	35kV	987
PPE	HEC Shëngjon 2	0.356			
PPE	HEC Blaç	1.3	"BLAC ENERGY" sh.p.k	35kV	878
PPE	HEC Qarrishtë	0.3	"IDI-2005" SHPK	35kV	507
PPE	HEC Vendresh	0.456	"HP VENDRESH ENERGY" SHPK	35kV	60
PPE	HEC "Antena"	1.105	"DERBI-E" shpk	35kV	1,158
PPE	HEC "Kamenicë"	0.973	HP Kamenica shpk	10	1,031
PPE	HEC "Qytezë"	0.9	Muso hec Qytezë	10	499
PPE	HEC Marjan Gura e Vesheve	0.63	Marituda Shpk	10	421
PPE	HEC Skatinë	2.677	Skatina Hec Shpk	10	828
PPE	HEC Kaparjel	0.2	ABV Konstruktion Shpk	10	147
PPE	HEC Letaj	0.54	Asi-Tre Shpk	10	310
PPE	HEC Nice	2.133	MP-HEC Shpk	35	145
PPE	HEC Meshurdhe	1.8	SIMA-Com Shpk	10	795
PPE	HEC Thanez	1.95	AFRIMI K Shpk	35	1,803
		265			646,366
PRODHIMI GJATE VITIT 2019 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)					
	EMËRTIMI I CENTRALIT PRODHUES	KAPACITETI INSTALUAR (MW)	SHOQËRIA	LIDHJA	2019
PPE	UKKO (pa sist)	1.000	"UKKO" sha (Ujsjell.Kanal.Korce)		
PPE	Seman – 2	2	"SEMAN2SUN" sh.p.k	35 kV	3,840
PPE	Topojë	1.998	"SONNE" sh.p.k	35 kV	3,905
PPE	Topojë 2	1.998	"AED SOLAR" sh.p.k	35 kV	3,862
PPE	Topojë (Sheq Marinas)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	3,903
PPE	Topojë (Sheq Marinas) 2	2	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	3,891
PPE	Seman Isolar	2	SEMANISOLAR sh.p.k	35 kV	953
PPE	Plug, Lushnje	2	"AEE" sh.p.k	10 kv	1,844
		14.996			22,196
LEGJENDA					
P.Pub	Prodhues Publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit Publik)				
P.Pav	Prodhues të Pavarur (Prodhues në treg të Hapur)				
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)				

Figura 26 Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2019.

1.3 TRANSMETIMI I ENERGISË ELEKTRIKE

Transmetimi i Energjisë Elektrike në Shqipëri kryhet nëpërmjet rrejtit të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV, 150 kV, dhe 110 kV.

Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar përcakton se : “Sistemi i Transmetimit” është sistemi i përdorur për transmetimin e Energjisë Elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për lëvrimin e Energjisë Elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

1.3.1 Bilanci energjistik

Tabela e mëposhtme paraqet bilancin energjetik të OST sh.a. për vitin 2019 si dhe krahasimin me periudhën 2015 – 2018.

Bilanci i Energjisë Elektrike i OST sha për vitin 2019 (MWh)	2019
	MWh
Prodhimi nga KESH_GEN në Rrjetin e Transmetimit	2,979,252
Prodhimi nga HEC/HPP e vogla në Rrjetin e Transmetimit	229,380
Prodhimi nga PPE/IPP e mëdha në Rrjetin e Transmetimit	625,142
Prodhimi nga HEC Peshqesh	91,100
Prodhimi nga HEC Banja	153,357
Prodhimi nga HEC FANG	166,396
Prodhimi nga HEC Moglicë	0
Prodhimi nga HEC Ashta	191,495
Prodhimi nga KURUM (Ulez-Shkopet&Bistrica1,2)	330,742
Eksperti (-) nga Linjat e Interkonjeksionit	770,480
Importi (+) nga Linjat e Interkonjeksionit	3,176,515
Balanca (Total Interkonjeksioni)	2,406,036
Energjia Totale në Marrje	7,943,380
Humbjet në Rrjetin e Transmetimit (përfshirë Nevojat Vetjake)	168,621
Humbjet në Rrjetin e Transmetimit %	2.12
Energjia Totale në Dhënie	7,774,759
<i>Transmetuar në Linjat e Interkonjeksionit</i>	770,480
<i>Transmetuar tek Klientët e Kualifikuar</i>	867,029
<i>Transmetuar në rrjetin e Shpërndarjes (OSHEE) 110 kV</i>	5,185,082
<i>Transmetuar në rrjetin e Shpërndarjes (OSHEE) 35 kV</i>	532,492
<i>Transmetuar në rrjetin e Shpërndarjes (OSHEE) 6, 10, 20 kV</i>	419,676

Nr.	Bilanci Energjetik i OST sh.a (GWh)	2015	2016	2017	2018	2019
I	ENERGJI TOTALE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT	7,830	8,462	7,577	9,848	7,943
1.	- Prodhimi vendas	5,475	6,636	4,174	8,076	4,766
2.	- Energji në marrje	2,355	1,827	3,403	1,772	3,177
II	ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR	7,672	8,272	7,419	9,606	7,775
1.	- Energji në dhënie	956	1,869	488	2,685	770
2.	- Energji e transmetuar për OSHEE sh.a.	6,106	5,901	6,148	5,963	6,137
3.	- Energji transmetuar për klientë të lidhur në rrjetin e transmetimit	610	503	781	957	867
III	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+Nevojat Vetjake	159	190	158	242	169
	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+Nevojat Vetjake (%)	2.03	2.25	2.08	2.46	2.12

Figura 27 Bilanci Energjetik i OST sh.a për vitin 2019 krahasuar me atë të viteve 2015-2018 (GWh).

Niveli i Humbjeve në sistemin e transmetimit për vitin 2019 është 169 GWh ose 2.12 % e energjisë elektrike të transmetuar. Niveli i humbjeve në Sistemin e Transmetimit është i lidhur me sasinë e energjisë elektrike të transmetuar si dhe me nivelin e prodhimit të HEC-eve të lidhura në Sistemin e Transmetimit.




Figura 28 Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjitik shqiptar për vitin 2019.

Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjitik Shqiptar jepet në menyre të detajuar në figurën më sipër. Sasia totale e energjisë elektrike e injektuar në sistemin e transmetimit për vitin 2019 është 7,943 GWh. Sasia totale e energjisë elektrike e injektuar në sistemin e shpërndarjes është 6 576 GWh. Energjia elektrike në sistemin e shpërndarjes injektohet nga sistemi i transmetimit dhe nga impiantet gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes. Sistemi i transmetimit injekton në rrjetin e shpërndarjes sasinë prej 6 137 GWh, ndërsa impiantet gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes injektojnë në këtë rrjet sasinë neto të energjisë elektrike prej 439 GWh. Një pjesë e sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar në impiantet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes injektohet në rrjet nëpërmjet sistemit të transmetimit. Kjo dukuri ndodh për shkak të konfiguracionit të rrjetit dhe pamundësisë së konsumatorëve në ato zona ku janë të lidhura këto impiante për të konsumuar energjinë elektrike të gjeneruar. Element tjetër që ndikon në këtë dukuri është dhe fakti se njesitë gjeneruese hidrike të lidhura në rrjetin e shpërndarjes janë pa base të grumbullimit të ujit dhe në periudha me rreshje të larta gjenerojnë me kapacitet maksimal.

1.3.2 Veprimtaria e OST sh.a.

Operatori i Sistemit të Transmetimit është personi juridik i licencuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, i cili ka në pronësi sistemin e transmetimit dhe respekton parimin e pavarësisë, të përcaktuar në nenin 54 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar. Në vendin tonë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.). OST sh.a. është shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore. Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si prodhimi, shpërndarja, tregëtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në ligj.

OST sh.a. aktualisht kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Tregut si dhe Operatorit të Sistemit të Dispeçerimit.

OST sh.a. garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

- Furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes, si dhe klientëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit,
- Transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit,
- Tranzitimin dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Në këtë kuadër OST sh.a. zhvillon Sistemin e Transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me Energji Elektrike, me planet e zhvillimit të burimeve të reja të Energjisë Elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkonjeksionit me vendet fqinje. OST sh.a. dispeçeron sistemin Elektroenergjitik Shqiptar nëpërmjet menaxhimit të flukseve të energjisë në sistem, duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera fqinje.

1.3.2.1 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike të Shqipërisë përfshin të gjitha linjat me tension 400 kV, 220 kV, 150 kV, dhe 110 kV dhe nënstacionet lidhëse midis tyre që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike dhe interkonjeksionit me vendet fqinje. Sistemi i transmetimit përbëhet nga 3 395.3 km linja transmetimi të energjisë elektrike. Pjesën kryesore të rrjetit të transmetimit në vendin tonë e zënë kryesisht linjat 220 kV dhe 110 kV.

Gjatësitë e linjave të sistemit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit janë:

- | | |
|--------------------------------|------------|
| • Linjat e transmetimit 400 kV | 445.7 km |
| • Linjat e transmetimit 220 kV | 1,250 km |
| • Linjat e transmetimit 150 kV | 34.4 km |
| • Linjat e transmetimit 110 kV | 1,665.2 km |

Sistemi i transmetimit shqiptar është i ndërlidhur me sistemet e transmetimit të vendeve fqinje nëpërmjet linjave të interkonjeksionit të paraqitura më poshtë:

- Linja e interkonjeksionit 400 kV Zemblak (Shqipëri) – Kardia (Greqi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Prishtinë (Kosovë)
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Fierzë (Shqipëri) – Prizren (Kosovë)
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Koplík (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)

- Linja e interkonjeksionit 150 kV Bisticë (Shqipëri) – Myrtos (Greqi).

Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Prishtinë (Kosovë), aktualisht nuk është në operim për shkak të problematikës ndërmjet KOSTT Operatorit Sistemit Transmetimit të Kosovës dhe EMS Operatori Sistemit Transmetimit të Serbisë. KOSTT nuk është njohur si sistemi i pavarur i operimit të sistemit të transmetimit të Kosovës dhe ky problem nuk mundëson vënien në operim të kësaj linje interkonjeksiioni.

Kapaciteti teknik i interkonjeksionit me vendet fqinje është i mjaftueshëm për të realizuar shkëmbimet e nevojshme dhe tranzitimet e kërkuara të energjisë elektrike në çdo kohë megjithatë në periudha të caktuara, krijohen konxhestion të kapaciteteve transmetuese në interkonjeksion për shkak të konxhestioneve në rrjetet nacionale të vendeve fqinje.




Figura 29 Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë.




Figura 30 Harta e Sistemit të Transmetimit Shqiptar.




Figura 31 Skema njëpolare e Sistemit Elektroenergetik Shqiptar në nivelin 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV.

Tabela më poshtë paraqet listën e Nënstacioneve të Sistemit të Transmetimit:

Nr.	Tipi Nënstacionit	Fuqia e instaluar	Njesia operative
1	400 kV	N/St. 400/220 kV, Koman	Shkodër
2		N/St. 400/220/110 kV, Tirana2	Tiranë
3		N/St. 400/220 kV, Elbasan2	Elbasan
4		N/St. 400/110 kV, Zemblak	Korcë
5	220 kV	N/St. 220/110 kV, V.Dejes	Shkodër
6		N/St. 220/110 kV, Fierze	Shkodër
7		N/St. 220/110 kV, Koplik	Shkodër
8		N/St. 220/110 kV, Burrel	Shkodër
9		N/St. 220/110/20 kV, Tirana1	Tiranë
10		N/St. 220/110 kV, Sharre	Tiranë
11		N/St. 220/110 kV, Rrashbull	Tiranë
12		N/St. 220/110 kV, Elbasan1	Elbasan
13		N/St. 220/110 kV, Fier	Fier
14		N/St. 220/110 kV, Babice	Fier
15	110 kV	N/St. 110/150 kV, Bistrica1	Fier

Figura 32 Asetet kryesore të Sistemit të Transmetimit

1.3.2.2. Investimet në Sistemin e Transmetimit nga OST sha gjatë vitit 2019.

Tabela e mëposhtme paraqet listën e Investimeve të planifikuara dhe të investimeve faktike të realizuara për vitin 2019. Investimet eplanifikuara nga OST sh.a. në vitin 2019 janë në vlerën 2,314,228, 186 Lekë. Investimet e realizuara në vitin 2019 nga OST sh.a janë në vlerën 1,737,256,386 Lekë ose rreth 75.1 % të investimeve të planifikuara nga OST sh.a. për vitin 2019. Investimet të cilat rezultojnë të pa realizuara gjatë vitit 2019 sipas tabelës së mëposhtme rezultojnë që një pjesë e tyre, janë përfshirë në planin e investimeve të OST sh.a. për vitin 2020. Kryesisht kjo për arsye të rialokimit të fondeve që OST sh.a. realizon edhe në kuadër të përditësimit të planit të zhvillimit dhe të vjeçar të rrjetit të transmetimit.

Realizimi i Investimeve per vitin 2019 (lekë)				
Nr.	Pershkrimi	Plan	Fakt	Realizimi
Projekte me fondet e OST sh.a.				
1	Demontimi dhe ndertimi i linjes se re 110kV me 1 qark Skuraj-Laç 1		37,087,679	
			37,087,679	
1	Rehabilitimi i impjantit 110kV N/st Lac 2 dhe rikonstruksioni i linjes TL 110kV, Lac 1- Lac 2		29,993,572	
2	Zgjerimi i N/st Koman me 1 autotransformator 400/200 Kv - SIEMENS		23,646,868	
3	Mbikqyrja e punimeve per objektin e rehabilitimit te impjantit 110kV te N/st Laç 2 dhe rikonstruksioni i linjes TL 110kV Laç1-Laç 2		336,260	
			53,976,700	
1	Furnizim vendosje e Shunt reaktorit 400kV 120 MVAR, Sistemit Total te monitorimit te tij, Konfigurimin ne sistemin SCADA, furnizimin dhe vendosjen e Traktit 400 kV ne N/st Zemblak si dhe kryerja e te gjitha punimeve civile ne lidhje me kete projekt.	40,624,084	44,744,679	110.1%
2	Rikonstruksioni i linjave 110 kV Laç2-Ura e Matit dhe Skuraj Ura e Matit	97,195,998	38,878,399	40.0%
3	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit Jagodine	149,639,040	134,713,759	90.0%
4	Ndertimi i linjes 110kV N/st Sallmonë – Gjiri i Lakezit	133,575,302	29,209,062	21.9%
5	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit F.Arrez	113,312,490	0	0.0%
6	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit Ibe	77,768,232	45,269,818	58.2%
7	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit Plasmus	76,128,874	74,540,849	97.9%
8	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit Kajan	84,506,530	84,451,876	99.9%
9	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit Prenjas	76,646,281	65,839,535	85.9%
10	Rikonstruksioni i anes 110kV te nenstacionit Rubik	47,631,371	45,203,770	94.9%
11	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110kV te nenstacionit Librazhd	79,956,863	73,060,703	91.4%
12	Akresi dhe monitorimi i rrjetit te transmetimit te sistemeve te komunikimit me kapacitete	12,824,000	12,824,000	100.0%
13	Instalimi i OPGW ne linjen 220kV Burrel – Elbasan 1	48,392,996	38,869,206	80.3%
14	Implementimi i Sistemit te Analizimit te Rrjetit nepermjet PMU (Phasor Measuring Unit)	12,046,000	12,046,000	100.0%
15	Ndertimi i Magazines prane N/stacionit Tirana2	29,202,920	4,839,200	16.6%
16	Furnizim vendosje e traktit te linjes 110-13 ne N/stacionin Lac1 dhe punime civile	25,363,585	24,746,280	97.6%
17	Plotesimi dhe venia ne pune e Traktit 110kV ne nestacion Fier per N/stacionin 110/20kV te OSHEE + trainimi i personelit Inxhiniero –teknik te DSHMT	32,761,600	32,761,600	100.0%
18	Sistemi i problematikave te drenazhit ne Nenstacionit Tirana2	11,735,740	4,542,000	38.7%
19	Nderrhyrje ne linjat e transmetimit 110/220kV te rajonit te Njesise Operative Shkoder	15,364,654	8,098,360	52.7%
20	Mbikqyrja e punimeve per objektet e reja.	22,100,237	5,116,350	23.2%
21	Ngritja e nje sistemi per lokalizimin e avareve ne linjat e transmetimit. Blerje, instalim, konfigurim i serverit per analizatoret e vajt te AT -ve e celsave te nivelit 110kV e lart.	105,280,000	105,280,000	100.0%
22	Furnizim i nje celsi te ri 245 kV me gas SF6 si dhe pjese reserve te tij dhe per celsat aktual, 3(tre) analizatore per celsat e niveleve te ndryshme tensioni si dhe 2(dy) paisje mbrojtjeje, automatizimi dhe monitorimi.	25,964,000	25,964,000	100.0%
23	Lyerja e shtyllave te transmetimit te TL	74,722,297		0.0%
24	Integrimi i N.st. Elbasan 1 dhe Elbasan 2 ne sistemin e monitorimit dhe programimit online te Sistemit te Mbrojtjes RELE	19,145,000	19,145,000	100.0%
25	Nderrhyrje ne linjat e transmetimit 110kV te rajonit te Njesise Operative Fier.	0		
	TOT Kontrata te vitit 2018	1,411,888,093	930,144,446	65.9%
1	Ndertim i linjes 220kV me dy qarqe Komsí-Shumat	199,995,692	199,995,692	100.0%
2	Ndertimi i nenstacionit 220/110/35kV Shumat dhe traktit 220kV ne nenstacionin 220/110/10kV Komsí	144,041,200	144,041,200	100.0%
3	Linja 110kV N/St Fiber -Librazhd	80,000,000		0.0%
4	Punime per perfundimin e linjes kablore 110kV Tirana-Selite dhe lidhja me nenstacionin 110/20kV Kombinat	83,000,000		0.0%
5	Furnizim dhe vendosje e celave rezerve 20kV dhe 35kV per N/st Tirana1 dhe pjese kembimi per keto celsa	45,000,000		0.0%
6	Nderrhyrje per rastet emergjence ne linjat e TL	40,000,000	3,660,000	9.2%
7	Blerje materiale per nenstacione	100,000,000	62,599,620	62.6%
8	Blerje materiale dhe vegla punet e sigurimit teknik si dhe pajisjet (laborator) per testimin e mjeteve te sigurimit teknik	30,000,000		0.0%
9	Upgrade i sistemit te kontrollit dhe BCU te N/st 220kV Koplik	36,000,000		0.0%
10	Upgrade Hardware-Software i sistemit te kontrollit te nenstacionit 400/220/110kV Tirana 2	29,488,200	29,488,200	100.0%
11	Blerjen e dy licensave USB per program kompjuterik PSS®E per analizen e rrjetit	8,315,000	8,315,000	100.0%
12	Mbikqyrje e punimeve gjate zbatimit te kontratave	13,000,000		0.0%
13	Punime civile per rikonstruksionin e traktit 110kV te linjes Fier –Kuçovë.	10,000,000		0.0%
14	Punimet riparuese per godinen e nenstacionit Zemblak	9,000,000		0.0%
15	Punimet riparuese per godinen e nenstacionit Rrashbull dhe magazinën qendrore te OST	5,000,000		0.0%
16	Blerje module shtese per sofini ODMs mirembajtje/suport per nje periudhe 3 vjecare	35,000,000		0.0%
17	Instalimi i OPGW ne linjen Bistrica1-Kufi	32,000,000		0.0%
18	Rinovimi i sistemit antivivus	2,500,000		0.0%
	TOT Kontrata te vitit 2019	902,340,092	448,099,712	49.7%
	TOTALI i Investimeve me fondet e OST sh.a.	2,314,228,186	1,469,308,538	63.5%
Projekte me Financime te Huaja				
1	Efienca Energjitike		109,410,976	
2	Linja 400kV Shqiperi-Maqedoni		75,045,993	
3	Instalim Matjes/Qendra e te dhenave		83,490,862	
	Totali i Investimeve me fonde te Huaja		267,947,831	
	TOTALI INVESTIMEVE OST sh.a. PER VITIN 2019	2,314,228,186	1,737,256,368	75.1%

Figura 33 Situata e Investimeve në Sistemin e Transmetimit nga OST sha gjatë vitit 2019.

1.3.3 Gjendja e Përgjithshme e Sistemit Eelektroenergjetik referuar raportimit të OST sh.a, në zbatim të nenit 25, pika 2 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

I. Siguria operative e rrjetit

Në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit bazuar në kërkesat dhe parimet e sigurisë operative duke garantuar funksionimin e Sistemit të Transmetimit në nivel të lartë koordinimi, besueshmërie, cilësie dhe qëndrueshmërie.

Siguria operative e rrjetit është aftësia e sistemit të transmetimit për të qëndruar në gjendje normale dhe/ose aftësia për tu kthyer në gjendjen normale sa më shpejt të jetë e mundur. OST sh.a. ka marrë të gjitha masat e nevojshme organizative dhe teknike për të operuar brenda limiteve të sigurisë operative të përcaktuar në Kodin e Transmetimit/Kodi i Operimit në përputhje me detyrimet që përcakton Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe legjislacionin sekondar të miratuar nga ERE, mbi operimin e siguritë të sistemit të interkonektuar.

Investimet e realizuara gjatë viti 2019 në rrjetin e transmetimit janë:

- Furnizim-vendosje e shunt-reaktorit 400 kV (120 MVAR) dhe traktit 400 kV në N/Stacionin Zemblak.
- Rikonstruksioni i N/Stacionit 110/35/20/6kV Lushnjë (Plasmas) (impianti 110 kV i nënstacionit).
- Rehabilitimi i N/Stacionit 110/35/6kV Rubik (impianti 110kV i nënstacionit).
- Implementimi i Sistemit të Analizimit të Rrjetit nëpërmjet PMU (Phasor Measuring Unit)
- Furnizim-vendosje e traktit të linjës 110-13 N/Stacionin Laçl

Gjithashtu janë në procese implementimi edhe projektet e mëposhtëme:

- Rikonstruksioni i linjave 110 kV Laç 2-Ura e Matit dhe Skuraj —Ura e Mati
- Rehabilitimi i impianti 110 kV të N/Stacionit 110/35/6 kV Jagodinë
- Ndërtimi i linjës 110 kV N/Stacioni Salimone - Gjiri i Lalëzit
- Rehabilitimi i N/Stacionit 110/35/10kV Fushë Arrëz (impianti 110kV i nënstacionit)
- Rehabilitimi i N/Stacionit 110/10kV Ibë (impianti 110kV i nënstacionit)
- Rikonstruksion i N/Stacionit 110/10kV Kajan (impianti 110kV i nënstacionit)
- Rehabilitimi i N/Stacionit 110/35/6kV Përrenjas (impianti 110kV i nënstacionit)
- Rikonstruksioni i N/Stacionit 110/20/10kV Librazhd
- Instalimi i OPGW në linjën 220kV Burrel - Elbasani etj.,

Kodi i Transmetimit përcakton detyrimin e OST sh.a. për përcaktimin e limiteve të sigurisë operative për çdo element të rrjetit të transmetimit, duke marrë parasysh aftësitë e kërkuara për përdoruesit e rëndësishëm, si nga ana e gjenerimit ashtu edhe nga ana e kërkesës, si dhe për çdo interkonektor në koordinim me OST përkatëse për përcaktimin e limiteve të sigurisë operative duke përfshirë: limitet e rrymës në përputhje me limitin termik, mbingarkesën e lejuar tranzitore dhe diapazonet e tensionit.” për operimin e sigurtë dhe zhvillimin e rrjetit të Sistemit të

Transmetimit, në përputhje me zhvillimet në Tregun Shqiptar dhe Rajonal të Energjisë, marrëveshjet dypalëshe, marrëveshjen Operacionale të Zonës Sinkrone dhe angazhimet e Shqipërisë në rajon.

Parametrat e sigurisë operative të detajuara në këtë dokument, konsiderohen në çdo proces të planifikimit të rrejtit, planifikimit operacional dhe skedulimit, operimit në kohe reale, alokimit e planifikimit të rezervave dhe shërbimeve ndihmëse, si dhe në masat për mbrojtjen dhe restaurimin e sistemit. Këto parime të sigurisë operative janë thelbësore për OST sh.a për të menaxhuar përgjegjësitë e saj për funksionimin e Sistemit në interkoneksion, me një nivel të lartë të koordinimit, besueshmërisë, cilësisë dhe qëndrueshmërisë. Arritja e një kuadri teknik të harmonizuar dhe të qëndrueshëm, duke përfshirë zbatimin e të gjitha proceseve të nevojshme të kërkuara për sigurinë e operimit, duke marrë parasysh sfidat aktuale dhe të pritshme, përfshirë rritjen e shpejtë të burimeve të rinovueshme të energjisë të tilla si burimet fotovoltaike, burimet hidrike me rrjedhje të lirë pa basen ujë mbledhës, të cilat kanë ndikim në operimin e qëndrueshëm të Sistemit janë një ndër sfidat që OST sh.a. do të përballlet gjithmon e më shumë në të ardhmen.

1.1 Gjendjet e Sistemit

Gjatë vitit 2019 sistemi ka funksionuar qëndrueshëm në kushte normale Operimi.

Përdorimi i sistemeve SCADA/EMS përbën një zhvillim të mëtejshëm në teknologjinë e kontrollit të rrejtit. Nëpërmjet kësaj platforme operohen, monitorohen dhe komandohen në kohë reale të gjitha nyjet e transmetimit, komandohen gjeneratorët për ulje/rritje të gjenerimit në varësi të nevojës së sistemit për të mos devijuar nga programi i shkëmbimit ndërkufitar, si dhe për të ruajtur frekuencën e sistemit, në përputhje me vlerat e planifikuara. Aktualisht nën kontrollin e AGC (Automatic Generation Control) janë 5 hidrocentrale, Fierze, Koman, Vau Dejës, Banja, dhe Fangu.

OST sh.a., nëpërmjet platformës SCADA/EMS komunikon në kohë reale me OST-të fqinje duke shkëmbyer të dhëna të nënstacioneve dhe nyjeve kritike.

Platforma SCADA/ EMS ka të integruar një sërë aplikacionesh të cilat janë në shfrytëzim të vazhdueshëm nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të realizuar me efikasitet menaxhimin e Sistemit Energjetik dhe përgatitjen e veprimeve përmirësuese, në mënyrë që të mbahet sistemi në gjendjen normale apo të kthehet në normalitet sa më shpejt të jetë e mundur në raste të avarive ose incidenteve.

Struktura e operimit të sistemit mbështetet në dy shtylla kryesore:

- Përpunimi i informacionit
- Monitorimi, mbrojtja, komanda dhe kontrolli




Figura 34 Skema e vlerësimit të Gjendjes së sistemit dhe rivendosja me gjendje normale operimi.

Analiza e sigurisë së sistemit përfshin:

- Vlerësimin e gjëndjes dhe monitorimin e topologjisë;
- Statusi i lidhjes ose vlerat elektrike (të tilla si tensionet, rrjedha e flukseve, këndi i rotorit)
- Analiza statike dhe dinamike e sigurisë së rrjetit;
- Parashikimi i ngarkesës;
- Menaxhimi i flukseve brenda kufijve të sigurisë operacionale ;
- Menaxhimin e humbjeve të energjisë;
- Profili i tensionit
- Masa operacionale ose masa të tjera për të parandaluar devijimin nga limitet maksimale dhe minimale të qarkut të shkurtër.
- Kontrollin fuqi-frekuencë etj.,

1.2 Rrjeti i Sigurisë së Telekomunikacionit

Rrjeti kryesor kombëtar i Telekomunikacionit që përdoret në veprimtarinë e OST sh.a., bazohet në infrastrukturë FO me OPGW të instaluar në linjat HV me nivele tensionet: 400kV; 220kV; 110kV. Standardet e përdorura janë ITU-T G.652-D dhe ITU-T G.655. Rrjeti logjik i komunikimit është ndërtuar me multiplex të tipit FOX515 e ABB. Të gjitha infrastrukturat kritike të shënuara më poshtë mbështeten plotësisht në infrastrukturën e telekomunikacionit të OST sh.a (fizike dhe logjike):

1. Sistemi SCADA/EMS (perishing SCADA kryesore dhe Back Up)
2. Sistemi i Matjes së OST sh.a
3. Platforma e funksionimit të tregut/sistemit të OST sh.a.

Një rrjet i sigurt, i besueshëm dhe me kosto efektive për komunikimin e të dhënave është një nga shtyllat kryesore të çdo sistemi transmetimi. OST aktualisht disponon një rrjet telekomunikacioni të sigurtë, i dedikuar për përdorim ekskluziv të funksionimit të rrjetit të transmetimit. Pothuajse në të gjitha linjat e sistemit të transmetimit kemi fibrën optike të instaluar.

Rrjeti i telekomunikacionit i mundëson personelit operativ veprimin në nivele të ndryshme të kontrollit, përfshirë komunikimin me OST-të fqinje, për të shkëmbyer komandat dhe informacionet. Ai siguron bartjen e sinjaleve të destinuara për funksionimin e sistemeve të mbrojtjes në rrjetet dhe objektet elektrike ose për kryerjen e veprimeve në distancë nga pajisjet automatike të kontrollit lokal. Për mirë-funksionimin e sistemit dhe sigurinë operationale sot disponojmë redundancën e kanaleve të transmetimit në rrjetin e telekomunikacionit, si dhe dublikimin e pajisjeve lidhëse (routerave).

1.3 Sistemi i Telekontrollit

Pajisjet e kontrollit dhe të sigurisë së rrjetit përbëjnë sistemin e telekontrollit të OST ku monitorohen në kohë reale:

- a) Flukset e fuqisë aktive dhe reaktive;
- b) Tensioni në zbara;
- c) Frekuenca dhe gabimi i kontrollit të rivendosjes së frekuencës në zonën e vet të LFC;
- d) Rezerva e fuqisë aktive dhe reaktive;
- e) Gjenerimi dhe konsumi.

Kjo duke u bazuar në telemetrinë dhe matjet në kohë reale në zonën e saj të observimit, duke marrë parasysh të dhënat strukturore dhe në kohe reale. Nëpërmjet sistemit të telemetrisë OST arrin të realizojë:

- Garantimin e monitorimit të Sistemit të Transmetimit, duke i siguruar Operatorit regjistrimin e të dhënave, në çdo kohë, për flukset e energjisë, topologjinë e rrjetit dhe vlerën e madhësie elektrike (frekuenca dhe tensioni) karakteristikë e operimit të Sistemit. Ky observim përfshin gjithashtu të dhënat nga OST-të fqinje, informacion që shërben për të menaxhuar kompleksitetin e shkëmbimeve në mënyrën më të mirë të mundshme, duke siguruar njëkohësisht besueshmërinë e operimit të sistemit të ndërlidhur;
- Garantimin e kontrollit të Sistemit të Transmetimit duke i ofruar Operatorit dhe pajisjeve automatike të kontrollit mundësinë e operimit nëpërmjet telekontrollit të çelësave dhe kontrollit automatik të centralizuar të frekuencës;

- Furnizimin me informacion të besueshëm për funksionet komplekse të analizës së sigurisë operative, të cilat i mundësojnë Operatorit:
 - o të parashikojë pasojat e ngjarjeve të tilla si, stakim të objekteve gjeneruese apo të elementeve të sistemit të transmetimit,
 - o përgatitjen e veprimeve përmirësuese.

Sistemi i telekontrollit është me rëndësi jetike për besueshmërinë dhe sigurinë e sistemit dhe për këtë arsye merren të gjitha masat për të siguruar vazhdimësinë e të gjitha karakteristikave relevante të tij:

OST sh.a disponon rrjet telekomunikacioni të dedikuar për operimin e sigurtë të sistemit. OST sh.a., ka një qendër rezervë të kontrollit të lidhur në rrjetin e telekomunikacionit të sigurisë dhe e pajisur me pajisje kontrolli. Të gjitha të dhënat që merren në distancë, thirren apo përftohen dhe përpunohen në mënyrë të dyfishtë me anë të kanaleve të ndryshme;

Burime energjie mikse, të pavarura të jashtme dhe të brendshme sigurojnë furnizim të pandërprerë me energji elektrike të pajisjeve të telekontrollit dhe pajisjeve të telekomunikacionit në QKD.

1.4 Menaxhimi i Kontrollit të Frekuencës

OST sh.a. siguron rezervat e nevojshme në rritje/ulje për mbajtjen e balancës së sistemit me anë të kontratës bilaterale të lidhur me KESH (gjeneruesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik). Gjithashtu për t'i paraprirë zhvillimeve në hapjen e tregut të sektorit të energjisë dhe funksionimin e tregut balancues, OST sh.a. ka parashikuar duke detajuar në Kodin e Transmetimit kërkesat teknike specifike dhe ligjore, gjithashtu ka filluar procesin për miratimin e Rregullave të Reja të Balancimit, ku përfshihen përcaktimi i madhësisë së këtyre rezervave, kriteret teknike që duhet të plotësojnë ato, proceset e parakualifikimit si të tilla, mundësinë e ndarjes së tyre me fqinjët, optimizimi i tyre etj. Siguria e operimit në lidhje me qëndrueshmërinë e frekuencës së sistemit realizohet nëpërmjet mbajtjes së balancës së vazhdueshme ndërmjet gjenerimit dhe kërkesës, duke siguruar cilësi të frekuencës dhe qëndrueshmëri të Zonës Sinkrone brenda parametrave të sigurisë operative.

1.5 Kontrolli i Tensionit dhe Menaxhimi i Fuqisë Reaktive

Kushtet e niveleve të tensionit në Sistemin e Transmetimit janë të lidhura direkt me situatën e energjisë reaktive në nyjet e sistemit. Mënyrat për kontrollin e tensionit dhe menaxhimin e fuqisë reaktive që përdor OST sh.a janë:

- I pavarur ose i koordinuar;
- Automatik ose manual (OST sh.a mund të instruktojë tarime të pikave të punës, ndryshim të ancafkave, me anë të veprimeve të koordinuara me OST-te fqinje, etj. sipas nevojave të sistemit)
- Përdorimi i mjeteve të kontrollit të veçanta ose mjeteve të kontrollit në mënyrë të vazhdueshme.

Shunt-reaktorët, kapacitorët dhe blloqet e baterive tashmë të instaluar në mënyrë manuale ose automatike në sistemin e transmetimit bëjnë menaxhimin e fuqisë reaktive duke mbajtur tensionin brenda parametrave të sigurisë së operimit. Gjithashtu marrëveshjet e lidhura me fqinjët dhe SAFA kanë dispozita të veçanta që sigurojnë kontrollin e tensionit dhe menaxhimin e fuqisë reaktive në ndërfaqe në mënyrë të koordinuar. Nga ana tjetër, të gjithë gjeneruesit e lidhur në rrjetin e transmetimit janë të detyruar të kontribuojnë në rregullimin e tensionit në ndërfaqe duke

gjeneruar/absorbuar energji reaktive sipas aftësive teknike në përputhje me dispozitat e Kodit të Transmetimit.

Sa më lart, me anë të kontratës për sigurimin e shërbimeve ndihmëse nga KESH, garantohet mbajtja e niveleve të tensionit dhe rezervat e fuqisë reaktive të disponueshme në sasi dhe në kohëzgjatje, në përputhje me termat dhe kushtet e saj.

Për të rregulluar tensionin dhe menaxhuar energjinë reaktive OST sh.a ka udhëzuar sipas nevojave të sistemit të gjithë përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit përfshirë dhe OSHEE për kryerjen e veprimeve operative të nevojshme për mbajtjen e niveleve të tensionit brenda kufijve të sigurisë së operimit. OST sh.a. sigurohet që të gjithë gjeneruesit të gjenerojnë ose të absorbojnë energjinë reaktive sipas nevojave të sistemit për të funksionuar brenda kufijve të sigurisë operationale, ku sipas dispozitave të Kodit të Transmetimit ata janë të detyruar ta ofrojnë pa pagesë këtë shërbim sipas instruksioneve të operatorit. Gjithashtu, sipas dispozitave të Kodit të Transmetimit dhe Kodit të Shpërndarjes nuk lejohet shkëmbimi i energjisë reaktive me sistemin si dhe koeficienti i fuqisë në ndërfaqe duhet të jetë 0.9.

OST ka menaxhuar tensionin dhe fuqinë reaktive sipas përcaktimeve në kodin e transmetimit dhe ka mbajtur sistemin brenda parametrave të sigurisë operationale. OST sh.a. raporton se gjatë vitit 2019 në sistem nuk janë shënuar ngjarje apo cënim i kufijve të sigurisë operationale.

1.6 Menaxhimi i Rrymës së Lidhjes së Shkurtër

Me qëllim funksionimin e sigurtë të sistemit të transmetimit, për të parandaluar nga dëmtimi të gjitha llojet e objekteve të gjenerimit, elementet e sistemit të transmetimit dhe pajisjeve të lidhura me të, si dhe për të ruajtur sigurinë e personelit, me anë të sistemit përkatës të mbrojtjes OST realizon:

- Llogaritjen e saktë të rrymave të lidhjes së shkurtër.
- Monitorimin e rrymave të lidhjes së shkurtër dhe marrjen e masave përmirësuese, dhe parandaluese në qoftë se cënohen kufijtë e sigurisë operative.
- Sigurimin e informacionit dhe të komunikimit me OST-të fqinje, OSHEE dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit, në mënyrë që të jenë në gjendje të marrin në konsideratë efektin e sistemeve të tjera të transmetimit dhe shpërndarjes.

Menaxhimi i rrymave të lidhjeve të shkurtra realizohet nëpërmjet shkyqjes së shpejtë dhe selektive të pjesës që ndodhet në qark të shkurtër.

1.6.1 Menaxhimi i fluksit të energjisë

Menaxhimi i fluksit të energjisë ka të bëjë me krijimin apo përcaktimin e mjeteve operationale për të mbajtur rrjedhën e flukseve të energjisë brenda kufijve të sigurisë operative në çdo element të sistemit të transmetimit. Për të monitoruar dhe kontrolluar parametrat operationale është e nevojshme që të ketë informacion të saktë mbi gjendjen e sistemit dhe vlerësimin e tij. OST kontrollon parametrat operationale brenda zonës së vet të përgjegjësisë dhe në mënyrë të koordinuar, merr në konsideratë parametrat operative nga zona e observimit që përfshin pjesë të OST-ve fqinje.

Çdo element i Sistemit të Transmetimit ka kufijtë e sigurisë operative në drejtim të rrjedhës së energjisë. Këto kufizime janë të rëndësishme për mbrojtjen e pajisjeve dhe njerëzit në afërsi të një elementi të caktuar të Sistemit të Transmetimit, duke marrë parasysh kufizimet teknike të materialeve të përdorura, me qëllim shmangien e dëmtimit apo vjetrimin e parakohshëm të pajisjes. Për të qenë në gjendje për të përballuar avaritë në sistem, nga ana e OST përgatiten veprimet

përmirësuese individuale dhe të koordinuara dhe zbatohen kur është e nevojshme, për të parandaluar shkeljen e limiteve të Sigurisë Operative dhe për të suportuar kthimin në normalitet në rastet e gjendjes së alarmit ose gjendjes së emergjencës.

1.6.2 Analiza e kontigjencave dhe trajtimi

OST sh.a. përfiton analiza sigurie nga Qendra e Koordinimit të Sigurisë, SCC Ltd. Belgrade (Regional Security Coordinator for SEE) nëpërmjet një kontrate si përdorues i shërbimeve të SCC Ltd. Belgrade. Kjo kontratë përfshin 5 shërbimet e mëposhtme:

- Vlerësimi dhe përmirësimi i modelit të rrjetit individual/të përbashkët (IGM/CGM),
- Llogaritja e koordinuar e kapacitetit (ndërkufitar),
- Koordinimi i analizës së sigurisë (përfshirë masat përmirësuese, parandaluese),
- Mjaftueshmëria, besueshmëria e punës në terma afat shkurtër/mesëm,
- Koordinimi i planifikimit të remonteve.

Siguria e operimit të sistemit është shkaku i realizimit të analizave të kontigjencës, të cilat OST i realizon duke simuluar stakim të elementeve të Sistemit të Transmetimit. Kjo analizë kryhet duke përdorur modelin individual të OST dhe modelin e përbashkët të rrjetit, duke respektuar kufijtë e sigurisë operative dhe ndërkohë bëhet përgatitja për kryerjen e veprimeve përmirësuese para dhe pas incidentit, kur kërkohet nga rezultati i analizës. Parimet kryesore që ndiqen në lidhje me analizën e kontigjencave, janë:

- Sigurimi i parandalimit dhe/ose përmirësimit për sa i përket veprimeve përmirësuese, të kërkuara për të ruajtur sigurinë e operimit, për të gjitha kontingjencat e besueshme që ndikojnë në sistemin e transmetimit.
- Koordinimi i analizave dhe veprimeve përmirësuese, kurdo që është e nevojshme, për të siguruar rezultatin e dëshiruar - ruajtjen e sigurisë operative në sistem dhe në interkoneksion.
- Mbështetja në të dhënat e duhura dhe informacionin në kohë reale dhe atë të bazuar në parashikimin e ngarkesave. Përdorimi i modelit të përbashkët të rrjetit rajonal dhe shkëmbimi i të gjitha të dhënave të nevojshme dhe informacionit ndërmjet OST, OSHEE dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit.
- Suportimi i përpunimit të dispozitave të standardeve pan-Evropiane për analizat e kontigjencave për ruajtjen e sigurisë së operimit duke maksimizuar përdorimin e sistemit.

1.6.3 Mbrojtja

Me qëllim mbrojtjen e aseteve të sistemit të transmetimit nga dëmtimet OST ka instaluar pajisjet e mbrojtjes së nevojshme dhe pajisjet rezervë të mbrojtjes, duke koordinuar me mbrojtjen e pajisjeve të përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit. Çdo pesë vjet, OST shqyrton dhe analizon konceptet dhe strategjinë e mbrojtjes.

OST operon mbrojtjen e sistemit të transmetimit të saj me tarime (set-point) që sigurojnë besueshmëri, shpejtësi dhe selektivitet të pastrimit të avarisë (l.sh.), duke përfshirë mbrojtjen rezervë për pastrimin e l.sh. në rast të mosfunksionimit të sistemit kryesor të mbrojtjes. Funkcionaliteti dhe statusi i gjendjes së sistemit monitorohen, komunikohen dhe koordinohen ndërmjet OST-ve fqinje dhe palëve të tjera të prekura nga sistemi i mbrojtjes.

Skemat e sistemit të mbrojtjes përdoren për të zbuluar kushtet anormale të sistemit dhe ndërmarrin veprime korigjuese të paracaktuara, për të ruajtur integritetin e sistemit, me një performancë të pranueshme të sistemit, në mënyrë të koordinuar. Funkcionet për mbrojtjen e sistemit analizohen duke u mbështetur në llogaritjet e rrjetit, duke konsideruar funksionimin korrekt dhe jo korrekt.

Nëse parashikohen pasoja të papranueshme, funksionaliteti dhe redundanca e skemës së mbrojtjes së sistemit përshtaten në përputhje me rrethanat për të përmbushur kërkesat e sigurisë operacionale.

1.6.4 Menaxhimi i qëndrueshmërisë dinamike

OST monitoron qëndrueshmërinë dinamike të Sistemit të Transmetimit në termat e tensionit, frekuencës dhe qëndrueshmërisë së këndit të rotorit, me studime off-line me matje në zonë të gjerë, duke përfshirë shkëmbimin e të dhënave relevante me OST-të e tjera kur është e nevojshme, në mënyrë që të jetë në gjendje të marrë masat e nevojshme korrigjuese kur siguria operative e sistemit është në rrezik.

OST sh.a realizon studime për vlerësimin e qëndrueshmërisë dinamike (VSD), në mënyrë që të identifikohen kufijtë e qëndrueshmërisë dhe problemet e mundshme të saj në sistemin e transmetimit. Studimet e VSD koordinohen ndërmjet OST-ve në Zonën Sinkrone dhe kryhet për të gjithë ose një pjesë të rëndësishme të Zonës Sinkrone.

Qëllimi i VSD është të sigurojë ndërgjegjësimin e operatorit të OST në lidhje me gjendjen aktuale dhe parashikimin në të ardhmen të situatës së sistemit në lidhje me qëndrueshmërinë, në situatën (N) dhe në atë të mundshme (N-1). Përveç kësaj, VSD mbështet vendimet ndaj veprimeve përmirësuese sa më efikase, për parandalimin e incidenteve ose korrigjimin e pasojave të tyre, nëse ato ndodhin.

Përdorimi i gjerë i VSD lejon aplikime të ndryshme, jo vetëm në kohë reale, por edhe në fazat e planifikimit operacional. Staf i operativ i OST është trajnuar për përdorimin e VSD, si dhe për mirëmbajtjen e vazhdueshme të modeleve dhe të simulatorit përkatës.

1.6.5 Trajnimi Operativ dhe Certifikimi

Në përputhje me kërkesat dhe parimet minimale për sigurinë operative, për të mbajtur në operim të vazhdueshëm Sistemin Shqiptar të Transmetimit të ndërlidhur me Sistemin Evropian të Transmetimit, OST trajnon dhe çertifikon Operatorët e Sistemit, si dhe personelin tjetër operativ. Kjo bën të mundur që ata të veprojnë në mënyrë të sigurtë gjatë të gjitha situatave operacionale, duke reaguuar ndaj kushteve operative jonormale në afatet kohore përkatëse, në mënyrë të koordinuar me OST-të e tjera.

Proçesi i trajnimit përfshin:

- Trajnimin fillestar,
- Zhvillimin e vazhdueshëm të personelit dhe
- Ri-vlerësimin e rregullt të çertifikimit.

Kodi i Operimit vendos detyrimin për OST që të ketë të aktivizuar programet e vazhdueshme zhvillimore për stafin e saj në dhomën e kontrollit dhe të bashkërendojë e bashkëpunojë në trajnimet ndër-rajonale për çështje të transmetimit rajonal. Staf i trajnuar i OST sh.a është në gjendje të veprojë në mënyrë efikase në balancimin e sistemit dhe në maksimizimin e mundësisë për transfertat ndërkufitare të cilat së bashku ofrojnë përfitime reale ekonomike për klientët. Trajnimi i stafit operativ të OST në mënyrë të vazhdueshme ndikon drejtëpërdrejtë në zvogëlimin e avarive të mëdha në sistem të cilat mund të çojnë në ndërprerje të furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve.

II. BALANCA E PARASHIKUAR E KËRKESËS DHE FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE NË TREGUN E BRENDSHËM PËR NJË PERIUDHË PESËVJEÇARE

Bazuar në të dhënat historike të OST sh.a, duke konsideruar rritjen potenciale të gjenerimit të prodhuesve privat të energjisë elektrike PPE + PVE dhe reduktimin e humbjeve jo teknike në rrjetin e shpërndarjes, është vlerësuar që rritja e pritshme e vëllimit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST sh.a, të jetë e rendit rreth 1%. Mbi këtë vlerësim, duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji, është bërë parashikimi i parametrave kryesore energjetike dhe sigurimi i balancës së sistemit për pesë vjeçarin në vijim 2020 - 2024.

Të dhënat për balancën në sistemin energjetik për periudhën 2020 – 2024 jepen në tabelat e mëposhtme:

Viti 2020

Flasifikimi i parametrave kryesorë energjetikë për vitin 2020														
Viti 2020		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi për OSHEE	GWh	707	568	519	456	452	466	519	559	666	696	506	657	6,549
Konsumi për Klientin e lidhur në transmetim	GWh	29	58	86	88	86	86	77	71	81	96	110	112	981
Humbje + N.V.	GWh	17	16	15	16	17	16	17	17	12	15	16	17	190
Kërkesa totale	GWh	753	642	620	560	555	568	613	647	760	807	632	787	7,520

Flasifikimi i parametrave kryesorë energjetikë për vitin 2020														
Viti 2020		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Produktimi	GWh	565	551	662	597	600	502	662	622	251	626	636	661	6,229
KESH	GWh	259	318	266	262	259	275	297	292	221	228	266	261	5,474
PVE	GWh	97	94	125	155	168	76	56	55	51	69	99	129	1,154
PPE	GWh	89	129	171	180	192	151	89	76	79	119	166	171	1,601

Flasifikimi i parametrave kryesorë energjetikë për vitin 2020														
Viti 2020		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Integrimi	GWh	206	69	-22	-26	-65	65	171	22.6	209	179	166	126	1,292
OSHEE	GWh	251	127	68	60	66	11.6	166	21.0	196	187	162	167	1,722
F→K	GWh	29	58	86	88	86	86	77	71	81	96	110	112	981
OST	GWh	17	16	15	16	17	16	17	17	12	15	16	17	190
PPE (skajom)	GWh	-89	-129	-171	-180	-192	-151	-89	-76	-79	-119	-166	-171	-1,601

Viti 2021

Flançioni i parametrit kryesor energjeticë për vitin 2021														
Viti 2021		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi për OSHEE	GWh	720	560	530	665	660	675	530	570	675	505	515	670	6,475
Konsumi për Klientët e Indur në transmetim	GWh	60	65	90	90	90	85	85	70	75	95	110	115	1,030
Rimbje + N.V.	GWh	15	15	15	16	17	16	17	18	16	15	16	18	195
Shërbesa totale	GWh	795	640	635	771	767	776	632	658	766	615	641	803	7,700

Flançioni i parametrit kryesor energjeticë për vitin 2021														
Viti 2021		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Produksi	GWh	590	520	600	600	610	565	670	660	625	500	520	675	6,525
KESH	GWh	280	280	295	250	255	260	280	290	280	210	295	275	3,550
FVLE	GWh	100	95	120	160	165	130	95	80	55	70	110	120	1,300
PPK	GWh	110	145	175	190	190	155	95	90	90	120	145	170	1,675

Flançioni i parametrit kryesor energjeticë për vitin 2021														
Viti 2021		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Impoziti	GWh	208	120	25	-29	-62	21	162	218	129	115	91	128	1,175
OSHEE	GWh	260	185	105	55	60	85	155	220	160	125	110	165	1,625
F→K	GWh	60	65	90	90	90	85	85	70	75	95	110	115	1,030
OBT	GWh	15	15	15	16	17	16	17	18	16	15	16	18	195
PPK (ekspor)	GWh	-110	-145	-175	-190	-190	-155	-95	-90	-90	-120	-145	-170	-1,675

Viti 2022

Flançioni i parametrit kryesor energjeticë për vitin 2022														
Viti 2022		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi për OSHEE	GWh	720	560	530	665	660	675	530	570	680	510	520	700	6,520
Konsumi për Klientët e Indur në transmetim	GWh	90	90	100	95	95	92	95	95	80	100	115	120	1,158
Rimbje + N.V.	GWh	15	15	16	16	17	17	18	18	15	16	16	18	200
Shërbesa totale	GWh	825	655	646	776	772	785	643	683	775	626	651	838	7,878

Flançioni i parametrit kryesor energjeticë për vitin 2022														
Viti 2022		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Produksi	GWh	620	525	615	620	620	570	680	650	660	520	565	665	6,730
KESH	GWh	280	280	295	250	255	260	280	290	280	210	295	275	3,550
FVLE	GWh	110	100	140	170	175	140	100	70	65	80	120	120	1,400
PPK	GWh	140	145	180	200	200	170	100	90	95	120	150	180	1,780

Flançioni i parametrit kryesor energjeticë për vitin 2022														
Viti 2022		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Impoziti	GWh	198	120	21	-66	-58	15	162	223	125	106	86	125	1,148
OSHEE	GWh	220	180	95	65	70	75	150	210	125	120	105	195	1,570
F→K	GWh	90	90	100	95	95	92	95	95	80	100	115	120	1,158
OBT	GWh	15	15	16	16	17	17	18	18	15	16	16	18	200
PPK (ekspor)	GWh	-140	-145	-180	-200	-200	-170	-100	-90	-95	-120	-150	-180	-1,780

Viti 2023

Planifikimi i parametrave kryesore energjetike per vitin 2023														
Viti 2023		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	720	560	535	465	460	475	530	570	480	510	520	705	6,530
Konsumi per K	GWh	110	90	110	115	120	119	110	110	90	105	115	130	1,324
Humbje + N.V.	GWh	18	16	17	16	17	17	18	19	15	16	17	19	205
Kerkesa totale	GWh	848	666	662	596	597	611	658	699	585	631	652	854	8,059

Planifikimi i parametrave kryesore energjetike per vitin 2023														
Viti 2023		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Prodhimi	GWh	650	535	640	645	655	575	480	480	450	530	570	685	6,875
KESH	GWh	380	280	295	250	255	280	280	290	280	310	295	375	3,550
PVE	GWh	120	110	155	175	180	145	100	80	70	85	120	130	1,470
PPE	GWh	150	145	190	220	220	170	100	90	100	135	155	180	1,855

Planifikimi i parametrave kryesore energjetike per vitin 2023														
Viti 2023		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Importi	GWh	198	131	22	-49	-58	36	178	239	135	101	82	169	1,184
OSHEE	GWh	220	170	85	40	25	70	150	200	130	115	105	200	1,510
F->K	GWh	110	90	110	115	120	119	110	110	90	105	115	130	1,324
Ost	GWh	18	16	17	16	17	17	18	19	15	16	17	19	205
PPE (eksport)	GWh	-150	-145	-190	-220	-220	-170	-100	-90	-100	-135	-155	-180	(1,855)

Viti 2024

Planifikimi i parametrave kryesore energjetike per vitin 2024														
Viti 2024		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	725	565	540	470	462	477	535	575	482	513	525	710	6,579
Konsumi per KK	GWh	115	100	115	125	130	130	120	120	100	115	130	150	1,450
Humbje + N.V.	GWh	18	16	17	16	17	17	18	19	15	16	18	20	207
Kerkesa totale	GWh	858	681	672	611	609	624	673	714	597	644	673	880	8,236

Planifikimi i parametrave kryesore energjetike per vitin 2024														
Viti 2024		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Prodhimi	GWh	670	555	670	665	680	600	495	480	470	545	585	695	7,110
KESH	GWh	380	280	295	250	255	260	280	290	280	310	295	375	3,550
PVE	GWh	130	120	170	185	190	160	105	90	80	95	130	140	1,595
PPE	GWh	160	155	205	230	235	180	110	100	110	140	160	180	1,965

Planifikimi i parametrave kryesore energjetike per vitin 2024														
Viti 2024		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Importi	GWh	188	126	2	-54	-71	24	178	234	127	99	88	185	1,126
OSHEE	GWh	215	165	75	35	17	57	150	195	122	108	100	195	1,434
FK->KK	GWh	115	100	115	125	130	130	120	120	100	115	130	150	1,450
Ost	GWh	18	16	17	16	17	17	18	19	15	16	18	20	207
PPE (eksport)	GWh	-160	-155	-205	-230	-235	-180	-110	-100	-110	-140	-160	-180	(1,965)

Figura 35 Të dhënat për balancën në sistemin energjetik për periudhën 2020 – 2024.

III. NIVELI I PRITSHËM I KËRKESËS DHE PERSPEKTIVA E SIGURISË SË FURNIZIMIT PËR NJË PERIUDHË PESË DERI NË PESËMBEDHJETE VJEÇARE NGA DATA E RAPORTIT

Në bazë të të dhënave historike të zhvillimit të ngarkesës, duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji, është bërë parashikimi i kërkesës për energji elektrike sipas tre skenarëve, Optimist, realist dhe pesimist të mundshëm, siç jepet në tabelën e mëposhtme, për një periudhë 20 vjeçare: Skenari realist i kërkesës për energji elektrike merr në konsideratë një rritje të kërkesës për energji elektrike në vend rreth 2 % në vit. Skenari optimist i kërkesës për energji elektrike merr në konsideratë në rritje të kërkesës për energji elektrike në vend rreth 3 % në vit. Skenari pesimist i kërkesës për energji elektrike merr në konsideratë në rritje të kërkesës për energji elektrike në vend rreth 1 % në vit. Skenari bazë për vlerësimin e ecurisë së kërkesës për energji elektrike në vend për periudhën në vijim merret skenari realist i rritjes së kërkesës për energji elektrike në vendin tonë rreth 2 % në vit.

2020 – 2039

Vitet	Skenari optimist i kërkeses per energji elektrike	Skenari realist i kërkeses per energji elektrike	Skenari pesimist i kërkeses per energji elektrike
2020	7,750	7,520	7,309
2021	8,021	7,700	7,382
2022	8,302	7,878	7,456
2023	8,592	8,059	7,530
2024	8,893	8,236	7,606
2025	9,204	8,418	7,682
2026	9,471	8,603	7,774
2027	9,746	8,792	7,867
2028	10,028	8,977	7,977
2029	10,319	9,165	8,089
2030	10,618	9,358	8,202
2031	10,884	9,554	8,317
2032	11,156	9,755	8,434
2033	11,435	9,960	8,569
2034	11,721	10,169	8,706
2035	12,014	10,382	8,845
2036	12,290	10,601	8,987
2037	12,573	10,823	9,130
2038	12,862	11,050	9,276
2039	13,158	11,282	9,425

Figura 36 Parashikimi afatgjatë i kërkesës për energji elektrike për periudhën 2020 – 2039 sipas secilit skenar.




Figura 37 Parashikimi afatgjatë i kërkesës për energji elektrike për periudhën 2020 – 2039.

IV. KAPACITETI SHITESË PRODHUES I PROPOZUAR, I PLANIFIKUAR APO NË FAZË NDËRTIMI

Të dhënat e parashtruara më poshtë paraqesin centrale të energjisë elektrike të cilat janë lidhur në rrjetin e transmetimit në vitin 2019, janë në fazë ndërtimi, ose kanë marrë miratimin paraprak për lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe janë:

- **Centrale Hidrike që kanë lidhur marrëveshje për lidhje në vitin 2019 dhe priten të energjizohen gjatë vitit 2020:**
 1. HEC Moglica (177 MW) – DEVOLL HYDROPOWER sh.a.
 2. HEC-et Seta (14.9 MW) – Hydro Seta sh.p.k.
 3. HEC Lashkiza (5.2 MW) – HEC Lashkiza sh.p.k.
 4. HEC-et Darsi (20.52 MW) – HENZ ENERGY sh.p.k.
 5. HEC Slabinja 2E (6 MW) – Hydropower Elektrik sh.p.k.
- **Centrale që kanë nënshkruar marrëveshje lidhje në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2019:**
 1. HEC Veleshica (13.9 MW) – KALISI HYDROPOWER sh.p.k.
- **Centrale që kanë marrë miratim paraprak për lidhje në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2019:**
 1. Park FV Darzezë (70 MW) - PARABEL ALBANIA sh.p.k.
 2. Park Eolik Fleti (12 MW) – VENTUS sh.p.k.
 3. Park Eolik Karaburun (10 MW) – EURUS sh.p.k.
 4. Park Eolik Karaburun (10 MW) – WF ENERGY sh.p.k.
 5. Park Eolik Vlorë (30 MW) – Carinthianwinds Albania sh.p.k.

V. PARASHIKIMI I INVESTIMEVE, PËR JO MË PAK SE PESË VITET E ARDHSHME, QË PLANIFIKOHEN TË REALIZOHEN NGA OST APO ÇDO PALË TJETËR, LIDHUR ME RRRITJEN E KAPACITETIT NDËRKUFITAR TË INTERKONEKSIONIT

V.1 Parimet e menaxhimit të kufizimit të kapaciteteve në linjat ekzistuese dhe ato të planifikuara të sistemit të transmetimit.

Me investimet e bëra gjatë viteve të fundit në sistemin e transmetimit, kryesisht rehabilitimi i rrjetit 110 kV, ndërtimi i linjave të reja 110 kV ku vlen të përmendet Unaza e Jugut, është bërë e mundur plotësimi i kriterit të sigurisë N-1 në rrjetin e brendshëm të Sistemit për të gjitha regjimet e punës, dhe nuk kemi probleme të kufizimit të kapaciteteve transmetuese. Lidhur me menaxhimin e kapaciteteve ndërkufitare, në zbatim të rregullave të ENTSO-E, zbatohet procedura e mëposhtme:

Përcaktimi i kapacitetit transmetues ndërkufitar, NTC, aktualisht bëhet sipas Marrëveshjeve bilaterale ndërmjet OST-ve fqinje dhe bazohet në Manualin Operacional të ENTSO-E, respektivisht në Politiken Nr. 4, dhe Aneksin e saj. Është e rëndësishme të theksohet dallimi i qartë ndërmjet vlerave komerciale dhe atyre fizike, pasi siç dihet, ekzistojnë dy sete definimesh, një i lidhur me vlerat e programit (skedulimit) dhe tjetri me fluksin fizik të energjisë elektrike, që në shumicën e rasteve nuk përputhen kur merret në konsideratë një interkonektor i veçuar nga pjesa tjetër e rrjetit. Komplexiteti i anës fizike të fluksit të energjisë trajtohet nga OST-të, që janë përgjegjëse përkundrejt Autoriteteve përkatëse për kryerjen e kësaj detyre në mënyre jo diskriminuese.

Periudhat kohore të përcaktimit të kapacitetit transmetues ndërkufitar.

Proçesi i përcaktimit të NTC prodhon rezultate për periudhat kohore: vjetore, mujore, një ditë përpara (D-1) dhe brenda ditës.

Të dhënat për modelin individual të rrjetit

Sipas dispozitave të Kodit të Transmetimit, Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit i mundësojnë OST-së informacionin e nevojshëm për përcaktimin e kapacitetit transmetues. Ky informacion përfshin por nuk kufizohet në:

- Informacionin lidhur me të dhënat teknike;
- Informacionin lidhur me disponueshmërinë e pajisjeve dhe elementëve të rrjetit;
- Informacionin lidhur me skedulimin e njësisve gjeneruese.

Për çdo periudhë kohore të përcaktimit të kapacitetit, çdo njësi gjeneruese apo ngarkese i mundëson OST-së të gjitha të dhënat e specifikuar, dhe ndërkohë

Inputi kryesor për llogaritjen e NTC-së është dokumenti për përgatitjen e modelit rajonal të rrjetit “SEE regional common grid model for different time horizons” i përgatitur nga Grupi Rajonal i Evropës Jug-Lindore nën Komitetin e Tregut të ENTSO-E. Ky dokument ofron dy elemente themelore për proçesin e llogaritjes së NTC:

- Tabela e harmonizuar e rastit bazë të shkëmbimit (BCE);
- Modeli i Bashkuar i Rrjetit Rajonal për periudha kohore të ndryshme.

OST-të e SEE përgatisin supozimet për Rastin Bazë të Shkëmbimit (BCE), të cilat janë parashikimet e skeduleve tregtare në modelin mujor dhe i nisin ato OST-së koordinatore. Këto tabela përgatiten në bazë të historikut të fundit dhe eksperiencës së OST-vë. OST-ja koordinatore

pasi mbledh të gjithë tabelat e BCE-vë të OST-ve të rajonit SEE bënë harmonizimin e saj. Totalët e shkëmbimeve të deklaruara në këto tabela vendosen më pas në modelet individuale të çdo OST-je.

Për çdo periudhë kohore të përcaktimit të kapacitetit, një Model i Bashkuar i Rrjetit Rajonal krijohet në nivel rajoni duke bashkuar inputet (modelet individuale) nga të gjithë Operatorët e Sistemit, nëpërmjet funksionit të OST-se koordinatorë. Funksioni i OST-së koordinatorë performohet nga një OST e SEE në nivel mujor. Në kuadrin e grupit të punës RG SEE, Operatorët e Transmetimit kanë rënë dakord që aktiviteti i koordinimit rajonal të bëhet me rotacion me bazë mujore.

Rolin e koordinatorit për skenarët referenca vjetore, dimër dhe verë, për zonën sinkrone të Evropës Kontinentale (RG CE), e kryejnë qendrat e koordinimit të sigurisë (RSC) CORESO, TSCNET, ose SCC Ltd Belgrade, nëpërmjet të dhënave që sigurohen në nën grupin e punës të ENTSO-E Network Modelling and Forecasting Tools (NMFT).

Skenarët e Modelit të Bashkuar të Rrjetit

Të gjitha OST-ët e SEE emetojnë një skenar bazë për çdo periudhë kohore të përcaktimit të kapacitetit, i cili krijohet në Modelin e Bashkuar të Rrjetit.

Në rast të nevojës së përcaktimit të skenarëve shtesë për periudha kohore, OST-ët fqinje duhet të bien dakord rreth periudhave karakteristike shtesë, duke konsideruar programin e mirëmbajtjes (remonteve) dhe angazhimin e gjeneratorëve, të cilët mund të ndikojnë përcaktimin e vlerës së NTC-së.

Metodologjia e Kalkulimit të NTC-së.

OST sh.a dhe çdo Operator i Sistemit të transmetimit të rajonit, do të përdorë metodologjinë e përshkruar në Manualin Operacional të ENSTO-E “Politika 4” mbi Koordinimin e Planifikimit Operacional.

3. Vlera e NTC-së, Kapaciteti Neto i Transmetimit përcaktohet si diferencë e kapacitetit total të transmetimit (TTC) dhe marzhit të sigurisë së transmetimit (TRM).

$$NTC = TTC - TRM$$

Kufizimet e Sigurisë Operacionale

Gjatë procesit të përcaktimit të kapaciteteve të transmetimit në interkoneksion, OST ka respektuar Kufizimet e Sigurisë Operative të shprehura më poshtë dhe të përcaktuara në Kodin e Sigurisë Operacionale. Për vitin 2019 nuk rezultojnë të raportuara probleme që lidhen në sigurinë operacionale në sisteminin tonë të transmetimit në përgjithësi dhe në linjat e interkoneksionit në vençanti:

Përcaktimi i Marzhit të Sigurisë (TRM).

Përcaktimi i madhësisë së Marzhit të Sigurisë bazohet në përjasje statistikore, duke marrë parasysh evidencat historike dhe parashikimet në të ardhmen. Marzhi i Sigurisë përfshin elementet e mëposhtme:

- Devijimet e paqëllimshme të flukseve fizike gjatë operimit, për shkak të funksionimit fizik të rregullimit fuqi-frekuencë,
- Shkëmbimet emergjente midis OST-ve për tu përballur në kohë reale me situata të disbalancave të papritura,

- Pasaktësitë, p.sh në mbledhjen e të dhënave dhe matjeve,
- Pasaktësitë në rastin bazë të përdorur për llogaritje, si parashikimet e gjenerimit, konsumit, shkëmbimeve dhe topologjisë së rrjetit, etj.
- Aktualisht, në Marrëveshjet Bilaterale, është pranuar që madhësia e marzhit TRM të jetë 100 MW në kufirin me Malin e Zi dhe Greqinë respektivisht, ndërsa në kufirin me Kosovën (Serbinë) 50 MW

Harmonizimi i Rezultateve të Përcaktimit të Kapacitetit NTC.

Vlera vjetore e NTC për çdo kufi dhe drejtim fluksi, llogaritet duke konsideruar vlerën minimale mujore që është përdorur, shfrytëzuar, në tre vitet e fundit, dhe rakordohet me OST-të fqinje respektive brenda muajit Nëntor të çdo viti.

Vlerat mujore të NTC, llogariten dhe harmonizohen me OST-të fqinje për çdo kufi veçmas, brenda datës 6 të çdo muaji, për muajin e ardhshëm. Për këtë ndiqet procedura e mëposhtme:

- a) 10 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen të dhënat, modeli nacional me të gjitha nyjet e nivelit 220/400 kV, ndërmjet OST-ve, në formatin e aprovuar UCT, përfshirë rezervën e fuqisë aktive për rritjen/uljen e gjenerimit dhe të dhëna mbi programin e remonteve (elementët jashtë pune) për periudhën e konsideruar,
- b) 5 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, kryhen llogaritjet (simulimet) për vlerat e TTC/NTC, që kryhen me anë të analizatorit të rrjetit (softit TNA) me të cilin janë të pajisur të gjitha OST-të e rajonit,
- c) 2 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen vlerat e përcaktuara të TTC për çdo kufi dhe fillon procesi i harmonizimit të tyre. Në rast mospërputhje të vlerave të llogaritura dhe nëse palët nuk arrijnë të bindin njëra tjetrën, atëherë vlera më e vogël e TTC hyn automatikisht në fuqi.

Në rast të ndryshimeve sinjifikative të situatës së Sistemit në krahasim me situatën e parashikuar, kur janë llogaritur kapacitetet ndërkufitare, OST-të fqinje, pas shkëmbimit të të dhënave relevante të situatës së re, bëjnë ri-kalkulimin e kapacitetit ndërkufitar dhe përcaktojnë bashkërisht vlerat e reja të NTC e respektivisht ato të ATC.

Alokimi i kapacitetit ndërkufitar për pjesëmarrësit e tregut në rajonin tonë bëhet nga Zyra e Ankandit të Koordinuar SEE CAO në Podgoricë.

Të dhënat për ankandet e kapaciteteve të realizuara për vitin 2019 jepen në tabelën në figurën 67, e cila pasqyron të dhënat e alokimit të kapaciteteve në transmetim. Kjo tabelë jep një informacion të plotë mbi kapacitetet e alokuara në të gjitha kufijtë dhe në të dy drejtimet import dhe eksport, si dhe çmimet përkatëse me të cilat janë shitur kapacitetet e interkoneksionit në këto ankande.

V.2 Modelet e pritshme të prodhimit, furnizimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit, duke mundësuar marrjen e masave për menaxhimin e kërkesës.

Siç edhe është dhënë edhe më sipër është kryer parashikimi i kërkesës për energji elektrike, mbulimi i saj nëpërmjet prodhimit vendas dhe importit për pesë vitet e ardhshme, 2020-2024. Të gjitha këto jepen të grupuara në tabelën e mëposhtme:

Viti	2020	2021	2022	2023	2024
Prodhimi Vendas [GWh]	6,229	6,525	6,730	6,875	7,110
Shkëmbimi (import) [GWh]	1,291	1,175	1,148	1,184	1,126
Konsumi [GWh]	7,520	7,700	7,878	8,059	8,236

Figura 38 Parashikimi i kërkesës për energji elektrike, mbulimi i saj nëpërmjet prodhimit vendas dhe importit për pesë vitet e ardhshme, 2020-2024.

V.3 Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian .

OST kryen studime të vazhdueshme si për zona të veçanta të rrjetit të transmetimit ashtu edhe të lidhjes së sistemit elektroenergjetik Shqiptar me sistemet e vendeve fqinje. Studimet më të rëndësishme dhe që kanë rëndësi të veçantë kryhen në bashkëpunim me institucionet studimore ndërkombëtare në kuadrin e WBIF (Western Balkans Infrastructure Facility).

Gjatë fazave të planifikimit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit me qëllim: (i) Rehabilitimin dhe Fuqizimin e rrjetit të transmetimit, (ii) Krijimin e nyjeve të reja lidhëse, (iii) përmirësimin e procesit të menaxhimit, kontrollit, matjes etj., OST merr në konsideratë zhvillimin kombëtar dhe rajonal në përputhshmëri të plotë me direktivat e ENTSO-E (Rrjetit Evropian të Operatoreve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike).

Projektet në proces implementimi dhe ato të planifikuara kryesisht lidhen me përmirësimin e sistemit elektro energjetik Shqiptar. Edhe projektet e vitit 2019 të paraqitura në tabelën e Realizimit të investimeve nga OST sh.a. konstatohet një numër i konsiderueshëm projektesh me qëllim rehabilitimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit, kryesisht rrjetit 110 kV.

V.4 Informacion i hollësishëm i OST, për investimet e parashikuara për linjat e interkoneksionit dhe për ndërtimin e linjave të brëndshme të rrjetit, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në linjat e interkoneksioneve ndërkufitare

Nga pikëpamja strategjike, projektet që përforcojnë lidhjet interkonjektive me rajonin, duke krijuar kushte më të mira për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajonin e Evropës Juglindore, janë:

- **Ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 kV Elbasan2 (Shqipëri) – Bitola (Maqedoni) dhe Elbasan2 – Fier, si dhe zgjerimi i nënstacioneve Elbasan2 dhe Fier.**

Financimi i këtij projekti, do të sigurohet nga Bashkëpunimi Gjermano-Shqiptar i Zhvillimit.

Ky projekt përforcon lidhjet interkonjektive me rrjetin rajonal të energjisë elektrike, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon, zhvillon rrjetin 400 kV në zonën Jugore të Shqipërisë ku parashikohen të zhvillohen burimet e ardhshme të prodhimit të energjisë elektrike dhe si pjesë e infrastrukturës së Korridorit të Tetë Evropian krijon mundësi të mira për lidhje nëpërmjet kabllit nënujor me Italinë.

Projekti përfshin:

- Ndërtimi i një linje të re transmetimi 400 kV me një qark, për të implementuar një lidhje binacionale mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe për të përforcuar lidhjen ekzistuese të transmetimit 220 kV të tej ngarkuar dhe të vjetër midis Elbasanit dhe Fierit. Traseja e Linjës Elbasan-Bitola, do të ketë një gjatësi përafërsisht 56 km ndërsa linja Elbasan –Fier përafërsisht 74 km.

- Ndërtimin e nënstacionit të ri Elbasan 3 dhe përforcimi dhe zgjerimi i nënstacionit ekzistues të Fierit. Nënstacioni i ri Elbasan 3, do të zgjerojë nënstacionin ekzistues 400/220 kV Elbasan 2, me një impiant në nivelin 400 kV për të lidhur linjat Tiranë 2, Zemblak, Fier dhe Maqedoni e Veriut, si dhe instalimin e një shunt reaktori. Gjithashtu nënstacioni Fier, do të zgjerohet dhe pajiset me transformatorë 400/220 kV dhe një impiant në nivelin 400 kV për të mundësuar lidhjen me rrjetin 400 kV drejt Elbasanit 3.
- ***Ndërtimi i linjës së re 110 kV Zemblak–Maliq–Lozhan, 35 km.***

Për të bërë të mundur përmirësimin e situatës në zonën Maliq-Lozhan është duke u vlerësuar mundësia e ndërtimit të një linje të re 110 kV me një qark me gjatësi rreth 35 km me përcjellës ACSR-240/40mm². Traseja e mundshme ku mund të kalojë kjo linjë, nis nga nënstacioni 400/110 kV Zemblak, kalon në afërsi të nënstacionit 35 kV Maliq dhe përfundon në zonën e Lozhanit, në një hapësirë të përshtatshme dhe për ndërtimin e një nënstacionit të ri 110/35 kV, jo shumë larg nënstacionit ekzistues 35 kV të Lozhanit. Pjesë e këtij projekti parashikohet të jetë edhe ndërtimi i anës 110 kV të nënstacionit të ri Lozhan.

Vlerësimet paraprake tregojnë se ndërtimi i kësaj linje, si pjesë e fuqizimit të rajonit juglindor, do të bëjë të mundur rritjen e sigurisë së furnizimit të klientëve dhe të operimit të burimeve të reja gjeneruese, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe plotësimin e kriterit të sigurisë N-1.

1.4 SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

1.4.1 Veprimtaria e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.)

Shpërndarja e energjisë elektrike në vendin tonë kryhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE sh.a.), i licencuar nga ERE sipas dispozitave të Ligjit nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi asetet në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, me qëllim lëvrimin e energjisë elektrike tek klientët. Kufiri i sistemit të shpërndarjes me sistemin e transmetimit është i përcaktuar në ligj.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE) është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes, përbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike; mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është licencuar. Në përputhje me ligjin "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", OSHEE sh.a. prokuron energji elektrike në tregun e hapur dhe nga burimet e rinovueshme, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me rregulloren e miratuar nga ERE dhe nëpërmjet platformës elektronike për procedurat e blerjes së energjisë elektrike.

Në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe VKM Nr. 244, datë 30.3.2016, të ndryshuar, OSHEE sh.a, deri më 31.12.2019, ka vijuar të kryej funksionin e Furnizuesit të Shërbimit Universal për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga ky shërbim.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE sh.a.) është organizuar në 11 Zona Shpërndarje dhe 42 Agjenci .

Sipas të dhënave të OSHEE, energjia totale e hyrë në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2019 është 6,576,432 MWh, nga e cila 5,093,468 MWh është energjia e lëvruar në rrjetin e shpërndarjes dhe 1,482,962 MWh janë humbjet në rrjetin e shpërndarjes.

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat mbi treguesit kryesorë të Operatorit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. gjatë vitit 2019.

1.4.2 Konsumi i Energjisë Elektrike

Konsumi total vjetor i Energjisë Elektrike (duke përfshirë edhe konsumin e klientëve në treg të parregulluar) në Shqipëri për periudhën 2003 deri në 2019 paraqitet në mënyrë grafike më poshtë.




Figura 40 Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike ndër vite.

Siç vërehet në paraqitjen grafike, konsumi më i ulët i energjisë elektrike i regjistruar në vendin tonë është në vitin 2007 me 5,767,652 MWh dhe konsumi më i lartë i energjisë elektrike është ai i regjistruar në vitin 2013 me 7,855,698 MWh. Për vitin 2019 konsumi i energjisë elektrike në vendin tonë është 7,612,079 MWh. Krahasuar me vitin 2018 vërehet një ulje e lehtë e konsumit të energjisë elektrike në vend me 26,767 MWh.




Figura 41 Kontributet e prodhimit neto vendas dhe balancës Import-Eksport në konsumin total të Energjisë Elektrike në Shqipëri.

KONTRIBUESIT PËR MBULIMIN E KONSUMIT 2018 SI SIGUROHET ENERGJIA E PËRDORUR				KONTRIBUESIT NË KONSUMIN E ENERGJISË SË SIGURUAR 2018 KU KONSUMOHET ENERGJIA E SIGURUAR				
Prodhimi Publik (KESH)	Prodhues me përparësi	Prodhues në Treg të Hapur	Balanca në Interkoneksion	Konsumi i OSHEE (shitje+humbje)	Konsumuar nga Klientet ne TL ("kualifikuar")	Konsumuar nga Klientët e lidhur në 35kv	Konsumuar nga OST (humbje +nevoja vetiake)	Konsumuar nga TEC Vlora 2018
5,850,932	1,696,245	1,004,975	-913,306	6,422,287	957,323	14,624	242,705	1,907
			7,638,846			7,638,846		
			dalje					

KONTRIBUESIT PËR MBULIMIN E KONSUMIT 2019 SI SIGUROHET ENERGJIA E PËRDORUR 2019				KONTRIBUESIT NË KONSUMIN E ENERGJISË SË SIGURUAR 2019 KU KONSUMOHET ENERGJIA E SIGURUAR 2019				
Prodhimi Publik (KESH)	Prodhues me përparësi	Prodhues në Treg të Hapur	Balanca në Interkoneksion	Konsumi i OSHEE (shitje+humbje)	Konsumuar nga Klientet ne TL ("kualifikuar")	Konsumuar nga Klientët e lidhur në 35kv	Konsumuar nga OST (humbje +nevoja vetiake)	Konsumuar nga TEC Vlora 2019
2,979,252	1,485,196	741,595	2,406,036	6,535,220	867,029	41,209	168,621	
			7,612,079			7,612,079		
			hyrje					

Figura 42 Komponentët për mbulimin e konsumit dhe komponentët e konsumit të energjisë elektrike të siguruar për vitet 2018 – 2019




Figura 43 Komponentët për mbulimin e konsumit dhe komponentët e konsumit të energjisë elektrike të siguruar për vitet 2018 – 2019.

1.4.3 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike

NUMRI I KLIENTËVE SIPAS RAJONEVE DHE KATEGORIVE 2019						
	Buxhetor	Familjare	Jo-Buxhetore	Konsum vetjak	Privat	2019
Berat	965	88,830	350	35	13,940	104,120
Burrel	679	54,037	308	37	6,233	61,294
Durrës	901	149,699	324	27	18,854	169,805
Elbasan	940	94,592	439	34	12,944	108,949
Fier	682	72,600	239	19	10,056	83,596
Gjirokastrë	1,256	69,156	273	24	9,863	80,572
Korçë	947	81,291	271	22	9,446	91,977
Kukës	333	18,402	93	11	2,247	21,086
Shkoder	949	98,272	350	27	13,946	113,544
Tiranë	1,527	278,629	443	54	51,267	331,920
Vlorë	562	71,463	193	8	10,793	83,019
TOTAL	9,741	1,076,971	3,283	298	159,589	1,249,882

Figura 44 Numri i Klientëve të OSHEE sh.a 2019.




Figura 45 Shpërndarja e numrit të Klientëve 2019 sipas kategorive (%).

Të dhënat e paraqitura më sipër tregojnë se numri i përgjithshëm i klientëve për vitin 2019 është 1 249 899. Dhe për vitin 2019 pjesën më të madhe të klientëve të OSHEE sh.a. e zenë klientët familjar që shkojnë në 86.16 % e numrit total të klientëve të OSHEE sh.a. Në shpërndarjen demografike të klientëve të OSHEE sh.a. dhe për vitin 2019 pjesa më e madhe është në Tiranë në rreth 26.5 % e gjithë klientëve që ka OSHEE sh.a.

Struktura e klientëve të OSHEE sh.a. reflektohet dhe në strukturën e faturimit të energjisë elektrike të realizuar nga OSHEE sh.a. për vitin 2019. Klientet familjar që zenë pjesën më të madhe në OSHEE sh.a. zenë dhe pjesën më të madhe të energjisë së faturuar për vitin 2019 respektivisht 48 % të gjithë faturimit të realizuar për vitin 2019.




Figura 46 Raportet e Faturimit sipas Kategorive të Klientëve 2019.

Në figurën e mëposhtme paraqiten peshat specifike në faturim që zënë kategoritë e klientëve tariforë.




Figura 47 Klientët Familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite.

Klientët familjare zënë rreth 36.1 % të konsumit total shifër pak më e lartë kjo krahasuar me konsumin për të njëjtën kategori për vitin 2018 i cili ishte në masën 35.1 %.

1.4.4 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike

Nga studimi i profilit vjetor të konsumit të Energjisë Elektrike, tipari karakteristik i këtij profili është simetria thuajse e plotë e konsumit dimër – verë.

Ashtu sikurse në raportimet e viteve të mëparshme, edhe këtë vit vërehet i njëjti fenomen, ai i përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje në dimër. Çdo ndryshim i temperaturës së mjedisit reflektohet menjëherë në konsumin ditor të energjisë elektrike, pikërisht prej efektit të përdorimi ose mospërdorimit të ngrohjes me energji elektrike të banesës.

Gjatë stinës së verës, në muajt Korrik dhe Gusht tendenca e pikut është në rritje, i cili nga viti në vit po bëhet më evident dhe lidhet me ndryshimet klimatike, përmirsimin e kushteve të jetesës që çon në përdorimin gjithnjë e në shkallë më të gjerë të pajisjeve klimatizuese gjatë muajve të nxehtë.

Më poshtë paraqiten të dhënat e konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2019 krahasuar me të dhënat mesatare të periudhës 2007-2018.




Figura 48 Konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2019.

Në grafikun më poshtë jepet profili mesatar ditor me bazë orare të ngarkesës për vitin 2019.




Figura 49 Profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2019.

PIKU I NGARKESËS për vitin 2019 (1,498 MW) është shënuar në datë 31.12.2019 ora 18:00




Figura 50 Profili dhe piku i ngarkesës në dhjetor 2019 (MW).

NGARKESA MINIMALE për vitin 2019 (411 MW) është shënuar në datë 31.10.2019 ora 03:00




Figura 51 Profili dhe minimumi i ngarkesës në tetor 2019 (MW).

Më poshtë paraqiten të dhënat mbi peshën specifike të konsumit të energjisë elektrike në treg të liberalizuar për vitin 2019, krahasuar me të dhënat e vitit 2018.

	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	2018
Konsumi Total në Shqipëri 2018	731,931	680,200	711,377	588,214	582,944	571,928	613,414	645,398	556,616	568,498	616,718	786,232	7,653,471
Konsumi i klientëve në treg të liberalizuar 2018	71,981	89,223	113,623	119,645	115,321	102,888	104,369	106,123	91,007	96,917	98,666	104,890	1,214,653
Pesha Specifike e Konsumit në treg të Liberalizuar (%) 2018	9.8	13.1	16.0	20.3	19.8	18.0	17.0	16.4	16.4	17.0	16.0	13.3	15.9
Konsumi i klientëve në treg të liberalizuar të lidhur në transmetim 2018	51,047	60,676	75,901	82,709	87,403	88,692	86,592	89,002	77,830	84,087	84,658	88,726	957,323
Konsumi i klientëve në treg të liberalizuar të lidhur në 35 kV 2018	0	0	606	1,172	1,400	1,272	1,340	652	1,150	2,340	2,251	2,441	14,624
Humbjet e OST të blera në treg të liberalizuar	20,933	28,547	37,116	35,763	26,518	12,925	16,437	16,469	12,027	10,490	11,757	13,723	242,705
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	2019
Konsumi Total në Shqipëri 2019	788,833	645,666	663,281	608,522	606,579	605,057	633,016	663,326	555,963	534,955	579,085	727,800	7,612,083
Konsumi i klientëve në treg të liberalizuar 2019	55,267	60,585	106,807	110,850	108,713	108,052	103,642	102,026	88,007	66,961	74,623	91,268	1,076,801
Pesha Specifike e Konsumit në treg të Liberalizuar (%) 2019	7.0	9.4	16.1	18.2	17.9	17.9	16.4	15.4	15.8	12.5	12.9	12.5	14.1
Konsumi i klientëve në treg të liberalizuar të lidhur në transmetim 2019	37,932	46,989	91,997	95,784	88,488	89,715	85,145	82,221	72,836	53,159	56,425	66,270	866,960
Konsumi i klientëve në treg të liberalizuar të lidhur në 35 kV 2019	2,452	2,076	3,033	2,987	3,367	3,863	4,467	4,487	3,858	3,739	3,458	3,421	41,210
Humbjet e OST të blera në treg të liberalizuar	14,883	11,520	11,777	12,080	16,858	14,474	14,029	15,318	11,313	10,063	14,740	21,577	168,631

Figura 52 Të dhënat mbi peshën specifike të konsumit të energjisë elektrike në treg të liberalizuar për vitin 2019, krahasuar me të dhënat e vitit 2018.




Figura 53 Grafiku mbi peshën specifike të konsumit të energjisë elektrike në treg të liberalizuar për vitin 2019, krahasuar me të dhënat e vitit 2018.

1.4.5 Treguesit e energjisë elektrike së furnizuar, shitur dhe humbur për çdo zonë dhe agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. gjatë vitit 2019

Më poshtë paraqiten të dhënat lidhur me treguesit e energjisë elektrike së Furnizuar, shitur dhe humbur për çdo zonë dhe agjenci të OSHEE sh.a. gjatë vitit 2019 (MWh).

Drejtoria Rajonale/Agjensia	VIII 2019			
	Energjia e Hyre MWh	Energjia e Shitur MWh	Humbjet MWh	Humbjet ne %
Tirana1	824,384	743,781	80,603	9.8%
Tirana2	835,312	688,535	146,777	17.6%
Tirana3	630,482	531,741	98,741	15.7%
Dr. Rajonale Tirane	2,290,178	1,964,057	326,121	14.2%
Durres	391,549	326,805	64,744	16.5%
Kavaje	154,865	128,892	25,974	16.8%
Kruje	142,274	95,212	47,062	33.1%
Shijak	162,425	123,876	38,549	23.7%
Dr. Rajonale Durres	851,113	674,784	176,329	20.7%
Ballsh	49,749	44,521	5,228	10.5%
Fier	317,960	270,608	47,352	14.9%
Patos	67,354	54,595	12,759	18.9%
Dr. Rajonale Fier	435,062	369,723	65,339	15.0%
Elbasan	286,471	240,064	46,407	16.2%
Gramsh	20,509	17,486	3,023	14.7%
Librazhd	54,603	41,218	13,385	24.5%
Peqin	31,165	23,554	7,612	24.4%
Dr. Rajonale Elbasan	392,748	322,321	70,427	17.9%
Bilisht	34,444	28,016	6,428	18.7%
Kolonje	13,152	9,373	3,779	28.7%
Korce	185,550	146,742	38,807	20.9%
Pogradec	69,028	59,858	9,171	13.3%
Dr. Rajonale Korce	302,175	243,990	58,185	19.3%
Delvine	17,112	13,843	3,269	19.1%
Gjirokaster	87,374	69,904	17,470	20.0%
Permet	22,028	18,140	3,888	17.7%
Saranda	112,537	93,242	19,295	17.1%
Tepelene	31,966	22,972	8,995	28.1%
Dr. Rajonale Gjirokaster	271,018	218,100	52,918	19.5%
Koplik	67,817	30,138	37,680	55.6%
Lezhe	160,005	102,542	57,463	35.9%
Puke	28,238	14,422	13,816	48.9%
Shkoder	395,241	249,102	146,139	37.0%
Dr. Rajonale Shkoder	651,301	396,204	255,097	39.2%
Berat	117,895	95,842	22,053	18.7%
Kuçove	50,607	42,637	7,970	15.7%
Lushnje	167,446	132,209	35,237	21.0%
Skrapar	24,596	18,867	5,728	23.3%
Dr. Rajonale Berat	360,544	289,555	70,989	19.7%
Has	28,047	12,109	15,938	56.8%
Kukes	90,641	50,827	39,814	43.9%
Tropoje	53,015	15,305	37,711	71.1%
Dr. Rajonale Kukes	171,703	78,241	93,463	54.4%
Bulqize	47,594	40,042	7,552	15.9%
Diber(Peshkopi)	61,428	41,206	20,222	32.9%
Lac	157,540	101,800	55,740	35.4%
Mat (Burrel)	50,136	33,127	17,009	33.9%
Mirdite	43,010	29,160	13,850	32.2%
Dr. Rajonale Burrel	359,708	245,336	114,372	31.8%
Himare	23,719	20,406	3,313	14.0%
Selenice	44,750	16,864	27,886	62.3%
Vlore	259,490	208,712	50,778	19.6%
Dr. Rajonale Vlore	327,959	245,982	81,977	25.0%

Figura 54 Të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo Agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. gjatë vitit 2019.

Treguesit sa më sipër, sipas drejtorive rajonale për vitin 2019, në krahasim me ato të vitit 2018, rezultojnë të përmirësuar e konkretisht në vlerat e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes ku në vitin 2018 ishin 1,538,503 MWh dhe në vitin 2019 1,482,961 MWh duke u zvogëluar humbjet e energjise elektrike në sistemin e shpërndarjes me 55,542 MWh.

Humbjet më të larta i takojnë Drejtorive Rajonale Kukës dhe Shkodër, ndërkohë nivel më të ulët të humbjeve gjatë vitit 2019 kanë patur Drejtoritë Rajonale Tiranë dhe Fier.




Figura 55 Shpërndarja e Furnizimit me Energji Elektrike sipas Drejtorive rajonale (%).

Siç evidentohet edhe në figurë, pjesën më të madhe të konsumit të energjisë elektrike në vend për vitin 2019 e zë Drejtoria Rajonale Tiranë, ndërkohë që pjesën më të vogël të konsumit e zë Drejtoria Rajonale Kukës.




Figura 56 Shpërndarja e Humbjeve të Energjisë Elektrike sipas Drejtorive rajonale (%).

Krahasimi i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes me targetat e vendosura në VKM-në nr. 253, datë 24.04.2019.




Figura 57 Humbjet mujore dhe mesatare në sistemin e shpërndarjes krahasuar me targetin e humbjeve të energjisë elektrike sipas VKM nr.253, datë 24.04.2019 (%).

Paraqitja e kontributit në furnizim dhe në humbjet respektive sipas agjensive .




Figura 58 Sasia në Furnizim dhe Humbje të Energjisë Elektrike në Rajonet dhe Agjencitë e Rrjetit të Shpërndarjes (Burimi: OSHEE sh.a).

Në tabelat vijuese jepen treguesit e sintetizuar nga operatorët publik (OST sh.a. dhe OSHEE sh.a.) të sistemit elektroenergjetik në Shqipëri.

Bilanci i Energjisë Elektrike OST sha për vitin 2019 MWh		TABELA ME TËDHENA TE OSHEE Sh.a 2019 MWh	
Prodhimi nga KESH_GEN në Rrjetin e Transmetimit	2,979,252	Energji Totale e Hyrë në OSHEE Sh.a (MWh)	6,576,432
Prodhimi nga HEC/HPP e vogla në Rrjetin e Transmetimit	229,380	Energji e transmetuar nepermjet OST per llogari te OSHEE Sh.a	5,907,870
Prodhimi nga PPE/IPP e mëdha në Rrjetin e Transmetimit	625,142	Nga KESH -Gen nepermjet OST	2,878,441
Prodhimi nga HEC Peshqesh	91,100	Nga OST si import i OSHEE Sh.a	2,171,583
Prodhimi nga HEC Banja	153,357	Energji e transmetuar per klientet_35kV (te dal ne treg te parregulluar)	41,209
Prodhimi nga HEC FANG	166,396	Nga OST per llogari te klienteve te OSHEE Sh.a prodhuar nga HEC-et ne rrjetin e tran	816,637
Prodhimi nga HEC Moglicë	0	Energji elektrike e injektuar ne OST nga Hec-et Lokale	229,380
Prodhimi nga nga HEC Ashta	191,495	Energji e transmetuar direkt ne rrjetin e OSHEE Sh.a	668,561
Prodhimi nga KURUM (Ulez-Shkopet&Bistrica1,2)	330,742	HEC Ulez,Lanabregas	33,368
Eksporti (-) nga Linjat e Interkonjeksionit	770,480	Impjantet Private/me Koncesion	612,997
Importi (+) nga Linjat e Interkonjeksionit	3,176,515	Burimet e Rinovueshme Fotovoltaik (BRE)	22,196
Balanca (Total Interkonjeksioni)	2,406,036	*Energji Totale e shpërndarë në Rrjetin e Shperndarjes (MWh)	6,805,811
Energjia Totale në Marrje	7,943,380	Humbjet Totale ne Rrjetin e Shperndarjes (MWh)	1,482,962
Humbjet në Rrjetin e Transmetimit (përfshirë Nevojat Vet)	168,621	Humbje Teknike njesite e TL (MWh)	117,739
Humbjet në Rrjetin e Transmetimit %	2.12	Humbje Teknike ne Zona (MWh)	836,561
Energjia Totale në Dhënie	7,774,759	Humbje JoTeknike ne Zona (MWh)	528,661
<i>Transmetuar në Linjat e Interkonjeksionit</i>	770,480	Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (%)	21.79%
<i>Transmetuar tek Klientët e Kualifikuar</i>	867,029	Humbje Teknike njesite e TL (%)	1.73%
<i>EL Kurum</i>	292,830	Humbje Teknike ne Zona (%)	12.52%
<i>Fushe Arrëz</i>	8,192	Humbje JoTeknike ne Zona (%)	7.77%
<i>Titan</i>	94,420	Energjia e përdorur në Rrjetin e Shpërndarjes	5,322,848
<i>F.Kruje 220</i>	119,986	Shitur Klienteve FMF (MWh)	38,098
<i>N/ST 220/6,3 Colacem</i>	11,089	Shitur Klienteve FMF Privat (MWh)	27,946
<i>ACR T1</i>	74,358	Shitur Klienteve FMF JoBuxhetore(MWh)	10,152
<i>ACR T2</i>	0	Shitur Klienteve Private (MWh)	1,648,168
<i>AES T1</i>	65,710	Shitur nga rrjeti i Transmetimit per llogari te OSHEE Sh.a	-
<i>AES T2</i>	55,521	Shitur per nevoja te veta te OSHEE Sh.a	9,415
<i>N/ST 220kV Moglice</i>	5,540	Shitur Klienteve Private (pa ate per nevoja te veta dhe Ne TL)	1,638,753
<i>Hec Peshqesh</i>	251	Shitur Klienteve JoBuxhetore (MWh)	352,342
<i>Hec Ashta</i>	2	Shitur Klienteve Buxhetore (MWh)	263,471
<i>Hec BANJE</i>	228	Shitur Klienteve Familjare (MWh)	2,750,180
<i>Hec FANG</i>	374	Shitur Klienteve Familjare (MWh)	2,673,140
<i>Gjerim KURUM</i>	121	Shitur Klienteve Familjare per Ambientet e Perbashketa	77,040
<i>Tec Ballsh T1</i>	36,075	Energji elektrike e injektuar ne OST nga Hec-et Lokale	229,380
<i>Ferro Krom</i>	102,330	Energji elektrike e perdorur nga klientet ne treg te parregulluar	41,209
<i>Transmetuar në rrjetin e Shpërndarjes (OSHEE)</i>	6,137,250	*Në Energji Totale e shpërndarë në Rrjetin e Shperndarjes (MWh) , eshte llogaritur edhe sasia OUt nga DSO-OST (229.380 MWh)	
<i>Transmetuar në rrjetin e Shpërndarjes (OSHEE) 110 kV</i>	5,185,082		
<i>Transmetuar në rrjetin e Shpërndarjes (OSHEE) 35 kV</i>	532,492		
<i>ansmetuar në rrjetin e Shpërndarjes (OSHEE) 6, 10, 20 kV</i>	419,676		

Figura 59 Treguesit nga operatorët kryesore të sistemit Elektroenergjetik në Shqipëri 2019.

Bazuar në të dhënat e mësipërme të tabelave dhe informacioneve periodike apo specifike të operatorëve të tregut të energjisë u ndërtua Bilanci Energjetik për vitin 2019 si më poshtë.

BILANCI ENERGJITIK 12-Mujori 2019 (MWh)												
	Neto KESH	Blerje ne Treg te hapur OSHEE	Neto (Selit)	HC.Priv/Kone Rrjetin e OSHEE	HC.Priv/Kone Rrjetin e OST	FOTOVO LTAIK	Neto Ashta	Neto Banja	Neto KURUM	H/C Peshqesh	H/C Fangu	Prodhim neto vendas
Prodhimi Neto KESH sha	2,979,252		33,368	612,995	625,142	22,196	191,495	153,357	330,742	91,100	166,396	5,206,043
<i>Ballanca e shkembimeve ne Interkoneksion.</i>												
<i>Ballanca e shkembimeve te brendeshme (pa OST, OSHEE).</i>												
<i>Shitur OST per Humbje + konsum vetiak</i>		2,171,583										
<i>Konsumuar nga Tec Vlora</i>	-100,811											
<i>Devijime nga Programi i Interkoneksionit</i>												
<i>Energji per sherbime ndihmese + disbalanca</i>												
Energji per OSHEE sha nga KESH sha	2,878,441	2,171,583	33,368	612,995	625,142	22,196	191,495					
								153,357	330,742	91,100	166,396	
				6,535,220				41,209	Energji per FMF (Treg Lib)			
				6,576,429					Verifikim i saktësisë së vlerave 0			
				6,576,429								Ballanca ne interkoneksion (marrije)
												2,406,036
Energji ne rrjetin e OSHE / FMF (klient ne treg te liberalizuar)	41,209											
Shitur Kons Familjare FSHU	2,750,180											
Shitur Kons Jo Familjare FSHU	2,263,981	5,052,259										
Shitur Kons Jo Familjare FMF	38,098											
Humbje tekn TL	117,739			6,535,220								
Humbje teknike ne zona	836,561	1,482,961										
Humbje Jo teknike ne zona	528,661											
Konsumi i OSHEE (shitje+humbje)				6,535,220								
Konsumuar nga Klientet ne TL ("kualifikuar")				867,029								
Konsumuar nga OST (humbje +nevoja vetiake)				168,621								
Energji e transmetuar ne rrjetin e OSHE per FMF jo klient				41,209								
KONSUMI TOTAL 2019				7,612,079								Konsumi total vendas
												7,612,079
Burimi OST, OSHEE sha												

Figura 60 Bilanci Energjetik viti 2019.




Figura 61 Të dhëna të tregut të energjisë elektrike për vitin 2019 në raport me energjinë elektrike të konsumuar në Shqipëri.

1.4.6 Efektiviteti i shitjes së energjisë elektrike

Gjatë vitit 2019 efektiviteti i shitjes të energjisë elektrike vazhdon në vlera të rritura në referencë gjithnjë të faktorëve përcaktues në nivelin e efijencës së konsumit të energjisë elektrike të cilët janë:

1. Niveli i humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje.
2. Niveli i arkëtimit të energjisë elektrike së faturuar.

Humbjet e përgjithshme të raportuara nga shoqëria për vitin 2019, arrijnë në **21.79%**, duke shënuar ulje të nivelit të humbjeve krahasuar edhe me vitin 2018 me rreth 2.17 %.

Niveli total i arkëtimit të raportuar nga OSHEE sh.a. është 98.4 % kundrejt energjisë elektrike të faturuar (shih tabelën e Faturim – Arkëtimit).

Shifra e arkëtimit përfshin edhe arkëtimet e prapambetura të periudhës 2007 - 2018.



Figura 62 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2019.




Figura 63 – Grafiku i Humbjeve Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2019.

HUMBET (SHPËRNDARJES) 2009-2019												
	2012											
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Humbjet teknike ne nenshtacionet e TL	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272
Humbjet teknike në zonat e shpërndarjes	280,330	280,330	280,330	280,330	280,330	280,330	280,330	280,330	280,330	280,330	280,330	280,330
Humbjet teknike Totale	438,602	438,602	438,602	438,602	438,602	438,602	438,602	438,602	438,602	438,602	438,602	438,602
Humbjet jo-teknike Totale	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272	158,272
Humbjet Totale	596,874	596,874	596,874	596,874	596,874	596,874	596,874	596,874	596,874	596,874	596,874	596,874
ENERGI TOTAL NË OSSH	6573,010	6573,010	6573,010	6573,010	6573,010	6573,010	6573,010	6573,010	6573,010	6573,010	6573,010	6573,010




Figura 64 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2019.




Figura 65 Niveli i Arkëtimeve Mujore në periudhën 2011-2019.

PERFORMANCA E OPERATOTRIT TE SHPERNDARJES 2009-2019 (%)												
NIVELI I HUMBJEVE (%) 2009-2019												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	40.75	37.05	38.05	32.93	33.44	30.75	32.60	30.20	25.34	30.67	33.44	36.89
2010	38.62	35.41	36.90	31.37	35.17	31.45	26.94	29.69	21.47	20.61	22.16	29.05
2011	55.55	38.00	36.95	23.11	24.85	21.29	21.88	19.41	22.95	25.15	32.20	35.70
2012	35.72	59.16	55.23	45.41	38.87	39.77	45.51	45.51	42.09	35.53	41.89	49.32
2013	51.12	48.71	48.29	39.66	39.52	40.33	43.33	38.50	35.08	45.98	48.08	53.04
2014	47.00	42.14	42.78	35.69	36.85	34.10	36.59	36.36	31.67	34.52	32.88	37.54
2015	36.68	31.82	32.88	30.54	31.24	28.60	30.62	29.29	25.30	29.92	30.82	34.50
2016	34.69	29.00	29.93	26.07	26.97	24.35	25.97	25.15	22.12	27.11	29.30	30.99
2017	33.50	27.63	28.66	25.81	25.88	28.31	24.69	23.29	19.79	23.76	23.55	27.90
2018	30.65	24.91	27.22	23.33	23.03	20.76	21.46	20.77	19.32	21.53	22.73	26.70
2019	29.25	23.21	26.5	21.36	22.10	19.92	20.42	19.81	17.54	20.40	21.58	24.76
												26.41
												23.9
												21.79
Niveli i Arketimeve (%) 2009-2019												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	69.32	85.95	74.38	86.58	86.31	76.37	75.40	72.46	83.20	80.82	61.77	70.01
2010	55.37	66.28	86.63	89.46	86.70	79.42	74.84	124.98	84.20	70.81	56.15	66.48
2011	67.26	57.61	87.66	71.61	96.73	73.00	65.00	81.00	66.00	63.86	51.47	87.30
2012	59.80	79.20	78.50	78.00	94.70	83.50	91.60	102.90	74.00	98.00	72.60	78.00
2013	61.40	63.70	86.20	80.70	79.10	69.60	87.90	90.10	78.50	84.30	89.00	102.00
2014	84.90	77.10	85.90	85.50	81.90	80.20	86.70	83.60	102.60	101.00	101.90	141.00
2015	112.70	120.50	103.70	86.60	95.70	97.10	98.40	104.70	95.30	100.30	92.20	100.70
2016	92.10	87.00	95.60	90.10	99.10	92.00	94.20	96.70	91.50	96.70	90.30	96.70
2017	85.20	87.60	105.70	94.50	105.70	91.80	104.80	97.40	94.60	103.80	92.70	100.10
2018	96.39	95.69	105.82	98.92	111.64	100.16	105.00	102.12	93.03	108.76	96.24	108.94
2019	90.7	92.6	99.8	102.4	102.50	94.00	104.40	99.30	93.90	104.70	89.60	110.70
												96.6
												101.6
												98.4
Efektiviteti i shitjeve (%) 2009-2019												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	41.1%	54.1%	46.1%	58.1%	57.4%	52.9%	50.8%	50.6%	62.1%	56.0%	41.1%	44.2%
2010	34.0%	42.8%	54.7%	61.4%	56.2%	54.4%	54.7%	87.9%	66.1%	56.2%	43.7%	47.2%
2011	29.9%	35.7%	55.3%	55.1%	72.7%	57.5%	50.8%	65.3%	50.9%	47.8%	34.9%	56.1%
2012	38.4%	32.3%	35.1%	42.6%	57.9%	50.3%	49.9%	56.1%	42.9%	63.2%	42.2%	39.5%
2013	30.0%	32.7%	44.6%	48.7%	47.8%	41.5%	49.8%	55.4%	51.0%	45.5%	46.2%	47.9%
2014	45.0%	44.6%	49.2%	55.0%	51.7%	52.9%	55.0%	53.2%	70.1%	66.1%	68.4%	88.1%
2015	71.4%	82.2%	69.6%	60.2%	65.8%	69.3%	68.3%	74.0%	71.2%	70.3%	63.8%	66.0%
2016	60.2%	61.8%	67.0%	66.6%	72.4%	69.6%	69.7%	72.4%	71.3%	70.5%	63.8%	66.7%
2017	56.7%	63.4%	75.4%	70.1%	78.3%	65.8%	78.9%	74.7%	75.9%	79.1%	70.9%	72.2%
2018	66.8%	71.9%	77.0%	75.8%	85.9%	79.4%	82.5%	80.9%	75.1%	85.3%	74.4%	79.9%
2019	64.2%	71.1%	73.4%	80.5%	79.8%	75.3%	83.1%	79.6%	77.4%	83.3%	70.3%	83.3%
												71.1%
												77.3%
												77.0%

Figura 66 Ecuria e treguesve të efektivitetit të shitjes së Operatorit të Shpërndarjes (%).

Efektiviteti i shitjeve të OSHEE sh.a. praktikisht përfaqëson përqindjen (%) e energjisë elektrike që është shitur dhe arkëtuar. Per vitin 2019 efektiviteti i shitjeve për OSHEE sh.a. është 77 %, pothuajse në të njëjtin nivel me atë të vitit 2018.

Efektiviteti i shitjeve për periudhën 2009-2019 jepet dhe në grafikun e mëposhtëm.




Figura 67 Efektiviteti i shitjeve të OSHEE 2009-2019 (Burimi: OSHEE sh.a).




Figura 68 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së futur në sistemin Elektroenergjitik kundrejt konsumit.

Në figurën e mësipërme jepet ecuria e humbjeve totale të energjisë elektrike e cila përfshin humbjet në sistemin e shpërndarjes edhe ato në sistemin e transmetimit, gjatë periudhës 2005 – 2019. Të dhënat tregojnë se humbjet e energjisë elektrike në vlera absolute kanë ardhur duke u ulur nga viti në vit. Për vitin 2019 humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe të transmetimit janë 1,651 GWh. Krahasuar me vitin 2018 kemi një ulje të humbjeve totale të energjisë elektrike me 134 GWh.

Në figurën më poshtë është paraqitur marrëdhënia e faturim-arkëtimeve të energjisë elektrike përgjatë periudhës 2005 - 2019. Siç shihet dhe në figurë deri në vitin 2014 diferenca ndërmjet faturimit dhe arkëtimit ka qënë e konsiderueshme. Diferenca ndërmjet faturimit dhe arkëtimit arrin nivelin maksimal në vitin 2011, në rreth 30 %. Për vitin 2019 diferenca ndërmjet faturimit dhe arkëtimit është vetëm 1.4 %. Ulja e ndjeshme e diferencës ndërmjet energjisë elektrike të faturuar dhe asaj të arkëtuar fillon në vitin 2015 dhe vijon të jetë një proces i konsoliduar në vitet në vijim.




Figura 69 Faturimi/Arkëtimi 2002-2019 me TVSH (Burimi: OSHEE sh.a.).

1.4.7 Asetet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna mbi asetet në administrim nga OSHEE sh.a. për vitin 2019, si nënstationet, linjat, kabinat dhe transformatorët në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Të dhënat mbi asetet e OSHEE sh.a. përfshijnë të dhëna mbi elementet kryesor të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Numrin e nënstationeve, numrin e transformatorëve, gjatësinë e linjave ajrore dhe kabllore si dhe numrin e kabinave elektrike. Numri total i kabinave elektrike në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2019 është 25,820 nga të cilat 13,218 janë në pronësi të OSHEE sh.a. dhe pjesa tjetër është në pronësi të subjekteve private.

Gjatësia totale e linjave të tensionit të mesëm në sistemin e shpërndarjes është 16 6826 km. Gjatësia totale e rrjetit të tensionit të ulët në sistemin e shpërndarjes është 36 912 km. Në mënyrë më të detajuar të dhënat jepen në tabelën më poshtë.

TË DHËNAT E RRJETIT SHPËRNDARJES (OSHEE) PER VITIN 2019		Gjatesia Totale e rrjetit TM (km)	
			16,826
		Linja 35 kV (km) Ajrore	1,245
		Linja 35 Kv (km) Kabllore	18
		Linja 20 Kv (km) Ajrore	191
		Linja 20 Kv (km) Kabllore	2,230
		Linja 10 Kv (km) Ajrore	7,518
		Linja 10 Kv (km) Kabllore	197
		Linja 6 Kv (km) Ajrore	4,873
		Linja 6 Kv (km) Kabllore	555

NESTACIONE, KABINA DHE TRANSFORMATORE		Gjatesia Totale e rrjetit TU (km)	
Numri i Nënstationeve	177		36,912
Numri transf. ne nenstacione	301	Ajror me percjelles te xhveshur (km)	18,073
Numri i Kabinave total	25,820	Ajror me kabell ABC(km)	4,539
Numri i Transformatorëve TM/TU	26,463	Kabllor PVC, XLPE	1,373
		Kabell Koaksial	12,927

KABINAT	TIPI DHE NUMRI I KABINAVE												FUQIA E INSTALUAR (kVA)				NUMRI I TRANSFORMATOREVE TE FUQISE TM/TU					
	METALIKE			MURATURE			BOX			SHYLLLORE			NUMRI I TOTAL	6 kV			10kV			20kV		
	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV		6 kV	10kV	20kV	Total	6 kV	10kV	20kV	Total	
Gjithsej	337	293	12	2,664	3,793	4,016	55	115	1,577	7,032	5,835	91	25,820	1,652,922	1,723,228	2,596,835	5,956,129	10,200	10,028	6,235	26,463	
Pronesi OSHEE	257	210	4	1,685	2,752	2,218	40	65	1,504	2,026	2,410	48	13,218	808,375	1,066,569	1,553,465	3,428,409	4,067	5,412	3,983	13,462	

Figura 70 Të dhëna mbi asetet kryesore të OSHEE (Burimi: OSHEE).

1.4.8 Investimet në Sistemin e Shpërndarjes nga OSHEE sh.a. gjatë vitit 2019.

Realizimi i planit të investimeve për vitin 2019 nga shoqëria OSHEE sh.a. rezulton 89 % e planit të investimeve të miratuar nga ERE. Në këtë vlerë realizimi janë përfshirë investimet e kontraktuara dhe realizuara në vitin 2019 si dhe investimet e kontraktuara në vitin 2018, si edhe ajo pjesë e investimeve që janë kontraktuar në vitin 2019 por pritet të realizohen në vitet në vijim, kjo nuk nënkupton vlerën e kapitalizuar nga shoqëria deri në 31.12.2019.

PLANI I ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË OSHEE sha 2019 (lekë)		Plan i Investimeve për OSHEE sha miratuar në ERE	Realizimi i kontratave deri 31.12.2019	Kontraktuar ne 2018 por filluar dhe perfunduar ne 2019	Kontraktuar ne 2019 perfunduar ne 2019	Kontraktuar ne 2019 dhe vijojne ne proces zbatimi. Vlera e pasqyruar I referohet realizimit brenda vitit 2019
Nr.	Grup Investimi					
I	Ndertim/rikonstruksion elektrik per Nenstacionet	311,900,000	546,351,549		479,964,926	66,386,623
II	Ndertim/Rikonstruksion linjash te TL	105,592,034	153,869,304	143,533,003		10,336,301
III	Blerje Paisje makineri per N/Stacione dhe likujdim avarish	1,130,000,000	-			
IV	Ndertim Rrjeti TM	96,040,490	826,055,529	169,539,911	469,039,454	187,476,164
V	Ndertim/Rikonstruksion Rrjeti TM /TU	561,190,999	1,686,537,048	403,166,028	1,161,428,286	121,942,734
VI	Ndertim/Rikonstruksion kabinash elektrike	1,254,006,254	828,880,625	371,039,817	370,199,707	87,641,101
VII	Investime prioritare ne TU (Rrjet TU - ABC lines)	344,998,428	620,635,610	357,433,148	263,202,462	
VIII	Teknologji Monitorimi	170,000,000	297,035,000	194,985,000	102,050,000	
IX	Investimi ne matje	1,300,000,000	364,774,800		364,774,800	
X	Vlera 10% qe do te paguhet nga OSHEE per investimet Bankes Boterore	179,201,439	-			
XI	Kosto lokale per investimet e Bankes Boterore	1,261,899,163	877,404,250	128,760,547	317,648,598	430,995,105
XII	Oponenc, Supervizion, Kolaudim,shpronesime,leje ndertimore etj	260,000,000	-			
		6,974,828,807	6,201,543,714	1,768,457,454	3,528,308,234	904,778,027

Figura 71 Të dhëna mbi Investimet në Sistemin e Shpërndarjes nga OSHEE sh.a. gjatë vitit 2019. (Burimi: OSHEE).

Gjatë vitit 2019, nga shoqëria OSHEE sh.a., me miratim të Këshillit Mbikqyrës janë ndryshuar e rialokuar fondet e investimeve disa herë për t'ju përshtatur gjendjes financiare të shoqërisë si rezultat i alokimit të fondeve për blerjen e energjisë elektrike në tregun e pa rregulluar.

Me mbylljen e Bilancit financiar dhe auditimin e OSHEE sh.a. do sigurohet informacioni i saktë lidhur me kapitalizimet e investimeve të realizuara për vitin 2019.

2. TREGU I ENERGISË ELEKTRIKE.

Gjatë vitit 2019, Tregu i Energjisë Elektrike ka funksionuar bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016, i ndryshuar “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e Energjisë Elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me Energji Elektrike. Për sa përcaktuar nga Këshilli i Ministrave ky vendim shërben si Model i Përkohshëm Tregu deri në zbatueshmërinë e VKM Nr. 519, datë 13.07.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, implementimi i së cilës lidhet me bërjen efektive të Tregut të Një Dite më parë dhe ngritjen e Bursës së Energjisë Elektrike. Veç të tjerash, modeli aktual, ka përcaktuar qartë pjesëmarrësit e tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri (TEE), si dhe rolin dhe përgjegjësitë e secilit pjesëmarrës në treg të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë me qëllim reflektimin e kërkesave të këtij ligji ka vijuar punën për të miratuar aktet rregullatore nënligjore në zbatim të tij.

Për sa është parashikuar dhe në nenin 98 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe në VKM-në Nr. 244, datë 30.03.2016, të ndryshuar, Rregullat e Përkohshme të Tregut miratuar nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 139, datë 15.08.2016, të ndryshuar kanë qënë në zbatim përgjatë vitit 2019.

Gjithashtu, me Vendimin e ERE-s Nr. 193, datë 27.11.2017, janë miratuar "Rregullat e përkohshme për mekanizimin balancues të Energjisë Elektrike", me qëllim dhënien e një zgjidhje të pranueshme dhe transparente për të gjithë pjesëmarrësit e tregut në trajtimin e balancimit të sistemit Elektro-Energjistik Shqiptar dhe përgjegjësisë së tyre.

Janë hedhur hapa konkrete për liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike sa i përket krijimit të kushteve teknike dhe të kuadrit nënligjor e rregullator për daljen në treg të hapur edhe për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe akteve nënligjore përkatëse të cilët dalin në treg të lirë në Mars të vitit 2020 dhe nga kjo datë nuk mund të furnizohen më nga ana e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit. Ky proces do të vijojë në vitet në vijim dhe me daljen në treg të lirë të klientëve të lidhur në tensionin 20 kV, 10 kV dhe 6 kV. Me qëllim garantimin e të drejtave si të furnizuesve por edhe të klientëve të energjisë elektrike, ERE ka plotësuar kuadrin ligjor rregullator me bazën e nevojshme për të grantuar operimin e sigurt, transparent dhe mbi baza jo diskriminuese. Për këtë qëllim janë miratuar një sërë aktesh nën ligjore ndër të cilat përmendim, Marrëveshjen e Shërbimit të Shpërndarjes në mes të OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike, Rregullore për Kriteret standarte të Cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Rregullore mbi Procedurat për Paraqitjen e një Kërkese Shqyrtimin e saj dhe Afatet e Njoftimit kur Klienti Dyshon në Saktësinë e të Dhënave të Aparatit Matës të Energjisë Elektrike, Rregullore mbi Ndryshimin e Furnizuesit të Energjisë Elektrike, Rregullore mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë, Rregullorja mbi kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me Energji Elektrike për klientët fundore.

Po ashtu ERE ka instruktuar FSHU për të sensibilizuar klientët për daljen në treg të parregulluar nëpërmjet njoftimit të këtyre të fundit lidhur me detyrimet që dalin nga zbatimi i Ligjit të Sektorit si dhe pamundësisë së Furnizimit si mundësi e Fundit pas daljes në treg të parregulluar.

Aktualisht numri i klientëve për të cilat është bërë e mundur krijimi i kushteve teknike është mbi 90, gjithsesi në këtë drejtim pritet të bëhet më tepër në krijimin e kushteve teknike nga ana e OSHEE sh.a. për liberalizimin e mëtejshëm të tij.

Me vendimin Nr. 519, datë 13.07.2016, Këshilli i Ministrave në zbatim të nenit 97/3 të këtij ligji ka miratuar Modelin e Tregut, në bazë të të cilit ERE me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 214 dt. 28.12.2017, ka miratuar "Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike si dhe marrëveshjen e pjesëmarrjes në bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike", të cilat sëbashku dhe me ndryshimet e fundit të Ligjit të Sektorit të Energjisë Elektrike nr. 7/2018 që krijojnë bazën e duhur ligjore për krijimin dhe operimin e Bursës së Energjisë Elektrike në Shqipëri. Në këtë kuadër Komiteti Drejtues për krijimin e Bursës, në të cilën bën pjesë dhe ERE, ka qënë aktiv duke bashkërenduar punën me OST për hapat që duhen ndërmarrë drejt këtij procesi. Përgjatë vitit 2019 nga ana e Qeverisë Shqiptare me anë të VKM-se nr. 609, datë 11.09.2019 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e Operatorit të Tregut" janë përcaktuar hapat që do të ndërmerren në drejtim të përzgjedhjes së aksionerëve ndërkombëtarë të Bursës si dhe ofruesit të shërbimit me reputacion dhe eksperiencë në këtë fushë.

Rregullorja për përcaktimin e kushteve për Nominimin e Operatorit të Tregut të Energjisë elektrike (NEMO)

Bordi i ERE me Vendimin Nr. 240, datë 23.12.2019, në mbështetje të neneve 16 dhe 57 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, VKM Nr. 322, datë 15.05.2019 “Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut”, nenit 19, pika 1, gërma f dhe nenit 26 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, filloi procedurën për miratimin e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të energjisë elektrike (NEMO) dhe rolet dhe përgjegjësitë e NEMO- s dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të energjisë në Tregun e Bashkuar.

Sa më sipër vlen të përmendim se, Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB) ka mbështetur masat rregullatore për implementimin e kushteve të Bashkimit të Tregjeve të ditës në avancë dhe të tregut brenda të njëjtës dite në palët kontraktore të Komunitetit të Energjisë.

Rregullorja për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionëve (capacity allocation and congestion management) (CACM) përcakton qartë se për të bërë të mundur funksionimin e Bashkimit të Tregjeve të ditës në avancë dhe të tregut brenda të njëjtës dite të sektorit të energjisë elektrike në vendet anëtare të Sekretariatit dhe Bashkimit Evropian, duhet të përcaktohen përgjegjësitë e Operatorëve të Sistemit të Transmisionit (OST) dhe Operatorëve të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike(NEMO).

ECRB ka sygjerruar se palët kontraktore të Komunitetit të Energjisë duhet të përshkruajnë përgjegjësitë e NEMO-s dhe OST në një akt rregullues, i cili në varësi të kornizës rregullatore të Palëve Kontraktuese mund të jetë në formën e një vendimi rregullues të veçantë, rekomandim ose të përfshirë në vendimin rregullator për miratimin e alokimit të nënkuptuar ose bashkimin e tregut.

Miratimi i këtyre akteve është një përgjigje fleksibile dhe e përshtatshme për angazhimet rregullatore nga Palët Kontraktuese dhe më saktësisht për autoritetet rregullatore kombëtare të WB6, angazhime të ndërrmarra me nënshkrimin e memorandumit të WB6.

Me vendimin e Bordit të ERE Nr. 40, datë 06.03.2020, u miratua “Rregullorja për kërkesat dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të energjisë elektrike (NEMO) dhe rolet dhe përgjegjësitë e NEMO- s dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të energjisë në Tregun e Bashkuar”.

2.1 MONITORIMI I VEPRIMTARIVE NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE

2.1.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike

Në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neni 7, neni 20, gërma ç), d), f) dhe g), neni 22, neni 58, pika 9, neni 62, pika 4 si dhe neni 72, gërma dh); Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016, i ndryshuar “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, neni 13; si dhe kushtet e licencave të lëshuara nga ERE, shërbimet e operatorëve të licencuar nga ERE janë objekt i monitorimit në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore si dhe zbatimin e rregullave, vendimeve dhe urdhërave të ERE-s.

Në zbatim të sa më sipër, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit të sektorit por edhe detyrimeve të përcaktuara në Vendimin nr. 134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë, “Mbi miratimin e

manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, ERE ka detyrimin të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me gjetjet gjatë ushtrimit të funksionit të vetë monitorues.

Në lidhje me sa më sipër, ERE gjatë vitit 2019 me qëllim grumbullimin e të dhënave të cilat japin një pasqyrë të plotë të funksionimit dhe zhvillimeve të tregut të energjisë elektrike, ka ushtruar këtë detyrë në dy forma:

1. Nëpërmjet mbledhjes së të dhënave e marrjes së informacionit dhe të dhënave nëpërmjet raportimeve periodike nga të licencuarit dhe monitorimit në vijimësi duke kryer verifikimet e këtyre të dhënave të së njëjtës natyrë të marra nga burime të ndryshme raportimi.
2. Nëpërmjet monitorimeve specifike të kryera pranë të licencuarve me objekte specifike monitorimi.

Në lidhje me pikën e parë lartpërmendur, rezultatet dhe analizat janë paraqitur në Pjesën I-rë “Gjendja Sektorit dhe Tregut të Energjisë Elektrike” të këtij raporti, duke dhënë edhe mundësinë e krahasimit me vitet paraardhëse si dhe në mënyrë krahasuese me ecurinë e të dhënave, për të cilat janë vendosur targete në Kapitullin VI “Plani i zbatimit” të VKM-së nr. 253, datë 24.4.2019 “Mbi miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik.

Në mënyrë që të sigurohen raportime sa më korrekte dhe në kohë nga të licencuarit dhe pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 203, datë 12.12.2019, miratoi “Rregullat për monitorimin e tregut të energjisë elektrike”.

ERE në bashkëpunim me donatorë të sektorit është duke parë mundësinë e zhvillimit të një platforme elektronike e cila do ti mundësojë pjesëmarrësit në tregun e energjisë për të plotësuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Direktivat dhe Rregulloret e KE-së si dhe Ligjet 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar dhe 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, njëkohësisht do ti shërbejë të gjithë të interesuarve për marrjen e informacioneve dhe të dhënave të nevojshme në një kohë sa më të shpejtë.

Nga analizimi i rezultateve dhe përpunimi i problematikave e informacioneve të marra, nga ERE, është gjykuar sipas rastit të zhvillohen verifikime, analiza, seanca dëgjimore dhe monitorime në terren.

Grupet e monitorimeve specifike janë organizuar me pjesëmarrje të specialistëve të ERE nga fusha të ndryshme me qëllim realizimin e monitorimit në mënyrë sa më profesionale.

Githashtu është analizuar situata e raportimeve periodike të të licencuarve ku konstatohen mangësi nga ana e tyre në respektimin e detyrimit për raportim periodik, lidhur me sa konstatuar ERE ka vijuar me korespondencat përkatëse në kuadër të përmirësimit të këtyre praktikave dhe përmirësimit të mangësive

Përfaqësues të ERE-s janë anëtarë të grupeve të punës së organizmave ndërkombëtare me të cilat ERE ka vendosur tashmë marrëdhënie bashkëpunimi.

Në këtë kuadër ERE dërgon informacionet e kërkuara nga këto institucionet e organizatat e ndryshme bashkëpunuese me ERE-n, si dhe merr pjesë në takime, që janë në objektin e punës së ERE.

Në mënyrë që të rritet transparenca në tregun e energjisë elektrike, me Vendimin e ERE-s Nr. 118, datë 27.07.2017, u miratuan “Rregullat për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike”, ndërkohë publikimi i të dhënave kryesore katërmujore për funksionimin e tregut të energjisë elektrike publikohen rregullisht në faqen e internetit të ERE-s sipas parashikimeve të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar. Për të siguruar zbatimin e

parashikimeve ligjore dhe nënligjore të detyrimeve që lidhen me transparencën në tregun e energjisë ERE ka monitoruar periodikisht faqet e internetit të operatorëve kryesorë në tregun e energjisë. Rezulton se për vitin 2019 këto detyrime zbatohen kryesisht nga operatorët në kuadër të rritjes së transparencës, dhe për çdo rast nga ana e ERE-s janë bërë shkresa për ku i kërkohet operatorëve përmirësimi i këtij procesi duke i evidentuar detyrimet përkatëse. Nga ana e operatorëve, është vërejtur shtimi i informacionit që publikohet në kuadër të transparencës, kryesisht OST nëpërmjet platformës së transparencës së ENTSO-e, gjithsesi përmirësimi të këtij procesi duhet të vijojnë, fakt që do të jetë objekt i punës së ERE-s në vijimësi.

Disa ndër monitorimet specifike pranë të licencuarve paraqiten shkurtimisht si vijon :

2.1.2 Monitorime Specifike nga informacionet periodike të OST sh.a.

I. Alokimi i kapaciteteve në interkonjeksione

Në tabelën e mëposhtme paraqiten alokimet e kapaciteteve të interkonjeksionit sipas kufijve.

Ankandë	Periodha	Shqipëri - Mali Zi						Shqipëri - Greqi						Shqipëri - Kosove											
		ATC e ofruar		ATC e shitur ne		Cnimi Ankandit		ATC e ofruar		ATC e shitur ne		Cnimi Ankandit		ATC e ofruar		ATC e shitur ne		Cnimi Ankandit							
		Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import						
		[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]						
Janar	1.01.2019-31.01.2019	100.5	125	100.5	125	0.16	0.94	50	50.5	50	50.5	5.05	3.13	125	125	125	125	0.18	0.94						
Shkurt	1.02.2019-28.02.2019	100.5	125	99.5	125	0.13	1.7	50	50.5	50	50.5	4.07	3.76	125	125	125	125	0.12	2						
Mars	1.03.2019-17.03.2019													100	100	100	100	0.21	0.33						
	18.03.2019-21.03.2019													75	75	75	75	0.36	0.76						
	22.03.2019-31.03.2019													100	100	100	100	0.21	0.34						
	1.03.2019-10.03.2019	100.5	125	100.5	124.5	0.28	0.25	50	50.5	50	50.5	10	0.25												
	11.03.2019-13.03.2019	75.5	100	75.5	100	0.28	0.25																		
	14.03.2019-17.03.2019	100.5	125	100.5	124.5	0.28	0.25																		
	18.03.2019-21.03.2019	25.5	25	25.5	15	0.28	0.25																		
22.03.2019-31.03.2019	100.5	125	100.5	124.5	0.28	0.25																			
Prill	1-22.04.2019													105	105	105	105	0.15	2.32						
	26-30.04.2019													105	105	105	105	0.15	2.32						
	1-30.04.2019	100.5	125	100.5	125	0.31	2.1	50	50.5	50	50.5	9	0.33												
Maj	1.05.2019-31.05.2019	100.5	125	100.5	125	0.11	2.11	50	50.5	50	50.5	9.39	0.32	105	105	105	105	0.15	2.27						
	1.06.2019-17.06.2019	100.5	125	99	125	0.12	2.89	50	50.5	50	50.5	13.67	0.26	105	105	105	105	0.3	1.6						
Qershor	18.06.2019-30.06.2019	50.5	50	50.5	50	0.12	2.89	50	50.5	50	50.5	13.67	0.26	105	105	105	105	0.3	1.6						
	1.07.2019-12.07.2019	0.5	100	0.5	100	0.08	2.15	50	50.5	50	50.5	14.5	0.57	105	105	105	105	0.08	2.33						
Korrik	13.07.2019-31.07.2019	100.5	125	100.5	125	0.08	2.15	50	50.5	50	50.5	14.5	0.57	105	105	105	105	0.08	2.33						
	1.08.2019-31.08.2019	100.5	125	100.5	125	0.05	1.44	50	50.5	50	50.5	8.51	0.17	105	105	105	105	0.09	1.3						
Shtator	01.09.2019-14.09.2019							50	50.5	50	50.5	6.54	0.43	105	105	105	105	0.06	1.82						
	15.09.2019-19.09.2019																		105	50	105	50	0.06	4.32	
	20.09.2019-24.09.2019																			105	105	105	105	0.07	2.99
	27.09.2019-30.09.2019																			75	105	75	105	0.1	2.99
	01.09.2019-16.09.2019	100.5	125	100.5	125	0.05	1.66																		
17.09.2019-30.09.2019	50.5	25	50.5	25	0.08	5.11																			
Tetor	01.10.2019-06.10.2019							50	50.5	50	50.5	3.87	1.55	62.5	37.5	62.5	37.5	0.08	1.17						
	07.10.2019-09.10.2019							0	0	0	0	3.87	1.55	62.5	25	62.5	25	0.09	5.22						
	10.10.2019-31.10.2019							50	50.5	50	50.5	3.87	1.55	62.5	37.5	62.5	37.5	0.09	5.11						
	01.10.2019-13.10.2019	100.5	125	100.5	124	0.08	1.57																		
14.10.2019-31.10.2019	50.5	25	50.5	25	0.17	7.99																			
Nëntor	01.11.2019-15.11.2019	75.5	50	75	50	0.16	3.64	50	50.5	50	50.5	2.25	0.97	62.5	62.5	62.5	62.5	0.16	2.07						
	16.11.2019-30.11.2019	125.5	100	125.5	100	0.08	1.93																		
Dhjetor	01.12.2019-07.12.2019							50	50.5	50	50.5	6.77	0.29												
	08.12.2019-11.12.2019	100.5	125	100.5	125	0.21	1.18	0	0	0	0	6.77	0.29	62.5	62.5	62.5	62.5	0.16	0.73						
	12.12.2019-31.12.2019							50	50.5	50	50.5	6.77	0.29												

Figura 72 Të dhëna mbi Ankandet e Alokimit të Kapaciteteve në Sistemin e Transmetimit gjatë vitit 2019.

Siç shihet, në shumicën e rasteve ka patur konxhestion në alokimin e kapaciteteve në të dy krahët import/eksport.

Për alokimin e kapaciteteve në interkonjeksione, gjatë vitit 2019 janë ndjekur procedurat sipas rregullave të miratuara nga ERE me Vendimin Nr. 140, datë 22.11.2013, të ndryshuar “Rregullorja mbi alokimin e kapacitetit në interkonjeksione” për kufirin Shqipëri - Kosovë dhe “Rregullores të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO)” versioni 1.4, miratuar me Vendimin Nr. 167, datë 18.10.2016, për kufinj të Shqipëri-Mal i Zi dhe Shqipëri-Greqi.

- Ankandet e kapaciteteve në interkonjeksion janë zhvilluar në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara, në rregulloret apo vendimet përkatëse të ERE-s.
- Vlen të theksojmë se nuk ka patur asnjë ankimim të Pjesëmarrësve të Tregut, pjesëmarrës në ankand, për afatet, procedurat, procesin e zhvillimit të ankandit, procesin e vlerësimit të ofertave, përcaktimit të fituesve dhe çmimeve të ankandit, komunikimit dhe publikimit të njoftimit të ankandit dhe rezultateve të tyre.
- Implementimi i Tregut të energjisë është edhe një proces bashkëpunimi dhe i vlerësimit të ndërsjellë ndërmjet OT dhe Pjesëmarrësve të Tregut, sipas rolit përkatës të tyre në tregun e energjisë.

II. Disbalancat

Në zbatim të Rregullave të Përkohshme të Tregut dhe Rregullave të Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike (Rregullat për Mekanizmin Balancues) për sa i përket trajtimit të çështjes së tregut balancues, mbi bazën e të dhënave orare të marra nga sistemi i matjes që zotëron OST sh.a. ka bërë llogaritjet e disbalancave për secilin pjesëmarrës tregu të cilët janë përgjegjës për disbalancat që shkaktojnë, në bazë orare.

Disbalancat e pjesëmarrësve të tregut janë llogaritur dhe faturuar në bazë mujore..

Zbatimi i mekanizmit të përkohshëm të balancimit për disbalancat e shkaktuara nga pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike është objekt i monitorimit të vazhdueshëm të ERE-s.

Në këtë kuadër për të trajtuar mosmarrëveshjet që lindin si rezultat i zbatimit të mekanizmit të përkohshëm të balancimit ERE në bashkëpunim me palët e interesuara ka ndërmarë hapa për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve respektive. Konkretisht ERE ka filluar procedurën për shqyrtimin e problematikës të ngritur nga Energji Ashta sh.a., nëpërmjet rishikimit të mekanizmit të përkohshëm të balancimit.

Po ashtu nga ana ERE-s ka ndërmarrë monitorime të procesit të zbatimit të rregullave të balancimit për të gjithë pjesëtarët e tregut rezultateve të cilave do ti shërbejnë vendimarrjeve të mëtejshme në kuadër të këtyre rregullave.

Pale Përgjegjëse Balancuese	JANAR		SHKURT		MARS		PRILL		MAJ		QESHOR		KORRIK		GUSHT		SHTATOR		TEJTOR		NETOR		DHJETOR		TOTALI 2019	
	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]
KURUM	256.49	116.39	191.89	103.90	1,235.65	2,043.53	1,456.41	1,280.45	1,063.66	1,463.38	1,428.15	1,309.26	1,609.60	1,021.00	1,419.08	1,120.64	1,358.77	882.73	752.05	585.64	1,226.61	547.86	818.82	1,797.99	12,817.18	12,272.77
DEVOLL	81.82	16.93	12.06	31.84	14.06	21.75	12.01	25.89	26.14	53.86	18.04	37.27	18.85	4.77	26.97	2.58	14.69	3.46	22.12	6.90	12.12	2.58	11.51	44.21	270.38	252.05
ENERGIA GAS & POWER									2.43	111.64	-	275.33	10.43	187.92	24.62	182.66	128.22	170.47	209.99	63.05	333.42	14.41	428.02	3.52	1,137.13	1,009.01
AYEN ENERGY TRADING	261.57	66.36	173.07	275.42	364.99	206.33																			799.63	548.11
AYEN AS ENERGI	1,645.35	246.94	1,115.62	147.80	2,054.23	77.74	829.87	340.46	593.42	237.82	572.91	274.42	120.32	95.11	147.55	152.12	303.00	25.62	263.89	29.20	263.59	244.20	127.79	174.17	8,037.55	2,045.59
GSA	560.60	1,572.85	205.38	364.50	612.82	1,222.74	1,215.75	848.37	581.07	1,767.38	1,381.29	1,151.47	962.99	871.15	921.14	946.43	3,435.92	1,604.00	199.63	1,017.31	299.15	1,496.77	436.25	1,615.50	10,812.00	14,478.47
GEN-I					4.00		20.00			266.12	167.02	542.96	402.02	302.30	257.90	259.49	293.63	521.69	420.67	264.28	218.62	420.53	199.81	279.65	2,167.86	2,857.01
DANSKE										9.00																9.00
AES	414.33	742.72	2,168.51	247.14	2,601.23	179.05	1,601.18	95.09	1,173.02	85.08	1,488.37	82.26	951.08	142.32	649.58	271.71	1,222.33	148.78	1,114.38	218.26	1,155.55	71.00	1,386.26	29.03	15,925.82	2,312.45
ASHTA	832.62	922.17	869.77	698.55	1,020.08	714.82	990.81	660.03	836.89	666.22	630.38	632.31	516.93	425.07	561.59	514.43	636.80	510.47	614.61	593.49	1,302.43	738.26	941.53	861.65	9,814.43	7,937.46
OSHEE	38,535.10	16,192.98	4,436.50	28,991.15	11,145.23	20,548.92	4,085.02	22,661.33	2,838.19	27,149.12	8,862.93	10,707.10	9,037.88	12,833.41	4,999.67	10,761.87	5,874.30	14,046.48	5,625.68	5,889.53	4,750.79	28,131.24	7,180.10	24,403.56	107,371.39	222,316.70
NOA	105.00	-																	4.00						169.00	-
KESH (Pale Përgjegjëse Bala	202.12	8.47	8.28	95.11	14.21	250.81	-	192.79	4.30	83.94	3.38	99.51	32.12	18.68	23.75	27.81	44.13	0.68	110.15	-	208.66	25.15	51.52		329.88	1,191.59
KASTRATI	3,319.19	422.56	1,873.21	1,016.53	1,955.52	945.78	2,773.51	273.71	5,785.90	27.93	3,046.64	257.77	1,226.25	651.67	1,409.56	289.17	246.94	1,954.17	45.57	2,153.30	2,642.11	382.45	7,945.81	8.33	1,068.04	337.67
OST - HUMBJET ne Transm	3,319.19	422.56	1,873.21	1,016.53	1,955.52	945.78	2,773.51	273.71	5,785.90	27.93	3,046.64	257.77	1,226.25	651.67	1,409.56	289.17	246.94	1,954.17	45.57	2,153.30	2,642.11	382.45	7,945.81	8.33	32,270.23	8,383.35
Ofruesi i Sherbimit te Balancimit	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Rritje Gjenerimi [MWh]
KESH	14,113	38,062	23,688	4,735	16,591	11,129	15,341	5,536	20,824	3,418	10,453	8,959	12,643	9,855	9,969	5,662	13,153	7,182	7,064	5,192	27,395	5,152	19,978	9,832	191,211	114,714
TOTALI	60,387	58,370	34,742	36,707	37,613	37,340	28,326	31,914	33,913	35,339	28,074	24,397	27,609	26,437	20,502	20,215	26,896	27,166	16,553	16,177	39,842	37,443	39,744	39,158	394,202	390,665
Disbalancat mujore [MWh]	2,017	(1,965)			273	(3,588)			(1,426)	3,676			1,172	287	(270)			376		(2,399)		(586)				(3,537)

Figura 73 Disbalancat totale për vitin 2019 (MWh), Burimi OST sh.a.

2.1.3 Monitorime të tjera të lidhura me veprimtarinë e të licencuarvë në sektorin e energjisë elektrike

- **Monitorimi periodik i treguesve dhe të dhënave kryesore të Sektorit të Energjisë Elektrike për vitin 2019.**

Të dhënat kryesore të sektorit të energjisë elektrike për vitin 2019, jepen në tabelën e mëposhtme në kolonën “Fakt”, të krahasuara me kolonën “Target”, ku pasqyrohen vlerat e vendosura si target në Kapitullin VI “Plani i zbatimit” të VKM-së nr. 253, datë 24.4.2019 “Mbi miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik”.

Krahasim target fakt i disa nga të dhënat të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar për vitin 2019 (GWh)	Targeti	Fakti
Humbjet në shpërndarje (import nga OSHEE)	1 464	1 483
Humbjet në transmetim (OST)	167	169
Klientë të kualifikuar Industri (të lidhur në OST)	760	867
Familjare	2 841	2 750
Kërkesa totale e energjisë	7 291	7 612
Gjenerimi Neto nga KESH	3 955	2 979
TEC Vlora	0	0
Koncesionare dhe PPE	1 935	
Gjenerim Neto i Brendshem	5 888	5 206
Humbje totale në shpërndarje (%)	23	21.79
Mbledhja e të ardhurave (%)	95	98.4

- **Monitorimet e kryera pranë shoqërisë KESH sh.a., lidhur me ankesën e shoqërisë Gen-I Tirana sh.p.k. mbi zbatimin e procedurave të shit-blerjes së energjisë elektrike për vitin 2017 dhe periudhën janar- mars 2018, si dhe zbatimin e kontratave të depozitimit dhe shkëmbimit nga KESH sh.a. për vitet 2017 dhe 2018.**

Referuar rezultateve të këtij monitorimi, Bordi i ERE-s, me Vendimin Nr. 93, datë 03.06.2019, vendosi:

- 1- T'i rekomandojë KESH sh.a., të kërkojë e të propozojë në organet drejtuese të shoqërisë rishikimin rregullores për procedurat e shitblerjes së energjisë, duke i përshtatur ato me kërkesat e tregut dhe parashikimet e Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 103/2016, e cila parashikon ndërtimin e një platforme IT online, përfshirë publikimin të të dhënave të blerësit dhe shitësit në funksion të blerjes/shitjes së energjisë elektrike.
- 2- Të vijojnë monitorimet e nisura, në transaksionet e Energjisë elektrike dhe në bashkëpunim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, të shfrytëzojë të gjitha mjetet e lejuara ligjore me qëllim zbardhjen e rrethanave që çuan në fillimin e monitorimeve me qëllim trajtimin e ankesës së një pjesmarrës tregu, duke shqyrtuar transaksionet e kryera nga të gjithë pjestarët e tregut të energjisë elektrike.

Bazuar në më sipër, është konstatuar se KESH sh.a. ka dërguar shkresat përkatëse për përfundimin e këtyre kontratave dhe ka përfunduar kontratat në fjalë. Aktualisht nga raportimet

që kemi KESH sh.a. është duke punuar për realizimin e platformës IT on line dhe aktualisht procedurat e shitjes dhe të blerjes së energjisë elektrike realizohen në formë elektronike nëpërmjet e-mailit.

- **Monitorim i centraleve prodhuese mbi ecurinë e investimeve për subjekte të licencuara gjatë viteve 2017-2018**

Në monitorimin e realizuar nga ERE lidhur me verifikimin e ecurisë së realizimit të investimeve të parashikuara në dokumentacionin në aplikimin për licencën e prodhimit të energjisë elektrike, janë monitoruar ato subjekte të cilat janë licencuar përgjatë viteve 2017-2018.

Përgjatë verifikimit në terren është konstatuar se shumica e subjekteve të licencuar kanë filluar punimet për realizimin e investimeve të parashikuara, madje disa prej tyre kanë përfunduar fazën e investimeve dhe tashmë kanë filluar prodhimin e energjisë elektrike nga centralet.

Vërehet se vetëm një numër shumë i vogël subjektësh nuk ka respektuar grafikun e punimeve të parashikuara në aplikimin për licencë, për shkak të problematikave të ndryshme që kanë hasur kryesisht lidhur me nxjerrjen e lejeve ndërtimore të nevojshme për fillimin e procesit të ndërtimit.

- **Monitorimi i të licencuarve në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.**

Gjatë monitorimeve u konstatua që të licencuarit përgjithësisht respektojnë kushtet e licencës së prodhimit ndërkohë që një numër i vogël rezultuar me shmangie të kapacitetit të instaluar faktik nga limiti i lejuar në licencë ($\pm 10\%$ e kapacitetit të instaluar).

- Në monitorimet e ardhshme të së njëjtës natyre, të bashkërendohet puna edhe me institucione të tjera (si MIE, AKBN etj.) të cilat janë gjithashtu përgjegjëse për monitorimin e këtyre subjekteve në veprimtarinë e prodhimit të enegjisë elektrike, si dhe objekti i këtyre monitorimeve të jetë me konkret për tu realizuar.
- T'i ritheksohet të licencuarve detyrimi për respektimin rigoroz të kushteve të licencës si dhe të gjitha akteve të tjera për zbatim, duke sjelle në vëmendje se moszbatimi do të shoqërohet me sanksione sipas legjislacionit në fuqi. Pas gjetjeve përkatëse nga ana e ERE-s gjatë monitorimeve të realizuara dhe bazuar në urdhërat e MIE respektivisht (i) Urdhërit Nr. 47, datë 31.01.2019, i cili ka pezulluar procedurat koncesionare si dhe ato objekt i VKM Nr. 822, datë 07.10.2015, nga burimet hidrike të energjisë elektrike që nuk janë finalizuar me lidhje kontrate, si dhe, (ii) Urdhërit Nr. 48, datë 30.01.2019, për fillimin e procesit të verifikimit të zbatimit të kontratave koncesionare apo kontratave objekt i VKM Nr. 822, datë 07.10.2015, ERE i ka dërguar shkresë MIE dhe do të vijojë bashkëpunimin me Ministrinë e linjës për evidentimin dhe marrjen e masave rast pas rasti për këto subjekte.

- **Monitorimin lidhur me realizimin e planit të investimeve të OST sh.a. gjatë viteve 2017 dhe 2018.**

Përgjatë vitit 2019 u realizua monitorimi i shoqërisë OST sh.a. lidhur me realizimin e planit të investimeve të OST sh.a. gjatë viteve 2017 dhe 2018. Për sa u konstatua gjatë monitorimit të realizuar nga ERE i'u rekomandua shoqërisë OST sh.a. si më poshtë vijon:

- OST sh.a. duhet të mbajë regjister të asetëve sipas legjislacionit dhe standarteve në fuqi.
- Aplikimi për shqyrtim dhe raportet mbi realizimin e planit të investimeve dhe të zhvillimit të rrjetit duhet të bëhen duke zbatuar në mënyrë rigorozë parashikimet e Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e Energjise Elektrike", i ndryshuar dhe Rregullores së paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga Operatorët, për sa i takon formës dhe përmbajtjes si dhe afateve të paraqitjes.

- OST sh.a. duhet të bëjë analiza kosto - përfitim për zërat e planit të investimeve siç kërkohet në Rregullore së paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga Operatorët.
- OST sh.a. në planet e investimeve sipas viteve tarifore duhet t'i përmbahet në mënyrë rigorozë planit të zhvillimit të rrjetit 10-vjeçar për projektet që parashikohen në këtë plan zhvillimi.
- OST sh.a. duhet të realizojë planin e investimeve brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- Përgjat vitit 2020 do të mbetet në fokusin e ERE monitorimi mbi realizimin e investimeve dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ERE për të licencuarit si dhe monitorime të tjera në përputhje me detyrat e ERE-s siç mund të jenë, zbatimi i ndarjes funksionale të Shpërndarjes, plotësimi i kushteve për hapjen e tregut, si dhe monitorime rutinë mbi të licencuarit e sektorit.

2.1.4 Transaksionet e kryera nga KESH sh.a, OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. në Treg të hapur (parregulluar) gjatë vitit 2019.

Gjatë vitit 2019 ERE ka monitoruar përmes raportimit periodik blerjet e energjisë elektrike në treg të hapur nga shoqëritë e rregulluara OSHEE sh.a. dhe OST sh.a., ku rezulton se çmimi mesatar i blerjes së energjisë në treg të hapur nga këto dy shoqëri të ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik është rreth 69.94 EUR/MWh.

OSHEE sh.a. ka blerë në treg të parregulluar me qëllim sigurimin e furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga VKM 244/2016, dhe sipas Rregullave të përkohshme të tregut si dhe Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr, 103/2016, i ndryshuar.

KESH sh.a. gjatë vitit 2019 ka shitur/blerë energji në treg të parregulluar në zbatim të “Rregullores së Tregtimit të Energjisë Elektrike nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare KESH sh.a.” miratuar me vendimin nr. 2762/8, datë 06.06.2018, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në rolin e pronarit të KESH sh.a. dhe “Rregullave të përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.” të miratuar me Vendimin Nr.5233/1, datë 12.06.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

OST sh.a. ka blerë në treg të parregulluar me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit në zbatim të detyrimeve që burojnë nga VKM nr. 244/2016, dhe sipas Rregullave të përkohshme të tregut si dhe Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr, 103/2016, i ndryshuar.

Më poshtë po paraqesim një tabelë me të dhëna të transaksioneve të kryera gjatë vitit 2019:

[MWh]	Transaksionet e KESH.sh.a në treg të hapur gjatë vitit 2019												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total 2019
Transaksione hyrëse nga interkoneksioni	0	4,414	13,547	5,293	2,892	4,731	8,447	26,955	15,866	35,381	241	3,597	121,364
Transaksione dalëse në interkoneksion	0	18,360	0	0	5,650	0	5,920	7,206	0	5,460	1,575	6,138	50,309
Transaksione në tregun e brendëshëm	0	2,431	4,108	1,666	9,792	8,610	6,498	32,702	12,488	12,161	14,955	27,146	132,557

[MWh]	Transaksionet e OSHEE.sh.a në treg të hapur gjatë vitit 2019												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total 2019
Blerje në treg të hapur	388,660	173,040	259,417	236,480	127,304	140,670	126,480	141,360	230,880	210,724	136,568	0	2,171,583

[MWh]	Transaksionet e OST.sh.a në treg të hapur gjatë vitit 2019												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total 2019
Blerjenë treg të hapur për mbulimin e humbjeve në transmetim	14,883	11,520	11,777	12,080	16,858	14,474	14,029	15,318	11,313	10,053	14,740	21,577	168,621

Figura 74 Transaksionet e kryera gjatë vitit 2019 nga KESH sh.a. ; OSHEE sh.a. dhe OST sh.a.

Në grafikun e Figurës 75 është paraqitur balanca (hyrje – dalje) import-eksport e energjisë elektrike për periudhën 2007 – 2019.

Për 10-vjeçarin e fundit, me përjashtim të vitit 2010, 2016 (vlera të vogla) dhe 2018 vendi ynë rezulton të jetë një importues neto i energjisë elektrike. Sqarojmë se vlerat e paraqitura përfaqësojnë të gjitha flukset hyrëse e dalëse nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.




Figura 75 Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite (Burimi: OST sh.a.).

2.2 Regjistri i Pjesëmarrësve të rregjistruar në tregun e energjisë elektrike gjatë vititi 2019.

Regjistri Pjesëmarrësve të Tregut të Energjisë Elektrike (aktiv deri 31.12.2019)		PRODHUES I ENERGJISË ELEKTRIKE		P
		TREGTAR I ENERGJISË ELEKTRIKE		T
		FURNIZUES I ENERGJISË ELEKTRIKE		F
		FURNIZUES I SHËRBIMIT UNIVERSAL		FSHU
		SHPERNDARJE e ENERGJISË ELEKTRIKE		SH
Nr	Emri i Subjektit	EIC Code	data e regjistrimit	Roli në TEE
1	Albanian Energy Supplier	54X-AEG-02-1603G	26.05.2015	T; F
2	AXPO Albania	23X--150330-AA-K	20.01.2011	T; F
3	Ayen AS Energji	23X--150416-A--N	17.12.2014	P; T; F
4	Ayen Energy Trading	23X--140426-AY-W	04.05.2014	T; F
5	Danske Commodities Albania	23X--121120DCALG	30.10.2012	T; F
6	Devoll Hydropower	23X--150409-DHP5	11.06.2015	T; F
7	Energjia doo Veternik	54X-EDOOV-15-020	15.12.2015	T; F
8	Energji Ashta	54X-HECASHITA-059	25.05.2012	P
9	Energy Supply-AL	34X-0000000017-C	15.05.2013	T; F
10	Erdat Lura	54X-HEC-LURA-069	17.09.2013	P
11	GEN-I Tirana	23X---120709GEN0	31.01.2011	T; F
12	Gjo-Spa Power	54X-HEC-LAPAJ075	17.09.2013	P
13	Green Energy Trading Albania	23X--150702GE--3	01.07.2015	T
14	Grupi Sistemeve Automatike	22XGSA-----N	09.05.2011	T; F
15	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare	23X--130918APC-M	25.04.2011	P; T
16	KURUM International	23X--131115KI--1	17.12.2013	P; T; F
17	NOA Energy Trade	23X--150630-NE-6	10.03.2015	T; F
18	Operatori Shperndarjes Energjise Elektrike	23X--130503--CS-2	25.04.2011	SH; FSHU
19	Stravaj Energy	54X-STRAVAJ-E086	25.04.2014	P; T
20	WENERG	54X-WENERG---10E	10.06.2015	P
21	YLLIAD	29XYLLIAD-AL---W	03.03.2011	T
22	Energy Market Albania	54X-ENMARKETAL99	23.03.2017	T
23	Grid Energy	54X-GRID-ENERGYR	05.04.2017	T; F
24	GAEA-Energjia Alternative e Gjelber	54X-GAEA11-1501R	07.12.2015	T; F
25	Energy Financing Team Tirana	54X-EFT-TIRANA-V	24.08.2017	T; F
26	Alpiq Energy Albania	23X--141204AEA-T	29.04.2011	T; F
27	Le Trading Albania	23X--150309-LT-Y	16.02.2015	T
28	Energy to Energy	54X-EN-TO-EN-13F	13.10.2017	T
29	DON-UCD	54X-DON-UCD--15T	17.07.2018	T;F
30	URADRIN	54X-100ID101218J	10.08.2018	T
31	Energia Gas and Power Albania shpk	23x-150309-LT-Y	22.10.2018	T; F
32	RENRGY Trading Group	54X-10IRN102618R	12.11.2018	T,F
33	Ener Trade shpk	54X-10 IET091118	21.12.2018	T; F
34	Kastrati Energy	54X-11LKE250319U	25.03.2019	T; F
35	Power and Gas Operations	54X-10IPG2307196	23.07.2019	T
36	ENSCO Trading (Albania) sh.pk	54X-110IESA1019G	02.12.2019	T
37	KESH sha	23X--130918APC-M	16.12.2019	

Burimi OST sha

Figura 76 Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2019.

3. LICENCIMI DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË TË LICENCUARËVE NË SEKTORIN E ENERGJISË

3.1 Licencimet dhe Kërkesat e Trajtuara gjatë vitit 2019.

Gjatë vitit 2019, ERE ka vijuar procesin e licencimit të subjekteve në veprimtaritë/aktivitetet e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

Në total ERE ka lëshuar në vitin 2019, 27 licenca nga të cilat 26 janë lëshuar në sektorin e energjisë elektrike dhe vetëm 1 në sektorin e gazit natyror.

Gjatë këtij viti janë lëshuar 12 Licenca për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, 11 licenca për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike si edhe 3 licenca për furnizimin e energjisë elektrike. Në të njëjtën kohë në sektorin e gazit natyror është lëshuar vetëm një Licence për transmetimin e gazit natyror në vendin tonë. Janë rinovuar 7 licenca nga të cilat 4 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe 3 në veprimtarinë e furnizimit me enegji elektrike.

Modifikime të licencave janë realizuar 2 të tilla për vitin 2019.

Licenca të hequra në veprimtarinë e tregtimit janë 2 të tilla, dhe 1 në veprimtarinë e furnizimit, me kërkesë të licencuarve. Mosfillim procedure të licencimit është realizuar për 4 aplikime për mungesë të dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesit.

Për të gjitha aplikimet e paraqitura, është respektuar transparencja e parashikuar në procedurat për licensim, në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”. Në përputhje me kuadrit ligjor të mësipërm janë zbatuar afatet e publikimit në median e shkruar për marrjen e opinionit nga të interesuarit. Gjithashtu çdo aplikim për licensim i është nënshtruar një analize të kujdesshme të rregullshmërisë dhe plotësisë me korrektësi të dokumentacionit përkatës ligjor, administrativ, financiar, teknik dhe marrjes së lejeve përkatëse të përdorimit të ujrave apo leje mjedisore në rastet e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, të dhëna nga institucionet e tjera në përputhje me veprimtarinë që subjektet kanë kërkuar të licencohen.

Subjektet e licencuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2019:

SUBJEKTI	PRODHUES ENERGJIE ELEKTRIKE	FUQIA E INSTALUAR
“RTS” sh.p.k	Central Fotovoltaik	2000 kW
“Eglantina Xhoxhaj”sh.p.k	Centrali Fotovoltaik “Lugano”	2000 kW
“SANG 1” sh.p.k	H/C “Thirrë”	1820 kW
“S G D ENERGJI” sh.p.k	H/C “Ndërfushas“	1125 kW
“SMART WATT” sh.p.k	Centrali Fotovoltaik, Sheq Marinas, Topojë, Qarku Fier,	2000 kW
“ <u>BE-IS ENERGY</u> ” sh.p.k	HEC “KALIVAR 1”	1475 KW
	HEC “KALIVAR 2”	526 KW
	HEC “KALIVAR 3”	3321 KW
	HEC “KALIVAR 4”	275 KW
	Kapaciteti total i instaluar	5597 kW
“ S.P.E GJADËR” sh.p.k	“HEC Gjadër Nr.1/1”	2134 kW
		4406 kW
	“HEC Gjadër Nr. 1/2”	2983 kW
		3874 kW
	“HEC Gjadër Nr. 2”	5922 kW
	5619 kW	

	“Hec Gjadër Nr. 3” “HEC Gjadër Nr. 4” “HEC Gjadër Nr. 5” Kapaciteti total i instaluar	24938 kW
“IRARBA ENERGI” sh.p.k	H/C “Shengjun”	2040 kW
“MP - HEC” sh.p.k	H/C “Niçë”	2270 kW
“ELVA 2001” sh.p.k	H/C “Mivas”	1940 kW
“HEC Arsti” sh.p.k	H/C “Arsti”	3130 kW
“HYDRO POWER PANARIT” sh.p.k	H/C “Vilë”	1994 kW

Figura 77 Subjektet e licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2019

- Nga Bordi i ERE-s gjatë vitit 2019, është miratuar modifikimi i licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “HENZ ENERGI” sh.p.k, me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE Nr. 65, datë 28.05.2012, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “DARSI 1” me kapacitet 2240 KW, “DARSI 2” me kapacitet 7633 KW, “DARSI 3” me kapacitet 1066 KW, me kapacitet TOTAL 10939 KW. Kjo licencë u modifikua për shkak të optimizimit të skemës energjitike të kryer nga shoqëria duke miratuar emërtimet dhe fuqitë e mëposhtme:
 - HEC “DARSI 1” kapaciteti i instaluar 3328kW
 - HEC “DARSI 2” kapaciteti i instaluar 11635kW
 - Kapacitet Total i instaluar 14963kW
- Po ashtu u miratua modifikimi i licencës së shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k, me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 92, datë 16.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga hecet: “GERMANI 1” me kapacitet të instaluar 1200 kW, “GERMANI 2” me kapacitet të instaluar 1680 kW, “GERMANI 3” me kapacitet të instaluar 1290 kW, “GERMANI 4” me kapacitet të instaluar 810 kW, me kapacitet total të instaluar 4980 kW. Ky modifikim u krye për shkak të optimizimit të skemës së HEC-eve në pronësi të shoqërisë duke miratuar emërtimet dhe fuqitë e mëposhtme:
 - HEC “GERMANI 1” me kapacitet të instaluar 4800 kW, dhe
 - “GERMANI 2” me kapacitet të instaluar 1500 kW.
 - Kapacitet Total i instaluar 6300 kW

Të licënuarit në veprimtarinë e Tregëtimit të Energjisë Elektrike gjatë 2019:

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI I LICENSUAR	DATA E VENDIMIT TË BORDIT
1	“Hydro Seta” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 5, datë 17.01.2019
2.	“Kastrati Energy” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 38, datë 07.03.2019
3.	“Energy 24” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 80, datë 31.05.2019
4.	“Power and Gas Operations” PGO sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 99, datë 21.06.2019
5.	“Terna Energy Trading” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 105, datë 26.06.2019
6.	“Sang 1” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 106, datë 26.06.2019
7.	“Ensco Trading” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi nr. 136, datë 06.09.2019
8.	“Ayen AS Energji” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 141, datë 24.09.2019
9	“Electral Batra” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 153, datë 21.10.2019
10	“Kroi Mbret Energji” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 192, datë 02.12.2019
11	“AXPO Albania” sh.a	Tregëtim	Vendimi Nr. 216, datë 20.12.2019

Figura 78 Subjektet e licencuar në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike për vitin 2019.

- Rinovimin e licensës së shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a, në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 29, datë 31.03.2014. (vendimi i ERE-s nr. 45, datë 15.03.2019)
- Rinovimin e licensës së shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a, në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 35, datë 04.03.2015. (vendimi i ERE-s nr. 159, datë 29.10.2019).
- Rinovimin e licensës së shoqërisë “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 133, datë 24.12.2014. (vendimi i ERE-s nr. 204, datë 12.12.2019)

- Rinovimin e liçensës së shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 7, datë 02.02.2015. (vendimi i ERE-s nr. 222, datë 20.12.2019).
- Rinovimin e liçensës së shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 30, datë 31.03.2014. (vendimi i ERE-s nr. 44, datë 15.03.2019)
- Rinovimin e liçensës së shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 102, datë 21.12.2009, rinovuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 84, datë 16.09.2014. (Vendimi i ERE-s nr. 127, datë 13.08.2019)
- Rinovimin e liçensës së shoqërisë “FSHU” sh.a në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014 dhe transferuar me vendimin nr. 215, datë 11.10.2019, të Bordit të ERE. (Vendimi i ERE-s nr. 164, datë 04.11.2019).
- Heqja e liçensës së shoqërisë “A.E DISTRIBUTION” sh.p.k në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike e miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 82, datë 09.06.2016. Heqja e liçensës të kesaj shoqërie u bë me kërkesë të vete shoqërisë, duke qënë se nuk do të ushtrojë më këtë veprimtari në të ardhmen. (vendimi i ERE-s nr. 30, datë 28.02.2019)
- Heqja e liçensës së shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike e miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 103, datë 07.11.2014. Heqja e liçensës së kesaj shoqërie u bë me kërkesë të shoqërisë duke qënë se nuk do të ushtrojë më këtë veprimtari në të ardhmen. (vendimi i ERE-s nr. 225, datë 20.12.2019)

Subjektet e liçensuar në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë elektrike, gjatë vitit 2019 :

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI LICENSUAR	DATA E VENDIMIT TE BORDIT
1	“KESH” sh.a	Furnizim	Vendimi Nr.25, Datë 28.02.2019
2.	“Kastrati Energy” sh.p.k	Furnizim	Vendimi Nr. 39, Datë 07.03.2019
3.	“Ayen AS Energy” sh.a	Furnzim	Vendimi Nr. 142, Datë 24.09.2019

Figura 79 Subjektet e licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për vitin 2019.

- Heqja e liçensës së shoqërisë “A.E DISTRIBUTION” sh.p.k në veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 83, datë 09.06.2016. Heqja e licencës u bë me vullnet të plotë të shoqërisë duke qënë se nuk do të ushtrojë më këtë veprimtari në të ardhmen. (vendimi i ERE-s nr. 31, datë 28.02.2019)
- Mosfillim procedure për rinovimin e liçensës së shoqërisë “Hydropower Elektrik” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë të klientëve të kualifikuar, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 20, datë 11.02.2015.

- Mosfillim procedure për rinovimin e liçensës së shoqërisë “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë të klientëve të kualifikuar, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 18, datë 11.02.2015.
Këto aplikime të parashtruara më sipër, nuk kanë filluar procedurat e shqyrtimit nga ERE pasi paraqitja e kërkesave për Rinovim të liçensave është bërë përtej afatit të përcaktuar në aktet ligjore respektive.
- Mosfillim procedure për liçensimin e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit të nevojshëm. (vendimi i ERE-s nr. 179, datë 20.11.2019)

Subjektet e liçensuar në aktivitetet e Gazit natyror për vitin 2019			
Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	DATA E VENDIMIT TE BORDIT
1	“TAP AG” sh.p.k	Transmetim	Vendimi Nr. 15, datë 31.01.2019

Figura 80 Subjektet e licencuar në aktivitetet e gazit natyror për vitin 2019.

- Refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për liçensim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit të nevojshëm. (vendimi i ERE-s nr. 134, datë 06.09.2019)
- Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 187 datë 10.11.2017, i ndryshuar me vendimin me nr. 261, datë 19.12.2018, “Për liçensimin e shoqërisë Alb gaz sha në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror” (Vendimi i ERE-s nr. 36, datë 04.03.2019) Shtyrja e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të liçensimit u vendos deri në datën 20.12.2019, për shkak të mosplotësimit të kushteve të vendimit të liçensimit që lidhen me dokumentacionin pronësor, lejet dhe autorizimet mjedisore dhe çertifikatën e sigurimi nga shoqëri sigurimi.
- Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 188 datë 10.11.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 262, datë 19.12.2018, “Për liçensimin e shoqërisë Alb gaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror” (vendimi nr. 37, datë 04.03.2019). Shtyrja e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të liçensimit u vendos deri në datën 20.12.2019, për shkak të mosplotësimit të kushteve të vendimit të liçensimit që lidhen me dokumentacionin pronësor, lejet dhe autorizimet mjedisore dhe çertifikatën e sigurimi nga shoqëri sigurimi.
- Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për liçensimin e shoqërisë Alb gaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, “Për liçensimin e shoqërisë Alb gaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror” i ndryshuar (vendim nr. 220, datë 20.12.2019). Shtyrja e afatit të plotësimit të kushteve të vendimeve të liçensimit u vendos deri në datën 20.06.2020, për shkak të mosplotësimit të kushteve të vendimeve të liçensimit që lidhen me lejet dhe autorizimet mjedisore dhe çertifikatën e sigurimi nga shoqëri sigurimi.

Për të gjithë subjektet e liçensuar nga ERE, mbahet dhe arkivohet regjistri për secilin aktivitet, me të dhënat e nevojshme për subjektin dhe llojin e liçensës, të cilat pasqyrohen të përditësuara në faqen e internetit të ERE dhe mund të konsultohen nga çdo palë e interesuar. Po ashtu mbahet i përditësuar edhe një regjistër i liçensave të dhëna me kusht, plotësimi i të cilave ndiqet me

rigorozitet nga ERE, duke mbajtur korrespondenca zyrtare me shoqerite deri në plotësimin e kushtit.

3.2 Mbikqyrja e të licencuarve gjatë vitit 2019.

Gjatë këtij viti Mbikqyrja e të licencuarve, si një risi në strukturën organizative të ERE-s, ka filluar punën me kontrollin dhe vlerësimin e informacionit të siguruar nga raportimet në lidhje me veprimtarinë e licencuar për çdo subjekt. Janë përpunuar dhe analizuar treguesit tekniko-ekonomik sipas evidencave periodike ose dokumentave të tjera raportuese duke bërë edhe krahasimet me kërkesat e licensave të dhëna dhe nxjerrë konkluzionet përkatëse. Është krijuar dhe azhornuar në mënyrë të vazhdueshme database-i i nevojshëm në lidhje me raportimet nga të licencuarit.

Po ashtu gjatë këtij viti është vijuar me një tjetër proces monitorimi/mbikqyrjeje të plotësimit të kushteve të vendimeve të licencimit për shoqëritë që do të prodhojnë energji elektrike nga Çentralet Eolike, të licencuara nga ERE si më poshtë:

- “Hera” sh.p.k është licencuar nga ERE me vendimin nr. 61, datë 02.11.2007;
- “Alb Wind Energy” sh.p.k është licencuar nga ERE me vendimin nr. 13, datë 28.01.2008;
- “ERS-08” sh.p.k është licencuar nga ERE me vendimin nr. 63, datë 13.06.2008;
- “E Vento s.r.l Albania” sh.p.k, licencuar nga ERE me vendimin nr. 84, datë 17.07.2008;
- “Albanian Green Energy” sh.p.k, licencuar nga ERE me vendimin nr. 89, datë 06.08.2008;
- “Biopower Green Energy” sh.p.k, licencuar nga ERE me vendimin nr. 90, datë 06.08.2008;

Gjatë vitit 2019 për shoqëritë e licencuara sipërcituar, Bordi i ERE-s pezulloi shqyrtimin e kërkesave për shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të licencimit, për të vijuar me kryerjen e monitorimeve pranë këtyre shoqërive, proces që ka nisur në fund të vitit 2019 pranë selive dhe zonave ku do të shtrihen dhe zhvillohen projektet eolike, me qëllim evidentimin, dokumentimin dhe shqyrtimin e të gjitha rrethanave të cilat aplikuesit pretendojë se u kanë pamundësuar zbatimin e kushteve dhe afateve të parashikuara respektivisht në: Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 61, datë 02.11.2007, “Për licencimin e shoqërisë “Hera” sh.p.k, i ndryshuar; Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, “Për licencimin e shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania sh.p.k., i ndryshuar; Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 13, datë 28.01.2008, “Për licencimin e shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k., i ndryshuar; Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 63, datë 13.06.2008, “Për licencimin e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., i ndryshuar; Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, “Për licencimin e shoqërisë “E Vento s.r.l Albania” sh.p.k., i ndryshuar; Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 89, datë 06.08.2008, “Për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., i ndryshuar; Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 90, datë 06.08.2008, “Për licencimin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., i ndryshuar.

Proçesi i monitorimit, hartimi i konkluzioneve përkatëse dhe marrja e vendimeve nga ERE pritet të mbyllet përgjatë vitit 2020. Me përfundimin e këtij monitorimi nga ERE do të vlerësohen në analizë të gjetjeve të monitorimit edhe shtyrja apo jo e afateve për plotësimin e secilës prej kushteve të këtyre licensave nga subjektet respektive.

3.3 Certifikimet

Gjatë vitit 2019 ERE është shprehur në lidhje me vendimet e Çertifikimeve për OST-në e energjisë elektrike dhe OST-në e gazit natyror. Shkak për rishikimin e vendimeve të Çertifikimit u bë pamundësia e shoqërive për ti plotësuar në kohë kërkesat respektive për certifikim duke qenë se plotësimi i këtyre kushteve nuk varej nga vullneti i tyre, por nga nje sërë institucionesh të tjera. Këto kushte kanë të bëjnë me bashkëveprimin ndërinstitucional dhe ndryshimet në kuadrin ligjor respektiv në fuqi. Si e tillë operatorët paraqitën kërkesat për shtyrje të afateve të cilat u shqyrtuan nga ERE dhe u vendos shtyrja sipas vendimeve të pasqyruar më poshtë:

- **Vendim nr. 47, datë 19.03.2019 “Mbi miratimin e kërkesës së OST sh.a. për një ndryshim në vendimin e ERE nr. 43 datë 15.03.2017, mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të sekretariatit të komunitetit të energjisë.”**

Bordi i ERE-s në mbështetje të nenit 3, pika 8 dhe neneve 16; 54 dhe 58, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 53 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; neneve 3; 6; 8 dhe 10 të “Rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 154 datë 11.12.2015, të Bordit të ERE-s, nenit 8 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, miratoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a për një ndryshim të afatit të pikës 2 të vendimit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, deri në datën 15.12.2019. Ky ndryshim erdhi për shkak të pamundësisë së shoqërisë për të plotësuar kushtin e certifikimit që ka të bëjë me bashkëveprimin ndërinstitucional për ndryshimet në Ligjin nr. 43/2015, i ndryshuar, për të plotësuar detyrimin për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave tek Ministria e Ekonomisë, i cili nuk varet nga vullneti i shoqërisë.

- **Vendim nr. 207, datë 16.12.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për një ndryshim në vendimin e ERE nr. 43, datë 15.03.2017, mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të sekretariatit të komunitetit të energjisë.”**

Bordi i ERE-s në mbështetje të nenit 3, pika 8 dhe neneve 16; 54 dhe 58, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 53 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; neneve 3; 6; 8 dhe 10 të “Rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin Nr. 154 datë 11.12.2015, të Bordit të ERE-s, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, miratoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a., për ndryshimin e afatit të pikës 2 të vendimit të ERE Nr.43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të

sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, deri në datën 16.06.2020. Sikurse në vendimin e sipërcituar, edhe ky ndryshim erdhi për shkak të pamundësisë së shoqërisë për të plotësuar kushtin e certifikimit që ka të bëjë me bashkëveprimin ndërinstitucional për ndryshimet në Ligjin nr. 43/2015, i ndryshuar, për të plotësuar detyrimin për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe shkëputjen e kompetencave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise tek Ministria e Ekonomisë. Pavarësisht se plotësimi i këtij kushti nuk varet nga vullneti i shoqërisë OST sh.a, kjo e fundit ka bërë të gjitha përpjekjet e saj për ta plotësuar kushtin në afat. Gjithësesi ndryshimet e duhura ligjore të cilat lidhen me plotësimin e kushteve të certifikimit kanë kaluar tashmë për miratim në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese.

3.4 Programi i Pajtueshmërisë për OST e energjisë elektrike

Në zbatim të përcaktimeve të vendimit nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, si dhe në zbatim të përcaktimeve të Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 30.04.2018, Zyrtari i Pajtueshmërisë së shoqërisë OST sh.a, në përmbushje të detyrave të tij, dërgoi në ERE Raportin e Pajtueshmërisë së OST sh.a për vitin 2018.

Nga ky raport u konstatua se OST sh.a duhet të përmirësojë punën në drejtim të zbatimit të parashikimeve të vendimit të certifikimit sipërcituar, të programit të pajtueshmërisë dhe implementimin e rekomandimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë. Nga ana e ERE-s janë dhënë një sërë rekomandimesh në kuadër të këtyre detyrimeve të cilat duhet të përmbushen nga ana e administratës së OST sh.a dhe të raportohen nga Zyrtari në vijim përgjatë raportit të vitit në vijim.

4. AKTIVITETI I ERE-s NË FUSHËN E RREGULLIMIT TË TARIFAVE DHE ÇMIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR

Në zbatim të neneve 19, 20, 79 dhe 83 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, të neneve 16, 17, 32, 75 dhe 92 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 10 të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për veprimtaritë e rregulluara dhe ato që kanë detyrimin e shërbimit publik në sektorin e energjisë, bazuar në metodologjitë respektive në fuqi.

Në këtë kuadër, veprimtaritë kryesore të ERE-s në fushën e rregullimit të tarifave dhe çmimeve të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror gjatë vitit 2019 kanë qënë:

1. Shqyrtimi i aplikimeve për miratimin e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për:

- Aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike;
- Aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike;
- Aktivitetin e furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike;
- Aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyrorë;
- Aktivitetin e furnizimit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike;
- Aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 7/2017;
- Aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW dhe era me fuqi të instaluar deri 3 MW për vitin 2018, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 7/2017.

2. Ndryshimi i metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 144, datë 25.06.2018.

3. Fillimi i procedurës për miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës të shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.

4.1 Shqyrtimi i aplikimeve për miratimin e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror në aktivitetet e lartpërmendura:

4.1.1 Lidhur me aplikimin e shoqërisë OST sha për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020.

Shoqëria OST sh.a. me shkresën nr. 7335 Prot, datë 05.11.2019, paraqiti pranë ERE-s kërkesën për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020.

Në këtë aplikim OST sh.a., parashtroi argumentet e saj në lidhje me kërkesën për të ardhurat si dhe parashikimeve për sasinë e energjisë elektrike, e cila pritej të transmetohej gjatë vitit 2020, duke kërkuar një rritje të tarifës së transmetimit të energjisë elektrike në nivelin 1.2 lekë/kWh, nga 0.75 lekë/kWh që ishte tarifa në fuqi e miratuar nga ERE me Vendimin e Bordit nr. 266, datë 21.12.2018 për vitin 2019.

Në lidhje me sa kërkuar nga OST sh.a. në këtë aplikim, ERE kreu vlerësimet e saj, në mbështetje të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Proçedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin

e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr.180, datë 08.11.2017, vlerësime të cilat i paraqesim në formë të përmbledhur si më poshtë vijon:

- ERE me shkresën nr. 541, datë 10.09.2019 i është drejtuar shoqërisë OST sh.a për paraqitjen e aplikimit për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020, konform metodologjisë të llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike.
- Meqënëse shoqëria OST sh.a. paraqiti kërkesën për aplikimin e tarifës së transmetimit përtej afateve të përcaktuara në "Rregulloren për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s", koha e mbetur ne dispozicion për shqyrtimin dhe analizimin e tij deri në fund të vitit 2019, nuk mundësonte marrjen e një vendimi nga ana e ERE-s bazuar në një proces sa më gjithëpërfshirës dhe transparent me palët e interesuara.
- Të dhënat e paraqitura në këtë aplikim në lidhje me sasinë e energjisë elektrike që do të lëvrohej në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2020, në kushtet kur mungonte aplikimi apo parashikimi i shoqërisë OSHEE sh.a, mund të rezultonin me diferenca, të cilat mund të sillnin të ardhura të kërkuara më të mëdha apo më të vogla nga parashikimi i shoqërisë.
- OST sh.a nuk paraqiti analiza të detajuara dhe argumenta lidhur me kostot faktike operative dhe kapitale (CAPEX & OPEX) të 10-muajve të mbyllur të vitit 2019 si dhe parashikimet mbi pritshmëritë e saj për pjesën e mbetur të vitit për shpenzimet operative, të ardhurat dhe tarifatat/çmimet e aplikuar gjatë vitit të testimit.
- Plani i investimeve për vitin 2020, bazuar në përcaktimet e "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike", duhet të paraqitet në ERE për shqyrtim në të njëjtën kohë me aplikimin për tarifë.
- OST sh.a. në llogaritjen e të ardhurave të kërkuara, pra si kosto për t'u mbuluar nga tarifa e transmetimit të energjisë elektrike, kishte përfshirë dhe pagesën e detyrimeve për kredi të prapambetura, të cilat bazuar në Vendimet nr. 190, datë 22.12.2016 dhe nr. 52, datë 6.4.2017 të Bordit të ERE, janë detyrime të cilat duhet të paguhen nga shoqëria OSHEE sh.a.
- Shuarja e detyrimeve të ndërsjellta mes shoqërive nuk ishte realizuar ende dhe për rrjedhojë shuarja e tyre do të sillte ndryshimin e llogarive të pozicionit financiar të shoqërisë, kjo në përputhje dhe me parashikimet e VKM nr. 253, datë 24.4.2019 "*Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjetik*".
- Bazuar në raportimet e OST sh.a. tarifa prej 0.75 lekë/kWh e miratuar nga ERE, mundësonte kryerjen e një aktiviteti në kushte normale për shoqërinë dhe për vitin 2020.

Në përfundim të shqyrtimit të aplikimit të paraqitur nga shoqëria OST sh.a, Bordi i ERE me Vendimin nr. 198, datë 12.12.2019, vendosi mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020 prej 1.2 lekë/kWh si dhe lënien në fuqi të vendimit Nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020 prej 0.75 lekë/kWh.

4.1.2 Lidhur me vendimarrjen e Bordit të ERE-s për miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe çmimeve me pakicë të energjise elektrike për klientët fundor që furnizohen nga FSHU për vitin 2020.

Deri në përfundim të vitit 2019, pavarësisht kërkesës së ERE, shoqëria OSHEE sh.a. nuk paraqiti aplikim lidhur me tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe çmimeve me pakicë për klientët fundorë që furnizohen nga FSHU sh.a. për vitin 2020.

Gjendur në këto kushte si dhe në zbatim të nenit 20 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, në mënyrë që shoqëritë bija “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. si dhe “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. të mund të realizonin aktivitetin për të cilin janë licencuar me bërjen efektive të ndarjes së shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a (OSHEE) nga data 1 janar 2020, u bë e domosdoshme që shoqëritë të vijonin aktivitetin duke u bazuar në tarifatat dhe çmimet e miratuara nga ERE edhe përgjatë vitit 2020.

Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 199, datë 12.12.2019, vendosi:

- Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2020, për tarifatat si më poshtë:

Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV	1.5 Lekë/Kwh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV	3.9 Lekë/Kwh
Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes	4.79 Lekë/Kwh

- OSHEE sh.a. në funksion të OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a., përveç shlyerjes së detyrimeve korrente, të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. për detyrimet e prapambetura në përputhje me parashikimet e VKM nr. 253, datë 24.04.2019, “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjitik”.
- Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë OSSH sh.a. do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas për caktimeve të nenit 20, gërma “c” të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Me Vendimin nr. 200, datë 12.12.2019, vendosi:

- Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2020, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal si më poshtë:

Çmimi I shitjes për Klientët në 20 kV *	Nr. 200, Datë 12.12.2019	11 Lekë/Kwh Në Pik 12.65 Lekë/Kwh
Çmimi I shitjes për Klientët në 10/6 kV *	Nr. 200, Datë 12.12.2019	11 Lekë/Kwh Në Pik 12.65 Lekë/Kwh
* Miratim I përkohshëm për klientët që nuk arrijnë të siguronë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit në përputhje me VKM nr. 449, datë 15.06.2016, furnizimi si mundësi e fundit i këtyre klientëve kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit me çmimet si më lartë		
Çmimi I shitjes për Konsumatorët e lidhur në TM dhe me matës në TU	Nr. 200, Datë 12.12.2019	12.4 Lekë/Kwh Në Pik 14.3 Lekë/Kwh
Çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundor	Nr. 200, Datë 12.12.2019	*Çmimet paraqiten në tabelën më poshtë
ÇMIMET E SHËRBIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDOR		
Niveli I tensionit	Çmimi (Lekë/Kwh)	Çmimi pik (Lekë/Kwh)
Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjarë	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndricim shkalle, pompe, ashensor)	9.5	
Tarifë fikse e shërbimit për leximin "zero" (Leke/Muaj)	200	
<i>*Çmimi I energjisë reaktive është sa 15% e çmimit të energjisë aktive</i>		
<i>*Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar</i>		
<i>Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00</i>		
<i>Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00</i>		

Figura 81 Tabela e Tarifave dhe Çmimeve të lëna në fuqi për vitin 2020.

- OSHEE sh.a. në funksion të OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a., përveç shlyerjes së detyrimeve korrente, duhet të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. për detyrimet e prapambetura në përputhje me parashikimet e VKM nr. 253, datë 24.04.2019, "Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjitik".
- Lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE nr. 53, datë 06.04.2017, "Mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi universal për kategorinë objekte kulti/bashkësi fetare" për vitin 2020.
- Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë FSHU sh.a. do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 20, gërma "c" të Ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar.

4.1.3 Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror, deri më datë 31.12.2019.

Shoqëria ALBGAS sh.a. ushtron aktivitetin e saj në konform Ligjit nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar si dhe direktivave të Bashkimit Europian në lidhje me gazin natyror. Meqënëse, tarifa e aktivitetit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëria Albgas sh.a., aksesin në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t'i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE, Bordi i ERE me Vendimin Nr. 269, datë 21.12.2018, vendosi për shtyrjen e fuqisë juridike të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.04.2018 "Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgas sh.a. për vitin 2018, i ndryshuar", deri më datë 31.03.2019.

Në mungesë të paraqitjes së një aplikimi për rishikimin e tarifës së transmetimit të shoqërisë Albgaz sh.a për vitin 2019 si dhe të paraqitjes së planit të investimeve për vitin 2019, si komponent i rëndësishëm i llogaritjes së tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2019, si dhe në zbatim të nenit 17, gërma “e”, të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “*ERE ka të drejtë të miratojë tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarjeje, në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave*”, Bordi i ERE me Vendimin nr. 60, datë 15.04.2019, vendosi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kwh deri më datë 31.12.2019.

4.1.4 Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 60, datë 15.04.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a” për vitin 2020.

Deri në përfundim të vitit 2019, pavarësisht kërkesës së ERE, shoqëria ALBGAS sh.a. nuk paraqiti aplikim për tarifën e transmetimit të gazit natyror për vitin 2020. Gjendur në këto kushte, në zbatim të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, si dhe direktivave të Komunitetit të Energjisë, meqënëse aksesit në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE, Bordi i ERE me Vendimin nr. 206, datë 16.12.2019, vendosi shtyrjen e fuqisë juridike të Vendimit Nr. 60, datë 15.04.2019, të Bordit të ERE-s, për vitin 2020 deri në miratimin e një tarife mbështetur në aplikimin e shoqërisë Albgaz sh.a..

4.1.5 Në lidhje me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2019

Bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjise nga burimet e rinovueshme”, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi

llogaritet nga ERE, në përputhje me “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017.

Bazuar në metodologjinë e lartpërmendur, çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike përcaktohet nga: çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë të vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në eurocent/kWh, një koeficient bonus për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.3 dhe norma mesatare e këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

Në metodologji, përcaktohen gjithashtu edhe kufijtë maksimal dhe minimal të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, të cilët janë: jo më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 dhe jo më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016.

Bazuar në përcaktimet e kësaj Metodologjie, Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 8, datë 17.01.2019, miratoi çmimin vjetor që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2019 prej 8.4582 lekë/kWh.

Në vijim, meqënëse viti 2019 nuk ishte përfunduar dhe metodologjia e sipërcituar nuk lejon mundësinë e axhustimit/korrigjimit të komponentëve të formulës që përcakton çmimin e blerjes së

energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 201 datë 12.12.2019, vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Bordit të ERE nr. 8 date 17.01.2019 edhe për vitin 2020, deri në miratimin e një çmimi nga ERE, mbështetur në publikimin e raportit vjetor të Bursës Hungareze të Energjisë (HUPX), si dhe publikimet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit euro/lekë për vitin 2019.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve të miratuara për prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet për periudhën 2008-2019:




Figura 82 Ecuria e çmimeve të miratuara për Prodhuessit me Përparësi.

4.1.6 Miratimi i çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020

Me publikimin e raportit vjetor të Bursës Hungareze të Energjisë (HUPX), çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për vitin 2019 rezultoi në vlerën 50.36 Euro/MWh.

Nga të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit euro/lekë për çdo muaj të vitit 2019, rezultoi që kursi mesatar i këmbimit për vitin 2019 të jetë 123.01 EUR/Lekë.

ERE rezervon të drejtën që të axhustojë llogaritjet e bëra, në rast se kursi i këmbimit EUR/Lekë, i cili publikohet në Raportin Vjetor 2019 të Bankës së Shqipërisë (gjatë muajve në vijim) ndryshon nga ai i konsideruar në llogaritje.

Çmimi prej 8.0532 Lekë/kWh, i cili rezultoi nga zbatimi i formulës për llogaritje të cituar në metodologji, ndodhej brenda kufijve minimal e maksimal të përcaktuar në paragrafet 2.ç dhe 2.d, të VKM-së Nr. 687, datë 22.11.2017.

Përsa më sipër, Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 7, datë 16.01.2020, miratoi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike prej 8.0532 Lekë/kWh, i cili do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020.

• Aktiviteti i prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike & HEC Ashta për vitin 2019

Prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike (HEC-et me fuqi deri në 15 MW) në vitin 2019, pati një rënie prej 9.1%, ndërkohë që prodhimi i HEC Ashta ka patur një rënie më të theksuar, e cila ka arritur në nivelin 35.8% më pak, krahasuar me prodhimin e vitit 2018.

Grafikët në vijim, paraqesin ecurinë e energjisë së prodhuar dhe të ardhurat e realizuara në vite nga shitja e energjisë elektrike për prodhuesit me përparësi dhe HEC Ashta:




Figura 83 Ecuria e çmimeve të miratuara për Prodhuesit me Përparësi ndër vite.




Figura 84 Të ardhurat nga prodhuesit me përparësi (Burimi OSHEE sh.a.)

Siç vërehet nga grafiku i mësipërm, niveli i të ardhurave të realizuara nga PPE dhe HEC Ashta ka patur një rënie të konsiderueshme, sidomos për këtë të fundit. Niveli i të ardhurave në rënie ka qënë respektivisht 10.2% për PPE dhe 38.2% për HEC Ashta.

Arsyet e rënies së nivelit të të ardhurave lidhen kryesisht me rënien e prodhimit të energjisë elektrike si rrjedhojë e kushteve hidrogjike, si dhe me rënien e kursit të këmbimit Euro/Lekë,

komponent ky i rëndësishëm, i cili ka patur një ndikim domethënës për të ardhurat e realizuara nga PPE dhe HEC Ashta për vitin 2019.

OSHEE sh.a., në zbatim të VKM nr.244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, e ndryshuar, deri në përfundim të vitit 2019 ka pasur detyrimin për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë.

Gjatë vitit 2019, shpenzimet e blerjes së energjisë janë ndikuar nga hyrja në prodhim e kapaciteteve të reja prodhuese të teknologjisë hidro por dhe burimeve të vogla të rinovueshme të energjisë nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW.

Shpenzimet e OSHEE sh.a. për blerjen e energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi, HEC Ashta dhe burimet e vogla të rinovueshme të energjisë nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW për vitin 2019, përbëjnë rreth 34% të shpenzimeve totale për blerjen e energjisë elektrike duke rezultuar në një rënie të konsiderueshme prej 16% krahasuar me periudhën paraardhëse.

Çmimi mesatar i blerjes së energjisë nga këta prodhues për vitin 2019 ka rezultuar të jetë përafërsisht 68 Euro/MWh ose 8.4 Lekë/kWh.

Grafiku në vijim paraqet strukturën e shpenzimeve të OSHEE sh.a. për blerjen e energjisë elektrike për vitin 2019, krahasuar me ato të vitit 2018:




Figura 85 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE për vitin 2019 (Burimi: OSHEE sh.a., ERE).




Figura 86 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE për vitin 2018 (Burimi: OSHEE sh.a., ERE)

Siç dhe trajtuar në seksionet e mësipërme të këtij raporti, viti 2019 ka qënë një vit hidrologjik jo i mirë krahasuar me vitin 2018, i cili përbënte një rekord në rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme në vend. Siç vërehet në grafikët e mësipërm, rënia e prodhimit të PPE, HEC Ashta por dhe të KESH sh.a., ka sjellë si rezultat rritjen të shpenzimeve për blerjen e energjisë në tregun e lirë. Energjia elektrike e blerë në tregun e lirë për vitin 2019, ka patur një rritje prej 28% krahasuar me vitin 2018, ku çmimi i blerjes së energjisë elektrike në tregun e lirë ka rezultuar 75 Euro/MWh, i përafërt me atë të realizuar për vitin 2018.

4.1.7 Mbi përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2019.

Në zbatim të nenin 87, pika 4 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me Vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 144, datë 25.06.2018, Enti Rregullator i Energjisë ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për secilin muaj të vitit 2019.

Përlllogaritjet e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, janë kryer në zbatim të formulës së përcaktuar në metodologjinë e lartpërmendur, e cila paraqitet si më poshtë vijon:

$$\text{ÇFMFt} = \text{CBEt} + \text{Pr} * \text{CBEt} + \text{TRrTSHt} + \text{CA}$$

ku:

ÇFMFt - Çmimi i furnizimit në periudhën relevante *t*

CBEt - çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi (BRE).

Pr - Kthimi per riskun i percaktuar ne perqindje per vitin (do te pranohet ne masen 3% per dy vitet e para e me tej do te rishikohet bazuar ne te dhenat historike)

TRrTSHt - Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante t

CA - kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

Në vijim paraqiten çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2019, sipas vendimeve respektive të Bordit të ERE-s, si dhe çmimet maksimale të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës së këtij grupi klientësh, krahasuar me ato të vitit 2018.

Viti 2018	Vendimi	Cmimi I shitjes i miratuar nga ERE (lekë/kWh) 2018	Cmimi maksimal i blerjes se energjise nga OSHEE sh.a. (Euro/MWh) 2018	Viti 2019	Vendimi	Cmimi I shitjes i miratuar nga ERE (lekë/kWh) 2019	Cmimi maksimal i blerjes se energjise nga OSHEE sh.a. (Euro/MWh) 2019
Janar	Nr.66, Datë 26.03.2018	11.60	64.00	Janar	Nr.23, Datë 18.02.2019	18.73	114.77
Shkurt		9.50	44.97	Shkurt	Nr.42, Datë 15.03.2019	13.92	76.95
Mars	Nr.67, Datë 26.03.2018	9.50	37.75	Mars	Nr.55, Datë 03.04.2019	13.40	73.00
Prill	Nr. 92, Datë 20.04.2018	9.50	31.79	Prill	Nr. 75, Datë 10.05.2019	13.67	74.87
Maj	Nr. 116, Datë 21.05.2018	9.50	33.75	Maj	Nr. 78, Datë 31.05.2019	13.62	75.45
Qershor	Nr. 146, Datë 21.05.2018	9.82	54.50	Qershor	Nr. 111, Datë 10.07.2019	13.07	72.00
Korrik	Nr. 176, Datë 03.08.2018	12.86	68.05	Korrik	Nr. 126, Datë 08.08.2019	12.75	63.50
Gusht	Nr. 204, Datë 13.09.2018	12.86	68.16	Gusht	Nr. 138, Datë 16.09.2019	12.75	62.99
Shtator	Nr. 213, Datë 27.09.2018	12.86	67.72	Shtator	Nr. 150, Datë 10.10.2019	12.81	70.00
Tetor	Nr. 234, Datë 02.11.2018	16.00	92.80	Tetor	Nr. 165, Datë 04.11.2019	14.01	79.48
Nëntor	Nr. 254, Datë 11.12.2018	16.00	93.24	Nëntor	Nr. 195, Datë 12.12.2019	14.68	83.80
Dhjetor	Nr. 7, Datë 17.01.2019	15.22	87.98	Dhjetor	Nr. 1, Datë 10.01.2020	16.57	100.00

Figura 87 Krahasimi i çmimeve te shitjes së energjise elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitet 2018-2019

Në grafikun në vijim, paraqitet kurba levizëse e çmimit maksimal të blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE sh.a. për këtë kategori klientësh për vitet 2018 – 2019:




Figura 88 Kurba levizëse e çmimit maksimal të blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE sh.a. për këtë kategori klientësh për vitet 2018 – 2019.

Në grafikun në vijim paraqiten çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit të miratuara nga Bordi i ERE-s për vitin 2019, krahas çmimeve të shitjes për vitin 2018:




Figura 89 Kurba lëvizëse e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, të miratuar nga ERE për vitet 2018 – 2019.

Siç vërehet në grafikun e mësipërm, çmimet e miratuara nga Bordi i ERE-s për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV në zbatim të përcaktimeve të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, bazuar në dokumentacionin e paraqitur me anë të aplikimeve periodike të shoqërisë OSHEE sh.a për periudhën janar – qershor të vitit 2019, kanë ardhur në rritje krahasuar me çmimet e miratuara për të njëjtën periudhë të vitit 2018. Për periudhën korrik – shtator kemi patur një stabilitet në çmime, pothuajse në të njëjtat nivele për të dy vitet, ndërkohë që çmimet për periudhën tetor – dhjetor 2019 kanë rezultuar mesatarisht me një ndryshim të vogël, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018.

Viti 2019 paraqitet me një rritje të çmimit mesatar vjetor për këtë kategori klientësh prej 17% krahasuar me çmimin mesatar vjetor të vitit 2018. Rritja e çmimit mesatar të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2019, ka ardhur si rezultat i blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të klientëve, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit me çmime më të larta krahasuar me ato të vitit 2018.

Nga analiza e raporteve periodike të shoqërisë OSHEE sh.a. të vitit 2019, është evidentuar se sasia e energjisë elektrike e shitur për klientët e FMF-së ka qënë 38 GWh, me një vlerë të faturuar prej 537 milion lekë, duke rezultuar në një çmim mesatar vjetor prej 14.1 lekë/kWh. Krahasimi i realizimit si dhe diferenca e këtyre treguesve për vitet 2018-2019 paraqitet në tabelen si vijon:

Viti	Sasia (kWh)	Vlera (Lek)	Cmimi mesatar (Lekë/kWh)
2018	56,685,833	680,378,685	12.00
2019	38,098,488	537,217,272	14.10
Diference ne %	-33%	-21%	17%

(Burimi OSHEE sh.a., ERE)

4.1.8 Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW dhe era me fuqi të instaluar deri 3 MW për vitin 2018.

Në mbështetje të nenit 10 pika 2 dhe 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 10, pika 3 të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe parashikimeve të VKM nr.369, datë 26.4.2017, ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era me fuqi të instaluar respektivisht 2 MW dhe 3 MW.

Në zbatim të sa më sipër, Bordi i ERE me Vendimin nr. 205, datë 13.09.2018, vendosi mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW dhe era me fuqi të instaluar deri 3 MW për vitin 2018. Ky proces u shty për shqyrtim gjatë vitit 2019, në funksion të marrjes së një vendimi sa më të drejtë, bazuar në një analizë të plotë dhe të mbështetur në të dhëna reale mbi kostot e investimit për këto impiante, kjo në zbatim të pikës 2 të Vendimit nr. 120, datë 27.07.2017 të Bordit të ERE.

Për përllogaritjen e çmimit të shitjes për këto impiante, u mor në shqyrtim dokumentacioni i depozituar nga shoqëritë që aplikuan për licencat e prodhimit nga impiantet e diellit me fuqi të instaluar deri 2 MW dhe erës me fuqi të instaluar deri 3 MW të cilët kishin marrë aprovimin nga MIE gjatë vitit 2018.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar në MIE dhe në ERE të shoqërive të cilat patën marrë aprovimin për ndërtimin e impianteve fotovoltaike si dhe diskutimeve të zhvilluara gjatë këtij procesi, u kryen analizat dhe llogaritjet përkatëse për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhura nga centralet fotovoltaike për vitin 2018, të cilat rezultuan në një çmim prej 71.2 Euro/MWh.

Në lidhje me përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga centralet eolike deri në 3 MW, nuk rezultoi të jetë lëshuar miratim nga autoriteti shtetëror MIE për këtë teknologji gjatë vitit 2018, ndaj përcaktimi i një çmimi për këtë kategori nuk ishte i nevojshëm për arsye të pazbatueshmërisë së tij.

4.1.9 Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2MW dhe era me fuqi të instaluar deri në 3MW për vitin 2019.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi si dhe orientimeve të MIE me shkresën nr. 9437 Prot, datë 31.10.2019, protokolluar në ERE me nr. 690 Prot., datë 01.11.2019, ku për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike lundruese të merret në konsideratë metodologjia e vlerësimit të kostove të energjise nga burimet e rinovueshme, e cila mbështetet tek e njëjta formulë e LCOE sipas VKM nr. 369, datë 26.04.2017, Bordi i ERE me Vendimin nr.193, datë 02.12.2019, miratoi “Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2MW dhe era me fuqi të instaluar deri në 3MW për vitin 2019”.

Proçesi i miratimit të çmimeve për burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2MW dhe era me fuqi të instaluar deri në 3MW do të trajtohet gjatë vitit 2020, në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

4.2 Ndryshimi i metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 144, datë 25.06.2018.

Përgjatë procesit të miratimit të çmimeve të energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit gjatë vitit 2019, sipas përcaktimeve të metodologjisë në fuqi, janë konstatuar disa problematika në zbatimin korrekt të kësaj metodologjie nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a.

Në referencë të këtyre problematikave, Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 155, datë 29.10.2019, filloi procedurën për rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me Vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, të ndryshuar.

Pas miratimit të fillimit të procedurës për rishikimin e kësaj metodologjie, në mbështetje të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Proçedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, u bë njoftimi i palëve të interesuara si dhe u vijua me organizimin e seancave dëgjimore ku morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, shoqërisë OSHEE sh.a dhe subjektet të cilët furnizoheshin nëpërmjet shërbimit të furnizimit të mundësisë së fundit. Palët e interesit nuk shprehën kundërshti mbi propozimin e ERE-s në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 155, datë 29.10.2019 dhe nuk patën asnjë koment apo sugjerim për ndryshime mbi draftin e propozuar.

Në vijim, Bordi i ERE me Vendimin nr. 233, datë 20.12.2019, miratoi ndryshimet në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me Vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, të ndryshuar”.

Bazuar në përcaktimet e Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, klientët fundorë të cilët dalin për herë të parë në treg të liberalizuar, janë të detyruar të lidhin një kontratë furnizimi me një furnizues të ri, brenda 2 viteve nga fillimi i kontratës së furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Nisur nga ky fakt, ndryshimet e miratuara në këtë metodologji, konsistojnë kryesisht mbi evidentimin e qartë të mbulimit të kërkesës mujore të energjisë elektrike të klientëve të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit duke ngarkuar kostot reale që ata shkaktojnë.

Përlllogaritja e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga FMF, do të bazohet në çmimin mesatar të ponderuar të profileve të blerjes për sasinë e energjisë elektrike të siguruar për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar dhe nga prodhuesit me përparësi (BRE), duke përfshirë një marzh furnizimi që do të vendoset nga Rregullatori, kostot administrative si dhe kostot e transmetimit/shpërndarjes sipas nivelit të tensionit ku është i lidhur klienti.

Në vijim të ndryshimit të mësipërm është shtuar në metodologji se çmimi i energjisë në Pik, duhet të llogaritet dhe të evidentohet nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit bazuar në kostot reale të energjisë së furnizuar në periudhën e pikut.

Ndryshimet e miratuara me Vendimin e Bordit të ERE nr. 233, datë 20.12.2019, në këtë Metodologji, kanë filluar të jenë efektive dhe janë aplikuar në përlllogaritjen dhe miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit nga muaji Janar 2020.

4.3 Fillimi i procedurës për miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës të shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.

Nisur nga detyrimi mbi hartimin e akteve nënligjore që rrjedhin si zbatim i Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin Gazit Natyror”, i ndryshuar, Bordi i ERE me Vendimin nr. 186, datë 25.11.2019, filloi procedurën për miratimin e "Metodologjisë së përcaktimit të tarifës të shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit".

Kjo metodologji do të shërbejë për përcaktimin e tarifës të shitjes së gazit natyror të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit bazuar në parime të qarta të tarifimit dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e tarifave sa më të drejta dhe transparente në këtë fushë të rëndësishme. Tarifat e furnizimit të gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit duhet të jenë më të larta se tarifat mesatare të tij për furnizimin e klientëve të ngjashëm, të cilët furnizohen në tregun e gazit natyror, ose më të larta se çmimi i furnizimit të klientëve të ngjashëm që furnizohen në treg.


Gazi natyror i kontraktuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit duhet të sigurohet mbi bazën e një procedure konkurruese dhe me çmimin e ofertës më të ulët në treg, përveçse në rastin kur ekziston vetëm një ofertë, si furnizues i mundësisë së fundit. Në këtë rast, ERE e bazon vendosjen e çmimit sipas metodës krahasimore, referuar furnizuesve të ngjashëm në vendet fqinje.

Kjo metodologji do të gjejë zbatim vetëm mbi të licencuarin e ngarkuar me shërbimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e gazit natyror, i caktuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin Gazit Natyror”, i ndryshuar. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit duhet të organizohet si person juridik, të funksionojë i ndarë nga veprimtaritë e tjera të sektorit të gazit natyror, të mbajë të ndara llogaritë financiare, si dhe të përgatisë raporte financiare, në lidhje me përmbushjen e detyrimit të mundësisë së fundit.

Proçesi i miratimit të metodologjisë së përcaktimit të tarifës të shitjes së gazit natyror nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të trajtohet gjatë vitit 2020, në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

4.4 Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite

Në grafikun dhe tabelën në vijim, paraqitet ecuria e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike të miratuara ndër vite nga ERE në zbatim të legjislacionit në fuqi:



Tipi i Aktivitetit (leke/kWh)	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Prodhimi	0.78	0.78	0.40	0.63	1.00	1.00	1.00	1.45	1.45	1.45		
Hec-et egzistuese deri në 15 MW	6.50	6.50	7.40	7.57	7.77	7.53	7.53	7.64	7.45	7.45	8.57	8.46
Hec-et e reja deri në 15 MW	9.37	9.37	6.00	6.89	9.30	9.73	7.95	7.64	7.45	7.45	13.42	8.46
Impiantet fotovoltaike 2MW											13.42	9.08
Impiantet Eolike MW											10.20	
Furnizuesi Publik me Shumicë	1.61	1.61	2.03	1.48	2.20	2.20	2.20	3.00	3.00			
Transmetimi	0.50	0.50	0.60	0.60	0.65	0.65	0.65	0.65	0.65	0.65	0.75	0.75
Tarifa mesatare e Shpërndarjes	5.70	5.70	5.70	6.30	5.00	5.00	5.00	4.79	4.79	4.79	4.79	4.79
Çmimi Mesatar për Klientet e Sherbimit Universal	8.45	8.45	9.53	9.53	9.53	9.53	9.53	10.70	10.70	10.70	10.70	10.70
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin 35 kV								1.50	1.50	1.50	1.50	1.50
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin 20/10/6 kV										3.90	3.90	3.90

Figura 90 Tarifat dhe Çmimet e miratuara nga ERE për periudhën 2008 – 2019.

Siç vërehet në tabelën e mësipërme, viti 2019 në përgjithësi nuk ka patur ndryshime të tarifave apo çmimeve përveç rënies së çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuesve me përparësi të energjisë si dhe çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2MW, arsyet e të cilave janë shpjeguar në konstatimet e vendimmarjeve përkatëse të ERE si dhe në seksionet respektive të këtyre aktiviteteve në këtë raport vjetor.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve mesatare të realizuara të energjisë elektrike në tërësi, si dhe për klientët familjarë dhe jofamiljarë:




Figura 91 Çmimi mesatar i realizuar (Burimi ERE, OSHEE sh.a.).

Bazuar në përlllogaritjet e strukturës së shitjes të shoqërisë OSHEE sh.a. edhe për vitin 2019, çmimi mesatar për klientët fundorë rezultoi në vlerën 11.15 lekë/kWh, i njëjtë me atë të vitit 2018.

Tabela në vijim paraqet realizimin e çmimeve për kategori të ndryshme të klientëve në nivelet përkatëse të tensionit krahasuar me miratimin e tyre për vitin 2019

Kategoria e Klienteve	Çmimi i Miratuar 2019		Çmimi i realizuar 2019	
	Aktive	Ne pik	Aktive	Ne pik
Kliente ne 20/10/6 kV	11.00	12.65	11.00	12.81
Furra buke dhe prodhim mielli 20/10/6 kV	7.10	8.74	7.58	8.73
Kliente te Lidhur ne 20/10/6 kV Matja ne TU(kabine me nje abonent)	12.40	14.30	12.40	14.26
Kliente te Lidhur ne 20/10/6 kV Matja ne TU (Kabine me shume se nje abonent)	14.00	16.10	13.92	16.10
Kliente ne 0.4kV	14.00	16.10	13.98	16.10
Furra buke dhe prodhim mielli ne 0.4 kV	7.60	8.74	7.60	8.74
Objekte fetare	9.50	10.93	9.50	10.93
Familjare	9.50		9.50	
Ambjente te perbashketa	9.50		9.50	
Çmimi mesatar	10.70		11.15	

Figura 92 Çmimi i realizuar për kategoritë e klientëve (Burimi ERE, OSHEE)

Çmimi faktik prej 7.58 lekë/kWh për kategorinë “Furra buke e prodhim mielli” për nivelin e tensionit 20/10/6 kV rezultoi më i lartë se ai i miratuar prej 7.10 lekë/kWh për shkak të aplikimit nga ana e OSHEE sh.a. të tarifës 7.6 lekë/kWh për ata klientë të kësaj kategorie që lidhjen e kanë në tension të mesëm ndërsa matjen e kanë në tension të ulët.

4.5 Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2019

Në mungesë të përditësimit të Shoqatës Rajonale të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA) të të dhënave lidhur me tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike për vendet e rajonit, baza e këtyre të dhënave për vitin 2019 është marrë nga publikimet e EUROSTAT.

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike në eurocent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për klientët jofamiljarë për vitin 2019. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për klientët jofamiljarë për vendet e rajonit është 9.84 lekë/kWh.




Figura 93 Çmimet e energjisë elektrike të klientëve jofamiljarë në vendet e rajonit sipas raportimit më të fundit të EUROSTAT për vitin 2019 (Burimi EUROSTAT)

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike në eurocent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për klientët familjarë për vitin 2019. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për klientët familjarë për vendet e rajonit është 11.96 lekë/kWh.




Figura 94 Çmimet e energjisë elektrike të klientëve familjarë në vendet e rajonit sipas raportimit më të fundit të EUROSTAT për vitin 2019 (Burimi EUROSTAT)

5. RREGULLIMI I SEKTORIT TË GAZIT NATYROR

5.1 Projekti TAP, (Trans Adriatic Pipeline)

Projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) është pjesë e sistemit të transmetimit të gazit të prodhuar nga vendburimi Shah Deniz 2 (SD 2) në Azerbajxhan drejt Tregut European të Gazit. Transportimi përmes Azerbajxhanit dhe Gjeorgjisë ka filluar të bëhet me anë të tubacionit South Caucasian Pipeline, ndërsa transportimi përmes Turqisë po kryhet me anë të tubacionit TANAP dhe ka filluar që nga Korriku i vitit 2019. Gazi nga Azerbajxhani ka arritur deri në kufirin Turko-Grek.




Figura 95 Pikat e ndërlidhjes me projektin TAP.

Korridori Jugor i Gazit (SGC)

Korridori Jugor i Gazit (SGC) është një nga zinxhirët më të ndërlikuar të gazit në botë, i cili synon të sjellë Gaz nga rajoni i Kaspikut, një reserve e konsiderueshme mbi 100 triliard NM^3 Gaz, në drejtim të tregjeve Europiane, kjo që po ndodh është hera e parë dhe do të realizohet brënda vitin 2020. Gazi Natyror nga fusha e Shah Deniz do të bëjë një rrugë prej 3,500 km nga Deti Kaspik në Europë. Kjo kërkon përmirësimin e disa infrastrukturave ekzistuese dhe zhvillimin e një zinxhiri të tërë për gazsjellësat e rinj që i përkasin këtij rajoni, dhe pikërisht:

- Zhvillimin e Shah Deniz II, në të cilin vazhdojnë shpimet e puseve për rritjen e prodhimit të gazit në Detin Kaspik.
- Zgjerimin e impiantit të përpunimit të gazit në terminalin e Sangachal në bregun e Detit Kaspik në Azerbajxhan dhe dërgimi i gazit në Turqi për fazën e parë nëpërmjet projektit TANAP, në fakt u realizua në Korrik të vitit 2019.

- Përfundimin e tre projekteve gazsjellësish në zhvillim të njehershëm:
 - Gazsjellësi i Kaukazit të Jugut (SCPX) – Azerxhan, Gjeorgji
 - Gazsjellësi Trans Anatolian (TANAP) – Turqi
 - Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) – Greqi, Shqipëri, Itali
- Zgjerimi i rrjetit Italian të transmetimit të gazit.

Mundësi për lidhje të tjera me rrjetet e gazit në Europën Juglindore, Qendrore dhe Perëndimore

TAP tashmë është shtrirë përmes Greqisë, Shqipërisë, në tabanin e detit Adriatik dhe po bashkohet me Sistemin Italian të Transmetimit të Gazit në zonën e San Foca në Italinë Jugore, çka mundëson lëvizjen e mëtejshme drejt tregjeve evropiane.



Figura 96 Rrjeti i transmetimit të gazit në Ballkan

Projekti TAP është Zhvilluar nga Kompania TAP AG. Aksionerët e Kompanisë

Gjatë vitit 2019 nuk kemi patur ndryshime aksionerësh, për këtë janë njoftuar të gjitha palët e interesuara përfshi edhe tre autoritetet kombëtare, ajo Greke, Italiane dhe Shqiptare.

Tashmë aksionerët e TAP AG janë: SOCAR (Azerbajxhan) me 20%, BP (Angli) me 20%, SNAM S.p.A (Itali) me 20%, Fluxys (Belgjikë) me 19%, Enagas (Spanja) me 16% dhe Axpo (Zvicëranë) me 5%. Aksionerët aktualë paraqiten sipas figurës së mëposhtme:




Figura 97 Aksionerët e kompanisë TAP.

KOHËZGJATJA E PROJEKTIT DHE PROGRESI NË PËRGJITHËSI

Projekti TAP ka për qëllim transportin e gazit natyror të prodhuar në fushat e gazit në territorin e Republikës së Azerbajxhanit dhe për të furnizuar sipas Marrëveshjeve përkatëse në Shitjen e Gazit Shah Deniz (SD), por kryesisht zhvillimin e fazës së II të fushës së gazit Shah Deniz (SD). Fillimi i punimeve është i lidhur me fillimin e dërgesave të para të gazit SD II në Europë. TAP dhe Konsorciumi Shah Deniz (SD) ka rënë dakord për një mekanizëm për të siguruar që zhvillimi i tubacionit të përputhet plotësisht me zhvillimet e planifikuara. Mekanizmi njihet si ‘Mekanizëm Kontraktual’ dhe përcakton se si data e planifikuar për tu vendosur në operimin e TAP-it do të specifikohet më tej me dorëzimin e parë të dërgesave të gazit SD II në Evropë. Data e Planifikuar e Fillimit të Operimeve është përcaktuar nga Konsorciumi Shah Deniz (SD) përmes disa periudhave kohore të paracaktuara të cilat ngushtohen, duke qënë se Data e Fillimit të Operimeve po afrohet dhe është muaji Korrik i vitit 2020.

Pas marrjes së Vendimit Përfundimtar të Investimit me datë 17 Dhjetor 2013 për projektin Shah Deniz (SD) II, Konsorciumi i Shah Deniz (SD) informoi TAP, se sipas Mekanizmit Kontraktual, periudha e parë kohore 36-muaj gjatë së cilës do të jetë Data e Planifikuar e Fillimit të Operimeve, do të fillojë më 1 Janar 2020 dhe do të mbarojë më 31 Dhjetor 2022.

Në datën 16 Dhjetor 2014, Konsorciumi Shah Deniz (SD) informoi TAP se periudha e dytë kohore 12-muaj gjatë së cilës do të jetë Data e Planifikuar e Fillimit të Operimeve, do të fillojë në datën 1 Janar 2020 dhe do të përfundojë në datën 31 Dhjetor 2020 (që do të thotë se data e fundit e mundshme që mund të planifikohet për Fillimin e Operimeve është 31 Dhjetor 2020).

Periudha kohore prej 12-muajsh ndiqet nga një periudhë kohore tre-mujore (që do të thotë midis 1 Janar 2020 dhe 31 Mars 2020), e cila është njoftuar nga Konsorciumi Shah Deniz (SD) me datë 11 Mars 2019. Në 10 Qershor 2019, Data e Planifikuar e Fillimit të Operimeve ishte përcaktuar me qëllim llogaritjen e tarifave dhe ishte njoftuar data 1 Janar 2020.

Në lidhje me ecurinë e projektit për ndërtimin e gazsjellësit, në fund të muajit Nëntor 2019, progresi i përgjithshëm i Projektit TAP ishte 90.7%. Ndërtimi i gazsjellësit përmes Greqisë dhe Shqipërisë është duke përfunduar dhe pjesa në det vazhdon me ritme të larta drejt Italisë. Pothuajse 771 km të gjithë projektit (mbi 99 %) janë pastruar dhe vlerësuar, 768 km janë mbushur (rreth 99.0%), 769 km janë salduar (mbi 99 %), 746 km të tubacionit janë testuar nga ana hidrike dhe 741 km janë rivendosur (mbi 95%) të pjesës totale në tokë të gazsjellësit në Greqi, Shqipëri dhe Itali. Tubacioni 8 km në tokë në Itali, vazhdon të përparojë me punimet tek blloqet (që do të thotë në mënyrë të grupuar).

Në Greqi, progresi më i fundit mbi ndërtimin përfshin: 550 km të tubacionit janë pastruar dhe reshtuar, janë salduar, mbushur dhe janë testuar nga ana hidrike. Për më tepër, 547 km e rrugës janë rikthyer në gjendjen fillestare. Të gjitha vendkalimet kryesore u përfunduan në të gjithë Greqinë në Q3 2019. Lidhja Greqi-Shqipëri u përfundua në Nëntor 2019. Për më tepër, futja e gazit në ComSec 1 (ndërlidhës midis TANAP dhe TAP) u arrit në 25 Nëntor 2019. Ndërtimi i stacionit të kompresorëve Kipoi ka përfunduar. Komisionimi paraprak po përparon për të arritur paraqitjen e duhur tek datat për ardhjen e Gazit.

Në Shqipëri, progresi më i fundit i ndërtimit përfshin: 215km rrugë të pastruar, reshtuar, salduar, mbushur dhe testuar nga ana hidrike. Kthimi në gjendjen fillestare të rrugës po ecën dhe mbi 213 km janë rikthyer në gjendjen fillestare. Faza e II-të ndërtimi i (rrugëve dhe urave) është pothuajse i mbyllur. Ecuria e ndërtimit të stacionit të matjes në Bilisht ka përfunduar dhe është në përfundim stacioni i kompresimit në Fier. Punimet e mbetura janë në proces për të arritur paraqitjen e duhur tek datat për Gazin.

Në Itali, punimet filluan në muajin Maj 2016. Në muajin Nëntor 2019, u zbatua miratimi i fazës së 3-të për të lejuar shtrimin e tubacionit në pjesën në det. Punimet tek pjesa në det po përparojnë dhe do të realizohen sipas datës së vendosjes në operim. Tubacionet e para të TAP pjesa detare (7 km) në Shqipëri u instalua me sukses dhe është bërë mbushja e tyre në muajin Maj 2019. Mikro-tuneli me gjatësi 1.5 km me dalje në det në Itali ka përfunduar në muajit Prill 2019. Punimet e ndërtimit po përparojnë tek tubacioni 8 km në tokë në Itali dhe 43.5% ka përfunduar. Ndërtimi i terminalit marrës të tubacionit gjithashtu po përparon dhe në muajin Nëntor 2019, arriti në përfundimin 67.5%.

STATUSI I LEJUESHMËRISË

Janë identifikuar të gjitha kërkesat e lejueshmerisë të nevojshme për ndërtim si dhe aplikimet për leje janë dorëzuar ose janë marrë. Në shumë raste, ndryshimet kërkohen për lejet origjinale për shkak të ndryshimeve teknike në projekt dhe procesi ka qënë dhe vazhdon të menaxhohet në kohë. Në rastet kur janë identifikuar rreziqe të veçanta, siç janë vonesat e mundshme ose sfidat ligjore, ato trajtohen dhe merren masat e duhura.

Për fazën e ndërtimit janë nevojitur lejet kryesore të mëposhtme:

- Leja Mjedisore (Miratimi nga Vlerësimi i Ndikimit Social në Mjedis)
- Plani Sektorial në Vend
- Leja e Ndërtimit (Zhvillimit) faza 1
- Leja e Ndërtimit (Zhvillimit) faza 2

Leja e Ndërtimit (Zhvillimit) është leja e ndërtimit në Shqipëri. Leja e Zhvillimit në Tërësi faza 1 është “leja mbrojtëse” që miraton gjurmët për të gjithë projektin dhe nxirret për pjesën e tubacionit ose për llojin e shërbimit dhe është e detyrueshme për ndërtimin.

Miratimet për Vlerësimin e Ndikimit Social në Mjedis dhe Plani Sektorial në Vend janë marrë në vitin 2013 dhe Leja e Ndërtimit (Zhvillimit) për fazën e parë është miratuar në vitin 2014.

Kanë ndodhur tre ndryshime të miratuara nga Plani Sektorial në Vend dhe Leja e Ndërtimit (Zhvillimit) për fazën e 1-rë për të reflektuar ndryshimet tek gjurma e gazsjellësit dhe pjesë të tjera të projektit për vitin 2017 dhe 2018.

Miratimi i Lejes së Ndërtimit (Zhvillimit) për fazën e dytë është ndarë në disa pjesë (rrugët dhe urat me tre nën-paketa; për sheshet e tubave dhe ato të ndërtimit; tubacioni në pjesën në det dhe

stacionet e kompresimit). Të gjitha janë marrë në kohë për të lejuar fillimin e ndërtimit tek të gjitha fazat e projektit.

TAP ka marrë Miratimin e Lejes së Ndërtimit (Zhvillimit) për fazën e dytë për gazsjellesin në tokë, përkatësisht për pjesën e daljes në det, në muajin Gusht 2016 dhe për pjesët midis kufirit Shqipëri – Greqi në muajin Dhjetor 2016. TAP ka marrë në muajin Qershor 2017 po ashtu Miratimi i Lejes së Ndërtimit (Zhvillimit) për fazën e dytë për pjesët në tunelin e Çorovodës.

Ka patur aplikime për ndryshim të Lejes së Ndërtimit (Zhvillimit) për fazën e dytë të cilat duhet të trajtojnë ndryshimet e fundit të gjurmëve, përfshirë kushtet gjeologjike dhe mjedisore dhe ndryshimet e gjurmëve të cilat kanë lidhje me trashëgiminë kulturore, të identifikuar nga gazsjellësi në tokë Kontraktuesi për punimet Inxhinierike, të Prokurimit dhe ato të Ndërtimit, të cilat janë kryer në datën 13.02.2018. Aktualisht, për shkak të kushteve të pa parashikuara gjeologjike tek një mikro tunel është përzgjedhur si zgjidhje inxhinierike dhe është duke u kryer puna për të marrë miratimet e nevojshme për ndryshimin e lejeve origjinale të Lejes së Ndërtimit (Zhvillimit) për fazën e dytë.

Në Dhjetor 2016, TAP po ashtu mori Lejen e Ndërtimit (Zhvillimit) për fazën e dytë për stacionet e matjes dhe të kompresimit. Punimet e ndërtimit kanë filluar për të dyja këto stacione. Për shkak të ndryshimeve që janë bërë gjatë projektimit nga Kontraktuesi për punimet Inxhinierike, të Prokurimit dhe ato të Ndërtimit, TAP paraqiti ndryshimet e Lejes së Ndërtimit (Zhvillimit) për fazën e dytë, për stacionin e kompresorëve dhe stacionin e matjes. Këto ndryshime janë miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në datën 02.10.2018.

TAP po ashtu ka marrë Lejës së Ndërtimit (Zhvillimit) për fazën e dytë për pjesën në det në datën 25.06.2018.

Ndryshimi i Lejes së Ndërtimit (Zhvillimit) për fazën e dytë, Pjesa e gazsjellësit në tokë për ndërtimin e Mikro tunelit, është marrë në datën 31.10.2019. Për shkak të ndryshimeve me të cilat janë përballur, nevojitet një bypass për mikro tunelin, dhe si pasojë për ndërtimin e tij është dorëzuar tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë një aplikim për Leje Ndërtimi.

TAP ka marrë Çertifikatën e parë të Përdorimit për Mikro Tunelin e Çorovodës në datën 30.10.2019 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Çertifikata e Përdorimit për gazsjellësin në pjesën tokësore është paraqitur për miratim brenda vitit 2019.

LIÇENSA PËR TË OPERUAR

Ndërkohë që TAP është zhvendosur në fazën e funksionimit, ka liçensa shtesë, autorizime dhe leje që kanë lidhje me këtë fazë të projektit, të cilat duhet të merret nga autoritetet dhe ministritë e Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë përpara Datës së Planifikuar për tu vendosur në funksion (në përgjithësi “Licensa për të Operuar”. Në këtë drejtim, TAP ka krijuar brenda për brenda institucionit një staf të përkushtuar për rrjedhën e punës të liçensës së operimit, që do të angazhohet me Autoritetet Rregullatore (Shqipëri, Greqi, Itali) dhe autoritetet e tjera në vend për të marrë liçensën e operimit në kohën e duhur.

Liçensa e Transmetimit

ERE me Vendimin nr. 15, datë 31.01.2019, liçensoi në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, Trans Adriatic Pipeline AG Albania, për një afat 25 vjeçar, nga data e fillimit të operimit dhe subjekt i kushteve të përcaktuara në liçensën e ushtrimit të aktivitetit të transmetimit të gazit natyror, si dhe kushteve të këtij vendimi.

Liçensimi në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror reflekton kërkesat e nenit 4, pika 50; nenit 22, pika 2 gërma “a” dhe nenit 35 të Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për Sektorin Gazit Natyror”, si dhe nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5; nenit 8; nenit 9 pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, gërma “a” dhe nenit 10 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e Gazit Natyror”; Ky vendim u parapri nga procesi i fillimit të procedurave, analizës së dokumentacionit të dorëzuar, si dhe zhvillimit të procedurës për marrje mendimi, opinion apo ankesa të palëve të interesuara.

Ligji Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit përgjegjës për çështjet e rregullimit të sektorit të gazit natyror përfshirë të drejtën për të trajtuar çështjet që lidhen me liçensimin e subjekteve në aktivitetet e rregulluara të gazit natyror. Bordi i ERE-s me vendimin nr. 36, datë 31.03.2016, ka miratuar Çertifikimin përfundimtar të TAP AG si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror. “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e gazit natyror”, në nenin 9 pika 2 gërma “a” të saj vendos kushtin se: Subjekti që aplikon për një liçensë në transmetimin e gazit natyror, duhet që më parë të çertifikohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 37 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Sikurse cituar më lartë, aktualisht TAP AG me Vendimin nr. 36, date 31.03.2016, është çertifikuar si operator i pavarur i gazit natyror.

Trans Adriatic Pipeline AG Albania rezulton e regjistruar pranë QKB, si Degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a), konform Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”. Aktiviteti i TAP AG Albania sipas ekstraktit të QKB, konsiston në: - Të veprojë në përputhje me objektivat e shoqërisë të cilat janë të lidhura me planifikimin, zhvillimin dhe të zotërojë pronësinë ligjore të një linje tubacion gazi si dhe të çdo paisje të përfshirë në të. - Dega mund të angazhohet në çdo aktivitet tregtar financiar ose aktivitete të tjera të cilat janë në përputhje me objektivat e Shqipërisë. - Objekt i veprimtarisë është: **Operimi si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”,**

Nga vlerësimi që i'u bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga TAP AG, në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e Gazit Natyror” subjekti i ka plotësuar kryesisht kushtet e nje procesi liçensimi.

Referuar nenit 5 të Rregullores për “Procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e Gazit Natyror”; kohëzgjatja e vlefshmërisë së një Liçense të lëshuar në përputhje me nenin 4 sipas kësaj Rregulloreje për ushtrimin e aktivitetit të transmetimit të gazit natyror, do të jetë për një periudhë prej 30 vitesh. Afati i aplikueshem për Tap AG është i lidhur me Vendimin e përjashtimit të aksesit të palëve të treat, në kuptim të të cilit u vendos afati i liçensimit për një periudhë prej 25 vjet.

Liçensim i TAP AG ka për qëllim vazhdimësinë normale të punës në tregun e gazit natyror të këtij subjekti. Nga ana tjetër i gjithë procesi i shqyrtimit të këtij aplikimi është kryer në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e Gazit Natyror”.

Çertifikata e Përdorimit

Çertifikata e Përdorimit është leja e parë që lëshohet pas përfundimit të punimeve të ndërtimit të të gjithë infrastrukturës së tubacionit TAP në territorin Shqipëtar, duke përfshirë edhe objektet në tokë dhe në det të hapur.

Çertifikata e Përdorimit është një dokument zyrtar i nxjerrë nga Ministria që do të vërtetojë që ndërtimi i gazsjellësit është kryer në përputhje me termat dhe kushtet e Lejës së Ndërtimit dhe që ndërtimi kur të mbarohet të jetë i përshtatshëm për tu përdorur.

Aplikimet për Çertifikatat e Përdorimit u planifikuan të dorëzohen në Ministri në muajin Dhjetor 2019 për çdo leje Ndërtimi të lëshuar për të gjitha pjesët në tokë dhe në det të hapur të gazsjellësit dhe për stacionet në Shqipëri. Çertifikata e Përdorimit për Çorovodën është marrë në datën 31.10.2019. Periudha e miratimit pritet të realizohet në periudhen në vijim.

Çertifikatat e para të Përdorimit nga 9 në total janë marrë nga TAP për mikro tunelin e Çorovodës dhe paketa e dytë për Pjesën tjetër do të paraqitet më tej.

Çertifikata e Pronësisë e TAP

Çertifikatat e Pronësisë të TAP do të merret nga Drejtoria e Kadastrës në vend pas përfundimit të punimeve të ndërtimit për objektet e përhershme (stacionet e kompresimit në Shqipëri dhe valvulat e bllokimit në Shqipëri) dhe pas nxjerrjes së Çertifikatës së Përdorimit për punimet e ndërtimit.

Çertifikatat e Pronësisë së TAP do të mbulojnë pronat/objektet e përhershme të ndërtuara nga TAP në bazë të Ligjit nr. 107/2014 “Mbi Zhvillimin dhe Planifikimin Territorial” si dhe legjislacioni i sektorit dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave (të cilat aplikohen vetëm për Projektin TAP).

Çertifikatat e Pronësisë janë të ndryshme nga Çertifikatat e Pronësisë së Tokës dhe të drejtat/përdorimi i pronës që TAP ka marrë ose është në proces të marrjes ose ndryshimit me qëllim vendosjen në funksion të objekteve në territorin Shqiptar.

TAP tashmë ka fituar ose është në proces të blerjes ose ndryshimit, me qëllim të funksionimit të lehtësive të tij në territorin shqiptar.

Aplikimi për Çertifikatat e Pronësisë do të fillojë pasi është marrë Çertifikata e Përdorimit për të gjitha objektet në Shqipëri.

PROGRESI I MARRËVESHJEVE

Marrëveshjet Komerciale

Në Nëntor 2013, TAP nënshkroi marrëveshje për transportin e gazit për kapacitetin fillestar prej 10 miliard metër kub gas në vit me tre transportues: Azerbaijan Gas Supply Company (AGSC), SOCAR dhe Axpo Trading të cilat do të luajnë rolin e transportuesit të TAP nga Data e Vendosjes në Funksion (COD). SOCAR do të kryejë rolin e AGSC (Kompania e Furnizimit me Gaz në Azerbaixhan) si transportuese e TAP në Mars 2036.

Në Mars 2016, marrëveshjet e transportit të gazit me AGSC dhe SOCAR në lidhje me Kapacitetin Fillestar të TAP u ndryshuan sipas Kapacitetit të Rezervuar tek Pikat e Daljes së TAP në Greqi. Ndryshimi u fillua për të shmangur furnizimin me gas të zonave të tejmbushura të sistemit DESFA.

Këto Sasi të Rezervuara (Grumbulluara) nuk kanë ndryshuar që nga progres raporti i parë për vitin 2019 dhe përfshijnë rezervimet sipas fazës së parë të rezervimit për kapacitetin në avancë me pikë hyrje në Kipoi dhe pikë dalje në Komotini, si dhe rezervimet komerciale të rrjedhës në drejtim të kundërt.

Kushtet dhe Termat e Përgjithshme për transportin e gazit janë në dispozicion për qëllim informacioni gjatë procesit të konsultimit të Kodit të Rrjetit të TAP. Ato po ashtu përfshijnë ndryshime të cilat janë bërë tek Marrëveshjet aktuale të Transportit të Gazit sipas miratimit të ndryshimeve tek Kodi i Tarifave në muajin Korrik 2018.

Marrëveshje të Tjera

Janë nënshkruar disa marrëveshje për të mbështetur zhvillimin e projektit TAP. Në Shkurt 2013 një marrëveshje ndër-qeveritare (IGA) midis Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë është nënshkruar dhe ratifikuar në Itali me anë të Ligjit nr. 153/2013, ku qeveritë e këtyre tre shteteve u angazhuan për mbështetjen e tyre të plotë për realizimin e projektit. Takimi i parë i Komisionit të Implementimit përcaktuar nga marrëveshja ndër qeveritare midis Italisë, Shqipërisë dhe Greqisë u mbajt në Tiranë në datën 25 Janar 2016 me pjesëmarrjen e TAP.

Si pasojë, TAP ka nënshkruar marrëveshje me qeverinë pritëse (Host Government Agreement HGAs) me Greqinë dhe Shqipërinë. Komisioni Europian ka nxjerrë një vendim në datën 3 Mars 2016 ku deklarohet se Marrëveshja me qeverinë Pritëse të Greqisë (Greek HGA) përputhet me Rregullat e BE të Ndihmës së Shtetit (State Aid).

Aktualisht TAP po përfundon shqyrtimin e marrëveshjeve të interkonjeksionit me TANAP (Turqi), IGB (Bullgari), DESFA (Greqi) dhe SRG (Itali). Në datën 30 Shtator 2019, TAP filloi konsultimet publike mbi disa dispozita të draftit të Marrëveshjeve të Interkonjeksionit (IAS) me OST fqinje për Pikat e Interkonjeksionit si më poshtë (IPs):

- Marrëveshje interkonjeksioni (IA) me TANAP Dogalgaz iletim A§ për pikën e interkonjeksionit të Kipoi
 - Marrëveshje interkonjeksioni me (IA) me ICGB AD për pikën e interkonjeksionit në Komotini
 - Marrëveshje Interkonjeksioni me DESFA S.A. për pikën e interkonjeksionit në Nea Mesimvria
- Marrëveshje Interkonjeksioni me Snam Rete Gas S.p.A për pikën e interkonjeksionit të Melendugno. Konsultimi publik vazhdoi deri në datën 29 Nëntor 2019.

Përditësimi i Ecurisë së Projektit TAP Dhjetor 2019

Ecuria e Projektit:

- Ecuria në tërësi: mbi 90% ka përfunduar;
- Ndërtimi në Greqi dhe në Shqipëri pothuajse ka përfunduar 100%;
- Pjesa në tokë në Itali 80% e përfunduar;
- Mbi 99% e tubave janë vendosur;
- Punimet në det kanë përfunduar 60% e tyre.

Të dhënat kryesore:

- TAP është një projekt strategjik dhe i vetmi projekt i vërtetë dhe me investime kryesore për Greqinë / Shqipërinë / Italinë, duke sjellë shumëllojshmëri dhe sigurinë e furnizimeve të energjisë përmes një rruge të re për tregjet Europiane.

- TAP po kalon nga një projekt kompanie tek një Operator i Pavarur i Sistemit të Transmetimit që do të funksionojë në mënyrë të sigurt gazsjellësin dhe do të sigurojë kapacitetin e transportit për transportuesit.
- TAP do të funksionojë si një udhërrëfyes, duke i hapur rrugën vendit për të tërhequr investime të tjera ndërkombëtare të kalibrit të lartë.
- TAP është i shkallëzueshëm dhe mund të zgjerohet deri në 20 miliard metër kub në vit dhe mbetet një projekt parësor për BE me statusin e Projektit me Interesa të Përbashkëta (PCI). Në lidhje me këtë, TAP ka filluar procesin e testimin të tregut në korrik 2019. Faza e Vlerësimit të Kërkesës ka përfunduar dhe faza e Projektimit të Koordinuar ka filluar kohët e fundit. Gjatë kësaj faze, TAP do të kryejë studime teknike për zgjerimin e tubacionit nga 10 miliard metër kub në vit, deri në 20 miliard metër kub në vit.
- TAP është një investim kryesor që parashikon hapjen e tregjeve të gazit dhe ndërlidhjen ndërkufitare midis zonës së Europës Jug-Lindore / Ballkanit Perëndimor (përfshirë mundësinë për gazsjellësin interkonektor midis Greqisë dhe Bullgarisë (IGB)/ Gazsjellësit Jonian Adriatik (IAP). me pjesën tjetër të rrjetit European të gazit.
- TAP është thelbësor për finalizimin e suksesshëm të të gjithë vlerës së zinxhirit të Korridorit Jugor të Gazit me një investim prej 40 miliard dollarë.

Të dhëna të tjera të përgjithshme:

- TAP do të transportojë gaz natyror dhe do të kontribuojë në procesin e dekarbonizimit në Evropë, përfshirë Europën Jug-Lindore / Ballkanin Perëndimor dhe Italinë.
- **Shqipëria:**
 - TAP do të ndihmojë për një ndërlidhje më të madhe dhe bashkëpunim më të fortë ekonomik midis vendeve të rajonit, përfshirë krijimin e një rrjeti rajonal të gazit të integruar plotësisht me tregun European.
 - Kur të vendoset gazi në dispozicion nga Greqia në Stacionin e Matjes në Bilisht dhe me gatishmërinë e Stacionit Matës për futjen e gazit natyror, do të fillojë funksionimi i këtij projekti. Qëllimi është të kemi një Stacion Matës që mund të përdoret për të matur gazin që del nga Bilishti dhe në këtë pikë do të vendoset pranimi i fillimit operacional të objektit.
 - Gazi që del nga Bilishti do të futet në Stacionin e Kompresimit në Fier dhe kur objekti të jetë gati, Gazi do të futet në impiant dhe do të fillojë “funksionimi”kjo do të thotë se janë krijuar kushtet për dërgimin e gazit në Itali
 - Marrëveshja e Mirëmbajtjes e nënshkruar në fund të Dhjetorit 2018 midis Gazsjellësit Trans Adriatik dhe Albanian Gas Service Sh.A (AGSco) një ndërmarrje e përbashkët e Albgas dhe SNAM. AGSco do të kryejë mirëmbajtjen e TAP gjatë fazës së funksionimit. Marrëveshja e Mirëmbajtjes merr në konsideratë krijimin e disa pikave të mirëmbajtjes operative në rrethet Fier, Berat, Skrapar, Korçë. TAP dhe AGSco janë në proces trajnimit të stafit dhe të ngritjes së pikave të mirëmbajtjes.
 - Gazi do të futet gjithashtu nga Stacioni i Fierit më tej përmes gazsjellësit në Shqipëri, përmes tubacionit në pjesën detare të Adriatikut dhe më tej në Terminalin e Pranimin të Gazsjellësit në Melendugno.

- Shpenzimet e projektit të TAP në vitin 2019 në Shqipëri ishin afërsisht 100 mln €. TAP do të investojë 14 milion euro për zbatimin e projekteve në kuadër të programit të tij të Investimeve Sociale dhe Mjedisore në Shqipëri. Këto projekte janë përqendruar në mbështetjen e komuniteteve lokale në fushat e arsimit dhe trajnimit, menaxhimit të mjedisit, cilësisë së jetës së komunitetit dhe zhvillimit të jetesës.
- Në fund të vitit 2019, TAP ka shpenzuar 9.4 milion € për nisma specifike të Investimeve Sociale dhe Mjedisore. Për më tepër, investimet në vlerë 3 milion € janë aktualisht në negociim. Programi për Investimet Sociale dhe Mjedisore (SEI) i TAP ka ofruar 41 projekte deri më tani, me një shpenzim të përgjithshëm prej 7.2 milion €.
- **Greqia:**
 - TAP është një projekt strategjik "**model**" (ky term i referohet një projekti model që synon, përveç qëllimit të tij origjinal, të ketë një efekt për shumë projekte në vijim) dhe një investim kryesor afat-gjatë për Republikën Greke, si dhe një projekt "bazë" për zhvillim të mëtejshëm.
- **Italia:**
 - TAP ka marrë të gjitha lejet në Itali, kjo vjen nga mbështetja e garantuar e Presidencës së Republikës Italiane, Presidencës së Këshillit dhe ministritë përkatëse italiane;

Punimet dhe Ecuria e Projektit

Muajt në vijim do të jenë thelbësorë për të siguruar funksionimin e gazsjellësit dhe të stacioneve dhe janë në mënyrë progresive gati për funksionimin dhe fillimin e shpërndarjeve komerciale të gazit. Nga ana teknike, pasi të arrihet përfundimi mekanik, gazsjellësi dhe objektet fqinje do të hyjnë në fazat e para-funksionimit dhe të funksionimit. Kjo do të sigurojë që tubacioni dhe stacionet janë plotësisht të sigurt dhe të gatshëm për operim, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe ato teknike.

Paralelisht, TAP po përgatitet për veprimet komerciale për tu transformuar në një Operator të Sistemit të Transmetimit (OST) brenda procedurës së Operatorit të Pavarur të Sistemit të Transmetimit (ITO). Ekipi i Operimit po zbaton Programin e Gatishmërisë së Operimit.

Në **Shqipëri** punimet tek mikro tuneli dhe bypass i përkohshëm përfunduan në fund të vitit 2019 dhe tani përqëndrimi është tek përfundimi final dhe funksionim i aktiviteteve për tu përgatitur për futjen e gazit në tremujorin e parë të 2020.

Ecuria e plotë deri në fund të Dhjetorit 2019 ishte 97%. Pjesa dërrmuese e punëve të ndërtimit në vend ka përfunduar dhe stafi i projektit në vend po përqëndrohet në përfundimin final dhe vendosjen në funksion të aktiviteteve në përgatitje të futjes së Gazit.

Zërat kryesore të cilët kanë përfunduar në Shqipëri deri me tani përfshijnë

- Instalim dhe vendosje mbi 215 km tek tubi me diameter 48" nga kufiri Grek me arritje në tokë në Fier;
- Jane instaluar 9 stacione që Bllokojnë Valvulat përgjatë rrugës në Shqipëri
- 97% e Marrëveshjeve për daljen në tokë që u kthejnë përsëri pronat pronarëve ka përfunduar

- Po ashtu është bërë rivendosja dhe mbjellja e mijëra pemëve të reja përgjatë rrugës

Tubi me diametër 48 ”është shtruar në një terren të vështirë dhe / ose në tokë të fortë. Në 9-të blloqet e stacioneve të valvulave përgjatë rrugës në Shqipëri janë secila afërsisht 20 km larg nga njëra-tjetra. Këto blloqe të stacioneve të valvulave lejojnë që TAP të izolojë një segment të caktuar të gazsjellësit nëse kërkohen ndërhyrje të tjera në të ardhmen.

Fusha e veprimit të punimeve në Shqipëri po ashtu përfshin marrjen e mbi 10,000 lejeve nga autoritetet lokale dhe pronarët e tokave.

Shkalla e punës në Shqipëri ka qënë e madhe duke i kushtuar vëmendje forcës punëtore në vënd. Mesatarisht stafi i punësuar nga TAP përgjatë jetëgjatësisë së projektit në Shqipëri është 1,700 staf nga Shqipëria mbi 83% e forcës punëtore në total.


Ndërkohë që futja e Gazit Natyror dhe përfundimi janë planifikuar në vitin 2020, TAP aktualisht po shqyrton mundësitë për të rritur kapacitetin në të ardhmen, që mund të nënkuptojë mundësi zhvillimi në të ardhmen brenda vendit.

Në **Itali** punimet po vijojnë sipas Lejeve të Vetme të dhëna nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Itali.

Në datën 9 Nëntor 2019, TAP filloi aktivitetet përgatitore në pikën e daljes jashtë brigjeve Italiane për shtrimin e gazsjellës në Detin Adriatik midis Shqipërisë dhe Italisë. Operacionet kryesore në det kanë filluar dhe pritet të përfundojnë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020.

Lidhur me aktivitetet në det, punimet për përfundimin e pjesës tokësore në Itali të gazsjellësit dhe Terminalit të Pranimit të Gazsjellësit janë po ashtu në vazhdim, me mbi 70% të Terminalit të Gazsjellësit të përfunduar dhe më shumë se 3.5 km tub (afërsisht 8 km) tashmë në tokë. Mikro-Tuneli që anashkalon bregun e San Foca ka përfunduar me sukses në Prill 2019.

Në **Greqi** TAP ka përfunduar ndërtimin në kohë, sipas buxhetit dhe sipas angazhimeve dhe standardeve të TAP. TAP prezantoi me sukses hidrokarburet në funksion për pjesën 1 (2 km larg kufijve turq deri në stacionin Grek të kompresimit) në fund të muajit Nëntor 2019. Përveç kësaj, funksionimi i pjesëve 3 & 4 i është dorëzuar Ekipit të Operimit në përgatitje për prezantimin e Gazit Natyror deri në fund të muajit Janar 2020. Komunitetet e prekura nga projekti informohen për zhvillimet përmes një fushate që i dedikohet ndërgjegjësimit publik, e cila TAP pritet të fillojë në javët e ardhshme në Shqipëri.



Projekti TAP në Shqipëri

TAP aktualisht po bashkëpunon ngushtë me ERE për:

- Miratimin e Kodit të Rrjetit të TAP, i cili ka për qëllim të drejtojë operimin e sistemit të transportit të TAP. TAP e ka paraqitur Kodin e tij të Rrjetit tek Autoritetet Rregullatore për miratim, ende po vazhdojmë diskutimet deri në miratimin e tij..
- Bordi i ERE-s me vendim nr.15, datë 31.01.2019 pajisi TAP-in me liçensë në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror me një afat prej 25 vjet, e cila përkon me periudhën e përjashtimit të këtij projekti, pas këtyre viteve TAP do të vazhdojë si të gjitha kompanitë e tjera të liçensuara.
- ERE po bashkëpunon edhe me hartimin e Librit të Rregullave për fazën e Operimit të TAP pas fazës së ndërtimit të Tij, që është maksimumi fundi i vitit 2020.

Market Testi për Zgjerimin e Kapacitetit

Tashmë ka filluar Market Testi për zgjerimin e kapacitetit. Ai është harmonizuar me dispozitat e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përjashtimit të TAP AG, datë 6 Qershor 2013, lëshuar nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC, (‘Opinionit Përfundimtar i Përbashkët’) i Kodit të Tarifave të TAP ¹ me Rregulloren e BE 2017/459 duke krijuar kodin e rrjetit mbi Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit tek sistemet e transportit të gazit (“CAM NC”).

Sipas Paragrafit 4.1.7 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, Udhëzimet miratohen nga Autoritetet kompetente Rregullatore të Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë. (‘Autoritetet’), përkatesisht ARERA, RAE dhe ERE.

Kërkesa për Zgjerimin e Kapacitetit

Për kapacitetin e tij fillestar, TAP përjashtohet nga dispozitat e aksesit të palëve të treta, tarifat e rregulluara dhe veçimi i pronësisë sipas afateve të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët. Përjashtimi nga tarifat e rregulluara dhe veçimi i pronësisë po ashtu aplikohet për Kapacitetin e Zgjerimit aktual të ndërtuar të TAP.

Sipas Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, TAP duhet të kryejë një Testim të Tregut të paktën çdo dy vjet, duke filluar jo më vonë se Data e saj Komerciale e Vendosijes në Funkcion (‘COD’)

Neni 26 i Mekanizmit për Alokimin e Kapacitetit për Kodin e Rrjetit i kërkon Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të kryejnë një procedurë të koordinuar dhe që bazohet tek tregu për të vlerësuar nevojën për rritje kapaciteti.

Testimi i Tregut

Testimi i Tregut është një procedurë transparente, e hapur dhe jo diskriminuuese. Proçesi pasqyron kontekstin Rregullator unik dhe specifik të Transportuesit dhe përfshin udhëzimet se si TAP do të marrë pjesë në proçesin e gjerë për rritjen e kapacitetit të percaktuar në Kapitullin V të Mekanizmit për Alokimin e Kapacitetit të Kodit të Rrjetit.

TAP kërkon që çdo Projekt Zgjerimi duhet të përmbajë dispozita të veçanta për të qënë në përputhje me Opinionin Përfundimtar të Përbashkët. Konsultimi duhet të përmbajë informacionin sipas Nenit 27 (3) të Mekanizmit të Alokimit të Kapacitetit të Kodit të Rrjetit (CAM NC). Kjo do të përfshijë rregullat të cilat drejtojnë Fazën Detyruese, përfshirë çdo alternativë tjetër për

¹ Miratuar në Nentor 2013 nga Autoritetet Rregullatore Italiane, Greke dhe Shqiptare. Po ashtu është miratuar një ndryshim në muajin Korrik 2018

mekanizmin e alokimit në kuptim të Nenit 30 të Mekanizmit të Alokimit të Kapacitetit të Kodit të Rrjetit. Kjo alternativë tjetër e Mekanizmit të Alokimit mund të parashikohet të jetë e nevojshme për të lejuar pajtueshmërinë me rregullat e përcaktuara në Pjesën 3 të Kodit të Tarifave të TAP. Ajo po ashtu duhet të përfshijë mekanizmin e ankandit të përcaktuar në Pjesën 3. 3. 1 (e) të Kodit të Rrjetit të TAP.

Pas konsultimit, TAP dhe OST Fqinje do të finalizojnë hartimin e Projektit të propozuar për Zgjerimin dhe do ta paraqesin për miratim tek Autoritetet përkatëse. Sipas Nenit 28 (2) të Mekanizmit të Alokimit të Kapacitetit të Kodit të Rrjetit (CAM NC), brënda 6 muajsh nga marrja e propozimit përfundimtar të projektit nga Autoriteti i fundit përkatës, ato duhet të publikojnë vendime në koordinim me njëri tjetrin mbi propozimin e projektit. Propozimet e projektit ku përfshihen një ose me shumë Kërkesa për Lidhje mund të trajtohen në mënyrë individuale sipas një afati të ndarë, pasi këto kërkesa nuk i nënshtrohen testit ekonomik, por vetëm testit të realizueshmërisë teknike. Sipas Paragrafeve 4.7.5 dhe 4.7.8 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, kostot për këto kërkesa do të përballohen nga pala e tretë që e ka bërë kërkesën, sipas legjislacionit të vendit në kohën kur është bërë kërkesa.

Market Testi do të shërbejë për zgjerimin e kapacitetit në hyrje të projektit por gjithashtu edhe pikat e lidhjes që janë kërkuar në Korçë, Kuçovë sepse ajo e Fierit tashmë ekziston.

5.2 Aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria dhe Këshilli i Ministrave për sektorin e Gazit Natyror.

Është bërë një punë e madhe për hartimin e legjislacionit sekondar për sektorin e gazit natyror kjo si nga ministria e linjës ashtu edhe nga ERE dhe Albgazi, më poshtë po trajtojmë shkurtimisht sipas radhës.

Nga Ministria e linjës:

- **VKM nr.553, datë 25.07.2019.** "Për miratimin e kushteve dhe procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen për të licencuarit në sektorin e gazit natyror që operojnë transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e gazit natyror"
- **VKM nr. 663 datë 10.10.2019.**Rregullat teknike dhe kriteret e sigurisë për objektet e infrastrukturës së gazit natyror
- **VKM nr. 509, datë 17.7.2019.** Kriteret dhe procedura për lëshimin e çertifikatave 2.3 Vendimi i Përrjashtimit të TAP AG-s
Gjithashtu aktet e tjera të nxjerra nga Këshillim i Ministrave kanë bërë që pothuajse të kompletohet në tërësi kuadri i rregullave dhe urdhërave dhe që nuk pengon punën për hapjen e tregut të gazit në vëndin tonë
- **VKM Nr. 417, datë 10. 05. 2017,** "Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror, në përputhje me standardet minimale të sigurisë së furnizimit, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm me gaz natyror"
- **VKM Nr. 69, datë 07.02.2018,** "Për miratimin e kushteve dhe të procedurës për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit me gaz natyror"
- **VKM Nr. 590, datë 9.10.2018** "Për miratimin e modelit të tregut të gazit natyror".
- **VKM Nr. 573, datë 3.10.2018** "Për miratimin e rregullave dhe procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror të ministrisë përgjegjëse për energjinë"
- **VKM Nr. 685, datë 14.11.2018,** "Për miratimin e praktikave për promovimin e investimeve të përbashkëta rajonale në infrastrukturën e sektorit të energjisë"*

- **VKM Nr. 612, datë 27.10.2017**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, pjesa e tretë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”.
- **Urdhëri Nr. 96, datë 23.01.2018, i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë**, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme për akses në rrjetet e gazsjellësive të veprimtarive të kërkim prodhimit”
- **Urdhëri Nr. 912, datë 27.12.2018, i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë** “Për miratimin e udhëzuesit për përcaktimin e zonave për aktivitetin e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”.

5.3 Aktet nënligjore të miratuara nga ERE gjatë vitit 2019 për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e Gazit Natyror.

Vendimmarrjet e mëposhtme lidhen me miratimin e kuadrit ligjor të ERE-s në funksion të zbatimit të ligjit nr. “102/2015 për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, si dhe përgatitja e kushteve të tregut me fillimin e operimit të gazit në vitin 2020, i cili përkon me startimin e projektit TAP:

1. **Vendimi Nr.95 datë 17.06.2019 Mbi miratimin “Udhëzuesit për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik”.**

Qëllimi i miratimit të “Udhëzuesit për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik” është të përcaktojë rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen në procesin e Testimit të Tregut që zhvillohet nga TAP që në fillimin e vitit 2019, si dhe të informojë të gjitha palët e interesuara, dhe çdo palë tjetër të interesuar për të. Gjatë TAP-it-market test(testimit të tregut), të gjitha Palët e interesuara mund të kërkojnë kapacitete shtesë në sistemin e transportit TAP(“Kërkesat e Kapacitetit”), dhe gjithashtu të kërkojnë ndërtimin e pikave të reja të hyrjes dhe / ose të daljes dhe / ose rritjen e aftësisë teknike të pikave ekzistuese dhe / ose daljeve tashmë ekzistuese përgjatë sistemit të transportit të TAP.

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 13; 15, pika 1, gërma “a”; 16, pika 24 dhe nenit 108, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror” i ndryshuar; dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përrjashtimit të TAP AG, datë 6 Qershor 2013, lëshuar nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC, (‘Opinionit Përfundimtar i Përbashkët’) i Kodit të Tarifave të TAP AG dhe të Rregullores së BE 2017/459 për krijimin e një Kodi të Rrjetit mbi Mekanizmat për Alokimin e Kapacitetit për sistemet e transmetimit të gazit (‘Mekanizmi për Alokimin e Kapacitetit për Kodin e Rrjetit’), si dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016.

Ky udhëzim pasqyron regjimin rregullator specifik të TAP për performancën e Testeve të tij të Tregut. Ai vjen në harmoni me dispozitat e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë në Përrjashtimin e TAP AG Aplikimi, datë 6 qershor 2013, dhënë nga Autoritetet në përputhje me Direktivën 2009/73 / EC ("FJO") dhe me Rregulloren e BE 2017/459 që përcakton një kod rrjeti për ndarjen e mekanizmave të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit ("CAM NC").

Në përputhje me Seksionin 4.1.7 FJO. Ky Udhëzim është aprovuar gjithashtu edhe nga autoritetet kompetentë rregullatore të Italisë dhe Greqisë

2. Vendimi Nr.166 datë 04.11.2019, Mbi miratimin e “Rregullores mbi Sistemin e Njehsuar të Llogarive për Shoqëritë e Rregulluara në Sektorin e Gazit Natyror”

Sistemi i njësuar i llogarive rregullatore përcakton llogaritë për mbajtjen e regjistrave të kontabilitetit dhe hartimin e raporteve financiare për qëllime rregullatore. Kjo rregullore bazohet në parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), si dhe Ligjit të Kontabilitetit që zbatohet për shoqëritë që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Gjatë procedurës për miratimin e kësaj Rregullore, ERE konkludoi se shoqëritë kanë detyrim të paraqesin pranë ERE-s pasqyrat financiare të auditura sipas legjislacionit në fuqi për auditimin, duke qartësuar se auditimi nuk kryhet nga ERE.

Gjatë procedurës për miratimin e kësaj Rregullore, u konkludua se zbatimi i saj është i detyrueshëm jo vetëm për shoqëritë e liçensuara nga ERE, por për të gjitha shoqëritë, veprimtaria e të cilave është objekt rregullimi nga ana e ERE. Kjo reflektohet në përmbajtjen e Rregullores

3. Vendimi Nr.176 datë 14.11.2019, “Mbi miratimin e rregullores së lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror”

Kjo rregullore përcakton procedurën e aplikimit, kriteret për miratimin dhe realizimin e një lidhjeje të re ose modifikimin e një lidhjeje ekzistuese dhe përcaktimin e tarifave përkatëse për lidhjen e paisjeve të përdoruesit të rrjetit të transmetimit ose të shpërndarjes në sektorin e gazit natyror . Akti, sanksionon se çdo aplikant ka të drejtën e lidhjes me rrjetin e gazit natyror të operatorit të liçensuar për zonën përkatëse të shërbimit. Ajo garanton se Lidhja për të gjithë përdoruesit e rrjetit të gazit do të sigurohet në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese dhe do të bazohet në një marrëveshje lidhjeje Tip apo të dakortësuar. Rregullorja, përcakton Kërkesat teknike për projektimin dhe zbatimin e një lidhjeje, afatet dhe procedurat për realizimin e një lidhjeje të re, apo modifikimin e një lidhjeje ekzistuese si dhe Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Rrjetit por edhe të çdo përdoruesi të tij.

4. Vendimi Nr.103 datë 26.06.2019, për miratimin e transpozimit të rregullores 2017/459 të miratuar me Vendimin nr.2018/06/PHGL-ENC “Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit”.

Kjo Rregullore krijon një kod të rrjetit që vendos mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit për kapacitetet ekzistuese dhe në rritje. Ajo përcakton se si bashkëpunojnë operatorët e sistemit të transmetimit, në mënyrë që të lehtësojnë shitjet e kapaciteteve, duke pasur parasysh rregullat e përgjithshme komerciale si dhe teknike lidhur me mekanizmat e alokimit të kapaciteteve. Kodi i rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit zbatohet për pikat e interkonjeksionit midis Palëve Kontraktore.

Pikat hyrëse dhe dalëse të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian dhe pikat e hyrjes dhe daljes në vende të treta mund të konsiderohen pikat e interkonjeksionit për qëllimet e kësaj

Rregullore, sipas vendimit të autoritetit kombëtar rregullator përkatës. Kjo Rregullore nuk zbatohet për pikat e daljes në konsumatorët fundorë dhe rrjetet e shpërndarjes, pikat e hyrjes nga terminalët e termocentralit të lëngëzuar të gazit natyror (GNL) dhe objektet gjeneruese, si dhe pikat e hyrjes ose daljes në objektet e depozitimit.

5. Vendimi Nr. 231 datë 20.12.2019, për miratimin e “Kodit të rrjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit”

Ky kod i rrjetit pasqyron rregullat mbi strukturat e tarifave të harmonizuara të transmetimit për gazin, duke përfshirë rregullat për aplikimin e metodologjisë së çmimit të referencës, të shoqëruara me kërkesat për konsultime dhe publikime, si dhe llogaritjen e çmimeve të rezervës për produktet të kapacitetit standart. Kodi i Rrjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit siguron rregulla për zbatimin e tarifave që lidhen me shërbimet e transmetimit të gazit dhe për ato shërbime që nuk lidhen me transmetimin, si të parashikuara në nenin 4; për vlerësimin e alokimit të kostove në lidhje me të ardhurat e shërbimeve të transmetimit që do të mbuloohen nga tarifat e transmetimit, për çmimin e referencës dhe çmimeve të rezervës me metodologjitë përkatëse si të parashikuara në Kreun II “Metodologjitë e çmimit të Referencës” dhe Kreu III “Çmimet e Rezervës”. Gjithashtu parashikohen parimet dhe kushtet që do zbatohen ose që nuk do të zbatohen për harmonizimin e të ardhurave, metodat për çmimin e kapacitetit të lidhur dhe kapacitetit në pikën virtuale të interkonjeksionit ku çmimi i rezervës për një produkt të kapacitetit të lidhur do të jetë i barabartë me shumën e çmimeve të rezervës për kapacitetet që kontribuojnë në atë produkt si të përcaktuara në Kreu V “Çmimi i kapacitetit të lidhur dhe kapacitetit në pikën virtuale të interkonjeksionit” si dhe kushtet për ofrimin e qasjeve të çmimeve të pagueshme në pikat e interkonjeksionit si parashikohen në Kreu VI “Çmimi ekuilibër” dhe çmimi i pagueshëm”.

6. Gjatë vitit 2019, ERE me vendimin Nr. 236, Datë 20.12.2019, ka filluar procedurën për miratimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit të gazit natyror në Shqipëri.

Kodi i Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, Rregulloren e Komisionit (BE) 2017/459 e datës 16 mars 2017 për krijimin e një kodi të rrjetit mbi kapacitetin shpërndarës të sistemeve të transmetimit të gazit, Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 312/2014 të datës 26 Mars 2014 për krijimin e një Kodi të Rrjetit për Balancimin e Gazit në Rrjetet e Transmetimit /ENTSO-G CAM NC Modeli i Termave dhe Kushteve kryesore /Rregulloren (BE) Nr. 703/2015 e datës 30 Prill 2015. Krijimi i një kodi të rrjetit mbi rregullat e ndërveprimit dhe shkëmbimit të të dhënave /Kodin e Rrjetit TAP /Marrëveshjen e Transportit të Gazit TAP /Kodin e Transmetimit të Gazit i Irlandës Veriore dhe një numër dokumentash shoqërues /Kodin e Rrjetit i Sistemit Grek të Transmetimit të Gazit /Kodin e Rrjetit të Gazit SNAM Rete /Dokumenta të tjera rregullatore përkatëse. Ky dokument synon të kontribuojë në krijimin e Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror në Shqipëri mbi baza jo-diskriminuese për të gjitha palët me qëllim arritjen e objektivave strategjike në këtë sektor.

Gjithashtu synohet që të arrihet një planifikim dhe operim koherent dhe i koordinuar ndërmjet Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror ALBGAZ sh.a. dhe gjithë përdoruesve të rrjetit të Gazit aktual ose që do të krijohen në të ardhmen, me qëllim vendosjen e kushteve më të mira të mundshme për zhvillimin dhe funksionimin e një tregu të integruar dhe efektiv të Gazit Natyror. Kodi i Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror trajton çështjet që lidhen me planifikimin dhe operimin e sistemit të gazit në tërësi dhe aksesin e aktorëve të tregut në rrjetin

e transmetimit të Gazit Natyror në Shqipëri. Kodi i Rrjetit të Transmetimit parashtrohet normat, rregullat, procedurat dhe kërkesat e përgjithshme dhe themelore që drejtojnë operimin dhe zhvillimin e sistemit të Gazit Natyror në vendin tonë.

- 7. Vendimi Nr. 63, Datë 23.04.2019, “Për një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” Albgaz sh.a.”, të ndryshuar”.**

Me këtë vendimmarrje ERE pasi shqyrtoi ecurinë e përmbushjes në afat të kushteve të vendosura nga ERE për shoqërinë në vendimin e çertifikimit nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAZ sh.a” të ndryshuar, shoqëria Albgaz sh.a. , konstatoi plotësimin e disa prej kushteve, si dhe verifikoi se plotësimi i kushteve të tjera nuk varet tërësisht nga vullneti i shoqërië, vendosi për shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve ende të paplotësuara me afate të përshkallzuara.

- 8. Vendim nr. 190, datë 25.11.2019, Mbi kërkesën e shoqërisë Albgaz sh.a. “Për liçensim në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror”.**

Bordi i ERE-s në mbështetje të nenit 4 pika 50, nenit 22, pika 2, gërma d dhe neneve 59 dhe 80 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, si dhe nenit 4, pika 1, gërma d, nenit 5 dhe nenit 11 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e Gazit Natyror”, filloi procedurën për liçensimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e Operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

Kjo procedurë është në proces dhe pritet plotësimi i dokumentacionit përkatës nga shoqëria Albgaz sh.a, në mënyrë që ERE të vijojë me miratimin final të kësaj procedure.

- 9. VENDIM NR. 220, DATË 20.12.2019, MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 187, DATË 10.11.2017, “PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË ALBGAZ SH.A. NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”, I NDRYSHUAR DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 188, DATË 10.11.2017, “PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË ALBGAZ SH.A. NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR” I NDRYSHUAR**

Bordi i ERE-s në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, pika 12; neneve 46 dhe 56 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”; nenit 113, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative”; neneve 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, vendosi shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimeve sipërcituar deri në datën 20.06.2020, pasi shoqëria Albgaz sh.a. i është drejtuar ERE-s kërkesë për shtyrje duke u shprehur se pajisja me dokumentet e kërkuara është një proces që kërkon kohë dhe është është në varësi të përgjigjes nga institucionet përkatëse.

- 10. VENDIM Nr. 221, Datë 20.12.2019, MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 179, DATË 08.11.2017, “MBI ÇERTIFIKIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR” ALBGAZ SH.A.” TË NDRYSHUAR.**

Bordi i ERE-s në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e

gazit natyror”, i ndryshuar, nenit 53 dhe nenit 113, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative”; neneve 6-11 të “Rregullores për çertifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit Nr. 100, datë 05.08.2015, ndryshuar me vendimin e bordit nr. 129, datë 31.10.2015; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, vendosi shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të Çertifikimit të shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” Albgaz sh.a., të ndryshuar, deri në datën 20.06.2020 dhe 20.12.2020. Shtyrja u bë për shkak se shoqëria Albgaz sh.a. depozitoi në ERE kërkesën për shtyrje, në pamundësi për të plotësuar kushtin i cili lidhet me bërjen efektive të ndryshimeve në kuadrin ligjor, dhe etapat e realizimit të të cilit nuk varen nga vullneti i saj, por nga insitucionet shtetërore dhe si e tillë kërkojnë kohë.

11. VENDIM NR. 230, DATË 20.12.2019, MBI MIRATIMIN E KONTRATËS TË LIDHUR NDËRMJET SHOQËRIVE ALBPETROL SH.A. DHE ALBGAZ SH.A, PËR SHËRBIMIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR, PËR NJË AFAT NJË VJEÇAR DUKE FILLUAR NGA DATA 01.01.2019 - 31.12.2019.

Bordi i ERE-s në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 35 dhe nenit 36, të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 07.12.2016 “Për krijimin e shoqërisë ALBGAZ sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive: ALBGAZ sh.a. dhe ALBPETROL sh.a., si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit funksionimit dhe proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, vendosi të miratojë kontratën për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, të lidhur ndërmjet shoqërisë ALBGAZ sh.a. dhe shoqërisë ALBPETROL sh.a. për vitin 2019. Shkak i vonesës së këtij miratimi u bë mos dakordësia e palëve të saj, për disa nga parashikimet e kontratës në lidhje me detyrimet e palëve dhe sasinë e gazit natyror të parashikuar për tu transmetuar. Vendimmarrja e ERE u mbështet në dispozitat e kontratës së dakortësuar gjatë fillimit të proçedurës nga palët, duke reflektuar gjithsesi në të parashikime që u konstatuan si të pasakta apo jo tërësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në sasinë e përcaktuar nga ana e prodhuesit të gazit natyror

5.4 Veprimtaria e ALBGAZ për vitin 2019.

Shoqëria Albgaz sh.a., me kapital 100% shtetëror, po zhvillon veprimtarinë e saj **ne sektorin të gazit natyror në Shqipëri**, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator. Gjatë vitit 2019, “Abgaz” ka ushtruar aktivitetin e vet në disa drejtime. Në mënyrë të detajuar kjo veprimtari e shoqërisë Albgaz paraqitet më poshtë:

- Hartimin **Kodit të Rrejtit**, drafti është depozituar në **ERE për shqyrtim..**
- Plotësimin e dokumentacionit për të plotësuar kërkesat e vendosura nga ERE në kushtet e Liçensimit si “**Operator i Kombinuar Gazit Natyror**”, pra edhe për Transmetimin (TSO) dhe për Shpërndarjen (DSO);
- Plotësimin e dokumentacionit për Linçesimin e Depozitimit të Gazit Natyror në Dumre;
- Kërkime **Tekniko-Financiare** për realizimin e një “projektit pilot” të LNG në shkallë të vogël;

- Ndjekjen e zhvillimeve të një projekti të transmetimit për Albgaz (PIP1) siç është **Gazsjellësi FIER-VLORE** që mund të furnizojë **TEC-in e Vlorës** me gaz.
- Është përfunduar procedura e marrjes në pronësi të “truallit”, në Zonën e Korçës, mbi të cilën do të ndërtohet Qendra e Mirëmbajtjes (MQ) e Albgaz për zonën Jug-Lindore të Shqipërisë.
- Kanë filluar dhe janë në proces procedurat për projekt idenë e Qendrës së Mirëmbajtjes, sipas standarteve të TAP dhe të partnerit të Albgaz, SNAM”.
- Janë në proces negociimet në nivel teknik me TAP për pikën e daljes (**EXIT POINT**) në FIER, parashikuar minimalisht për një kapacitete 80,000 N m3/orë ose afërsisht 0.7 Bcm/vit.
- Ndjekja e procesit të zbatimit në praktikë e kontratës së **Mirëmbajtjes së TAP** midis AGS dhe TAP, e cila është nënshkruar në dhjetor të 2018.
- Përfundimi i procedurave për aprovimin e gjithë dokumentacionit fillestar dhe autorizimet përkatëse për krijimin e IAP,(**Ionian Adriatic Pipeline shpk**), midis Shqipërisë, Malit të Zi, Bosnje-Herzegovinë dhe Kroacisë dhe **Memorandumet e Mirëkuptimit** midis IAP dhe TAP, si edhe IAP dhe SOCAR (Azerbajxhan).
- Forcimin e bashkëpunimit institucional me **Komunitetin e Energjisë** në kuadër të **WBIF** (Western Balkans Investment Framework).
- Forcimin e bashkëpunimit institucional **ENTSO-G**, duke konsideruar anëtarësinë e Albgaz në këtë të fundit.
- Ndjekjen e punës për rezultatet e Feasibility Study për projektin e interkoneksionit me Kosovën i njohur ndryshe si “**ALKOGAP**”.

Në kushtet aktuale “aktivitetit i Albgaz” është një **proces kompleks, i shtrirë në kohë**, sepse aktivitete të tilla, si ato në këtë sektor, janë shumë **intensive në “investime kapitale”**, si në volume projektimi dhe financimi, ashtu dhe në shtrirje kohore, por rezultati final i tyre i pritshëm dhe gradual është:

1. Krijimi i kushteve për përfundimin e **investimeve të huaja direkte** në këtë segment të ekonomisë;
2. **Rritja e punësimit në sektor** dhe në industrinë që kanë impakt prej sektorit të gazit;
3. Përmirësimi i **furnizimit me energji** në nivel industrial, shërbimesh dhe rezidencial;
4. Krijimi i kushteve për **zhvillim të qëndrueshëm industrial** dhe **ulje kostosh energjike** në nivel prodhimi “mallrash dhe shërbimesh”;
5. Krijimi i **kapaciteteve njerëzore** në vend në drejtim të projektimit, menaxhimit të investimeve duke rezultuar në zbatimin efektiv dhe eficient të aktiviteteve përkatëse në industrinë e gazit.

Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit Natyror nga Albgaz Sh.a.

Në mbështetje të ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, në zbatim të kërkesave të nenit 47, Programi i Përputhshmërisë është miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me Vendim Nr. 77, datë 26.05.2017 “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”.

Me Vendimin Nr. 233, datë 16.10.2018, “Mbi miratimin e “Kërkesave minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse” dhe miratimin paraprak

të Zyrtarit të Përputhshmërisë së OST të Gazit Natyror”, Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë ALBGAZ Sh.a., Operator i Kombinuar i Gazit Natyror, krijuar me Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë ALBGAZ sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive ALBPETROL sh.a. dhe ALBGAZ sh.a.”, emëroi Zyrtarin e Përputhshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), me miratimin paraprak të Entit Rregullator të Energjisë sipas Vendimit Nr. 223, date 16.10.2018, “Mbi miratimin e "Kërkesave minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse" dhe miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë së OST të gazit natyror”.

Raporti vjetor u përpunua nga Zyrtari i Përputhshmërisë si kërkesë ligjore e parashikuar nga Vendimi i Bordit të ERE Nr. 78, datë 26.05.2017 “Mbi miratimin e kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë në sektorin e gazit natyror”. Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë të miratuar nga ERE me Vendim Nr. 77, datë 26.05.2017 “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”.

Me VKM Nr, 848, datë 07.12.2016 të ndryshuar me VKM Nr. 108, datë 23.2.2018, parashikohet detyrimi që aktivitetet e prodhimit dhe tregtimit të gazit natyror do të jenë të ndara nga aktivitetet e transportimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, por gjithashtu shprehet edhe detyrimi për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive që ushtrojnë veprimtari në fushën e gazit natyror, respektivisht për shoqërinë ALBPETROL Sh.a. do të jetë ministria përgjegjëse për energjinë (ish MIE) dhe për shoqërinë ALBGAZ Sh.a. do të jetë ministria përgjegjëse për infrastrukturën (MIE).

ALBGAZ sh.a. si OST është certifikuar sipas Vendimit Nr. 179 datë 08.11.2017 “Mbi Çertifikimin e Shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ALBGAZ SH.A.”, si OST dhe OSSH i gazit natyror.

Nga ana e zyrtarit të përputhshmërisë është vërejtur:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafëve 10 dhe 11 të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, ALBGAZ sh.a. si OST i plotëson kushtet dhe nuk është e përfshirë në aktivitetet që kanë të bëjnë me prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror, pavarësisht se këto aktivitete janë pothuaj në vlera krejtësisht minimale dhe konsiderohen si inegzistente.
- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafëve 12 dhe 13 dhe nën pikat e tyre të Programit, ALBGAZ sh.a. si OST sipas Vendimit Nr. 179 datë 8.11.2017 “Mbi Çertifikimin e Shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ALBGAZ SH.A.” është në diskutime me ERE dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në lidhje me një nga kushtet e certifikimit të Albgaz. Në vijim sa më sipër, duke qenë se ALBGAZ sh.a. si OST faktikisht nuk ka të bëjë me veprimtarinë e të licënsuarëve që kanë aktivitetet prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror, aktivitete këto të cilat janë pothuaj në vlera krejtësisht minimale dhe konsiderohen si inegzistente, OST në këto kushte konsiderohet se përkohësisht ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin ERE Nr. 179, datë 8.11.2017, gjë për të cilën edhe me shkresën e protokolluar në ERE Nr. 233/7 prot. datë 16.10.2018, është kërkuar shtyrje të afatit të plotësimit të plotë të kushteve të parashikuara në Vendimin Nr. 179, datë 8.11.2017 deri në datë 10.4.2019, me vendimin Nr. 63 datë 23.04.2019 është shtyrë afati deri në datën 20.12.2019, dhe me vendimin Nr. 221 datë 20.12.2019 afati është shtyrë deri më 20.06.2020

OST argumenton se shkak për shtyrjen e plotësimit në kohë të kushteve të sipërpërmendura janë situatat krejt specifike të mosfunksionimit real të tregut të gazit në Shqipëri, fakt i konfirmuar edhe nga institucionet e tjera përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit.

Në fushën e veprimtarisë së shoqërisë ALBGAS sh.a janë miratuar edhe dokumentat e rëndësishme për sektorin e energjisë dhe specifikisht të sektorit të gazit duke përfshirë direkt objektin e veprimtarisë së shoqërisë ALBGAS sh.a, të cilat janë:

- Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018 – 2030, miratuar me Vendimin Nr. 480, datë 31.7.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018– 2030”.
- Miratimi i Master Planit të Gazit Natyror për Shqipërinë, miratuar me Vendim Nr. 87, datë 14.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”.
- Shoqëria ALBGAS sh.a. gjatë vitit 2018 megjithë aktivitetin mjaft minimal në transmetimin e gazit natyror, ka patur një aktivitet konkret përsa i përket rolit të saj si kompania publike e transmetimit të gazit natyror. Gjatë vitit 2018 shoqëria ALBGAS sh.a. ka hyrë në marrëdhënie bashkëpunimi me shoqërinë italiane SNAM S.p.A. për krijimin e shoqërisë së përbashkët “ALBANIAN GAS SERVICE COMPANY” sh.a., e cila ka nënshkruar me shoqërinë Trans Adriatic pipeline AG (TAP AG) një Marrëveshje për shërbimin e mirëmbajtjes së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) në territorin shqiptar.
- ALBGAS sh.a. është aksionare e 75% të shoqërisë së përbashkët (“joint venture”) me shoqërinë italiane SNAM Spa tek shoqëria. “Albanian Gas Service Company” Sh.a. (AGSC) që ka si objekt të saj kryesor mirëmbajtjen e sistemit të tubacionit të gazsjellësit TAP në territorin shqiptar.
- Ngritja e shoqërisë “Albanian Gas Service Company” sh.a., si një shoqëri e përbashkët ndërmjet shoqërisë ALBGAS sh.a. dhe shoqërisë italiane SNAM S.p.A., është bërë me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr. 12, datë 01.11.2018, nëpërmjet të cilit është miratuar edhe Akti i Themelimit dhe Statuti i saj.

Bordi i ERE-s miratohet raportin e zyrtarit të përputhshmërisë duke lënë edhe detyra specifike për të ardhmen. Zyrtari i përputhshmërisë gjatë vitit në vijim në zbatim të programit të përputhshmërisë do të paraqesë raportin e tij për vitin 2019.

5.5 Disa Probleme për të Ardhmen në Sektorin e Gazit Natyror

- Ndjekja me përparësi e Projektit TAP sepse është viti vendimtar i vendosjes në punë të Tij, për këtë po punohet për miratimin e akteve nënligjore, rregulloreve dhe amendimeve për aq sa do të lindë e nevojshme.
- Bashkëpunimi me Entet Rregullatore të Energjisë së shteteve fqinje, Greqi dhe Itali, si dy shtete anëtare të BE-së, koordinimi i të gjitha akteve nënligjore dhe rregulloreve në përputhje me Direktivën 2009/EU dhe Rregulloren 715/EU, dhe marjen e vendimeve të përbashkëta për këtë qëllim
- Bashkëpunimi me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vienë për aktet e tjera të mbetura nënligjore dhe konsulenca e vazhdueshme për problemet që dalin gjatë hartimit të tyre

- Ndërtimi i infrastrukturës së gazit si një nevojë urgjente për hapjen e tregut të gazit natyror në vëndin tonë. Tashmë janë identifikuar pesë projekte prioritare të miratuara edhe nga Këshilli i Ministrave dhe kërkohet fillimi i ndërtimit sipas prioritetit
- Bashkëpunimi me MEI dhe me Albgaz, në aspektin rregullator, për të gjitha problemet që hasen për hapjen e tregut të gazit natyror
- Bashkëpunimi me institucionet Kombëtare dhe Ndërkombëtare për problemet e gazit, marja pjesë në studimet e tyre dhe mundësia e thithjes së investimeve të huaja për zhvillimin e infrastrukturës në vëndin tonë.

6. MBI RAPORTIMIN E ERE-S NË LIDHJE ME ZBATIMIN DHE NDJEKJEN E PLOTËSIMIT TË REKOMANDIMEVE TË “REZOLUTËS SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË PËR VITIN 2018”.

Në zbatim të pikës 1 të Kapitullit 2 të “Manualit të monitorimit vjetor dhe periodik” miratuar me vendimin nr. 134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë dhe “Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2018”, ERE ka raportuar përgjatë vitit 2019 lidhur me punën e kryer për ndjekjen, zbatimin e plotësimin e rekomandimeve dhe detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2019, në mënyrë periodike si më poshtë vijon:

- *Në lidhje me pikën 1 të Rezolutës - Të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për marrjen e masave të nevojshme për monitorimin e ndarjes së OSHEE sh.a. sipas parashikimeve ligjore. Proces i cili shoqërohet me ndarjen ligjore, funksionale dhe organizative ndërmjet aktivitetit të shpërndarjes dhe Furnizuesit Universal. Nga ana tjetër, të vijojë ndarja e aktiviteteve, llogarive dhe kostove midis Furnizuesit të Mundësisë së Fundit dhe aktiviteteve të tjera, duke mundësuar shërbim të sigurt, kompetitiv, transparent dhe me cilësi të klienteve fundorë.*

Në kuadër të reformës në sektorin e energjisë dhe në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015, “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar me ligjin nr. 7/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, VKM Nr. 519, datë 13.07.2016, “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, si dhe të Urdhërit Nr.157, datë 12.02.2018, të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë OSHEE sh.a, mbi “Krijimin e tre shoqërive të kontrolluara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, me qëllim fillimin dhe çuarjen përpara të procesit të ndarjes, OSHEE sh.a. ka themeluar tashmë tre shoqëri si më poshtë: “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.), “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.) dhe “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. (FTL sh.a.).

Bordi i ERE me vendimin Nr. 264, datë 20.12.2018, vendosi për “Përcaktimin e një periudhe tranzitore prej 12 muaj, për bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a), tek shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (O.S.SH sh.a); miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 216, datë 11.10.2018; Transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), tek

shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a. (FSHU sh.a.) miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 215, datë 11.10.2018. Me Vendimin nr. 211, datë 18.12.2019, Bordi i ERE vendosi të miratojë kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e periudhës tranzitore të sipërcituar deri në datën 31.12.2019, për bërjen efektive të transferimit të këtyre licencave .

Masa e mësipërme u mor, në kushtet kur u konstatua se në vijim të punës përgatitore të OSHEE sh.a. për procesin e ndarjes së shoqërisë, si dhe në kuadër të orientimeve, takimeve, diskutimeve të zhvilluara në zbatim të Urdhrit nr. 341, datë 17.09.2019, "Për ngritjen e grupit të punës për ndarjen e OSHEE sh.a.", të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, OSHEE sh.a rezultoi se ishte në pritje të ndryshimeve të nevojshme të akteve ligjore dhe nënligjore, në mënyrë që të vijohej me finalizimin e procesit të ndarjes së OSHEE sh.a. dhe që operatorët e krijuar të ishin plotësisht operativë në datën 01.01.2020.

Veprimet që lidhen me ndarjen ligjore dhe funksionale të OSHEE ndër të tjera përfshinin:

A. Ndarjen e llogarive.

Kjo nënkupton që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të mbajë llogari të veçanta financiare për aktivitetet e tjera të licencuara.

Nga ana tjetër më datë 26.11.2018, me vendimin nr. 244, u vendos "Për miratimin e sistemit të njehësuar dhe të standardizuar të llogarive për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike".

Gjatë procesit të miratimit të këtij dokumenti nga OSHEE u bënë me dije dhe evidentuan vështirësi që lidheshin me:

- detajimin e informacionit kontabël në shkallën që kërkon kuadri rregullator, ku parashikohen:
 - o Mungesa e një rregjistri të përditësuar të aktiveve afatgjata, i cili të mundësojë klasifikimin e tyre sipas funksionit dhe destinacionit në përputhje me kërkesat e listave të llogarive rregullatore
 - o Vështirësi që lidhen me organizimin e punës, i cili jo gjithmonë i përgjigjet asaj ndarje detyrash që kërkon evidentim të detajuar të zërave të kostove sipas listave të llogarive

Si të tillë, ERE duke marrë në konsideratë edhe kohën e nevojshme të implementimit vijojë të monitorojë procesin e pasqyrimin të llogarive të ndara.

B. Ndarja ligjore

Kërkonte që aktiviteti i shpërndarjes të ndahet nga aktiviteti i furnizimit duke u ushtruar këto dy aktivitete nga persona juridikë të ndryshëm.

Në këtë kuadër është realizuar krijimi i 3 shoqërive të sipërpërmendura, të cilat funksionojnë ligjërisht të ndara që nga 1 janari i vitit 2020. ERE gjatë vitit 2020 do të vijojë punën me qëllim përcaktimin e tarifave dhe çmimeve duke i identifikuar sipas aktiviteteve respektive të rregulluara si dhe operimin e tyre të ndarë si nga ana ligjore ashtu dhe nga ajo organizative e financiare.

Me fillimin e ushtrimit të aktiviteteve nga shoqëritë e krijuara nga OSHEE sh.a, ERE ka vijuar dhe do të vijojë punën për të monitoruar ndarjen funksionale të kompanive të licencuara sipas ligjislacionit në fuqi si dhe respektimin e kushteve të licencave përkatëse.

Duke filluar nga data 1 Janar 2020 kompanitë ushtrojnë veprimtaritë të ndara sipas përcaktimeve të Ligjit të Sektorit si dhe VKM-së nr.244, datë 30.03.2016 duke mundësuar një qasje të drejtë në hapjen e tregut të energjisë elektrike në vënd.

- ***Të luajë një rol proaktiv për rishikimin e akteve ligjore dhe nënligjore respektive, gjatë periudhës tranzitore, për bërjen efektive të ndarjes ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.***

Ministria e Infrastukturës dhe Energjisë me Urdhërin e Ministrit nr. 341 datë 17.09.2019 ngriti grupin e punës për analizimin dhe vlerësimin e zgjidhjeve ligjore për finalizimin e procesit të ndarjes së shoqërisë OSHEE sh.a. pjesë e të cilës ka qënë dhe operatorët dhe po ashtu dhe ERE.

ERE ka qënë pjesë aktive e këtij Grupi pune duke shprehur qëndrimet lidhur me ndryshimet e mundshme nënligjore, kryesisht VKM-ve të cilat mbështeten ndarjen e OSHEE sh.a. sipas parashikimeve të Ligjit 43/2015, i ndryshuar por dhe duke ndërmarrë ne po këtë prizëm dhe me autoritetin e saj hapat e mëposhtëm.

- Me vendimin nr. 198, datë 3.9.2018, ka liçencuar shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a”, (FTL sh.a.) në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike”;
- Me vendimin nr. 199, datë 3.9.2018, ka licencuar shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a” (FTL sh.a.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”;
- Me vendimin nr. 215 datë 11.10.2018, ka transferuar liçencën e furnizimit energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, dhe detyrimin të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, te shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.” (FSHU sh.a.)”
- Me vendimin nr. 216, datë 11.10.2018, ka transferuar liçencën për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 96 datë 27.10.2014, te shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a., e vlefshme deri në datën 27.10.2044.”

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 883, datë 27.12.2019, në përputhje dhe me konkluzionet e Grupit të Punës, u miratuan disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.244, datë 30.3.016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të liçencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar. ERE ishte pjesë aktive e grupit të punës tëngritur me përfaqësues të MIE dhe operatorëve OSHEE, KESH dhe OST për përpilimin e kësaj VKM-je me ndryshimet e nevojshme për ndarjen funksionale të OSHEE sh.a. në aktivitete të ndara tëfurnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

- *Ndër ndryshimet që solli kjo VKM vlejné per tu sjellë ne vëmendje ato që lidhen me nenin 11, pika 2 të VKM-së nr. 883, datë 27.12.2019, në të cilin është sanksionuar se Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE. Dispozita më sipër, transferoi detyrimin e shërbimit publik nga shoqëria OSHEE sh.a. tek shoqëria FTL sh.a. Tashmë e krijuar dhe funksionuale që nga janari 2020.Vlen për tu sjellë në vëmendje se edhe Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë iu ngarkua gjithashtu shoqërisë FTL sh.a., me ndryshimet që prodhoi Vendimi i sipërcituar Këshillit të Ministrave fakt që kërkon dhe ndryshimin e marrëveshjeve me prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike.*

- ***Të vijojë bashkëpunimin me aktorët e mandatuar për operimin dhe monitorimin e Bursës së Energjisë.***

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 883, datë 27.12.2019, në përputhje dhe me konkluzionet e grupit të punës, u miratuan disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 244, datë 30.3.016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar. ERE ishte pjesë aktive e grupit të punës, të ngritur me përfaqësues të MIE-s dhe operatorëve OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., për përpilimin e kësaj VKM-je me ndryshimet e nevojshme për ndarjen funksionale të OSHEE sh.a. në aktivitete të ndara të furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Ndër ndryshimet që solli kjo VKM vlejné për t’u sjellë në vëmendje ato që lidhen me nenin 11, pika 2 të VKM-së nr. 883, datë 27.12.2019, në të cilin është sanksionuar se detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE. Dispozita më sipër, transferoi detyrimin e shërbimit publik nga shoqëria OSHEE sh.a. tek shoqëria FTL sh.a., tashmë e krijuar dhe funksionale që nga janari 2020. Vlen për t’u sjellë në vëmendje se edhe detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë iu ngarkua gjithashtu shoqërisë FTL sh.a., me ndryshimet që solli Vendimi i sipërcituar i Këshillit të Ministrave, fakt që kërkon dhe ndryshimin e marrëveshjeve me prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike.

- ***Të vijojë bashkëpunimin me aktorët e mandatuar për operimin dhe monitorimin e Bursës së Energjisë***

Me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 609, datë 11.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në Operatorin e Tregut” janë përmbushur tashmë kushtet ligjore për fillimin e procesit të krijimit dhe operimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe ka filluar procedura e përzgjedhjes së aksionerëve të bursës dhe ofruesit të shërbimit me eksperiencë në këtë fushë. ERE ka qenë pjesë përbërëse aktive e Komitetit Drejtues, të ngritur me palët e interesit, për të diskutuar hapat që duhen ndërmarrë për krijimin dhe funksionimin e bursës, si dhe problematikat që duhen trajtuar nga palët e interesit për ta bërë më funksional këtë operim.

Po ashtu, ERE, në bashkëpunim me MIE-n dhe OST sh.a., si palë e caktuar drejtpërdrejt për krijimin e këtij operatori, si dhe në bashkëpunim me rregullatorin e Kosovës, ka vijuar takimet e përbashkëta të grupeve të punës për lehtësimin e kuadrit rregullator për operimin efikas të bursës në të dyja vendet dhe përcaktimin e hapave që duhen ndërmarrë për operimin sa më efikas të saj. Këto takime kanë konsistuar në vlerësimin teknik dhe rregullator të të dyja vendeve, për të marrë masat e duhura tekniko-organizative për përafrimin e kuadrit rregullator të të dyja vendeve, për të mundësuar operimin e bursës, e cila do të krijohet me pjesëmarrjen e të dy operatorëve të sistemit dhe do të shërbejë e operojë në të dyja vendet njëkohësisht.

Grupet e përbashkëta të punës, në përputhje me memorandumun e nënshkruar midis palëve, të asistuar dhe nga një konsulencë e USAID-it, kanë identifikuar tashmë fushat në të cilat nevojitet ndërhyrje, si nga ana e rregullatorit, ashtu dhe nga ana e operatorëve, që kanë të bëjnë me njohjen reciproke të licencave, përpilimin e rregullave të njëjta të tregut për të dyja vendet, operimin e sistemit si një zonë kontrolli e përbashkët etj.

- ***Të propozojë ndryshimet e nevojshme pranë MIE-s për zbatimin e kërkesave të certifikimit të operatorëve të transmetimit në përputhje me opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë***

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 47, datë 19.03.2019, vendosi të miratojë kërkesën e OST sh.a për shtyrjen e afatit të zbatimit të pikës 2, të vendimit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, deri në datën 15.12.2019.

Një vendimmarrje e tillë erdhi si rezultat i konstatimit të rrethanave që kanë penguar OST sh.a të përmbushë detyrimet e përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

OST sh.a. ka bërë me dije më herët se i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me propozimin për ndryshime në ligjin 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, që do të çonin në përmbushjen e kushtit të vendosur në vendimin e sipërcituar të Bordit të ERE-s, që lidhet me *bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Ekonomisë*. Në kuadër të angazhimeve që Shqipëria ka marrë si vend nënshkrues i Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe detyrimeve që rrjedhin nga Direktiva 72/2009 e Komunitetit Europian, i është kërkuar OST sh.a. informacion në lidhje me ecurinë e këtij procesi dhe statusin e shqyrtimit të kërkesës së OST sh.a nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

ERE, në konsultim dhe me MIE-n dhe OST sh.a., ka marrë dijeni dhe ka punuar për draft-propozimin për ndryshimet ligjore, të cilat i shërbejnë qëllimit të plotësimit të kushteve për certifikimin e OST sh.a., të cilat janë gjetur konform dhe nga ana e Sekretariatit të Energjisë në Vjenë. Ndryshimet në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, po shqyrtohen aktualisht nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, dhe pritet të kalojnë në Parlament. Ndryshimet në ligjin nr. 43/2015 plotësojnë të gjitha kushtet e vendosura në vendimin e certifikimit të OST sh.a., sa shprehur më sipër, dhe janë, po ashtu, në përputhje me rekomandimet e Sekretariatit të Energjisë lidhur me këtë çështje.

Gjendur në këto kushte dhe në vijim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria OST sh.a, Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 207, datë 16.12.2019, vendosi të miratojë kërkesën e shoqërisë së OST sh.a, për shtyrjen e afatit të zbatimit të pikës 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, deri në datën 16.06.2020.

Me vendimin nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” Albgaz sh.a.”, Bordi i ERE-s ka vendosur miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Kombinuar të gazit natyror Albgaz sh.a., në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 EC, duke përcaktuar kushtet përkatëse të certifikimit që duhet të plotësojë shoqëria Albgaz sh.a. Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, duke vlerësuar kërkesën e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe faktin që kjo

e fundit ka bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për përmbushjen e kushteve të certifikimit, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 236, datë 02.11.2018, si dhe vendimin nr. 63, datë 23.04.2019, vendosi të rishikojë vendimin nr. 179, datë 08.11.2017 Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” për sa i përket kushteve të certifikimit dhe afatit të plotësimit të tyre.

Sa më sipër konstatuar, ERE gjatë vitit 2019 ka vijuar korrespondencat edhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, së cilës i ka kërkuar të fillojë procedurat për ndryshimet e duhura në aktet që përcaktojnë pronësinë e Albgaz sh.a., në përmbushjen e kushteve të vendimit të certifikimit, që lidhen me zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albgaz sh.a., si dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, Neni 11 dhe 46 (10) i ligjit për sektorin e gazit natyror, dhe transferimi i kompetencave tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke qenë se pika 3 e VKM-së nr. 848, datë 07.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a dhe përcaktimin e Autoritetit Publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetrol sh.a dhe Albgaz sh.a” është ndryshuar me VKM nr. 108, datë 23.02.2018, “Për një ndryshim në VKM nr. 848, datë 07.12.2016”, “Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a dhe përcaktimin e Autoritetit Publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Albpetrol sh.a dhe Albgaz sh.a”.

Duke e konsideruar certifikimin e Albgaz sh.a., me mjaft rëndësi në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, dhe të pasojave që mund të shkaktohen në funksion të pjesëmarrjes së Albgaz sh.a. në rrjetin ENTSO-G, Rrjetin Evropian të Operatorëve të Transmetimit të Gazit Natyror, si dhe duke vlerësuar se sa më sipër janë detyra, zbatimi i të cilave shkon përtej vullnetit të shoqërisë, i është kërkuar MIE-s që të merren masat për ndryshimet e nevojshme të pronësisë ndërmjet shoqërive Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a. për përmbushjen e kushteve të certifikimit të operatorit të sistemit të gazit.

- ***T'i kushtojë një vemendje të veçantë implementimit të planit të masave nga OSHEE sh.a. në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, si dhe përditësimit të tij në funksion të problematikave që kanë dalë përgjatë zbatimit të tij, duke u fokusuar në zgjidhjen e ankesave të klientëve në një kohë sa më të shkurtër. Lidhur me zbatimin e tij, të monitorojë në mënyrë periodike, çdo tre muaj, OSHEE-në dhe të informojë çdo katër muaj Kuvendin e Shqipërisë.***

Për implementimin e këtij plani masash, nga ERE u ngrit grupi i punës “Mbi monitorimin pranë zyrave të OSHEE sh.a., lidhur me masat e marra për zbatimin e planit të masave”.

Nga monitorimi i kryer u konstatua si më poshtë vijon:

- Shoqëria OSHEE sh.a. ka bërë një punë shumë të mirë në lidhje me përmirësimin dhe shkurtimin e kohës së kthimit të përgjigjeve për ankesat e adresuara tek OSHEE sh.a nga të gjitha kanalet e komunikimit, si dhe ka ulur ndjeshëm numrin e ankesave të patrajuara ndër vite.
- Kushtet e punës të qendrave të Kujdesit Ndaj Klientit, të ngritura rishtazi apo atyre ekzistuese, rezulton se përmbushin përgjithësisht kushtet dhe standardet e punës.
- Në lidhje me eficiencën në dhënien e shërbimeve, OSHEE sh.a. ka miratuar procedura të brendshme, të cilat parashikojnë modalitetet e veprimit të stafit të strukturave të trajtimit të kërkesave/ankesave, si dhe afatet e procesimit të tyre. Nga verifikimi i ankesave dhe kërkesave me përzgjedhje, rezulton se këto afate dhe procedura respektohen përgjithësisht.
- Sa i përket transparencës në dhënien e informacionit të domosdoshëm për klientët, referuar verifikimeve të bëra nga grupi i punës, si nëpërmjet personave të ngarkuar me detyrën e

raportimit gjatë monitorimit, ashtu edhe nëpërmjet verifikimit të shërbimit call center, rezulton se punonjësit e OSHEE sh.a, përgjithësisht kanë dhe janë në gjendje të japin informacionin e domosdoshëm mbi kërkesat që iu adresohen.

- Sa i përket të drejtës për informacion, afishimit dhe publikimit të të dhënave të domosdoshme për klientët, si detyrim i operatorit të shpërndarjes edhe në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit universal apo/edhe furnizues i mundësisë së fundit, rezulton se në të gjitha KNK-të e verifikuara dhe mbështetur në setin e dokumentacionit informues (broshura), të vënë në dispozicion gjatë monitorimit, janë krijuar kënde të posaçme me informacion e broshura për shërbimet që ofrohen nga OSHEE sh.a.
- Në lidhje me kushtin që i licencuari duhet t'i bëjë të dukshme afatet dhe kushtet e përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet e tij me klientët në të gjitha zyrat e tij, t'i publikojë në faqen e tij të internetit dhe t'u japë klientëve mundësinë të marrin një kopje të dokumentit, rezulton se si në QNK-të e testuara, ashtu edhe në faqen zyrtare të OSHEE sh.a. ka mjaft informacion në lidhje me afatet dhe kushtet e përgjithshme që rregullojnë marrëdhënien e OSHEE sh.a. me klientët.

Gjatë zhvillimit të monitorimeve periodike, është rekomanduar që OSHEE sh.a. të përditësojë faqen e internetit të saj, lidhur me informacionin mbi tarifën e energjisë elektrike në fuqi dhe aktet e përditësuara në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Rezulton se faturat e energjisë elektrike të lëshuara nga OSHEE sh.a. kanë informacionin e nevojshëm sqarues për çdo klient lidhur me zërat e faturuar. ERE ka rekomanduar gjithashtu që OSHEE sh.a., në kuadër edhe të procesit të ndarjes, të vijojë punën për menaxhimin në nivel strukturor të marrëdhënieve me klientët, duke bërë një ndarje të detajuar të detyrave dhe përgjegjësi të strukturave të ngritura në funksion të mbarëvajtjes së kësaj marrëdhënieje.

Sa i përket detyrimit për publikimin e të dhënave mbi organizimin e njësisë së dedikuar për trajtimin e ankesave, duke përfshirë vendndodhjen, orët e punës, orët për takimet me klientët, numrin e telefonit të kontaktit, afatet dhe kushtet për lidhjen e klientëve me Rrjetin e Shpërndarjes, aplikimet për zbatimin e kushteve dhe procedurave për lidhjen e klientëve me Rrjetin e Shpërndarjes, në të gjitha zyrat e Kujdesit Ndaj Klientit të verifikuara rezulton se ka informacion të mjaftueshëm në lidhje me të dhënat e nevojshme e ato të domosdoshme sa i përket shërbimit ndaj klientit.

Gjithashtu, rezulton se sistemi i regjistrimit dhe trajtimit të ankesave i përditësuar së fundi, është i organizuar në mënyrë të qartë e që lejon kontrollin e verifikimit e çdo hallke të procesit të trajtimit të ankesave apo kërkesave, si dhe ndjekjen në afat të këtyre procesve. Në lidhje me procedurën sa më sipër për funksionimin e sistemit, ngelet e paqartë se si merr dijeni klienti për trajtimin e ankesës, pavarësisht së nëpërmjet pranimit të ankesës, mund të reflektohet ky pranim nëpërmjet sistemit të faturës pasardhëse. ERE ka kërkuar nga OSHEE sh.a. të dokumentojë informimin e çdo klienti ankues, si dhe rezultatit e trajtimit të ankesës nga OSHEE, si në rastin e pranimit të saj, ashtu edhe në rast refuzimi të saj.

ERE, pas zhvillimit të monitorimeve periodike, ka përcjellë me shkresë zyrtare në OSHEE sh.a. gjetjet e monitorimit, duke kërkuar zbatim më korrekt të planit të masave.

Gjatë vitit 2020, plani i masave i miratuar nga ERE do të kalojë në procesin e përditësimit, me qëllim përshtatjen e detyrave dhe përgjegjësi sipas fushës së veprimtarisë së të licencuarve. tashmë të shoqërive të ndara, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal.

- ***Të punojë, në bashkëpunim me aktorët e tjerë, nga njëra anë për nxitjen e investimeve në impiante të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, si centralet fotovoltaike, eolike, biomasë etj., investime të cilat sjellin edhe një diversifikim gradual të prodhimit të energjisë, dhe nga ana tjetër të bashkëpunojë me MIE për përgatitjen e kuadrit ligjor dhe rregullator për thithjen e tyre, si dhe uljen e kostove apo dhe shpërndarjen e drejtë të tyre te të gjithë klientët***

Pas miratimit të Udhëzimit nr. 3, datë 20.06.2019, të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”, si dhe në vijim të kërkesës së OSHEE sh.a. për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhues të energjisë elektrike nga dielli, ERE, me vendimin e Bordit nr. 152, datë 14.10.2019, ka vendosur fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, dhe ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 177 datë 08.11.2016, për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total deri në 500 kWp. Përveç tarifave për këtë kategori vetëprodhuesish, për miratimin e të cilave tashmë ka nisur procedura, do të mbahet në konsideratë nga operatorët e sistemit që të respektohen në çdo rast parimet mbi procedurat lehtësuese të parashikuara në udhëzimin nr. 3/2019, të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Për më tepër, Rregullorja e re e Bashkimit Evropian, e cila do të transpozohet së shpejti dhe në vendet e traktatit të energjisë, e ka vënë theksin dhe i ka kushtuar shumë rëndësi kësaj kategorie klientësh/prodhuesish, duke rritur të drejtat e tyre në operimin në tregun e energjisë elektrike.

Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 234, datë 20.12.2019 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 08.11.2016 të Bordit të ERE-s, për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhues të energjisë elektrike nga dielli”, vendosi të miratojë tarifat për lidhjen e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet të instaluar deri në 500 kW.

Shoqëria OSHEE sh.a., ka paraqitur kërkesën “Për miratimin e propozimit mbi caktimin e tarifave për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total deri në 500 kWp”, në zbatim të detyrave që rrjedhin nga Udhëzimi nr. 3, datë 20.06.2019, i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”.

Specifikimet e posaçme që Udhëzimi nr. 3, datë 20.6.2019 “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”, ka dhënë në lidhje me aksesin e lehtësuar për këtë kategori, lidhet me faktin që rregullat për aksesin e kësaj kategorie në rrjet, duhet të jenë të ngjashme me ato për lidhjet e reja, të miratuara me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin nr.177 datë 08.11.2016 të Bordit të ERE-s. Në konstatim të sa propozuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 152, datë 14.10.2019, u vendos fillimi i procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, ndryshuar me vendimin nr. 177 datë 08.11.2016 të Bordit të ERE-s, për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total deri në 500kW”.

Pas shterimit të procesit të konsultimit me palët e interesit e zhvillimit të seancave degjimore me përfaqësues të OSHEE sh.a dhe palë interesi, ERE konkludoi se Tarifa T1 (Tarifa e studimit dhe vlerësimit të miratimit të projektit) duhet të jetë e njëjtë në vlerë me atë të përcaktuar në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, ndryshuar me vendimin nr. 177 datë 08.11.2016 të Bordit të ERE-s, sipas niveleve përkatëse të tensionit ku realizohet lidhja me sistemin e shpërndarjes e vetëprodhuesve të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total të instaluar deri në 500 kWp.

Tarifa T2 (Tarifa e distancës) e lidhjes me sistemin e shpërndarjes e vetëprodhuesve të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total të instaluar deri në 500 kWp duhet të jetë 0 lekë, siç edhe propozuar nga shoqëria OSHEE sh.a.

Tarifa T3 (Tarifa e fuqisë) e lidhjes me sistemin e shpërndarjes e vetëprodhuesve të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total të instaluar deri në 500 kWp duhet të jetë 0 lekë, siç edhe propozuar nga shoqëria OSHEE sh.a.

T4 (Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjeve të reja dhe matjes), duhet të jetë e njëjtë në vlerë me atë të përcaktuar në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 08.11.2016 të Bordit të ERE-s.

Kjo tarifë përbëhet nga këta komponentë:

- 1) Tarifë për azhornimin e rrjetit ... 1500 lekë
- 2) Shpenzime administrative 1000 lekë
- 3) Tarifa për verifikimin/kolaudimin fillestar të matësve - monofazë - trefazor ku tarifa për verifikimin/kolaudimin fillestar të matësit, duhet të përcaktohet në zbatim të parashikimeve të nenit 77, pika 8, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

OSHEE sh.a. nuk paraqiti propozime për tarifat T1, T2, T3, T4 në rastin e shtesës së fuqisë, modifikimit të lidhjes ose transferimit, e në këto kushte ERE vlerësoi të drejtë që vlera respektive e tyre duhet të jetë 0 lekë.

Në vendimmarrjen e sipërcituar nr. 234, datë 20.12.2019, ERE vendosi gjithashtu se në kushtet kur do të aplikohet njëkohësisht për lidhje të re me rrjetin e shpërndarjes dhe lidhje për impiantet vetëprodhuese fotovoltaike me kapacitet total të instaluar deri në 500 kWp (p.sh. banesë e re e saponërtuar dhe e pajisur me impiant vetëprodhues të energjisë elektrike nga dielli apo biznes i porsangritur që ka montuar/planifikon montimin e impiantit fotovoltaike që në momentin e projektimit/hartimit të plan biznesit), tarifa T4 do të paguhet vetëm një herë.

Gjithashtu, ERE i është drejtuar me shkresë zyrtare OSHEE sh.a. dhe OST sh.a. lidhur me rishikimin e Kodit të Rrjetit të Shpërndarjes dhe Kodit të Matjes, për të plotësuar edhe kërkesat e udhëzimit të lartpërmendur. MIE, OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. kanë shprehur opinionet e tyre dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar për realizimin e ndryshimeve të kërkuara, duke bërë me dije se për përgatitjen e Kodit të Shpërndarjes, OSSH do të angazhojë një konsulencë me përvojë ndërkombëtare për draftimin e tyre. Përsa i takon Kodit të Matjes, MIE ka përgatitur termat e referencës për marrjen e një konsulence ndërkombëtare dhe ka ndërmarrë hapat për mbledhjen e komisionit të rishikimit të Kodit të Matjes.

Lidhur me draft-metodologjinë e propozuar nga MIE “Për përcaktimin e çmimit të energjisë së prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, me fuqi të instaluar deri 2MWp”, ERE ka dërguar vlerësimet e saj pranë MIE-s, duke marrë në konsideratë si më poshtë vijon:

- o Metodologjia të adresojë mundësinë e axhustimit të periudhës së mbështetjes së këtyre prodhuesve me “feed-in tariff” në mënyrë periodike, në varësi të parametrave realë që këta prodhues do të kenë përgjatë ndërtimit dhe operimit të impianteve.
- o Të qartësojë mënyrën e përdorimit të ndihmës shtetërore për mbështetjen financiare që do t’u jepet këtyre prodhuesve dhe nëse do të ketë një të tillë.
- o Metodologjia e propozuar të japë një analizë për tarifën e propozuar për vetëprodhuesit e energjisë elektrike.
- o Draft-metodologjia e propozuar të përcaktojë kriteret e llogaritjes së çmimit për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e erës me kapacitet të instaluar deri në 3 MW.

Në kushtet e hapave që po ndërmerren për krijimin e tregut të energjisë elektrike, mund të ishte më e përshtatshme llogaritja e “feed-in tariff” bazuar mbi çmimin e tregut që i korrespondon të njëjtit profil të gjenerimit të energjisë elektrike (p.sh. HUPLEX/HUDEX ose IBEX apo SEEPLEX) deri në operimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, plus një bonus si incentivim për këta prodhues. Duke marrë në konsideratë se kjo metodologji është aktualisht në përdorim në vendin tonë për prodhuesit e vegjël të energjisë nga burimet hidrike, sipas VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, mendojmë se një propozim i tillë do të shërbente dhe për nxitjen e hapjes së tregut të energjisë elektrike në vendin tonë.

- ***Të bashkëpunojë me MIE për kryerjen e një vlerësimi për menaxhimin e riskut hidrologjik në mënyrë që të menaxhohen risqet e rritjes së kostove të furnizimit të energjisë elektrike për klientët fundorë, për shkak të kushteve klimatike, si dhe të konsiderojë mundësinë e krijimit të një fondi garancie nga KESH me përfitimet financiare të nxjerra gjatë një viti hidrologjik të mirë, të cilat mund të kompensojnë riskun financiar të një viti hidrologjik jo të mirë***

Sa i përket kësaj detyre, ERE gjatë seancave dëgjimore për qëllime të shqyrtimit të marrëdhënies mes OSHEE sh.a./FSHU sh.a./FTL sh.a. dhe KESH sh.a. në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e sigurimit të sasisë së nevojshme të energjisë për OSHEE sh.a./FSHU sh.a./FTL sh.a., si i ngarkuar me detyrimin e furnizuesit universal, ka orientuar KESH sh.a. për marrjen e masave për krijimin e një fondi garancie që të shërbejë për të kompesuar riskun financiar të një viti hidrologjik jo të mirë. Në lidhje me sa më sipër, KESH sh.a. ka bërë me dije se do t’i propozojë Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë krijimin e një fondi të tillë, si dhe mënyrën e menaxhimit të tij për të siguruar uljen sadopak të riskut hidrologjik në vit të thatë.

ERE do të vijojë komunikimet me KESH sh.a. dhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e aksionarit të KESH.sh.a., me qëllim përmbyshjen e një detyrimi të tillë.

Ndyshimet e VKM-së nr. 244/2016 me VKM-në nr. 883, datë 27.12.2019, kanë mundësuar po ashtu që edhe shoqëria FTL sh.a. të kontribuojë në menaxhimin e riskut hidrologjik për garantimin e furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë.

- ***T’i kushtojë vëmendje të veçantë, gjatë vitit 2019, implementimit të strukturës së miratuar dhe rekrutimit të një stafi sa më të aftë profesionalisht për përballimin e sfidave të sektorit të energjisë dhe gazit natyror, profesionalizmi i stafit ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së punës dhe pavarësisë operacionale të ERE-s***

Pas miratimit, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 02.04.2019, të strukturës organizative të Entit Rregullator të Energjisë, si dhe në vijim të miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë të Rezolutës mbi veprimtarinë e ERE-s gjatë vitit 2018, ERE, me vendimin e Bordit nr. 144, datë 30.09.2019, ka miratuar Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të ERE-s, e cila ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e stafit sipas organigramës së re të miratuar. Gjithashtu, ERE ka marrë masa për implementimin e saj dhe po punohet për draftimin e kodit etik dhe sjelljes së personelit teknik, si dhe vijimin e procesit për rekrutimin e personelit sipas legjislacionit në fuqi.

Me qëllim plotësimin e strukturës organizative të ERE-s, përgjatë vitit 2019 janë marrë masat për rekrutimin e stafit të nevojshëm në përputhje me Ligjin “Për nëpunësin civil” dhe po ashtu janë duke vazhduar dhe konkurset për pozicionet e punës, të cilat do të shtrihen përgjatë vitit 2020, për të përmbushur detyrimin në fjalë. Aktualisht struktura e ERE-s është plotësuar nga një personel prej 50 punonjësish, të punësuar në pozicionet përkatëse.

- ***Të vazhdojë punën së bashku me entet rregullatore të Italisë dhe Greqisë për marrjen e vendimeve dhe nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse për projektin TAP-AG dhe krijimin e kushteve për hapjen e tregut të gazit natyror në vendin tonë, në përputhje me direktivën 2009/73/EC dhe Rregulloren 715/2009, EC***

ERE, me vendimin nr. 95, datë 17.06.2019, ka miratuar “Udhëzuesin për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik Pipeline”. Udhëzimi i miratuar lidhet me parimet e përmendura tek Opinioni Përfundimtar i Përbashkët (Final Joint Opinion), tek Mekanizmi i Alokimit të Kapacitetit të Kodit të Rrjetit, si dhe tek legjislacioni në fuqi në vend dhe nuk paraqet pengesa të panevojshme për procesin që parashikohet për ndërtimin e kapacitetit në rritje. Procesi i testimit të tregut është hartuar në mënyrë të tillë që të lehtësojë bashkëpunimin me OST fqinje, në mënyrë që të sigurojë zhvillimin e koordinuar të rrjetit, duke shmangur mospërputhjet e mundshme në ndërtimin e kapacitetit ndër kufitar.

Në vijim të sa më sipër dhe pas kërkesës së shoqërisë Albpetrol sh.a. për pjesëmarrje në testimin e tregut, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 149, datë 04.10.2019, është shprehur mbi kërkesën e shoqërisë Albpetrol sh.a. për miratimin e aplikimit për pajtueshmërinë e kërkesave jodetyruese të kapacitetit për limitet e kapacitetit të ofruar në kuadër të pjesëmarrjes në testimin e tregut në zbatim të parashikimeve të udhëzuesit për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatic Pipeline (TAP AG), miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 95/2019.

Gjithashtu, me Vendimin nr. 236 datë 20.12.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur fillimin e procedurës për miratimin e “Kodit të rrjetit të transmetimit të gazit natyror”, kod i cili do të miratohet gjatë vitit 2020.

- ***Të japë opinion për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe atë të Financave dhe Ekonomisë për gjetjen e rrugëve dhe zgjidhjeve për shuarjen e detyrimeve reciproke midis operatorëve publikë të sektorit të energjisë elektrike dhe marrjen e masave për parandalimin e krijimit të tyre në të ardhmen***

Ndër detyrat e përcaktuara për ERE-n për ndjekje dhe implementim gjatë vitit 2019, është edhe ajo që lidhet me rolin e saj këshillues për gjetjen e zgjidhjeve për shuarjen e detyrimeve reciproke midis operatorëve publikë të sektorit të energjisë elektrike dhe marrjen e masave për parandalimin e tyre në të ardhmen. Ndërkohë, me VKM nr. 253, datë 24.04.2019, është miratuar plani i konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjetik, i cili ka orientuar edhe në lidhje me masat që duhet të marrin operatorët e sektorit publik energjistik, për uljen dhe për shlyerjen e plotë të detyrimeve për borxhin e OSHEE sh.a. ndaj KESH sh.a.

Me qëllim marrjen e masave dhe dhënien e një opinioni edhe nga ERE, për të mundësuar shuarjen e detyrimeve sa më sipër, i është kërkuar zyrtarisht informacion shoqërive në lidhje me masën e këtyre detyrimeve, si dhe rakordimet e kryera mes palëve, duke vlerësuar kohën që kur kanë filluar të akumulohen këto detyrime dhe vlerën e debive të pranuar prej palëve, debi e krijuar për shkak të energjisë së lëvruar nga KESH sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë nga Furnizuesi i Shërbimit Universal OSHEE sh.a.

Në përgjigje të kësaj kërkese, KESH sh.a. ka bërë me dije se gjatë vitit 2019, marrëdhënia tregtare me OSHEE përsa i përket shlyerjes së detyrimeve korrente për shit-blerje të energjisë elektrike ka qenë korrekte dhe brenda afateve, duke mos krijuar borxh të ri gjatë kësaj periudhe. Përsa i përket detyrimeve të prapambetura që OSHEE sh.a ka ndaj KESH sh.a dhe i përkasin viteve 2011-2016, ndërmjet kompanive është nënshkruar tashmë marrëveshja me nr. 208 Rep, datë 06.04.2018 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. OSHEE sh.a. ka paguar këstin e parë në vitin 2018 sipas skedulit të kësaj marrëveshjeje dhe detyrimi i mbetur ndaj KESH sh.a. për këtë periudhë kohore është në vlerën rreth 50.8 miliardë lekë.

KESH sh.a. ka detyrim ndaj OSHEE sh.a. për kompensim për mosrealizim të kërkesës për energji për vitin 2017 në vlerën rreth 5.2 miliardë lekë, detyrim që buron nga VKM-ja nr. 244/2016, përpara se të ndodhnin ndryshimet e saj në fund të vitit 2017. Një ndër arsyet e ndryshimit të kësaj VKM-je ishte eliminimi i kostove shtesë të sektorit për furnizim me energji elektrike të klientëve tariforë. Ky detyrim është njohur nga KESH sh.a. në vitin 2019, si rezultat i faturës së prerë nga OSHEE sh.a. në mars të vitit 2018. OSHEE sh.a. nuk ka paguar gjatë vitit 2018 një pjesë të detyrimit korrent për blerje energjie për klientët tariforë dhe humbjet në vlerën totale rreth 2.8 miliard lekë, në fillim me argumentin e vështirësive financiare që kishte kompania e më pas për shkak të pretendimit të kompensimit që kishte ndaj KESH sh.a. Gjatë muajit shtator 2019 është prerë për llogari të OSHEE sh.a. faturë për vlerën e penaliteteve për vonesat në pagesa për vitin 2015 në vlerën rreth 2.1 miliardë lekë.

Përveç detyrimeve për energjinë, OSHEE sh.a. i detyrohet KESH sh.a. dhe për huatë afatgjata për këste të papaguara ndër vite, në zbatim të marrëveshjes së nënshkruar më 10 mars 2009 “Marrëveshja e ripagimit të kredive afatgjata”, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), sot OSHEE sh.a. e cila përmban dhe Aneksin 1, ku sipas skeduleve të çdo kredie të transferuar, janë përcaktuar vlerat e principaleve dhe interesave që duhen paguar në periudhat e caktuara.

Duke qenë se detyrimet e prapambetura të OSHEE sh.a. për energjinë janë të skeduluara për pagesë, nisur dhe nga fakti që ekzistojnë detyrime të ndërsjella KESH sh.a. - OSHEE sh.a. - MFE, KESH sh.a. propozon se mënyra me e përshtatshme është netimi tripalësh për huatë afatgjata. Marrëdhënia tregtare mes KESH sh.a. ka me OST sh.a. është përmirësuar gjatë vitit 2019, në drejtimin e pagesave të bëra nga OST sh.a., kryesisht për faturat e shërbimeve ndihmëse dhe energjisë së blerë për humbjet në rrjetin e transmetimit, duke shlyer dhe detyrime të prapambetura të akumuluar deri në dhjetor të vitit 2018 për këto zëra. Për energjinë e blerë nga OST për disbalanca dhe për shërbimin e balancimit, detyrime të cilat kanë dhe vlerën më të madhe në totalin e borxhit, nga kjo kompani nuk bëhen pagesa ndaj KESH sh.a., duke akumuluar kështu detyrime për këto dy zëra që nga viti 2016, në vlerën 4.2 miliardë lekë.

Gjatë vitit, ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a. kryhen netime mujore të vlerave për zërat e njëjtë për faturat e disbalancave dhe të shërbimit të balancimit.

Po në këtë kuadër, me financim të Bankës Botërore, pranë MIE janë duke u zhvilluar procedura për marrjen e konsulencave për gjetjen e zgjidhjeve për shlyerjen e këtij borxhi apo dhe marrjen e

masave për parandalimin e tyre në të ardhmen. ERE ka bashkëpunuar ngushtë me MIE për përpilimin e termave të referencës dhe ka shprehur gatishmërinë për pjesëmarrjen në Komitetin Drejtues që do të shqyrtojë propozimet e konsulentit dhe do t'i përcjellë ato më tej për palët e interesuara, si MEF, Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve etj.

- ***Të punojë për hartimin e një strategjie për infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë, në përputhje me direktivën e BE-së “Mbi sigurinë e sistemit dhe sistemeve informatike”, duke përfshirë në listën e këtyre infrastrukturave dhe infrastrukturat e kompanisë publike të gjenerimit apo dhe impiantet private të gjenerimit, të cilat mund të kenë impakt në sigurinë territoriale***

Në vijim të kësaj detyre të lënë nga rezoluta, ERE i është drejtuar shoqërive KESH sh.a., OSHEE sh.a. dhe OST sh.a. me shkresën nr. 495 prot, datë 30.07.2019, në të cilën ka sjellë në vëmendje të operatorëve se në korrik të vitit 2016, BE-ja ka miratuar Direktivën nr. 2016/1148 “Mbi Sigurinë e Sistemit dhe Sistemeve Informatike” (NIS), e njohur ndryshe dhe si Direktiva mbi Cybersecurity. Duke qenë se zbatimi i kësaj direktive është i një rëndësie të veçantë për Komitetin e Traktatit të Energjisë së Vendeve të Evropës Juglindore, pjesë e të cilit është dhe Shqipëria, nga ana e Sekretariatit të Energjisë, po ashtu dhe nga ana e USAID, me ndihmën e NARUC, me rregullatorët dhe operatorët rajonalë po ngrihen grupe pune për mbledhjen e informacioneve lidhur me masat e marra për zbatimin e kësaj direktive. ERE ngriti një grup pune për përgatitjen e strategjisë për infrastrukturën kibernetike, si dhe një pyetësor, i cili iu është drejtuar kompanive të sektorit të energjisë elektrike dhe atyre të sektorit të gazit natyror, që janë pjesë e infrastrukturave kritike, për të monitoruar dhe parë stadin aktual të njohurive apo dhe masat që duhen ndërmarrë nga këta operatorë për parandalimin e ndërhyrjeve kibernetike apo dhe investimet e nevojshme që duhen bërë për këtë qëllim.

Në këtë prizëm i është kërkuar informacion kompanive në lidhje me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo direktivë për sigurinë e sistemeve informative, si dhe për ruajtjen e të dhënave konfidenciale të klientëve.

KESH sh.a., ka bërë me dije se procesi i digjitalizimit është bërë pjesë përbërëse e domosdoshme, si në drejtim të realizimit të prodhimit, tregimit dhe mirëmbajtjes, ashtu edhe për pjesën tekniko-administrative. Në këtë kuadër, shoqëria ka ngritur dhe operon disa sisteme informatike, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin financiar, burimet njerëzore, dokumentacionin administrativ, monitorimin e prodhimit dhe të faktorëve hidrometeorologjikë, të dhënave hidrike etj.

Në vijim, gjithashtu edhe OST sh.a. ka bërë me dije se ka patur në fokus dhe ka ndërmarrë masa të rëndësishme për forcimin e gjendjes së sigurisë kibernetike, të cilat çojnë në eliminimin e efekteve të rreziqeve për Sigurinë Kombëtare. Po ashtu, shoqëria ka bërë me dije se është në fazën e rishikimit të rregullave dhe procedurave që duhet të ndiqen gjatë projektimit, instalimit dhe funksionimit të sistemeve, rrjeteve ose platformave të përdorura në mënyrë që të garantohet:

- a) siguria, integriteti dhe mirëmbajtja e funksioneve të sistemeve informatike dhe platformave teknologjike;
- b) krijimi i një sistemi të mbrojtjes kibernetike për infrastrukturën kritike të identifikuar nga AKCESK dhe platforma informatike të tjera të rëndësishme në përdorim;
- c) krijimi i një strukture (framework) me përjasje të përbashkët gjithëpërfshirëse në lidhje me menaxhimin e riskut të sigurisë dhe “Business Continuity and Disaster Recovery Planning”.

OSHEE sh.a. ka bërë me dije se referuar ligjit nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike” dhe VKM nr. 222, datë 26.04.2018 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit” dhe duke konsideruar që sistemi SCADA i

implementuar pranë OSHEE sh.a. është pjesë përbërëse e listës së infrastrukturës kritike të informacionit, janë marrë masa mbi përcaktimin e pikës së kontaktit me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, ku aktualisht është realizuar bashkëpunimi mbi aksesimin e “Sistemit të menaxhimit të raportimit të incidenteve të sigurisë kibernetike” për raportimin e incidenteve dhe shpërndarjen e informacioneve dhe njoftimeve për vulnerabilitetet apo kërcënimet e mundshme nga pikat e kontaktit të ndodhura në infrastrukturën e sistemit SCADA OSHEE sh.a.

Në bashkëpunim me agjencinë kombëtare AKCESK dhe AKSHI-n janë marrë masa të sigurisë bazuar edhe në direktivat e European Union Agency for Cyber Security (ENISA) dhe asistencës në nivel kombëtar në rastet e sulmeve apo incidenteve në fushën e sigurisë kibernetike për sistemin SCADA, të implementuar pranë OSHEE sh.a.

Sistemi SCADA është bazuar në standardet europiane ISO/IEC 27001, ISO/IEC 20000-1. Këto politika të sigurisë kibernetike janë implementuar në sistemin SCADA, në drejtim të sigurimit të Data Center, aksesit fizik dhe kibernetik, sigurimit të qendrës dispeçer dhe sistemit backup, si dhe sigurimit të marrjes së të dhënave nga nënstacionet në bazë të protokolleve të standardizuara të komunikimit për sistemin SCADA. Implementimi i politikave të sigurisë për pajisjet transmetuese të të dhënave, duke ofruar një rrjet transmetues të mbyllur dhe të sigurtë, përcaktimi i mënyrës së aksesimit nga palët e treta në rast ofrimi të suportit teknik janë në fokus të shoqërisë. Janë marrë masat e nevojshme mbi implementimin dhe operimin e sistemit qendror SCADA pranë kompanisë OSHEE sh.a. bazuar në standardet dhe certifikatat ndërkombëtare.

Në vijim, shoqëritë kanë sjellë pyetësorët e plotësuar në lidhje me informacionin e kërkuar. Në këto kushte, Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 235, datë 20.12.2019, vendosi fillimin e procedurave për miratimin e “Strategjisë për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë elektrike”, vendim i cili është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s dhe i është dërguar palëve të interesit për mendim.

Aktualisht janë marrë komentet nga palët dhe nga konsulentët e huaj dhe strategjia është në fazën e miratimit të saj nga ana e ERE-s.

- ***Të bëjë vlerësimet e propozimeve të paraqitura nga OSHEE, pas përfundimit të "Studimit të vlerësimit të humbjeve të energjisë elektrike në traktin e lidhjes nga njësia gjeneruese deri në pikën e lidhjes me rrjetin e OSHEE sh.a.", lidhur me humbjet e OSHEE prej pikës së lidhjes së prodhuesve të energjisë***

ERE i është drejtuar zyrtarisht OSHEE sh.a. në lidhje me realizimin e studimit të vlerësimit të humbjeve të energjisë elektrike në traktin e lidhjes nga njësia gjeneruese deri në pikën e lidhjes me rrjetin e OSHEE sh.a. dhe ka kërkuar që OSHEE sh.a. të marrë masa serioze për përfundimin e studimit sa më sipër cituar dhe përcjelljen në ERE të propozimeve konkrete në lidhje me shmangien e problematikave të konstatuara, me qëllim zgjidhjen e tyre në të ardhmen, duke i ofruar dhe bashkëpunimin e saj.

Shoqëria ka sjellë pjesë të studimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, por gjatë komunikimeve dhe seancave me shoqërinë, kësaj të fundit ERE i ka kërkuar që të paraqesë studime të detajuara fizibiliteti tekniko-ekonomik, në mënyrë që kostot e investimeve për uljen e humbjeve në rrjet të jenë me koston më të vogël të mundshme, me qëllim shmangien e rritjes së tarifave për klientët fundorë, si dhe kostove të operimit të rrjetit. Procesi i uljes së humbjeve në rrjet nga ana e OSHEE sh.a. për të arritur targetat e vendosura nga ana e qeverisë, do të jetë pjesë e vëmendjes së

vazhdueshme të ERE-s dhe raportimeve periodike në kuvend, në zbatim të detyrave të Rezolutës së Kuvendit.

- ***Të kërkojë nga OSHEE, që pas shtyrjes së afateve të përcaktuara në rregulloren "Kriteret Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike", shtyrje në të cilën OSHEE kërkoi një aplikim të përshkallëzuar për të miratuar nivelin e lejuar të kriterëve standarde të performancës në zona të ndryshme, respektimin që brenda kësaj periudhe shtyrjeje shoqëria të dorëzojë në ERE një studim të detajuar mbi përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuar sipas zonave të sipërcituara dhe vënien e treguesve për monitorimin e tyre***

Me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e rregullores për "Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike".

Në vijim të kësaj vendimmarrje, me kërkesë të shoqërisë OSHEE sh.a., si rezultat i pamundësisë për të përmbushur kërkesat e kësaj rregulloreje brenda afateve që ajo përcakton, në lidhje me realizimin e investimeve të domosdoshme, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 271, datë 21.12.2018, vendosi shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren për "Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike".

OSHEE sh.a., me shkresën nr. 13173 prot., datë 14.06.2019, në përgjigje të shkresës së ERE-s me nr. 400 Prot., datë 13.06.2019, me anë të së cilës iu rikujtua shoqërisë përfundimi i afateve, ka përcjellë tabelën për "Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike" të plotësuar nga OSHEE sh.a., analizën e treguesve të performancës së rrjetit shpërndarës për vitin 2018, si dhe krahasimin e realizimit të treguesve në vitet 2017- 2018.

Në vijim të kërkesave të OSHEE sh.a., ERE, me vendimin e Bordit nr. 104, datë 26.06.2019, dhe së fundi me Vendimin e Bordit nr.175, datë 14.11.2019, vendosi të miratojë kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregullore lidhur me nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, deri në datën 01.01.2021.

- ***Të caktojë afate konkrete për OSHEE-në lidhur me vënien sa më shpejt në punë të sistemit të ri të faturimit, të paktën në disa projekte pilot të identifikuar nga vetë OSHEE, i cili lehtëson në mënyrë të ndjeshme leximin e matjes së energjisë dhe krijon mundësi dhe opsione te reja, duke përfshirë edhe leximin periodik disamujor, si dhe në përfundim të konsultimeve me palët e interesit, aty ku kushtet teknike të kompanisë e lejojnë, të sigurojë përfshirjen në kontratën tip për vitin 2019 të kësaj mënyre leximi të sistemit të matjes.***

ERE ka kërkuar nga OSHEE sh.a. informacion mbi masat e marra dhe analizën e kryer me qëllim vënien në punë të sistemit të leximit, si dhe analizën mbi efektet që do të kishte vendosja e një sistemi të tillë faturimi e leximi për sa i përket rritjes së eficiencës financiare të shoqërisë, rritjes së eficiencës së shërbimit dhe transparencës ndaj klientëve të energjisë elektrike, efektet e pritshme në drejtim të uljes së numrit të debitorëve apo llogarive të arkëtueshme, si dhe argumentet përse kërkohet kjo mënyrë faturimi. OSHEE sh.a., me shkresën nr. 21695/1, datë 31.10.2019, ka përcjellë në ERE një prezantim lidhur me rezultatet e leximit disamujor, të kryer në formë simulimi në një prej nënstacioneve të saj, prej nga furnizohen rreth 20 000 klientë.

Leximi i testuar pa efekte (vetëm në sistem) ishte 3-mujor, dhe është marrë për referencë leximi i periudhës janar-shtator 2019. Në përfundim të simulimit për një periudhë 9-mujore, rezulton se leximi me vlerë referuese sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr.104, datë 23.06.2016 "Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të

padisponueshme dhe të paarritshme”, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr.49, datë 21.10.2004 dhe nr.146, datë 24.12.2013”, është me afër leximit faktik, dhe pas korigjimit të faturave rezulton me një sasi energji të matuar realisht më të madhe sesa fakti 9-mujor me sistemin.

Gjithsesi, ERE ka evidentuar disa problematika që mund të lindin nëse ky projekt pilot do të fillojë të implementohet, dhe do të bashkërendojë punën me shoqëritë lidhur me qartësimin e:

- një analize tekniko-ekonomike ku shoqëritë të paraqesin qartë përfitimet që do të sjellë kjo mënyrë leximi dhe faturimi, për secilën nga shoqëritë (reduktimin e kostove, eficientë dhe saktësinë e procesit); problematikat që mund të lindin nga ky proces dhe parandalimin e tyre, pritshmërinë lidhur me përmirësimin e transparencës ndaj klientëve, si dhe efektet e pritshme në drejtim të uljes së numrit të debitorëve dhe përmirësimin të llogarive të arkëtueshme;
 - evidentimin e saktë të klientëve që do të përfshihen në projekt, duke mbajtur në konsideratë që zonat në të cilat parashikohet të implementohet projekti pilot, të jenë të azhornuara teknikisht si dhe joproblematike në drejtim të arkëtimit të faturave të energjisë elektrike;
 - formën e pasqyrimin në bilancin energjetik dhe rakordimin më pjesëmarrësit e tjerë të tregut që afektohen nga ky projekt;
 - përgatitjen e një ankete për t’u kryer në zonat ku parashikohet të implementohet projekti, ku të jenë evidentuar të drejtat e detyrimit që u lindin palëve (ofruesve të shërbimit dhe klientit), si dhe opinionin në lidhje me këtë projekt.
- ***Të kërkojë nga OSHEE që në periudhë afatshkurtër të mundësojë lidhjen në rrjetin e shpërndarjes të impianteve fotovoltaike në ndërtesa, nxitja e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme është një prioritet i përcaktuar edhe në ligjin përkatës***

Pas miratimit të Udhëzimit nr. 3, datë 20.06.2019, të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë "Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli", si dhe në vijim të kërkesës së OSHEE sh.a. për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhues të energjisë elektrike nga dielli, ERE, me vendimin e Bordit nr. 152, datë 14.10.2019, ka vendosur për fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në "Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE-s, për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total deri në 500 kW.

Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 234, datë 20.12.2019 "Mbi disa shtesa dhe ndryshime në "Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 08.11.2016 të Bordit të ERE-s, për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhues të energjisë elektrike nga dielli", vendosi të miratojë tarifën për lidhjen e impianteve vetëprodhues të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet të instaluar deri në 500 kW.

Gjithashtu, janë përcjellë opinione dhe është bashkëpunuar me OSHEE sh.a. për përgatitjen dhe plotësimin e udhëzuesve, si dhe akteve ndihmëse, për lidhjen dhe operimin e këtyre impianteve, duke inkurajuar dhe kërkuar nga operatorët e sistemit propozimet për ndryshime të kodeve të rrjetit dhe matjes, në funksion të integritetit të këtyre impianteve. Në këtë prizëm, nga ana e MIE-s është kërkuar dhe është dakordësuar ngritja e Komisionit të Kodit, në përputhje me Kodin e Matjes, për të cilin ERE po ashtu është angazhuar për të marrë pjesë aktive.

- ***Të vijojë punën për mbrojtjen e konsumatorit përmes kompetencave që i jep ligji, mosrespektimi i afateve për shërbimet përkatëse, sjelljet arbitrare dhe të papërgjegjshme ndaj klientëve vijojnë të mbeten problem me gjithë uljen e numrit të ankesave pranë ERE-s. OSHEE duhet të ofrojë një qasje të re për shërbimin e kujdesit ndaj klientit***

Siç edhe u raportua më sipër, në vijim të monitorimeve të kryera në OSHEE sh.a., por dhe analizimit të ecurisë së trajtimit të ankesave të adresuara nëpërmjet ERE nga klientët e energjisë elektrike të OSHEE sh.a., rezulton se është përmirësuar puna në këtë aspekt. Është rritur cilësia e shërbimit ndaj klientit dhe po bëhet një punë më e mirë në respektimin e afateve të dhënies së zgjidhjeve apo përgjigjeve ndaj klientëve të energjisë elektrike në lidhje me kërkesat dhe ankesat e tyre.

Gjatë monitorimit në kuadër të mbylljes së vitit 2019 u paraqitën të dhënat e pyetësorit lidhur me cilësinë e shërbimit ndaj klientit. Pyetësori lidhet me zbatimin e rregullores së cilësisë në rrjetin e shpërndarjes, dhe përkatësisht mbi temat;

- ✓ nivelet e tensionit dhe siguria e rrjetit
- ✓ ndërprerjet dhe rikthimi i energjisë
- ✓ ofrimi i rrjetit dhe cilësia e leximit
- ✓ shërbimi në sportelet e klientit

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se nga 781 anketime të kryera në 61 Qendra Kujdesi të Klientit, secili nga treguesit tejkalon 75% të vlerësimit pozitiv. Sa më sipër, është e verifikueshme edhe të dhënat e anketës së mbajtur nga ERE, lidhur me cilësinë e shërbimit të ofruar klientëve.

Gjithsesi, monitorimet e ERE-s do vazhdojnë në mënyrë periodike, për të ndjekur përmirësimin e cilësisë së shërbimit sa i përket zgjidhjes së ankesave, përshpejtimin të afateve etj.

Ndërkohë po punohet për projektimin e një platforme të përbashkët OSHEE sh.a.–ERE, të ndjekjes së ecurisë së ankesave/kërkesave, si dhe monitorimin e tyre në kohë reale nga ERE, për të cilën ka pasur një angazhim të USAID-it për mundësinë e financimit të saj.

- ***Të kërkojë nga OSHEE anulimin e faturimeve të klientëve të energjisë elektrike, të cilët janë faturuar nën emërtimin “energji e pamatur” dhe “dëm ekonomik” në periudhën tetor 2008 - prill 2011. Me gjithë vendimin e ERE-s, problemi vijon të mbetet i pazgjidhur***

Nga monitorimi i OSHEE sh.a për zbatimin e vendimit të ERE-s lidhur me anulimin e faturave të klientëve të energjisë elektrike, nën emërtimin “dëm ekonomik” dhe “energji e pamatur” për periudhën 2008- 2011, vlen të theksohet se, siç rezulton nga pasqyra përmbledhëse e ankesave shembull të vëna në dispozicion nga OSHEE sh.a., gjatë monitorimeve të ushtruara nga ERE, një pjesë e madhe e këtyre sistemimeve janë bërë për raste për të cilat është ushtruar ankim gjatë viteve 2011 deri në 2018.

ERE i është drejtuar OSHEE sh.a. me shkresën nr. 444 prot., datë 10.07.2019, me kërkesën për informacion në lidhje me ankesat e klientëve të energjisë elektrike, të cilët janë faturuar nën emërtimin “energji e pamatur” dhe “dëm ekonomik” në periudhën tetor 2008 - prill 2011, duke kërkuar një vlerësim mbi statusin dhe numrin e kontratave të klientëve të cilët kanë paraqitur ankim në OSHEE sh.a. me objekt “dëm ekonomik” apo “energji e pamatur”. Nga të dhënat e OSHEE sh.a. dhe verifikimet e ERE-s rezulton se një pjesë e konsiderueshme e këtyre ankesave janë trajtuar dhe kanë gjetur zgjidhje. Pjesa e mbetur e kësaj tipologjie ankesash do të vazhdojë të trajtohet nga ERE, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të shoqërisë. Vlen të theksohet se nga të dhënat e vitit 2019, numri i ankesave për “dëm ekonomik” apo “energji e pamatur” ka pësuar

rënie të konsiderueshme, veçori që reflektohet edhe në ankesat e paraqitura në ERE nga klientët e energjisë elektrike.

- *Në bashkëpunim me OSHEE-në dhe institucionet përgjegjëse, të mbështesë propozimet për dhënien e një zgjidhjeje të problemit të pronësisë së kabinave elektrike, 51,3% e të cilave nuk janë në pronësi të OSHEE-së, si dhe të disa rrjeteve shpërndarëse të energjisë në pronësi private, duke krijuar kështu pengesa për të drejtën e ndërhyrjes dhe kryerjen e shpenzimeve financiare nga ana e OSHEE-së në rastet e nevojshme, si dhe të japë opinion nëse është e nevojshme për ndryshimet në legjislacionin për zgjidhjen e këtij problemi në të ardhmen.*

Në lidhje me sa më sipër, ERE ka kërkuar informacion nga OSHEE sh.a. në lidhje me masat e marra për adresimin e çështjes së kabinave elektrike në pronësi të të tretëve, që përbëjnë 47% të gjithë inventarit të kabinave elektrike të lidhura në sistemin e shpërndarjes sipas OSHEE sh.a. Deri më sot nuk ka pasur ndonjë propozim konkret nga palët e interesuara mbi këtë çështje dhe OSHEE sh.a. nuk ka propozuar ende zgjidhje të mundshme për problematikën. ERE është e gatshme të bashkëpunojë me OSHEE sh.a. dhe palët e interesit në gjetjen e rrugës së zgjidhjes së kësaj çështjeje dhe e ka shprehur këtë gatishmëri në çdo komunikim zyrtar me OSHEE sh.a. dhe MIE-n. Duhet theksuar se për shkak dhe të numrit të madh të kabinave elektrike, kohës së gjatë të kësaj problematike, gjetja e një zgjidhjeje të kënaqshme për palët është tejet e vështirë, duke marrë në konsideratë se duhet të preken të drejta të cilat rregullohen nga Kodi Civil, mbi të cilat çdo vendimmarrjeje e ERE-s apo dhe ndryshim në ligjin e sektorit do të ishte i pamundur, ndaj zgjidhja do të duhej të gjendej midis OSSH dhe palëve të afektuara që kane kryer këto investime dhe zotërojnë këto asete. ERE mbetet e gatshme për konsultimin e palëve për gjetjen e një zgjidhjeje të këtij problemi dhe nisjen e një procesi të konsultimit të palëve.

7. AKTIVITETI I ERE-S NË ZHVILLIMIN E LEGJISLACIONIT SEKONDRAR DHE NDRYSHIMET E TJERA LIGJORE TË NDODHURA GJATË VITIT 2019

7.1 Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të përshtatjes së tyre me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

Një pjesë e rëndësishme e aktivitetit të ERE-s është hartimi i legjislacionit sekondar, që përbën edhe kuadrin rregullator në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror. Ky kuadër është plotësuar nga ERE në një pjesë të konsiderueshme dhe aktualisht është ende në proces përpunimi nga ERE i disa akteve me mjaft rëndësi në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, që gjatë vitit 2018 ka pësuar ndryshime, por edhe ligjit 102/2015 “Për sektorin e gazit”, i ndryshuar me ligjet nr.64 dhe nr.89 të vitit 2018.

ERE ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për t’u krijuar palëve të treta mundësi njohjeje me përmbajtjen e dokumenteve, mundësinë e konsultimit dhe dëgjimit të palëve të interesuara nëpërmjet dërgimit të opinionëve apo komenteve të ndryshme, apo edhe nëpërmjet zhvillimit të seancave dëgjimore me prezencën e palëve që kanë shfaqur interes për dokumentat në proces përpunimi nga ERE. Çdo dokument, i cili ka hyrë në procesin e draftimit apo edhe të rishikimit,

është publikuar në faqen zyrtare të ERE-s për t'i siguruar mundësi aksesit në vendimmarrje kujtdo që ka interes në këto praktika. Në finalizim të këtyre proceseve të konsultimit publik dhe me palët e interesit, ERE është shprehur me vendimmarrje, të cilat shprehin jo vetëm plotësimin e parashikimeve ligjore, por edhe qëndrimin praktik të palëve të interesit. Mbledhjet vendimmarrëse janë të hapura për publikun.

Gjatë vitit 2019, ERE shënon disa vendimmarrje të rëndësishme në lidhje me shqyrtimin e akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të përshtatjes së tyre me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

Më poshtë po listojmë disa nga vendimmarrjet e rëndësishme që lidhen me hartimin e këtyre akteve shpjeguar më sipër :

VENDIMET E ERE VITI 2019

1. Vendimi Nr. 58, datë 15.04.2019 “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE) sh.a. dhe furnizuesit”.

Këto ndryshime kanë prekur disa dispozita të marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes, që lidhen kryesisht me afatet e njoftimit, apo parashikime të reja sa i përket detyrimeve të operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndaj furnizuesit, në rastet e mos respektimit të kushteve të marrëveshjes. Afatet e ndryshuara me vendimmarrjen e mësipërme janë zgjatur sa i përket kohës së njoftimit të furnizuesit nga ana e OSHEE në rastet e ndërprerjes për shkak të ndërhyrjeve teknike në rrjet. Janë plotësuar gjithashtu me dispozita të reja, modalitetet dhe afatet e njoftimit të furnizuesit nga ana e OSHEE në rastet e punimeve të mirëmbajtjes, duke i garantuar kështu Furnizuesit një koordinim më të mirë të punëve në kushtet e pamundësisë së furnizimit gjatë kryerjes së punimeve të mirëmbajtjes. Me anë të këtij dokumenti të përditësuar janë plotësuar e saktësuar përgjegjësit e furnizuesit në raport me detyrimet e ruajtjes së marrdhënies me klientet si dhe afatet e njoftimeve të këtyre të fundit, mbi ndërprerjen e energjisë.

2. Vendimi Nr. 84 datë 31.05.2019 “Mbi miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimit të balancimit (Kapacitetit rezerve dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energjitik për periudhën kohore 01.01.2019- 31.12.2019 midis OST sh.a dhe KESH sh.a.

Në zbatim të parashikimeve të nenit 20, gërma h) të Ligjit, nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, ERE miraton kontrata tip për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik. Veç sa më sipër aktualisht është në fuqi Mekanizmi i Përkohshëm i Balancimit, në të njëjtën kohë i vetmi Gjenerues i cili plotëson kriteret teknike sipas deklarimeve të OST sh.a. për ofrimin e shërbimeve ndihmëse është Prodhuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik KESH sh.a. Në kushtet kur me VKM 244/2016, shoqërisë KESH sh.a. i është ngarkuar detyrimi i shërbimit publik, është rëndësishme për ERE të rregullojë këtë marrëdhënie. ERE në vitin 2019, ka miratuar pas konsultimeve të gjera me palët e interesit si dhe autoritetin e Konkurrencës, kontratën e dakortësuar mes palëve, duke evidentuar dhe vendosur për disa ndryshime në kontratën e dakortësuar më herët mes palëve me qëllim reflektimin e parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Këto ndryshime lidhen kryesisht me Çmimi i negociuar mes palëve për sigurimin e kapacitetit të Rezervës së Restaurimit të frekuences në drejtim ngritje/ulje, Çmimin për sigurimin e kapacitetit të Rezervës Zëvendësuese (RR) si dhe detyrimin që Çmimi i ofrimit të energjisë balancuese të jetë ai i kalkuluar mbi bazën

e mekanzimit të përcaktuar në nenin 11 të "Rregullave të Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 193, datë 24.11.2017.

3. Vendimi Nr. 85 datë 31.05.2019 “Mbi miratimin e kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin A,B. Dhe C, sipas vendimit të ERE-s nr. 129, datë 04.06.2019, “Mbi miratimin e kodit të rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”.

Në vijim të miratimit nga ERE të “Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin e Gjeneruesve” (RfGj), me Vendimin e Bordit nr. 129, datë 04.06.2018, OST sh.a. ka propozuar në ERE miratimin e saj, për përcaktimin e niveleve kufi/pragjeve maksimale të kapacitetit për modulet gjeneruese të tipit A, B, C dhe D. Ky akt, është konsultuar me palët e interesit Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), KESH sh.a, Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT), shoqatat e prodhuesve dhe të furnizuesve. Ky akt nënligjor shërben për plotësim të kuadrit nënligjor dhe teknik për klasifikimin e gjeneruesve të lidhur në rrjetet përkatëse duke u bazuar në fuqinë e tyre të instaluar dhe niveli i tensionit të pikës së lidhjes. Ky akt nënligjor është miratuar si transpozim i kodeve dhe praktikave të harmonizuara me ENTSO – E. Procesi i klasifikimit të gjeneruesve dhe përcaktimi i nivelit të kufi/pragjeve synon të balancojë nevojën e OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., për të garantuar dhe menaxhuar sisteme të sigurta dhe të fuqishme, kundrejt vendosjes së një niveli proporcional të mbështetjes së detyrueshme të gjeneruesve të lidhur me sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes.

4.Vendimi Nr. 203 datë 12.12.2019 “Mbi miratimin e rregullave për monitorimin e tregut të Energjisë Elektrike”

Rregullat e monitorimit të tregut të energjisë elektrike përcakton një set parimesh, udhëzimesh dhe formatesh raportimi të përgjithshme të cilat ndihmojnë në realizimin e monitorimit të tregut të energjisë elektrike. Zhvillimet e tregut të energjisë janë dinamike dhe në këtë mënyrë nevoiten rregulla dhe standartizime për të ushtruar procesin e monitorimit nga ERE. Rregullat e monitorimit të energjisë elektrike përcaktojnë në mënyrë të detajuar mënyrën dhe procedurat që do të ndiqen nga ERE për monitorimin e funksionimit të Tregut të Energjisë Elektrike si dhe veprimtari të caktuara të Operatorëve të Transmetimit dhe të Shpërndarjes në funksion të tregut të Energjisë Elektrike në Republikën e Shqipërisë. Këto rregulla do t’i mundësojnë ERE që nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të funksionimit të tregut të energjisë elektrike të synojë rritjen eficientë, konkurrencës dhe transparencës së tregut të energjisë elektrike si dhe identifikimin e parregullsive apo mangësive në këtë treg. Këto rregulla do t’i mundësojnë pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që të kenë një informacion më të saktë lidhur me çështjet dhe mënyrën se si do të realizohet procesi i monitorimit të tregut të energjisë elektrike. Miratimi i këtyre rregullave është një garanci e shtuar për pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike të cilat garantojnë trajtimin në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese të pjestarëve të tregut të energjisë elektrike përgjatë procesit të monitorimit të tregut të energjisë elektrike.

5. Vendimi i Bordit të ERE nr. 215, datë 20.12.2019, miratoi rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike.

Në kuadër të reflektimit të shtesave dhe ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 7/2018 mbi ligjin “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” sa i përket veprimtarisë së Operatorit të Tregut si dhe çeljes së Tregut të Organizuar të Energjisë (Bursës Shqiptare të Energjisë), ERE gjatë vitit 2019 në

mbështetje të neneve 16 dhe 39 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 15 dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe nenit 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, me vendimin e Bordit të ERE nr. 215, datë 20.12.2019, miratoi rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”.

Në këtë Rregullore janë përfshirë gjithashtu edhe parashikimet e pikës 8 të VKM nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” i ndryshuar.

Nga zbatimi i kësaj rregulloreje në punën e përditshme të ERE-s, u gjykua i nevojshëm rishikimi i saj në kuadër të përmirësimit të disa termave, kushteve apo afateve që kjo rregullore përcakton si dhe përshtatjen e saj me parashikimet që sollen ndryshimet e Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike.

Risite që sollen ndryshimet në rregulloren e licencimit janë si më poshtë:

- Njohja reciproke të licensave, u bë në konsultim me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë dhe palët e interesit në vend, në kuadër të bashkëpunimit midis vendeve të rajonit, për të njohur reciprokisht për aq sa lejon legjislacioni në fuqi, licencat ndërmjet ERE-s dhe autoritetit përkatës rregullator në veprimtaritë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike. Kjo njohje bëhet në bazë të Marrëveshjeve dypalëshe midis Palëve Kontraktore të Komunitetit të Energjisë / një shteti Anëtar të Bashkimit Europian, ose një vend tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe.
- Kërkesat për dokumentacion tekniko ekonomik të kësaj rregulloreje, në lidhje me miratimin e projektit të Digës nga Komiteti Kombëtar i Digave (në rastet e objekteve me dige); Duke qënë se disa prej HEC-eve që licencohen nga ERE janë me Dige, atëherë u bë e domosdoshme të shtohet në këtë rregullore në pajtim edhe me Ligjin nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” dhe VKM 147, datë 18.03.2004, “Për rregulloren e sigurisë së digave dhe dambave”, miratimi i projektit të digës nga Këshilli Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), për lejen e vënies në ngarkesë për herë të parë të digës së objekteve. Ky parashikim i ri në rregullore nuk do të lejojë rastet e padëshiruara të ndodhura deri më sot, të moszbatimit të ligjit për digat. Ky propozim i cili u mirëprit nga palët e interesit dhe u refkeltua në rregullore erdhi në vijim të korrespondencave me KKDM.

6. Vendimi Nr. 214 datë 20.12.2019 “Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”

Me këtë vendimmarrje ERE i është përgjigjur kërkesës së OSHEE, për të ndryshuar dispozita të rregullores së blerjes që lidhen me afatet e pagesave të kësaj të fundit për tregëtarët. Një vendimmarrje e tillë nga ana e ERE, erdhi pasi u shqyrtua propozimi i OSHEE, komentet e palëve të interesit dhe u arrit në konkluzionin, që ndryshimi i afateve të pagesave të tregëtarëve, nuk lidhet thelbësisht me konceptin e rregullimit të procedurës. Ligji, në vetvete parashikon ngushtësisht detyrimin kryesor për përcaktimin e procedurave, me të cilat të kryhen transaksionet për qëllimet për të cilat është hartuar kjo rregullore. Nga ana tjetër ndryshimet në këtë akt, nuk çënojnë parimet e trajtimit të barabartë, transparent e jodsikriminues të tregëtarëve dhe këto parime janë të mbrojtura dhe të garantuara për sa kohë, procedura, termat dhe afatet e

prokurimit të energjisë elektrike për pjestarët e tregut të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik nga tregëtarët në tregun e parregulluar janë të njëjta dhe transparente.

7. Vendimi Nr. 234, datë 20.12.2019 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes“, miratuar me vendimin nr. 177, datë 08.11.2016 të Bordit të ERE-s, për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhues të energjisë elektrike nga dielli”.

Shoqëria OSHEE sha, paraqiti në ERE propozimet për miratimin e tarfiave si më sipër, në zbatim të detyrave të Udhëzimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3, datë 20.06.2019 "Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”. Specifikimet e posaçme që udhëzimi ka dhënë në lidhje më aksesin e lehtësuar për këtë kategori, rregullat për aksesin e kësaj kategorie në rrjet, duhet të jenë të ngjashme me ato për lidhjet e reja, të miratuara me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 177 datë 08.11.2016 të Bordit të ERE-s. Nga analiza e tarifave të propozuara nga OSHEE sh.a., për lidhjen e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli, u konstatua se ato kishin të njëjtin emërtim dhe përmbajtje si ato të miratuara me “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të ndryshuar.

Në kushtet kur nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a mungonte një analizë e detajuar e kostove, mbi bazën e të cilave ishin përlogaritur tarifat e propozuara ERE konkludoi me miratimin si më poshtë:

Për klientët familjarë – T1= 1000 lekë

Për klientët jofamiljarë në tension të ulët – T1= 5000 lekë

Për klientët e lidhur në tension të mesëm 6/10/20/35 kV – T1= 23000 lekë

Për shtesë fuqie, modifikim lidhje, transferim lidhje – T1= 0 lekë

T2- tarifa e distancës = 0 lekë

T3- tarifa e fuqisë = 0 lekë

T4 - tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjeve të reja dhe matjes, tarifë e cila përbëhet nga këta komponentë:

1) tarifë për azhornimin e rrjetit 1500 lekë

2) shpenzime administrative1000 lekë

8. Vendimi Nr. 10 datë 24.01. 2019 “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 113, datë 08.07.2016”.

Shtesat dhe ndryshimet sjellin një koncept të ri në rregullore duke vendosur një garanci më shumë në rastin e klientëve me marrëveshje afatgjata për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për energjinë e konsumuar nga furnizuesi aktual, përpara kalimit tek furnizuesi i ri. Kjo shërben për të krijuar mundësinë që edhe nëse në një kohë të dytë, këta klientë do të shmangen nga detyrimet me Furnizuesin e Mëparshëm, ky i fundit rezervon të drejtën të ndërpresë furnizimin e tyre me energji elektrike edhe pse kanë ndryshuar furnizues.

9. Vendimi Nr. 100 datë 21.06.2019 Për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”.

Kjo Rregullore përcakton i kritere standarte dhe kërkesa minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror tek klienti fundorë dhe do të zbatohet për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST-G), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-G), Furnizuesit përgjegjës për Detyrimin e Shërbimit Publik në përputhje me nenin 89, të Ligjit nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror, si dhe çdo furnizues tjetër i gazit natyror.

10. Vendim Nr. 122, datë, 29.07.2019, "Miratimin e Draft Kontratës ndërmjet KESH SH.A dhe OSHEE SH.A/OSSH, Për Shit-Blerjen e sasisë së tepërt të Energjisë Elektrike, që rezulton pas Përmbushjes së Kërkesës së Klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal me Qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e Shpërndarjes, për periudhën kohore 01.01.2019- 31.12.2019".

Kjo kontratë përcakton detyrimet kryesore të palëve, çmimin që do të aplikohet, mënyrën e faturimit dhe të kryerjes së pagesave. Miratimi i kësaj kontrate vjen si detyrim i parashikimeve të nenit 20 germa h) të ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e energjisë elektrike" si dhe detyrim i parashikimeve të nenit 5 të VKM-së nr. 244, datë 30.03.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" i ndryshuar.

11. Vendimi Nr. 213 datë 20.12.2019 "Mbi miratimin e marrëveshjes për bashkëpunimin midis ERE dhe ZRRE Kosovë"

Marrëveshja synon të shfrytëzojë avantazhin e forcimit të veprimit përmes bashkëpunimit dypalësh. Në mënyrë të veçantë palët e shohin këtë marrëveshje si mundësinë për të përqëndruar përpjekjet e tyre të përbashkëta mbi zhvillimin e një strukture të qëndrueshme rregullatore në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit në nivel rajonal dhe në nivel dypalësh. Marrëveshja për Bashkëpunim shihet si një strukturë për zhvillimin e bashkëpunimit afatgjatë dhe shkëmbimin e informacionit mbi bazën e barazisë, reciprocitetit dhe përfitimeve të ndërsjella.

12. Vendimi Nr. 43 datë 15.03.2019 "Mbi miratim e Propozimit të të gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 Korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve".

Ky dokument saktëson kërkesat në lidhje me dorëzimin e të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës, të nevojshme për të krijuar modelin e përbashkët nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel Evropian analiza e sigurisë me qëllim alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve.

13. Vendimi Nr. 103 datë 26.06.2019 "Mbi miratimin e transpozimit të rregullores 2017/459 të miratuar me vendimin nr. 2018/06/phgl-enc "Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit".

Ky draft është përshtatur në respektim të parashikimeve të dispozitave të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", si dhe parashikimeve të Vendimit nr. 2018/06/ PHGL –EnC datë 28.11.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, duke dhënë orientim në lidhje me mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror. Në referencë të vendimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë PHLG-ENC, ky kod do të bëhet i detyrueshëm për të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Transpozimi do të bëhet pa ndryshime në strukturën e tekstit të Rregullores të Bashkimit Europian (EU) Nr.2017/460, përveç përkthimit dhe përshtatjes të bëre sipas këtij vendimi.

14. Vendim Nr. 116, datë, 22.07.2019 , “Mbi miratimin e Propozimit të të gjithë OST-ve për nje metodologji të përbashket të rrjetit në perputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2012/1222 të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionëve”.

Ky dokument sjell kërkesa specifike mbi modelin individual të rrjetit, skenarët, modelin e përbashkët të rrjetit, parametrat e cilësisë së MIRr (Modeli individual i rrjetit) dhe MPRr (Modeli i përbashkët i rrjetit), blloqet bazë të modelit, procesin e bashkimit të modeleve individuale, impaktin e pritur në objektivat e Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 Korrik 2015 dhe merr parasysh sigurinë operationale, optimizimin në llogaritjen dhe shpërndarjen e kapacitetit ndërzonal duke siguruar trajtim të drejtë dhe jodiskriminues të pjesëmarrësve të tregut si dhe duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e informacionit.

15. Vendimi Nr. 230 datë 20.12.2019 “Mbi miratimin e kontratës për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, të lidhur ndërmjet shoqërisë Albgaz sh.a dhe shoqërisë Albpetrol sh.a për vitin 2019”.

Kjo kontratë rregullon të gjithë marrdhënien e shërbimit të transmetimit të gazit natyror ndërmjet palëve duke përfshirë, por pa u kufizuar edhe programin, normimin, livrimin dhe pranimin e gazit natyror për periudhën kohore 01.01.2019-31.12.2019.

16. Vendimi Nr. 232 datë 20.12.2019 “Mbi miratimin e “Metodologjisë së përlllogaritjes së rimbursimit të dëmit ekonomik nga operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes”.

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë metodologjinë për llogaritjen e dëmit ekonomik që i shkaktohet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes dhe rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike nga përdoruesit e rrjetit të lidhur në sistemin e shpërndarjes si dhe procedurave që ndiqen nga OSSH-ja për konstatimin dhe vendosjen e dëmit ekonomik, e cila do të mundësojë minimizimin e humbjeve jo-teknike në rrjetin shpërndarës të energjisë elektrike.

17. Vendimi Nr. 144, datë 30.09.2019 “Mbi miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë”.

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e çdo strukture organizative e në mënyrë më të detajuar, detyrat e të drejtat e çdo qelize të këtyre strukturave që përbëhen nga specialistë me ekspertizë sipas profilit të drejtorisë. Një aspekt i rëndësishëm i përmbajtjes së kësaj rregulloreje është edhe përfshirja e dispozitave që lidhen nga konflikti i interesave, identifikimi dhe regjistrimi i interesave private të zyrtarit në kushtet e konfliktit rast pas rasti të konfliktit të interesave etj.

Akte për të cilat ERE ka filluar procedurën dhe është është në proces konsultimi me palët e interesit janë:

1. “Mbi miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”;
2. “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr. 190, datë 23.11.2017 “Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”;
3. Mbi miratimin e kriterëve për të vendosur Kufizime sipas Kërkesave për lidhjen e Moduleve të Gjenerimit”;

4. “Mbi miratimin e Rregullores për burimet dytësore të energjisë elektrike”;
5. “Mbi miratimin e Kodit të rrjetit të transmetimit të gazit natyror”;
6. “Mbi miratimin e Strategjisë për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë elektrike”;
7. “Mbi miratimin e Rregullores së profileve të standardizuara të ngarkesës”.

Gjatë vitit 2020, ERE do të vijojë punën me qëllim miratimin apo azhormimin e legjislacionit sekondar të miratuar në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 7.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Ndër këto akte në proces, përmendim Rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”. ERE do të vijojë komunikimin, incentivimin dhe bashkëpunimin me Operatoret e rrjetit me qëllim draftimin e shqyrtimin e Kodit të matjes e të shpërndarjes të cilët duhet të vijnë si propozim në ERE nga të licencuarit për këto shërbime. Ndër të tjera në vitin në vijim një vëmendje e veçantë do të kushtohet miratimit të rregullores për përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së fundit. Ky hap bëhet i nevojshëm edhe në kuadër të liberalizimit dhe të hapjes së tregut të energjisë elektrike në vendin tonë, duke mundësuar edhe konkurimin e furnizuesve të ndryshëm për ofrimin e këtij shërbimi të rëndësishëm.

Paralelisht, ERE do të vijojë punën me qëllim miratimin e kuadrit rregullator në sektorin e gazit për të shtruar rrugën për operatorët e këtij sektori me qëllim rregullimin e kushteve të operimit.

7.2 Proçeset gjyqësore në të cilat ERE ka qënë palë gjatë vitit 2019

7.2.1 ERE në Cilësinë e Palës së Paditur në proçeset gjyqësore.

ERE ka qënë palë e paditur në 3 proçese gjyqësore përgjatë vitit 2019.

1. **Gjykata Administrative - Tiranë**, po gjykohet çështja me Nr. themeli 5731 akti, datë 16.12.2019, me palë ndërgjyqëse: Paditës: Shoqëria Albtek Energy shpk; i Paditur: Enti Rregullator i Energjisë (ERE) Person i tretë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Objekt gjykimi: Detyrimi i Entit Rregullator të Energjisë, të përcaktojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike të hedhur në rrjet, të shoqërisë Albtek Energy shpk, nga fillimi i hedhjes në treg të kësaj energjie.
2. **Gjykata Administrative - Tiranë**, është duke u gjykuar çështja administrative me Nr. themeli Nr. 5858 Akti, datë 30.12.2019, me palë ndërgjyqëse: Paditës: Shoqëria “Wonder” shpk; i Paditur: Enti Rregullator i Energjisë (ERE); Person i tretë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Shoqëria "Energ-Sas" sh.p.k; Objekt gjykimi: Shfuqizimin si të paligjshëm të vendimit të Bordit të Entit Rregullator i Energjisë (E.R.E)-s Nr. 171, datë 07.11.2019. Njohjen e të drejtës së palës paditëse për tu pajisur me licensën për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike sa i përket hidrocentralit Sasaj. Detyrimin e palës së paditur E.R.E të pasjisë palën paditëse me licensën përkatëse.
3. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor-Elbasan**, është duke u gjykuar çështja civile me numër akti 1881, me palë ndërgjyqëse Paditës: Manushaqe Elezi (trashëgimtarët ligjorë të saj) , të paditur : Luljeta Hysolli; Enti Rregullator i Energjisë dhe Ministria e Infrastukturës dhe Energjisë, Agim Elezi ; shoqëria “Amal “shpk, me objekt gjykimi: *pavlefshmëri absolute kontrate*

7.2.2 ERE në Cilësinë e Palës së Tretë në proceset gjyqësore në kuadër zbatimit të kompetencave ligjore.

Përgjatë vitit 2019, ERE është thërritur në cilësinë e personit të tretë në 5 procese gjyqësore:

1. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor –Tiranë**, është duke u gjykuar çështja civile me palë ndërgjyqëse: paditës: OSHEE sha, i paditur : OST sha, palë e tretë : ERE; IRTS ; me objekt gjykimi: Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë për dëmin e shkaktuar në masën 4,578,245 lekë, si pasojë e mosveprimit për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike në mënyrë të paligjshme të subjektit “Ionian Refining & Trading Company”sh.a (IRTC). Kamatë vonesën ligjore sipas normës mesatare të interesit të depozitave mujore në lekë për sistemin bankar të Bankës së Shqipërisë për shumën 4,578,245 lekë të përlloritur nga dita e depozitimit të kësaj kërkesë padie në gjykatë deri ditën e ekzekutimit të këtij vendimi. Detyrimin e palës së paditur të paguajë shpenzimet gjyqësore.
2. **Gjykata Administrative – Tiranë**, është duke u gjykuar çështja administrative me Nr. themeli 4206 akti, datë 06.11.2019 me palë ndërgjyqëse: Paditës: shtetasi: Artan Rama; i Paditur: OSHEEsh.a; Person i tretë: Enti Rregullator i Energjisë (ERE); Objekt gjykimi: Detyrimin e të paditurit OSHEE sh.a, ti jap paditësit informacion lidhur me : nëse shoqëria “Albtek Energy” shpk, prodhon energji elektrike dhe nëse energjia që prodhon lidhet në rrjetin e shpërndarjes. Dëmshpërblimin për dëmin jo pasuror në masën 300 000 lekë; Dhënien e Vendimit me ekzekutim të përkohshëm në lidhje me kërkimin në pikën 1 të objektit të padisë.
3. **Gjykata se Rrethit Gjyqësor Tiranë** është duke u gjykuar çështja civile me palë ndërgjyqëse: Paditës - Shoqërinë “SELISHTË” sh.p.k; Të paditur: Shoqëria "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare" sh.a; Person i tretë: Enti Rregullator i Energjisë: Ministria e Infstrukturës dhe Energjisë(MIE); Avokatura e Shtetit; me Objekt padie: Detyrimin e palës së paditur që të paguaj dëmin kontraktor të shkaktuar nga vonesat në pagimin e detyrimeve monetare, të cilat përbëhen nga dëmi kontraktor në formën e penaliteteve për shkak të likuidimit të vonuar të detyrimeve të palës paditëse ndaj palëve të treta (bankave) në vlerën e 21,240,914 Lekë.
4. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë** është duke u gjykuar çështje civile Nr. Akti 6407 dhe me palë ndërgjyqëse *Paditës: Lush Shtogu, të paditur: kompania OSHEE sha, me palë të tretë: ERE dhe me objekt gjykimi* : Konstatimin e shkeljeve nga ana e të paditurit "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike", sh.a, Tiranë, të kushteve të kontratës me Nr. G/230233, datë 18.10.2007, (Nr. 003043, serie) për furnizimin me energji elektrike, për sa i përket furnizimit me energji elektrike, mënyrës së faturimit të saj afrofe duke pas matës, si dhe sasi së faturimit të energjisë elektrike, si dhe detyrimin e palës së paditur, si furnizues monopol për lidhjen e energjisë sipas kontratës. Njohjen e pavërtetësisë së dokumentave fatura tatimore mujore të shitjes së energjisë elektrike (fatura të padërguara apo hedhur ato të dhëna në emrin time vetëm në sisteme të asaj pale që përdoret për atë qëllim) në emër të Lush Shtogu periudhat Janar-Dhjetor 2007, Janar-Dhjetor 2008, Janar-Dhjetor 2009, Janar-Dhjetor 2010, Janar-Dhjetor 2011, Janar-Dhjetor 2012, Janar-Dhjetor 2013, Janar Dhjetor 2014, Janar-Shtator 2015. Marrjen e masës provizore për sigurimin e objektit të padisë, duke urdhëruar shoqërinë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike që të bëj menjëherë furnizimin me energji elektrike të palës së paditur. Detyrimin e palës së paditur për pagimin e shpenzimeve gjyqësore, në të cilat do të përfshihen pagesa për avokatin mbrojtës (n.q.s kërkohet për të tre shkallët e gjykimit) për nxjerrjen e urdhrit-ekzekutiv, si dhe shpenzimet të tjera gjyqësore.
5. **Gjykata e Apelit - Tiranë**, është duke u gjykuar çështja civile me palë ndërgjyqëse: Paditës: Sokol Riska, i paditur: Anastas Riska, Shoqëria “Projeksion Energji” sh.a, me palë të tretë:

shoqëria OSHEE sh.a; ERE; Qendra Kombëtare e Biznesit; Drejtoria Rajonale Tatimore – Tiranë; KESH; me objekt gjykimi: Prishjen e shoqërisë “Projeksion Energji” sha.

7.3 Zhvillimi i seancave Dëgjimore në ERE

Në vitin 2019 janë zhvilluar 53 seanca dëgjimore të organizuara nga ERE, nga të cilat 22 seanca dëgjimore janë zhvilluar në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis operatorëve të licencuar në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, 15 seanca dëgjimore me palët e interesuara në kuadër të rishikimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe atë të Gazit Natyror si dhe 16 seanca të cilat kanë të bëjnë me ankesa të klientëve ndaj shoqërisë OSHEE sh.a për faturimin e energjisë elektrike dhe me të licencuar kryesisht për plotësim dokumentacioni.

8. VEPRIMTARIA E ERE-S NË FUSHËN E MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE MBIKQYRJES SË STANDARTEVE.

- Autoriteti dhe përgjegjësia e ERE-s në drejtim të zbatimit të masave më efektive për garantimin e mbrojtjes së klientëve të energjisë elektrike, zë një vend të veçantë në veprimtarinë e saj në funksion të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar. Veprimtaria e Sektorit të Mbrojtjes së Standarteve mbështetet kryesisht në parimet kryesore që konsistojnë në:
 - Trajtimin dhe zgjidhjen e të gjitha ankesave dhe konfliktet direkte që lindin në marrëdhëniet midis furnizuesit të energjisë elektrike dhe klientëve, duke pasur si qëllim:
 - Mbrojtjen e interesave të klientëve në aspektin individual.
 - Mbrojtjen e interesave të klientëve në tërësi nga abuzimet e aktorëve dominant në tregun e energjisë elektrike.
 - Trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të të gjithë klientëve përmes procedurave ligjore e transparente.
 - Monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve që ofron i licensuari ndaj klientëve të energjisë elektrike.
 - Sigurimin e një shërbimi të furnizimit me energji elektrike të pa ndërprerë dhe brenda standardeve të cilësisë së shërbimit.

Prioriteti i ERE-s në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet klientëve të energjisë elektrike dhe të licencuarve, vazhdon të mbetet ndër veprimtaritë kryesore të saj që vijnë si detyrim i zbatimit të parashikimeve të nenit 24 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe nenit 98 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Edhe gjatë vitit 2019 ka vijuar veprimtaria e ERE-s në drejtim të mbrojtjes së klientëve, me hartimin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe monitorimit të zbatimit nga “Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë” të akteve nënligjore të tilla si dhe “Rregullore për Kriteret Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” të miratuar me vendimin e ERE-s Nr. 181, datë 10.11.2017 i ndryshuar, Planit të masave për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSHEE sh.a për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike, miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 201, datë 03.09.2018. (etj).

Në funksion të lehtësimit të marrjes së informacionit nga ana e klientëve të energjisë elektrike por edhe të ndërgjegjësimit të tyre lidhur me proceset e funksionimit të tregut të energjisë elektrike, ERE ka përgatitur informacione orientuese të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

Këto informacione kanë të bëjnë me të drejtat e klienteve, mënyrën e furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit, procesin e trajtimit të ankesave, kontrollin e matësit të energjisë elektrike, procesin e ndërprerjes së kontratës së energjisë elektrike (i përkohshëm/i përhershëm), procesin e lidhjes së një kontrate të re të energjisë elektrike, informacion për klientët në nevojë, të dhëna lidhur me cilësinë e shërbimit, metoda për kryerjen e pagesave të faturave të energjisë elektrike etj.

Gjatë vitit 2019 OSHEE sh.a është monitoruar lidhur me implementimin e planit të masave në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, si dhe përditësimit të tij në funksion të problematikave që kanë dalë përgjatë zbatimit të tij, duke u fokusuar në zgjidhjen e ankesave të klientëve në një kohë sa më të shkurtër.

Nga monitorimet ka rezultuar se strukturat përgjegjëse të OSHEE sh.a, gjatë vitit 2019 nuk kanë realizuar ndryshime të akteve të brendshme sa i takon planit të masave, por ndërkohë kanë vijuar monitorimin më të shpeshtë të cilësisë së shërbimit dhe arritjes së transparencës së shërbimeve.

Viti 2019 u karakterizua nga puna për zbatimin e ndarjes së aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit dhe si e tillë është shoqëruar me sfida për zbatimin e planit të masave në kuadër të respektimit e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike gjatë këtij procesi .

Gjatë vitit 2019 nuk ka ndryshime në aktet e shoqërisë sa i takon procedurave të trajtimit të ankesë/kërkesave për furnizimin me energji elektrike, lidhjet e reja dhe shërbimet teknike.

Qëllimi i procedurave të brendshme lidhur me trajtimin e ankesë/kërkesave të klientëve në OSHEE sh.a është:

- evidentimi i hapave të punës për trajtim
- personelin e përfshirë në proces
- përgjegjësitë e personelit të përfshirë në proces
- nivelet e aprovimit
- afatet e zbatimit të hapave të punës nga personeli i përfshirë
- dokumentacionin e nevojshëm (matrica dhe modele të tjera të dokumentimit)
- rregjistrimi në sistemet e shërbimit të klientit
- rregjistrimi i efekteve në kontabilitetin e klientit.

Ankesat dhe shërbimet që kërkohen nga numri i lartë i klienteve që prej 1 Janar 2019 trajtohen edhe me sistemin e ri (CRM), Menaxhimi i Mardhënieve me Klientin), i cili tashmë është funksional në të gjithë vendin. Ankesë/Kërkesat me anë të këtij sistemi regjistrohen nga specialistët në Qëndrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe duke ndjekur hapat e procedurat për çdo tipologji të ankesë/kërkesave.

Të gjitha proceset e punës janë bashkuar në një sistem të vetëm duke transferuar edhe gjithë informacionin e sistemit të faturimit, për çdo klient.

Sistemi realizon përzgjedhje automatike të delegimit në strukturat përgjegjëse të ankesës apo kërkesës të paraqitur nga klienti.

Gjithashtu ky sistem lehtësisht mundëson marrjen e informacionit për raportim të numrit total të ankesave, zgjidhshmërinë e tyre, por edhe të ndarë sipas rajoneve përkatëse.

Në Qendrat e shërbimit të Klientit realizohen shërbimet e arkëtimit, depozitimi dhe ndjekja e zgjidhjes së kërkesave dhe ankesave të klientëve. Sipas procedurave të brendëshme të OSHEE sh.a.

Veç sa më sipër OSHEE sh.a ka vënë në dispozicion të klientëve edhe një kanal tjetër komunikimi që është Qendra telefonike e dedikuar (Call Center)

Call center është e organizuar të jetë në funksion të telefonatave të klientëve me dy turne, në afatin kohor 08.00 deri 22.00 çdo ditë të javës.

OSHEE sha për të monitoruar shërbimin që i ofrohet klienteve në qendrat KNK, ka mgritur sistemin e monitorimit të shërbimit të klientit nëpërmjet sistemit audio/video.

Në 59 Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit kanë në funksion Sistemin e Menaxhimit të Radhës, me anë të së cilit ju krijohet lehtësi klienteve që paraqiten në Qëndër për ankesat apo shërbimet që ju ofrohen nga ana e shoqerise.

Përsa i përket kontrolleve konstatohet se është rritur produktiviteti i gjithë procesit të punës në Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit.

Ky monitorim shkon deri në detaje duke parë dhe kontrolluar dokumentacionin e praktikës, etikën e çdo specialisti në komunikim me klientin, pra ndjek dhe kontrollon cilësinë e ofrimit të shërbimeve në këto qendra.

Me vendim të Këshillit Mbikqyrës të OSHEE sh.a është themeluar një Njësi, pranë Kabinetit të Administratorit të OSHEE sh.a, me qëllim koordinimin dhe ndjekjen e të gjitha ankesave dhe kërkesave të qytetarëve, të përcjella zyrtarisht nga Agjencia e Bashkëqeverisjes, pranë Këshillit të Ministrave.

Gjatë periudhës ushtrimore 1 janar -31 dhjetor 2019 kjo njësi ka koordinuar trajtimin e 1751 kërkesa dhe ankesa nga të cilat ka rezultuar 19% në favor të klientit ose 325 çështje, të cilat janë dërguar për trajtim nga komisioni i disiplinës, mbi bazën e të cilit janë dhënë 246 masa disiplinore që përfaqësojnë rreth 45% të çështjeve në favor të konsumatorit.

OSHEE sha në zatim të planit të Masave ka krijuar pyetësoin i cilësisë së klientit i ndërtuar në 3 seksione kryesore mbi perceptimin për zbatimin e rregullores së cilësisë në rrjetin e shpërndarjes.

Janë kryer 800 anketime me shtrirje në të gjithë territorin e RSH, pranë KNK dhe përkatësisht mbi temat;

- ✓ nivelet e tensionit dhe siguria e rrjetit
- ✓ ndërprerjet dhe rikthimi i energjisë
- ✓ ofrimi i rrjetit dhe cilësia e leximit
- ✓ shërbimi në sportelet e klientit

Qëllimi i pyetësorit ishte kuptimi i perceptimit të klientit në lidhje me përmirësimin e shërbimit të kujdesit, të klientit ,respektimin e të drejtave të klientit.

Me gjithë rezultatet inkurajuese të pyetësorit të performancës së OSHEE sha në drejtim të cilësisë së shërbimit ndaj klientëve ku secili nga treguesit tejkalon 75% të vlerësimit në të gjithë komponentët e pyetësorit, nevojitet një buxhet i veçantë jo vetëm për përmirësimin e infrastrukturës së KNK-ve, por dhe një fokus më i lartë në pritshmëritë e klientit sa i takon njoftimeve për ndërprerjet e energjisë.

Në vijim të detyrave që i ngarkohen nga ligji, ERE ka analizuar të dhënat lidhur me numrin e ankesave të klientëve të paraqitura gjatë vitit 2019 dhe ka evidentuar se ky numër është më i vogël

në krahasim me vitin 2018. Për vitin 2018, në ERE janë paraqitur dhe trajtuar 279 ankesa për energjinë elektrike, ndërkohë që gjatë vitit 2019 janë paraqitur dhe trajtuar 182 ankesa. Objekti i ankesave të paraqitura ka konsistuar në shkeljen e kushteve të përgjithshme të “Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientet Fundorë”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 15, datë 10.01.2018 në të cilat përcaktohen detyrimet reciproke të palëve në kontratë.

ERE në referencë të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, dhe akteve nënligjore, si: “Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë”; “Rregullores për Trajtimin e Ankesave të Paraqitura nga Klientët dhe për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve midis të Licencuarve në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror” dhe “Rregullave për Organizimin, Funkcionimin dhe Proçedurat e ERE-s, ka trajtuar dhe analizuar ankesat e klientëve të energjisë elektrike duke ia përcjellë shoqërisë OSHEE sh.a, së bashku me udhëzimet përkatëse. Të gjitha komunikimet me OSHEE sha, lidhur me trajtimin e ankesave të klientëve, u janë bërë me dije edhe vetë ankimuesve.

Gjithashtu edhe nga të dhënat e paraqitura nga shoqëria OSHEE sha, në tabelën e mëposhtëme pasqyrohen ankesat totale (sipas problematikave) të trajtuara nga ana e OSHEE sh.a. si dhe zgjidhjet përkatëse rast pas rasti..

Vihet re një ulje e numrit të ankesë/kërkesave për vitin 2019 në 132.438, krahasuar me 153.076 ankesë/kërkesave të paraqitura në 2018, nga të cilat janë zgjidhur 123.366 të tilla, pra rreth 93.2% të totalit të ankesë/kërkesave të paraqitura.

Ankesa OSHEE 2019 (CRM & Sistem faturimi)		
LLOJI I ANKESËS	Të paraqitura	Të zgjidhura
Ankesë për pagesa/kreditime	2044	2,096
Ankesë për Faturimin	36250	26,721
Cilësi shërbimi	4563	483
Ankesë për sistemin e matjes	37225	27,452
Ndryshim i të dhënave të kontratës	51920	45386
TOTALI	132,002	102,138
Ankesa OSHEE 2019 (Sistemi kërkesë/ankesë)		
LLOJI I ANKESËS	Të paraqitura	Të zgjidhura
Cilësi shërbimi	45	1,583
Ankesë për Faturimin	263	15,455
Komunikime me Palë të 3-ta	22	1,007
Kreditimi	9	84
Ndryshime Kontrate	97	3,099
TOTALI	436	*21228
*Çështje të zgjidhura në vitin 2019 nga sistemi i vjetër "Issue Tracking", të cilat i përkasin vitit të mëparshëm		
TOTAL ANKESA TË PARAQITURA	132438	
TOTAL ANKESA TË ZGJIDHURA	123,366	
ZGJIDHSHMËRIA (%)	93.2%	

Figura 98 Ankesat e trajtuara nga shoqëria OSHEE sh.a për vitin 2019.

Në tabelën më poshtë jepen të detajuara ankesë/kërkesat e trajtuara nga ERE gjatë 2019.




Figura 99 Ankesat e trajtuara nga ERE për vitin 2019.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, janë trajtuar nga ERE në total rreth 183 ankesa. Nga të dhënat e administruara konstatohet se ankesat me objekt “mbifaturim” zënë vendin kryesor në trajtimin e ankesave, të ndjekura nga ankesat me objekt “energji e pamatur” dhe “matje jashtë kushteve teknike”.

Nga anketa e plotësuar nga klientet pranë ERE (100 anketa), 10% të tyre kanë shfaqur pakënaqesi lidhur me mënyrën e trajtimit të kërkesave të tyre nga OSHEE sha (vonesa në përgjigje, sjellje të stafit, etj). Të dhëna këto që do të bëhen me dije shoqërive të reja të krijuara si rezultat i ndarjes funksionale të OSHEE sha, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të punës. Gjithashtu në bashkëpunim edhe me shoqëritë e reja do të punohet në vijim për të kuptuar dhe evidentuar arsyet e vonesave në trajtimin e ankesë/kërkesave të klientëve, në mënyrë përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit ndaj klientëve.

Megjithë performancën në rritje të OSHEE sha, sërisht ka problematika të cilat duhet të rishikohen në të ardhmen.

Janë evidentuar gjithashtu dhe ankesat me objekt kryesisht të: refuzimit të së drejtës për “lidhje të re” në sistemin e shpërndarjes; ndryshim tarifimi; kolaudim matësi; vlerë referuese; ndryshim emri etj.

Ankesat për “Energji të pamatur”.

Ankesa për “energji e pamatur“, gjatë vitit 2019 rezultojnë të jenë 19 . Vihet re se këto ankesa janë të mbartura dhe përfshijnë faturime të energjisë elektrike, të cilat kanë ardhur si pasojë e kontroleve të ushtruara nga shoqëria “CEZ Shpërndarje“ sh.a, përgjatë periudhës 2011-2013, ku vihet re se në shumicën e rasteve të paraqitura, proces-verbalet e mbajtura për konstatimin e ndërhyrjeve të paautorizuara në sistemin e matjes janë kryer jo në prezencën e klientit, në bokse kolektive të matësive të energjisë elektrike si dhe raste ku është lëshuar më shumë se një faturë, brenda 1 viti, që përmban “energji të pamatur”.

Sikurse evidentohet pavarësisht trajtimit të një pjese të konsiderueshme të këtyre faturimeve nga shoqëria OSHEE sh.a, vijon të ketë ende ankesa të pazgjidhura lidhur me këtë problematikë.

Sikurse dhe në vitet më parë, është për tu theksuar fakti se edhe gjatë vitit 2019, konstatohen ende ankesa nga klientë të energjisë elektrike, të paraqitura nga kanale të ndryshme komunikimi të OSHEE sha, dhe siç raportohet nga shoqëria janë sistemuar 65 fatura nën emërtimin ‘dëm ekonomik’.

Përgjigjet e OSHEE sh.a për vitin 2019




Figura 100 Përgjigjet e OSHEE sh.a lidhur me ankesat e paraqitura në ERE për vitin 2019.

8.1. Cilësia dhe niveli i mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike

Për sa i përket mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit, OST sh.a në zbatim të Rregullores së shfrytëzimit teknik organizon monitorimin dhe kontrollin periodik të të gjithë elementeve të Sistemit të Transmetimit, duke hartuar planin e kontrollit dhe mirëmbajtjes, në të cilin detajohen veprimet që do të realizohen për kryerjen e remonteve për pajisjet e nënstacioneve dhe kontrollet periodike për linjat e transmetimit. Kontrollet periodike dhe skanimit me kamera termike i linjave të transmetimit dhe nënstacioneve kanë ndihmuar në identifikimin në kohë të problemeve të cilat pas punimeve riparuese dhe ndërhyrjeve jashtë radhe janë eliminuar në kohë të shkurtër duke bërë dhe parandalimin e dëmtimeve të pajisjeve. Kontrollet me qëllim parandalues të defekteve kanë ndikuar në rritjen e cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

Sa i përket pajisjeve transformuese që përbëjnë asetin kryesor në marrjen e kapaciteteve të prodhimit dhe transmetimit, defektet në to mund të sjellin probleme, të cilat lidhen me shpërndarjen e ngarkesës dhe mungesën e kapaciteteve rezervë. Në rastin e dëmtimeve të riparueshme, për zëvendësimin e transformatorëve kërkohet kohë e gjatë, e cila shoqërohet me humbje të mëdha financiare. Për këtë, për transformatorët 400 kV të sistemit të transmetimit OST sh.a merr masa për zbulimin e defekteve që në fillësë nëpërmjet vlerësimit të gjendjes së transformatorit në kohe reale, duke mundësuar eliminimin e anomalive që në gjendjen fillestare të shfaqjes së tyre.

Për një pasqyrë të cilësisë së punës së Sistemit të Transmetimit më poshtë jepen tabelat Treguesit e Kritereve Standarde të Performancës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit.

Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (2014-2019)						
	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Koha mesatare e ndërprerjes (AIT) (Minuta)	102	60	108	40	34	8.7
Energjia e pa furnizuar (ENS) (MËh)	1435	770	1332	528	454	117
Cilësia e frekuencës (FQ)	+/- 200mHz					
Periudha e njoftimit të ndërprerjeve të planifikuara në sistemin e transmetimit (Orë)	72 orë					
Koha e nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave për lidhjet e reja (ditë)	35	28	32	30	30	42
Indeksi i kohëzgjatjes së ndërprerjeve mesatare (SAIDI) (Minuta)	225	170	240	92	82	26
Cilësia e tensionit (VQ)	Niveli Tensionit 220/154/110 kv					
	(-) 10% deri (+) 11.8%					
	Niveli Tensionit 400 kv					
	(-)10% deri (+) 5%					

Figura 101 Treguesit e Kriteve Standarde të Performancës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit për vitin 2019.

8.2. Cilësia e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike

Në tabelën e mëposhtme paraqiten rezultatet e treguesve të vazhdimësisë së furnizimit me energji të klientëve të OSHEE sh.a gjatë vitit 2019.

KRAHASIMI I PERFORMANCËS SË OSSH NË TL+TM 2018 - 2019 LIDHUR ME TREGUESIT KRYESORË SAIFI, SAIDI, CAIDI DHE N1,D1										
	SAIFI		SAIDI		CAIDI		N1		D1	
	Nr.i konsumatoreve te prekur nga nderprerjet/Nr. Kons.Gjithsej		Nr.i oreve te nderprerjeve gjithsej/Nr. Konsumatoreve Gjithsej		Nr.i oreve te nderprerjeve gjithsej /Nr. Kons. Te prekur nga nderprerjet		Numri total I nderprerjeve te paplanifikuara per nje klient te prekur		Kohezgjatja totale per nje klient te prekur nga nderprerjet e paplanifikuara	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Janar	2.87	2.7	6.23	5.0	4.34	4.0	2.55	2.4	5.51	4.3
Shkurt	3.42	3.7	7.39	8.6	4.31	4.3	3.10	3.3	6.65	7.7
Mars	4.25	2.3	9.03	4.5	3.80	4.3	3.99	1.8	8.29	3.1
Prill	2.54	2.4	4.38	5.3	3.73	4.7	1.88	1.7	2.75	3.3
Maj	3.16	2.3	5.63	4.7	4.03	4.5	2.48	1.7	4.04	3.0
Qershor	3.03	2.3	4.80	3.7	3.55	3.3	2.65	1.8	3.94	2.4
Korrik	2.65	2.6	4.58	4.4	3.35	3.0	2.25	2.3	3.57	3.6
Gusht	2.59	2.0	4.00	3.3	3.11	3.2	2.31	1.5	3.46	2.0
Shtator	2.37	2.4	4.91	4.6	4.36	3.7	1.86	2.0	3.58	3.7
Tetor	2.97	2.1	6.38	5.0	4.68	5.3	2.21	1.5	4.42	3.0
Nentor	2.76	2.4	5.15	3.7	3.80	3.1	2.36	2.1	4.12	3.1
Dhjetor	2.29	2.9	4.67	5.9	4.35	4.1	1.86	2.4	3.87	4.8
	35	30	67	59	47	48	30	24	54	44

SAIFI =	NUMRI TOT I KLIENTEVE TE PREKUR	SAIDI =	KOHA TOT E NDERPRERJEVE	CAIDI =	KOHA TOT E NDERPRERJEVE
	NUMRI TOT I KLIENTEVE		NUMRI TOT I KLIENTEVE		NUMRI I KLIENTEVE TE NDERPRERE

Figura 102 Treguesit e Kriteve Standarde të Performancës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2019, krahasuar me treguesit e vitit 2018.

Këto tregues merren në shqyrtim të ndarë sipas zonave urbane dhe rurale. Referuar treguesve të performancës së OSHEE sh.a., konstatohet se rrjeti i shpërndarjes për këtë periudhë është përmirësuar, por numri dhe kohëzgjatja e difekteve në zonat Rurale vazhdon të jetë akoma më i lartë.

Pra, siç vërehet edhe më lart, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar bazuar në të dhënat e SAIDI dhe SAIFI, rezulton se këto tregues janë përmirësuar.

9. AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ERE-S

9.1 Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

Ndër prioritetet e ERE-s është investimi për një përfaqësim sa më dinjitoz të vendit dhe Rregullatorit në aktivitetet rajonale dhe ndërkombëtare, duke patur si qëllim përputhjen dhe harmonizimin e praktikave të saj me praktikat e vendeve të BE-së. Qëllimi i pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ERE si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj. Kjo është një ndër arsyet për të cilat mund të përmendim aktivitetin dhe rolin e ERE-s në anëtarësimin dhe pjesëmarrjen aktive në organizatat ndërkombëtare, në organizimin e konferencave ndërkombëtare, në bashkëpunimin me institucionet e tjera për organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare, seminareve apo takimeve multilaterale dhe bilaterale.

Për vitin 2019, ERE ka punuar me një intensitet të lartë për realizimin e bashkëpunimeve sa më frytdhënëse në dobi të sektorit të energjisë së vendit. Duke vendosur këto priorite, ERE ka punuar në intensifikimin e marrëdhënieve multilaterale me organizatat ndërkombëtare si Sekretariati i Energjisë së Vjenës nëpërmjet ECRB, MEDREG, ERRA, USAID, NARUC, CEER, IGU, Shkolla e Rregullimit të Firence-s etj. Por në forcimin e rolit të ERE-s dhe harmonizimin e kuadrit Rregullator, janë mbajtur gjithashtu marrëdhënie bilaterale me institucione të tjera Rregullatore simotra, duke realizuar takime të përbashkëta dhe duke marrë pjesë në mënyrë aktive në konferencat dhe aktivitetet ndërkombëtare të lidhura me sektorin. Gjatë vitit 2019 ERE i ka kushtuar një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes në trajnime, seminare, takime, workshop dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare. Interesi i institucionit tonë në këto aktivitete ka qenë i lartë për t'u njohur me eksperiencat perëndimore dhe zhvillimet e fundit në sektorin energjetik duke marrë pjesë në këto aktivitete ndërkombëtare si dhe për të prezantuar denjësisht rregullatorin në këto aktivitete me anë të fjalimeve apo dhe prezantimeve të ndryshme.

9.2 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare.

- ERE është anëtare e ECRB Bordit Drejtues të Rregullatorëve të Vendeve të Traktatit të Energjisë dhe merr pjesë aktive në grupet e punës së ngritura prej kësaj të fundit duke kryesur sipas rasteve dhe grupet e punës së ngritura nga kjo e fundit.
- ERE është anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Evropës Juglindore dhe Euro-Azisë (ERRA), duke realizuar një pjesëmarrje të rregullt në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kryetarëve të ERRA-s, në konferencën e përvitshme të Investimeve të ERRA-s takimet e Komiteteve të përhershme të ERRA-s, atij të Licencimit e Monitorimit dhe atij të Tarifave e Çmimeve që zhvillohen në vendet anëtare të ERRA-s.
- ERE është anëtare e Shoqatës së Rregullatorëve të vendeve të Mesdheut (MEDREG) për energjinë elektrike, ku përgjatë vitit 2019 Kryetari i ERE ka mbajtur postin e zv/Presidentit të MEDREG, duke forcuar rolin dhe ndikimin e Entit Rregullator pranë këtij organizmi. Gjithashtu, stafi i ERE-s ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e grupeve të punës perfsire dhe drejtimin e tyre për konsumatorin, marrëdhëniet institucionale, energjitë e rinovueshme, çështjet e gazit, të grupit të punës së elektricitetit duke qënë dhe draftues i materialeve apo raporteve të këtyre të fundit. ERE ka statusin e vëzhguesit pranë CEER (Këshilli i Rregullatorëve Evropian të Energjisë), status i cili mundëson fuqizimin dhe marrjen e njohurive të stafit të ERE-s gjatë pjesëmarrjes në grupet e punës.

- ERE është pjesëmarrëse në takimet e UfM (Unioni për Mesdheun), i cili përbëhet nga 43 shteteve anëtare pjesë e Mesdheut dhe ka për qëllim të rrisë dhe forcojë bashkëpunimin rajonal si dhe implementimin e projekteve dhe iniciativave që do ti shërbenin rajonin. Në kuadër të bashkëpunimit në sektorin energjetik, UfM-së ka të hartuar platformën për sektorin e gazit natyror si dhe dy platforma të tjera në sektorin e energjisë elektrike, lidhur me burimet e rinovueshme dhe eficiencën e energjisë.
- ERE është anëtare me të drejta të plota në South – South-East Gas Regional Initiative (GRI SSE), e cila është Iniciativa e Rregullatorëve për Gazin në Rajonin Jug-Juglindje).
- Po, ashtu ERE është anëtare me të drejta të plota në OME (Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë).
- ERE është anëtare me të drejta të plota e Forumit të Këshillimit të Ballkanit në përbërje të së cilës janë Rregullatorët e Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Greqisë, Serbisë, Bosnës dhe Bullgarisë. Forumi shërben për shkëmbimin e eksperiencave midis këtyre rregullatorëve nëpërmjet krijimit të grupeve të punës në fusha me interes të përbashkët.
- Për vitin 2019 ERE ka vazhduar të mbaje një bashkëpunim të frytshëm me USAID dhe NARUC në projektin e përbashkët, të përkrahur nga USAID dhe NARUC në lidhje me hartimin e kodeve të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit si dhe në hartimin e legjislacionit sekondar në përputhje me paketën e tretë legjislative.
Gjithashtu, ERE ka marrë pjesë në projektin e USAID & NARUC lidhur me hartimin e planeve 10-vjeçar të zhvillimit të rrjeteve të transmetimit në Europën Juglindore si dhe workshop-in e organizuar lidhur me çështjet e sigurisë kibernetike.
Me mbështetjen e NARUC, ERE gjatë vitit 2019 ka vijuar punën për finalizimin e projektit “Mjetet e krahasimit të çmimeve dhe komunikimi me konsumatorët”, i cili ka për qëllim implementimin e një mjeti në faqen e internetit të ERE, i cili do të shërbejë për krahasimin e çmimeve të energjisë elektrike në tregjet e hapura me pakicë, duke bërë të mundur vlerësimin e kostove që ka çdo klient si dhe impaktin që jep mundësia e klientit për të zgjedhur dhe ndryshuar Furnizuesin.
- ERE në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë gjatë vitit 2019 ka marrë pjesë në Forumin e Athinës, Forumin e Gazit në Ljubjanë dhe aktivitetet e Komunitetit të Energjisë të organizuara nga Sekretariati i Vjenës si dhe grupeve të punës së këtij organizmi.
Gjithashtu ERE ka marrë pjesë në aktivitete duke bashkëpunuar në mënyrë intensive me Sekretariatit të Energjisë së Vjenës, duke u konsultuar për vendimet kryesore dhe duke kërkuar opinion për çështjet delikate. Po ashtu dhe draft vendimet e marra prej nesh si dhe draft rregulloret e hartuara nga ana jonë i janë dërguar për konsultim Sekretariatit të Vjenës ose janë realizuar takime me to për të patur një kuptim sa më të mirë të çështjes, si dhe jemi ndihmuar nga Sekretariati i Vjenës në draftimin e akteve sekondare në kuadër të ligjeve të reja. ERE ka ndjekur në mënyrë të rregullt dhe aktive takimet e Grupeve të Punës të ECRB për çështjet e konsumatorëve, të energjisë dhe tregut rajonal të saj, burimeve të rinovueshme, statistikave, elektricitetit, eficiencës, sigurisë së furnizimit, REMIT, gazit natyror, platforma e gazit. Për realizimin e një pune sa më të mirë dhe arritjen e rezultateve të larta, ERE ka zhvilluar takime të përbashkëta me Sekretariatit të Vjenës për sa i përket implementimit të paketës së tretë legjislative në kuadër të legjislacionin sekondar i cili ka qënë në proces draftimi dhe miratimi nga Bordi, si dhe për sa i përket implementimit të Kodeve të Rrjetit, miratimi i të cilave vjen si detyrim që rrjedh nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe ENTSO-E.

9.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s.

Marrëdhëniet bilaterale të ERE-s për vitin 2019 kanë pasur si qëllim të forcojnë kapacitetin institucional të saj dhe vendosjen e bashkëpunimeve sa më të suksesshme në dobi dhe përmirësim të sektorit energjitik të vendit. ERE ka punuar në drejtim të bashkëpunimit bilateral bazuar në marrëveshjet bilaterale, ku mund të përmendim takimet e ndërsjella me qëllim shkëmbimin e eksperiencës për paketën e tretë legjislative në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Gjatë vitit 2019 janë intensifikuar në mënyrë të mëtijshme dhe marrëdhëniet bilaterale me Rregullatorin Italian (ARERA) si dhe atë Grek (RAE). Ky bashkëpunim ka bërë të mundur realizimin në kohë të vendimeve të përbashkëta të tre rregullatorëve në lidhje me projektin TAP si dhe licensimin e TAP-AG në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

Gjithashtu, gjatë këtij viti ERE ka mbajtur një bashkëpunim aktiv me institucionet rregullatore të rajonit e më gjerë, ku mund të përmendim Rregullatorin e Kosovës, me të cilin në Dhjetor u firmos dhe memorandum i Mirëkuptimit për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e eksperiencave të të dy rregullatorëve në fusha me interes reciprok si dhe në përqendrimin e përpjekjeve të përbashkëta mbi zhvillimin e një strukture të qëndrueshme rregullatore në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit në nivel rajonal dhe në nivel dypalësh.

Po në Dhjetor është firmosur dhe Memorandumi i Mirëkuptimit me Rregullatorin e Malit të Zi, për shkëmbimin e eksperiencave Reciproke dhe bashkërendimit të punës në forume të përbashkëta.

Një tjetër iniciativë rajonale është ndërmarrë gjatë vitit 2019, me mbështetjen e CEI (Central European Initiative) dhe të rregullatorit Italian ARERA, duke vijuar fazën e dytë të Projektit KEP (Know-How Exchange Program) “Suporti i CEI për forcimin e autoriteteve rregullatore të energjisë në Ballkanin Perëndimor”, i cili ka si objekt shtrirjen e praktikave të njohurive për iniciativat e bashkimit të tregjeve të energjisë ndërmjet anëtarëve të BE në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në fund të vitit 2019, u mbyll me sukses faza e dytë e këtij projekti, për të vijuar me fazën e tretë e cila do të startojë në fillim të vitit 2020 dhe do të përfshijë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarinë.

Po ashtu, janë zhvilluar takime mes anëtarëve të Bordit të ERE-s dhe atyre të rregullatorit Italian dhe Turk me të cilët është diskutuar për rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit institucional mes rregullatorëve si dhe janë realizuar vizita studimore pranë Rregullatorit Austriak (E-Control) për rritjen e kapaciteteve në fushën e transparencës dhe integritetit të tregjeve të energjisë si dhe në sektorin e gazit natyror.

10. STRUKTURA E ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË DHE ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neni 9 pika 1 e tij, përcaktohet se ERE është institucioni Rregullator i sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit në Shqipëri që drejtohet nëpërmjet Bordit të Komisionerëve. Bordi i Komisionerëve të ERE përbëhet nga Kryetari dhe katër anëtarë të cilët përzgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Me Vendimin nr. 78, datë 29.04.2020, Bordi i ERE vendosi të miratojë strukturën organizative dhe organogramën e Entit Rregullator të Energjisë, duke përcaktuar se numri maksimal i punonjësve të ERE është 63, të cilët organizohen si më poshtë vijon:




Figura 103 Struktura Organizative e Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 78, datë 28.04.2020.

Përveç Bordit të Komisionerëve, i cili është organi vendimmarrës, ERE organizohet në Sekretarin e Përgjithshëm, 7 drejtori dhe sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve.

Struktura e re e ERE-s bazohet në një ndarje të qartë, me kapacitetet e nevojshme, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi që lidhen me fushat e rregullimit nga ERE në zbatim të legjislacionit në fuqi, të tilla si: Mbrojtja e Konsumatorit, Hartimi dhe miratimi i Akteve Nënligjore, Zhvillimit të Tregut të Gazit natyror, Monitorimi i Tregut, Standarteve të Cilësisë, Vendosja e Tarifave dhe Çmimeve në Segmentet e Rregulluara të Tregut, Licensimi, Modifikimi, Rinovimi dhe dhënia e Autorizimeve për operimet në aktivitetet e identifikuara në ligjet respektive, Marrëdhënia instiucionale brenda dhe jashtë vendit, Planifikimi e Hartimit i Buxhetit, Zhvillimi i Burimeve Njerëzore.

Kjo strukturë gjithashtu merr në konsideratë edhe zhvillimet më të fundit në sektorin e energjisë elektrike siç janë:

- Zbatimi i rregullores së integritetit dhe transparencës së tregjeve me shumicë të energjisë elektrike (REMIT), në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, përsa i takon hartimit të rregullores ashtu dhe monitorimit të zbatimit të saj nga ana e operatorëve të tregut, duke filluar që nga regjistrimi i paleve deri tek ruajtja e të dhënave apo marrja e indicieve për kryerjen e investigimeve të ndryshme për rastet e moszbatimit të kësaj rregullore.
- Certifikimi dhe mbikqyrja e Operatorit të Nominuar të Energjisë Elektrike, sipas rregullores të miratuar nga ERE me Vendimin e Bordit nr. 40, datë 06.03.2020.
- Miratimi dhe monitorimi i implementimit nga operatorët e rrjetit të strategjise se infrastrukturave kritike, i cili kërkon angazhimin dhe përfshirjen e një stafi të dedikuar me eksperiencë në sistemet e informimit për të përballuar këtë detyrë.
- Transpozimi i rregulloreve dhe kodeve për përafrimin e akteve nënligjore, objekt miratimi nga ERE si dhe përpunimi i të dhënave personale të të licensuarve, në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Mbikqyrja e standarteve të cilësisë së operimit të Operatorëve të sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes dhe rolit të ri të klientëve në përputhje me parashikimet e paketës së re legjislative si vetëprodhues.
- Digjitalizimi i arkivës së Entit Rregullator të Energjisë, duke patur në konsideratë se digjitalizimi nuk është kryer prej krijimit të Entit Rregullator dhe do të shërbejë krijimit të një arkive digjitale, e cila mund të jetë e aksesueshme në çdo moment dhe do të shërbejë dhe më tepër rritjes së transparencës së ERE.

Përsa i takon fushës së Burimeve Njerëzore, gjatë vitit 2019 është zbatuar me përpikmëri Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar me ligjin nr.86/2012 datë 18.09.2012, i ndryshuar me Ligjin nr.44/2014 datë 24.04.2014 dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” i ndryshuar me ligjin nr.85/2012 datë 18.09.2012, ligjin nr.45, datë 24.04.2014 si dhe ligjin nr.42/2017 datë 06.04.2017.

Janë plotësuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga zyrtarët që janë subjekt i këtij detyrimi, sipas afateve kohore të parashikuara nga ligji.

Gjithashtu është mbatjur komunikimi i rregullt me ILDKPKI në zbatim të njoftimeve të dërguara prej këtij institucioni.

Në zbatim të Vendimit nr.52 date 02.04.2019 të bordit të ERE është zbatuar me përpikmëri Ligji Nr. 9584 datë 11.07.2006, "Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", si dhe Vendimi nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e Prefektit" si dhe Vendimin nr. 202, datë 15.03.2017 " Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 të këshillit të ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore " të ndryshuar.

Në vijim të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, për përzgjedhjen, emërimin dhe promovimin në detyrë të punonjësve të ERE-s, janë zbatuar procedurat e ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" si dhe të gjithë aktet nënligjore të dala në funksion të tij.

11. ADMINISTRIMI I BURIMEVE FINANCIARE TË ERE-S GJATË VITIT 2019

Në fushën e administrimit dhe financës janë zbatuar me korrektësi aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse për administrimin e financave të ERE-s, përfshirë ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 për "Prokurimet Publike", i ndryshuar, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Urdhërit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standarteve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuar dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre".

Edhe për vitin 2019 është zbatuar me përpikmëri Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005" Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar me ligjin nr.86/2012 datë 18.09.2012, i ndryshuar me Ligjin nr. 44/2014 datë 24.04.2014 dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik" i ndryshuar me ligjin nr.85/2012 datë 18.09.2012, ligjin nr.45, datë 24.04.2014 si dhe ligjin nr.42/2017 datë 06.04.2017.

Janë plotësuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga zyrtarët që janë subjekt i këtij detyrimi, sipas afateve kohore të parashikuara nga ligji dhe nuk ka asnjë masë penaliteti për zyrtarët tanë, që i nënshtrohen këtij Ligji.

Në të gjitha rastet janë zbatuar procedurat dhe afatet kohore në lidhje me kryerjen e prokurimeve të fondeve publike, në përputhje me ligjin e prokurimeve dhe akteve të tjera nënligjore.

Gjithashtu, ka vijuar inventarizimi i aseteve që ERE ka në administrim. Për sa i takon fondeve monetare, ato sigurohen në përputhje me ligjet respektive të sektorit të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror, dhe përbëhen nga pagesat e aplikimeve për licencime/modifikime/rinovime dhe nga pagesat e rregullimit që ERE ka vendosur për të licencuarit.

Ndër zërat kryesorë të shpenzimeve të ERE mund të përmendim:

- Pagat e personelit, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimet mbi të ardhurat, për të cilat institucioni ynë ka shlyer të gjitha detyrimet dhe nga sistemi elektronik " Detyrimet në kohë reale " nuk rezultojnë debitor apo me gjoba.

- Publikimet për informim të opinionit publik janë realizuar në zbatim të Ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit nr.102/2015 ‘Për Sektorin e Gazit Natyror’.
- Pagesat për shlyerjet e detyrimeve të shërbimeve si ujë, energji elektrike, telefon për të cilat institucioni ynë gjithashtu nuk është debitor, shpenzime për shërbime të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës si dhe amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara etj.
- Pagesat me qëllim përmbushjen e angazhimeve në cilësinë e vendit anëtar në një sërë organizatash të rëndësishme ndërkombëtare të sektorit të energjisë të tillë si MEDREG, ERRA, IGU, CEER.

Edhe për vitin 2019 veprimtaria ekonomiko-financiare e ERE-s në zbatim të parashikimeve të nenit 17 të ligjit nr.43/2015, është audituar nga një grup ekspertësh kontabël të regjistruar dhe të licencuar për këtë aktivitet bazuar në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”. Në Shtojcën 1 të këtij raporti paraqitet raporti përkatës i ekspertit kontabël që lidhet me ecurinë financiare të ERE-s gjatë vitit 2019 si dhe Shtojcën 2 me raportin e performancës, të cilat do të përcillen menjëherë pas miratimit të tyre nga auditorët e pavarur.

Buxheti i ERE u miratua me vendim të Bordit nr. 22, datë 30.01.2020. Ky buxhet merr në konsideratë kërkesat për funksionimin e ERE-s përgjatë vitit 2020. Në mënyrë të detajuar ky buxhet paraqitet në tabelën e mëposhtme.

BUXHETI PËR VITIN 2020

Nr,	Emërtimi	Vlera
I	SHPENZIME KOHERENTE	252,172,000
	Paga personeli	150,467,000
	Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	14,000,000
	Shpenzime të tjera Operative dhe Shërbime më të tretë	81,705,000
	Shpenzime Amortizim	6,000,000
II	INVESTIME	42,000,000
	Shpenzime për akomodimin për efekt të ristrukturimit 2019 -2020	42,000,000
III	Fond Rezervë	6,700,000
	Totali i shpenzime të pritshme të vitit 2020	300,872,000

SHTOJCA 1 Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare

Auditues Ligjore
Ludmilla Paluka Licensa 161 Eneida Rahmani Licensa 158

Raport i Audituesve Ligjore te Pavarur

Per

Auditimin e Pasqyrave Financiare te
Entit Regullator te Energjise
Viti ushtrimor i mbyllur me 31.12.2019

Tirane, me 28 Maj 2020

1

Auditues Ligjore
Ludmilla Paluka Licensa 161 Eneida Rahmani Licensa 158

PERMBAJTJA

I. RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

II. PASQYRAT FINANCIARE DERI NE 31.12.2019

- **Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci)**
- **Pasqyra e performances (pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve)**
- **Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare**

Auditues Ligjore

Ludmilla Paluka Licensa 161

Eneida Rahmani Licensa 158

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR**Kryetarit te Entit Regullator te Energjise, Z. Petrit AHMETI****Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **Entit Regullator te Energjise**, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të **Entit Regullator te Energjise** me datën 31 Dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me *Standardet Kombetare te Kontabilitetit (të përmiresuara)*.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Entit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë.

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk

3

Auditues Ligjore

Ludmilla Paluka Licensa 161

Eneida Rahmani Licensa 158

është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në varesi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalise materiale në pasqyrat financiare, të cilat mund të vijnë si pasoje e mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqerte të pasqyrave financiare me qëllim që të përcaktojë procedura auditimi që janë të pershtatshme për rrethanat, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e pershtatmerisë së politikave kontabel të përdorura, të arsyeshmerisë së cmuarjeve kontabel të bera nga drejtimi, si edhe vlerësimin për paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të tij, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që në mund të identifikojmë gjatë auditimit

Auditues Ligjore të Pavarur

Ludmilla Paluka

Eneida Rahmani



Rr.H.Hidi, Ndertesa nr 2, Zyra 9,
Tirane
Nr.kontakti 069 20 36 339.



Rr.Ali Demi Nr.16 Tirane
Nr.kontakti 068 20 51 151

Tirane, me 28 Maj 2020

Raporti i Auditimit është i vlefshëm vetëm për pasqyrat financiare bashkelidhur tij.

4

Emertimi dhe Forma ligjore:	Enti Rregullator i Energjise
NIPT -i:	K517170241
Adresa e Selise:	Bul" Bajram Curri", Rr" Viktor Eftimiu", Tirane
Data e krijimit:	15.10.1995

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2 dhe Ligjit Nr. 25/18, date 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare")

VITI 2019

Pasqyrat Financiare jane individuale
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek
Pasqyrat Financiare nuk jane te rrumbullakosura
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2019 - 31.12.2019
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 30.04.2020

ENTI RREGULLATOR I ENERGIJISE PASQYRAT FINANCIARE

2019


Enti Rregullator i Energjise
Pasqyra e Pozicionit financiar

AKTIVE	Shenime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktivet monetare	4	10,544,139	32,711,968
Investime		-	-
Të drejta të arkëtueshme		-	-
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		74,631,853	56,714,047
<i>Debitore te tjere</i>		-	-
<i>Te tjera</i>		62,754	52,604
Totali I te drejtave te arketueshme	5	74,694,607	56,766,651
Inventarët		-	-
<i>Lende e pare dhe materiale</i>		3,010,594	3,273,055
<i>Parapagime per inventar</i>		-	-
Totali I inventarit	6	3,010,594	3,273,055
Shpenzime të shtyra		-	-
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		-	-
Totali I aktiveve afatshkurtra		88,249,341	92,751,675
Aktive financiare		-	-
Aktivet materiale		-	-
<i>Ndertesa</i>		-	-
<i>Makineri e pajisje</i>		-	-
<i>Mjete transporti</i>		9,283,076	11,603,844
<i>Pajisje zyresh</i>		1,648,995	2,061,244
<i>Te tjera pajisje dhe informatike</i>		9,528,422	5,001,154
Totali I aktiveve materiale	7	20,460,493	18,666,243
Aktivet biologjike		-	-
Aktive jo materiale:		11,138,291	-
Aktive tatimore të shtyra		-	-
Kapitali i nënshkruar i papaguar		-	-
Total Aktive		119,848,124	111,417,918
<i>Enti Rregullator i Energjise</i>			
Pasqyra e Pozicionit financiar			

Kryetari


 Petrit Ahmeti


Hartuesi i pasqyrave


 Aferdita Bushi

1 | Shenimet shpjeguese nga faqja 5 deri ne faqen 13 jane pjese perberese e pasqyrave financiare

ENTI RREGULLATOR I ENERJISE PASQYRAT FINANCIARE

2019

Enti Rregullator i Energjise

Pasqyra e Pozicionit financiar

PASIV	Shenime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime afatshkurtra:			
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>			63,279
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		1,568,680	1,399,865
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>		1,070,030	2,009,065
<i>Te pagueshme te tjera</i>		60,972	142,125
Shuma detyrime afatshkurtra	8	2,699,681	3,614,334
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Arketime ne avance-Të ardhura të shtyra		11,093,822	18,846,169
Provizione		-	-
Total detyrime afatshkurtra		13,793,503	22,460,503
Detyrime afatgjata:			
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		-	-
Provizione		-	-
Detyrime tatimore të shtyra		-	-
Te pagueshme te tjera		-	-
Total detyrime afatgjata	9	-	-
Total detyrime		13,793,503	22,460,503
Kapitali dhe Rezervat			
<i>Fondet e ERE</i>		88,957,416	71,858,598
<i>Rritje/Renie fondi gjate vitit</i>		17,097,204	17,098,818
<i>Fitim / Humbja e Vitit</i>			
Total kapitali aksionar	10	106,054,620	88,957,416
Totali I kapitalit dhe I detyrimeve		119,848,124	111,417,919

Kryetari

Petrit Ahmeti



Hartuesi i pasqyrave

Aferdita Bushi

2 | Shenimet shpjeguese nga faqja 5 deri ne faqen 13 jane pjese perberese e pasqyrave financiare

ENTI RREGULLATOR I ENERJISE PASQYRAT FINANCIARE

2019

Enti Rregullator i Energjise

<u>Pasqyra e performances</u>	<u>Shenime</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga faturimet e Operatoreve	11	163,511,165	143,468,002
Te ardhura nga licensimet		8,441,600	10,129,781
Te ardhura nga Organizma mbulim shpenzimesh		1,645,661	3,409,230
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	12	-	-
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>			
<i>Të tjera shpenzime</i>		-	-
Shpenzime të personelit	13	(106,738,180)	(103,698,499)
<i>Paga dhe shpërblime</i>		(96,949,701)	(95,088,001)
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		(9,788,478)	(8,610,498)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	14	(6,600,539)	(5,071,658)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	15	(43,242,607)	(31,011,088)
Të ardhura të tjera		-	-
Zhvlerësimi i aktiveve dhe investimeve financiare		-	-
Shpenzime financiare	16	80,104	(126,949)
<i>Shpenzime per interesa-komisione</i>		(105,574)	(76,552)
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>			-
<i>Fitime/humbje nga kurset e kembimit</i>		142,515	(50,411)
<i>Te ardhura te tjera</i>		43,163	14
<i>Gjoha dhe interesa</i>		-	-
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		-	-
Rritja/Renia neto e fondeve	17	17,097,204	17,098,818

Kryetari



Petrit Ahmeti

Hartuesi i pasqyrave

Aferdita Bushi

Enti Rregullator i Energjise

(metoda indirekte)

3 | Shenimet shpjeguese nga faqja 5 deri ne faqen 13 jane pjese perberese e pasqyrave financiare

ENTI RREGULLATOR I ENERGIJISE PASQYRAT FINANCIARE

2019

Enti Rregullator i Energjise

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare	31 dhjetor 2019	(metoda indirekte) 31 dhjetor 2018
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
<i>Rritja/Renia neto e fondeve</i>	17,097,204	17,098,818
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	6,600,539	5,071,658
<i>Shpenzime te shtyra</i>	-	-
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>	-	-
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	-	-
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>	-	-
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	(17,927,956)	(17,854,281)
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>	262,461	(31,092)
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	(8,667,000)	10,625,814
<i>Rritje/(rënie) në detyrime afatgjata</i>	-	-
<i>Tatim fitimi I paguar</i>	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(2,634,752)	14,910,918
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	(19,533,077)	(35,000)
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	-	-
<i>Dividentë të arkëtuar</i>	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(19,533,077)	(35,000)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Mjete monetare neto nga aktivitetin e financimit		
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare	(22,167,829)	14,875,918
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	32,711,968	17,836,051
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	10,544,139	32,711,968

Kryetari

Petrît Ahmeti



Hartuesi i pasqyrave

Aferdita Bushi

4

Shenimet shprehëse nga faqja 5 deri ne faqen 13 jane pjese perberese e pasqyrave financiare

SHENIMET SHPJEGUESE

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria «Enti Rregullator i Energjise» është Ent Publik i pavaruar me NIPT K51717024I, i cili është krijuar në datë 15.10.1995 sipas Ligjit Nr. 7963 Datë 17.07.1995. Objekti i Ligjit rregullon maredheniet në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, si dhe vendos rregullat e këtij tregu. Kryetar i Entit Rregullator të Energjise është z. Petrit Ahmeti.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin dhe ligjin nr.25/18, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE PASQYRAT FINANCIARE

2019

flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

✓ Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

✓ Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

✓ Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

✓ Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

✓ Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuara, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

✓ Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

✓ Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

✓ Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

7 | *Shenimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 13 janë pjesë perberese e pasqyrave financiare*

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të Tjera	Vlera e mbetur	20%

Aktive jo materiale Vlera fillestare 15%
iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

ENTI RREGULLATOR I ENERGIJISE PASQYRAT FINANCIARE

2019

3.11 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12 Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci Kontabel, Aktivët**4. Aktivët monetare**

Aktivët monetare janë në shumën 10 544 139 leke, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr	Likujditete	Viti 2019	Viti 2018
1	Depozita në banke	10,544,139	32,711,968
2	Para në arke	0	0
	Totali	<u>10,544,139</u>	<u>32,711,968</u>

Depozitat në banke në monedhe të huaja janë të konvertuara me kursin e datës 31.12.2019, diferencat nga kursi i kembimit janë të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

5. Të drejta të arketueshme

Paraqitet shuma e të drejtave të arketueshme deri më 31.12.2019, prej 74 631 853 leke, si më poshtë:

Nr	Të drejta të arketueshme	Viti 2019	Viti 2018
1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit	74,631,853	56,714,047
1	Debitorë të tjerë	62,754	52,604
	Shuma	<u>74,694,607</u>	<u>56,766,651</u>

6. Inventarët

Në këtë post paraqitet më 31.12.2019 inventari i materialeve në shumën 3 010 594 leke, si më poshtë:

Nr	Inventarët	Viti 2019	Viti 2018
1	Lëndë e parë dhe materiale	3,010,594	3,273,055
	Parapagime për inventar		
	Shuma	<u>3,010,594</u>	<u>3,273,055</u>

ENTI RREGULLATOR I ENERGIJISE PASQYRAT FINANCIARE

2019

Gjendja e materialeve eshte vleresuar me koston e blerjes. Gjate vitit 2019 nuk eshte ndryshuar menyra e mbajtjes se inventarit e cila vazhdon te jete me koston e blerjes (sipas metodes FIFO, materialet qe blihen te para dalin te parat).

7. Aktive materiale dhe jomateriale

Aktivitet afat gjata materiale dhe jo materiale jane te paraqitura me koston e blerjes minus amortizimin e vitit. Vlera kontabel e tyre eshte 31 598 783 leke, sipas dy tabelave te meposhtme :

Nr	Aktive afatgjata materiale	Viti 2019	Viti 2018
1	Mjete transpori	9,283,076	11,603,844
2	Pajisje informatike dhe zyre	11,177,417	7,062,399
	Totali	<u>20,460,493</u>	<u>18,666,243</u>

Nr	Aktive jo materiale	Viti 2019	Viti 2018
1	Sistemi dixhitalizimit - Studimi	11,138,291	-
	Totali	<u>11,138,291</u>	<u>-</u>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018.

Bilanci Kontabel, Pasivet

8. Detyrime afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra te shoqerise me 31.12.2019 paraqiten ne shumen 2 699 681 leke, si me poshte :

Nr	Detyrime afatshkurtra:	Viti 2019	Viti 2018
1	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	-	63,279
2	Të pagueshme ndaj punonjësve	8,170	
3	Të pagueshme ndaj sigurimeve	1,560,510	1,399,865
4	Të pagueshme ndaj TAP	1,070,029	2,009,065
5	Të tjera të pagueshme	60,972	142,125
	Shuma	<u>2,699,681</u>	<u>3,614,334</u>

9. Te ardhura te shtyra

Paraqitet detyrimi i shoqerise ne shumen 11 093 822 leke ne 31.12.2019:

Nr	Te ardhura te shtyra	Viti 2019	Viti 2018
1	Te ardhura nga mbi pagesa KESH	7,166,703	6,193,588
2	Te ardhura nga mbi pagesa Gurshpati		16,516
3	Te ardhura nga mbi pagesa AlbGazi	9,284	
4	Te ardhura nga mbi pagesa OST	3,917,835	12,636,065
	Shuma	<u>11,093,822</u>	<u>18,846,169</u>

ENTI RREGULLATOR I ENERGIJISE PASQYRAT FINANCIARE

2019

10. Kapitali

Kapitali paraqitet si me poshte:

Nr	Fonde te ERE	Viti 2019	Viti 2018
1	Fonde te mbartura	88,957,416	71,858,598
2	Ritje/Renie fonesh gjate vitit ushtrimor	17,097,204	17,098,818
	Totali	<u>106,054,620</u>	<u>88,957,416</u>

Gjate vitit 2019 kapitalet e veta jane rritur ne shumen pre 17 097 204 leke. Totali i kapitaleve te veta te shoqerise eshte 106 054 620 leke.

PASH - Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve**11. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit**

Te ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shoqerise per vitin 2019 jane 173 598 426 leke.

Nr	Te ardhurat	Viti 2019	Viti 2018
1	Të ardhura nga faturimet e Operatoreve	163,511,165	143,468,002
2	Te ardhura nga Organizma mbulim shpenzimesh	8,441,600.00	3,409,229.87
3	Te ardhura nga licensimet	1,645,661	10,129,781
	Shuma	<u>173,598,426</u>	<u>157,007,013</u>

12. Lenda e pare dhe Materiale te konsumueshme

Shoqeria ka shpenzime te lendes se pare dhe materialeve te konsumueshme gjate vitit 2019 me nje vlere prej 3.228.389 leke.

13. Shpenzime te personelit

Shpenzimet per personelin ne shumen 106 738 180 leke jane te detajuara si me poshte :

Nr	Kosto e Punes	Viti 2019	Viti 2018
1	Shpenzime per paga	96,949,701	95,088,001
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	9,788,478	8,610,498
	Shuma	<u>106,738,180</u>	<u>103,698,499</u>

14. Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi

Jane llogaritur shpenzimet per amortizimin e asetete sipas normave ligjore ne fuqi ne shumen 6 600 539 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Amortizimi I aktiveve	6,600,539	5,071,658
	Shuma	<u>6,600,539</u>	<u>5,071,658</u>

15. Shpenzime te tjera te aktivitetit

Ne kete ze jane ne shumen 43 242 607 leke, te perfshira si ne tabelen e meposhtme :

Nr	Emertimi i shpenzimit	Viti 2019	Viti 2018
1	Shpenzime te lende para e konsumi	3,228,382	2,889,757
2	Sherbime te ndryshme nga te tretet	4,893,444	4,490,595

12

Shenime shpjeguese nga faqja 5 deri ne faqen 13 jane pjese perberese e pasqyrave financiare

ENTI RREGULLATOR I ENERJISE PASQYRAT FINANCIARE

2019

3	Shpenzime uje energji	623,427	448,289
4	Mirembajtje automjete e taxa te lidhura me to	1,212,446	761,562
5	Publikime ne media	1,256,900	1,494,850
6	Udhetime dieta J.vend; kuotizacion	30,416,602	17,896,221
7	Poste telefon etj	974,587	1,039,860
8	Taksa dhe tarifa vendore	15,819	15,069
9	Trajnime profesionale	72,000	1,874,885
10	Te tjera	549,000	100,000
	Shuma	<u>43,242,607</u>	<u>31,011,088</u>

16. Shpenzime financiare

Paraqiten te ardhura per vitin 2019 ne shumen 80 104 leke te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Sherbime bankare	105,574	76,552
2	Humbje kursi kembimit		50,494
3	Rezultat nga kursi kembimit	-142,515	-83
4	Te tjera	-43,163	-14
	Shuma	<u>(80,104)</u>	<u>126,949</u>

Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

17. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Administratori


Petrit AHMETI



Hartuesi i pasqyrave


Aferdita BUSHI

SHTOJCA 2 Raporti i Performancës



Raport i Sigurisë së Profesionistit të Pavarur

Kryetarit dhe Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)

Enti Rregullator i Energjisë ("ERE" ose "Enti") angazhoi "GRANT THORNTON sh.p.k" ("Grant Thornton") për të shqyrtuar informacionin jo-financiar të paraqitur në Raportin Vjetor për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 ("të dhëna e zgjedhura"), me qëllim dhënien e sigurisë së kufizuar sipas kriterëve të përshkruara më poshtë (Qëllimi i punës). Për qëllimet e këtij raporti, të dhënat e zgjedhura kanë të bëjnë me veprimtarinë e Entit në Shqipëri dhe nuk përfshijnë informacione që kanë të bëjnë me palë të tjera bashkëpunuese ose aktivitete / performanca të palëve të treta.

Qëllimi i punës

Angazhimi i dhënies së sigurisë është planifikuar dhe kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar SNAS 3000, "Angazhimet e Dhënies së Sigurisë ("SNAS 3000") që ndryshojnë nga Auditimet ose Rishikimet e Informacioneve Financiare Historike", me qëllim që të japim një opinion për dhënie sigurie të nivelit të kufizuar për:

- Verifikimin e informacioneve shpjeguese cilësore dhe sasore të paraqitura në Raportin Vjetor 2019 në mënyrë specifike për gjëndjen në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në krahasim me kriteret e zbatueshme ("Kriteret e Performancës", të ilustruara në Raportin Vjetor), të cilat sigurojnë përputhshmeri ligjore me udhëzimet dhe detyrat e lëna nga Rezoluta e Parlamentit të Shqipërisë, datë 20 qershor 2019, mbështetur në Ligjin nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar.

Përgjegjësitë e drejtimit

Drejtimi i të Entit Rregullator të Energjisë është përgjegjës për përgatitjen, prezantimin, tërësinë dhe saktësinë e të dhënave jofinanciare të dhëna për ne, siç paraqiten në Raportin Vjetor 2019. Për më tepër, drejtimi i ERE është përgjegjës për regjistrimet e mbajtura dhe kontrollet e brendshme të përshtatshme që janë krijuar për të mbështetur procesin e raportimit dhe të përputhshmërisë ligjore. Në mënyrë të veçantë, drejtimi është përgjegjës për hartimin e kontrolleve të brendshme dhe zbatimin e tyre për të parandaluar që Raporti të ketë anomali materiale.

Përgjegjësitë e Grant Thornton

Ne kemi kryer një shërbim dhënie sigurie të kufizuar. Përgjegjësia jonë është të shprehim konkluzionin tonë bazuar në procedurat e kryera, për të dhënat e zgjedhura, siç përshkruhet më sipër në seksionin "Qëllimi i punës".

Përgjegjësia jonë është e kufizuar në informacionin shpjegues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, të prezantuar në Raportin Vjetor për vitin 2019.

Në masën që lejohet nga legjislacioni në fuqi, ne nuk pranojmë dhe nuk marrim asnjë përgjegjësi për angazhimin tonë, ndaj kujtdo tjetër përveç ERE, përveç rasteve kur është rënë dakord në mënyrë të shkruar, me pëlqimin tonë paraprak.

Ne kemi kryer punën tonë duke mbledhur gjitha të dhënat, dokumentacionin përkatës, informacionin dhe shpjegimet që ne i konsideruam të nevojshme për të dhënat e zgjedhura të përshkruara, në seksionin "Qëllimi i punës". Procedurat e ndjekura në lidhje me të dhënat e zgjedhura përfshijnë:

- Intervistat me drejtimin dhe personelin përgjegjës për informacionin dhe supozimet përkatëse.
- Vizita në ambientet e Entit Rregullator të Energjisë.
- Rishikimet dhe vlerësimet të proceseve dhe kontrolleve të përdorura për mbledhjen, grumbullimin, vlerësimin dhe raportimin e të dhënave;
- Teste me zgjedhje mbi të dhënat e mbledhura dhe formulat, kur kërkohen.

Niveli i Dhënies së Sigurisë

Procedurat që kemi kryer janë hartuar për të ofruar siguri të kufizuar, siç specifikohet në SNAS 3000, mbi të cilat ne u bazuam për të arritur në konkluzione për angazhimin tonë. Këto procedura nuk janë aq të zgjeruara sa ato që kërkohen për dhënien e sigurisë së arsyeshme; për pasojë, merret një nivel më i ulët i sigurisë.

Kufizimet

Për të kryer punën tonë, ne u mbështetëm ekskluzivisht në informacionin e dhënë nga drejtuesit e Drejtorive të Entit Rregullator të Energjisë, të cilin ne e pranuan me mirëbesim si informacion të plotë, të saktë, të vërtetë dhe jo mashtrues.

- Si rrjedhim, ne nuk kemi kryer procedura verifikimi shtesë, përveç procedurave të përcaktuara në mënyrë të qartë në Raportin tonë në seksionin, Përgjegjësitë e Grant Thornton, të cilat rrjedhin nga metodologjia e rene dakort reciprokisht.
- Asnjë punë nuk është kryer për të dhënat të periudhave të raportimeve të mëparshme, si dhe mbi të dhënat në lidhje me objektivat dhe parashikimet.
- Asnjë punë nuk është kryer për asgjë tjetër përveç qëllimit të rënë dakord dhe për rrjedhojë, mendimi ynë është i kufizuar për këtë qëllim.

Pavarësia

Grant Thornton zbaton kërkesat e Standardit Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë 1. Bazuar në këtë, mbajmë një sistem të kontrollit të integruar të cilësisë që përfshin politikat dhe procedurat për respektimin e parimeve morale, standardeve profesionale dhe kërkesave përkatëse ligjore dhe rregullatore. Ne jemi në përputhje me kërkesat e pavarësisë dhe standardet e tjera etike të Kodit Etikës së IFAC për profesionistët të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Audituesit (IESBA), i cili bazohet në parimet themelore të integritetit, paanshmërisë, përshtatshmërisë profesionale, konfidencialitetit dhe sjelljes profesionale. Në këtë kontekst, ekipi i dhënies së sigurisë është i pavarur nga Entit Rregullator të Energjisë dhe nuk ka marrë pjesë në përgatitjen e Raportit Vjetor për vitin 2019.

Konkluzione

Bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e marrë, asgjë nuk ka tërhequr vëmendjen tonë që të na bëjë të besojmë se ka ndonjë gabim ose anomali që do të ndikonte materialisht në dhënien e informacioneve rreth përputhshërisë ligjore të aktivitetit (përfshirë shënimet shpjeguese dhe referencat përkatëse) siç paraqiten në Raportin Vjetor të Entit Rregullator të Energjisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019. Për më tepër, asgjë nuk ka tërhequr vëmendjen tonë që të bëjë të besojmë se të dhënat e paraqitura, nuk janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përmendura më lart, në seksionin "Qëllimi i punës".

Tirana, 29/05/2020

Grant Thornton sh.p.k



Kledian Kodra



SHTOJCA 3 Regjistri i Vendimeve të ERE-s gjatë vitit 2019

Nr. 1	Datë 09.01.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e “Trans Adriatic Pipeline” AG, në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.	Fletore Zyrtare me Nr. 4 Datë 18.01.2019
Nr. 2	Datë 17.01.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratim të “Propozimit të të gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 Korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionëve”	Fletore Zyrtare me Nr. 8 Datë 01.02.2019
Nr. 3	Datë 17.01.2018	Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë MTC ENERGY sh.p.k., për vendosje hipoteke dhe barrë mbi asetet e shoqërisë “M.T.C ENERGY” sh.p.k, për efekt të ristrukturimit të kredisë në favor të Raffeisen Bank sh.a.	Fletore Zyrtare me Nr. 8 Datë 01.02.2019
Nr. 4	Datë 17.01.2019	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “KESH” sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr. 8 Datë 01.02.2019
Nr. 5	Datë 17.01.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “HYDRO SETA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr. 8 Datë 01.02.2019
Nr. 6	Datë 17.01.2019	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k, për modifikimin e Licencës me nr. 247, Seria PV14K, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 92, datë 16.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga Hecet: “GERMANI 1” me kapacitet të instaluar 1200 KW, “GERMANI 2” me kapacitet	Fletore Zyrtare me Nr. 8 Datë 01.02.2019
Nr. 7	Datë 17.01.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Dhjetor 2018.	Fletore Zyrtare me Nr. 8 Datë 01.02.2019
Nr. 8	Datë 17.01.2019	Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2019.	Fletore Zyrtare me Nr. 8 Datë 01.02.2019
Nr. 9	Datë 24.01.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit(kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energjitik për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a..	Fletore Zyrtare me Nr.17 Datë 14.02.2019
Nr. 10	Datë 24.01.2019	Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të	Fletore Zyrtare me Nr.17

		energjisë elektrike miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 113, datë 08.07.2016.	Datë 14.02.2019
Nr. 11			
Nr. 12			
Nr. 13	Datë 31.01.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “RTS” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik, me fuqi të instaluar 2MW, në fshatin Tren, Bilisht të Rrethit Korçë.	Fletore Zyrtare me Nr.17 Datë 14.02.2019
Nr. 14	Datë 31.01.2019	Mbi shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2018 dhe planit 10 vjeçar 2018-2027 të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë “ALBGAZ” sh.a..	Fletore Zyrtare me Nr.17 Datë 14.02.2019
Nr. 15	Datë 31.01.2019	Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të “Trans Adriatic Pipeline AG ALBANIA”, e rregjistruar pranë qkb, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a), “Trans Adriatic Pipeline AG”.	Fletore Zyrtare me Nr.17 Datë 14.02.2019
Nr. 16	Datë 18.02.2019	Mbi shtyrjen e afatit të zbatimit të Kontratës Tip për shit-blejjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018 dhe Kontratës për shit-blejjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezultojnë pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018-31.12.2018”.	Fletore Zyrtare me Nr.23 Datë 26.02.2019
Nr. 17	Datë 18.02.2019	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Enrgy Trading” sh.a., në	Fletore Zyrtare me Nr.23
Nr. 18	Datë 18.02.2019	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.23 Datë 26.02.2019
Nr. 19	Datë 18.02.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave në “Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues”, miratuar me Vendimin e Bordit Të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.	Fletore Zyrtare me Nr.23 Datë 26.02.2019
Nr. 20	Datë 18.02.2019	Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 245, datë 26.11.2018, “Për licencimin e shoqërisë “Renrgy Trading Group” sh.p.k në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.23 Datë 26.02.2019
Nr. 21	Datë 18.02.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.23 Datë 26.02.2019

Nr. 22	Datë 18.02.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.23 Datë 26.02.2019
Nr. 23	Datë 18.02.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Janar 2019.	Fletore Zyrtare me Nr.23 Datë 26.02.2019
Nr. 24			
Nr. 25	Datë 28.02.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.30 Datë 12.03.2019
Nr. 26	Datë 28.02.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për fillimin e procedurës për një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr 103 datë 23.06.2016 “, i ndryshuar.	Fletore Zyrtare me Nr.30 Datë 12.03.2019
Nr. 27	Datë 28.02.2019	Për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “THIRRE” me fuqi të instaluar 1820 KW.	Fletore Zyrtare me Nr.30 Datë 12.03.2019
Nr. 28	Datë 28.02.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.30 Datë 12.03.2019
Nr. 29	Datë 28.02.2019	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Hidro Vizion” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “RAZDOLL” me fuqi të instaluar 700 KW.	Fletore Zyrtare me Nr.30 Datë 12.03.2019
Nr. 30	Datë 28.02.2019	Mbi pranimin e kërkesës së shoqërisë “A.E Distribution” sh.p.k. për heqjen e licencës së veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.30 Datë 12.03.2019
Nr. 31	Datë 28.02.2019	Mbi pranimin e kërkesës së shoqërisë “A.E. Distribution” sh.p.k për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.30 Datë 12.03.2019
Nr. 32	Datë 28.02.2019	Mbi miratimin e “Propozimit të të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.	Fletore Zyrtare me Nr.30 Datë 12.03.2019

Nr. 33	Datë 28.02.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “SIMA-COM” sh.p.k., për fillimin e procedurës për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018 “Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”.	Fletore Zyrtare me Nr.30 Datë 12.03.2019
Nr. 34	Datë 28.02.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “AFRIMI K” sh.p.k., për fillimin e procedurës për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018 “Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”.	Fletore Zyrtare me Nr.30 Datë 12.03.2019
Nr. 35			
Nr. 36	Datë 04.03.2019	Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar me Vendimin me nr. 261, datë 19.12.2018, “Për licencimin e shoqërisë ALBGAZ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”.	Fletore Zyrtare me Nr.30 Datë 12.03.2019
Nr. 37	Datë 04.03.2019	Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 188 datë 10.11.2017, i ndryshuar me Vendimin nr. 262, datë 19.12.2018, “Për licencimin e shoqërisë ALBGAZ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”.	Fletore Zyrtare me Nr.30 Datë 12.03.2019
Nr. 38	Datë 07.03.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrik.	Fletore Zyrtare me Nr.34 Datë 19.03.2019
Nr. 39	Datë 07.03.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.34 Datë 19.03.2019
Nr. 40	Datë 07.03.2019	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e “Udhëzuesit për monitorimin e tregut të energjisë elektrike”.	Fletore Zyrtare me Nr.34 Datë 19.03.2019
Nr. 41	Datë 15.03.2019	Mbi rrëzimin e kërkesës së OST sh.a., mbi nëvojën e ndërhyrjeve në rrjetin e transmetimit.	Fletore Zyrtare me Nr.45 Datë 03.04.2019
Nr.42	Datë 15.03.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Shkurt 2019.	Fletore Zyrtare me Nr.45 Datë 03.04.2019
Nr. 43	Datë 15.03 .2019	Mbi miratim e “Propozimit të të gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 Korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionëve”	Fletore Zyrtare me Nr.45 Datë 03.04.2019

Nr. 44	Datë 15.03.2019	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “AYEN ENERGY TRADING” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.45 Datë 03.04.2019
Nr. 45	Datë 15.03.2019	Mbi rinovimin e licences së shoqërisë “AYEN ENERGY TRADING” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me Nr.45 Datë 03.04.2019
Nr. 46	Datë 19.03.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, nga ana e OSHEE sh.a. dhe çështje të tjera të rregullimit.	Fletore Zyrtare me Nr.45 Datë 03.04.2019
Nr. 47	Datë 19.03.2019	Mbi miratimin e kërkesës së OST sh.a. për një ndryshim në Vendimin e ERE nr. 43 datë 15.03.2017 Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.	Fletore Zyrtare me Nr.45 Datë 03.04.2019
Nr.48	Datë 27.03.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “S.P.E GJADËR” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hecet “GJADËR NR. 1/1” me kapacitet të instaluar 2134 kw, Hec “GJADËR NR. 1/2” ME KAPACITET TË INSTALUAR 4406 KW, HEC “GJADËR NR. 2” me kapacitet të instaluar 2983 kw, Hec “GJADËR NR. 3” me kapacitet të instaluar 3874 kw, Hec “GJADËR NR. 4” me kapacitet të instaluar 5922 kw, Hec “GJADËR NR. 6” me kapacitet të instaluar 5619 kw, me kapacitet total të instaluar 24.938 kw.	Fletore Zyrtare me Nr. 47, Datë. 09/04/2019
Nr. 49	Datë 27.03.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, të lidhur ndërmjet shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. dhe shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. për vitin 2019.	Fletore Zyrtare me Nr. 47, Datë. 09/04/2019
Nr. 50	Datë 27.03.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2MW, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier.	Fletore Zyrtare me Nr. 47, Datë. 09/04/2019
Nr. 51			
Nr. 52			

Nr. 53	Datë 03.04.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për kriteret standarde minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”.	Fletore Zyrtare me 55, Datë. 19/04/2019
Nr. 54	Datë 03.04.2019	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2019 për shoqërinë OST sh.a.	Fletore Zyrtare me 55, Datë. 19/04/2019
Nr. 55	Datë 03.04.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Mars 2019	Fletore Zyrtare me 55, Datë. 19/04/2019
Nr. 56	Datë 03.04.2019	Mbi fillimin e procedurës për transpozimin e Rregullores 2017/459 të miratuar me Vendimin nr. 2018/06/PHGL-ENC “Mbi themelimin e Kodit të Rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror”.	Fletore Zyrtare me 55, Datë. 19/04/2019
Nr. 57	Datë 15.04.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin A, B, C dhe D, sipas Vendimit të ERE-s nr. 129, datë 04.06.2018, “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”.	Fletore Zyrtare me 66, Datë. 08/05/2019
Nr. 58	Datë 15.04.2019	Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE) sh.a. dhe furnizuesit.	Fletore Zyrtare me 66, Datë. 08/05/2019
Nr. 59	Datë 15.04.2019	Për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “S G D ENERGJI” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “NDËRFUSHAS” me fuqi totale të instaluar 1125 KW.	Fletore Zyrtare me 66, Datë. 08/05/2019
Nr. 60	Datë 15.04.2019	Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAS” sh.a, prej 28 Lekë/M3 ose 2.6457 Lekë/KWH, deri më datë 31.12.2019.	Fletore Zyrtare me 66, Datë. 08/05/2019
Nr. 61	Datë 19.04.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ENERGY 24” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me 64, Datë. 06/05/2019
Nr. 62	Datë 23.04.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “GEN-I TIRANA” sh.p.k. për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 46 datë, 19.03.2019 “Mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të	Fletore Zyrtare me 67, Datë. 10/05/2019

		parregulluar, nga ana e OSHEE sh.a. dhe çështje të tjera të rregullimit”.	
Nr. 63	Datë 23.04.2019	Për një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAS sh.a.” të ndryshuar.	Fletore Zyrtare me 67, Datë. 10/05/2019
Nr. 64	Datë 23.04.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e “Englatina Xhoxhaj” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Lugano”, me kapacitet të instaluar 2 MW, në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Fletore Zyrtare me 67, Datë. 10/05/2019
Nr. 65			
Nr.66			
Nr. 67	Datë 26.04.2019	Për miratimin e raportit vjetor të ERE-s, “Gjendja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2018”	
Nr. 68	Datë 10.05.2019	Mbi fillimin e procedurave “Mbi miratimin e draft-kontratës tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/Kesh sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/Oshee sh.a për periudhën 01.03.2019 – 31.12.2019.	Fletore Zyrtare me 79, Datë. 30/05/2019
Nr. 69	Datë 10.05.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike	Fletore Zyrtare me 79, Datë. 30/05/2019
Nr. 70	Datë 10.05.2019	Mbi fillimin e procedurës, për modifikimin e e licencës së shoqërisë “henz energy” sh.p.k, nr. 158, seria pv12k, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ere-s nr.65, datë 28.05.2012, për licencimin e shoqërisë “henz energy” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec – et “darsi 1”, “darsi 2”, “darsi 3”.	Fletore Zyrtare me 79, Datë. 30/05/2019
Nr. 71	Datë 10.05.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Power and Gas Operations” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me 79, Datë. 30/05/2019
Nr. 72	Datë 10.05.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali Fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2MW, në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë Bashkia Fier.	Fletore Zyrtare me 79, Datë. 30/05/2019
Nr. 73	Datë 10.05.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimit të të gjithë Ost-ve të Evropës kontinentale për karakteristikat shpesh të FRC në	Fletore Zyrtare me 81,

		përputhje me nenin 154 (2) të rregullores së komisionit të be 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”	Datë. 05/06/2019
Nr. 74	Datë 10.05.2019	Mbi miratimin e “Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike” nënshkruar midis OSHEE sh.a dhe “Kastrati Energy” sh.p.k.	Fletore Zyrtare me 79, Datë. 30/05/2019
Nr. 75	Datë 10.05.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin prill 2019	Fletore Zyrtare me 79, Datë. 30/05/2019
Nr. 76	Datë 31.05.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores mbi sistemin e njëhësuar të llogarive për shoqëritë e rregulluara në sektorin e gazit natyror, përfshirë auditimin e llogarive ”	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 77	Datë 31.05.2019	Mbi miratimin e “Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike” nënshkruar midis OSHEE sh.a dhe Energia Gas and Power shpk	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 78	Datë 31.05.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin maj 2019	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 79	Datë 31.05.2019	Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të komisionerëve të Ere nr.67, datë 27.07.2019 për licensimin e shoqërisë “Dosku - EnERGZ” sh.p.k ne veprimtarine e prodhimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 80	Datë 31.05.2019	Mbi licensimin e shoqërisë “Energy 24” shpk, në aktivitetin e tregtimit të enegjise elektrike.	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 81	Datë 31.05.2019	Mbi licensimin e shoqërisë “SGD Energji” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë eleltriike nga Hec “Ndërfushas” me fuqi të instaluar 1125 KW.	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 82	Datë 31.05.2019	Mbi fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “ Diezela” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “LJUSA” me kapacitet të instaluar 1980 kW.	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 83	Datë 31.05.2019	Mbi licensimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektirk nga Hec “THIRRE ”.	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019

Nr.84	Datë 31.05.2019	Mbi miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimit të balancimit (Kapacitetit rezerve dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energjitik për periudhën kohore 01.01.2019- 31.12.2019 midis OST sh.a dhe KESH sh.a.	Fletore Zyrtare me 95, Datë. 02/07/2019
Nr. 85	Datë 31.05.2019	Mbi miratimin e kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin A,B. Dhe C, sipas vendimit të ERE-s nr.129, datë 04.06.2019, “Mbi miratimin e kodit të rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”.	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 86	Datë 31.05.2019	Mbi miratimin e “Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike” nënshkruar midis OSHEE sh.a dhe Renrgy Trading Group sh.p.k.	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 87	Datë 31.05.2019	Mbi licensimin e shoqërisë “Englantina Xhoxhaj” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Lugano”, me kapacitet të instaluar 2 MW në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 88	Datë 31.05.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimit të të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të rregullores së komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionëve.”	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 89	Datë 31.05.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sha, në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 90	Datë 31.05.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e draft kontratës ndërmjet Kesh sha dhe Oshee sha, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezultojnë pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 91	Datë 31 .05.2019	Mbi një ndryshim në “marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Oshee sha dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, të miratua me vendimin e bordit të ERE nr. 24, datë 15.02.2017 i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.04.2019.	Fletore Zyrtare me 88, Datë. 31/05/2019
Nr. 92			
Nr. 93	Datë 03.06.2019	Mbi rezultatet e monitorimit të kryer pranë shoqërisë KESH sh.a. lidhur me ankesën e	Fletore Zyrtare me 91,

		shoqërisë Gen-i tirana sh.p.k. mbi zbatimin e procedurave të shit-blerjes së energjisë elektrike për vitin 2017 dhe periudhën janar-mars 2018 si dhe monitorimit lidhur me zbatimin e kontratave të depozitimit dhe shkëmbimit nga Kesh sh.a për vitet 2017 dhe 2018.	Datë. 25/06/2019
Nr. 94			
Nr. 95	Datë 17.06.2019	Mbi miratimin “Udhëzuesit për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik”.	Fletore Zyrtare me 101, Datë. 12/07/2019
Nr. 96			
Nr. 97	Datë 21.06.2019	Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e periudhës tranzitore të vendosur në pikën 2 të Vendimit nr. 46, dt.19.03.2019 të bordit të ERE-s.	Fletore Zyrtare me 101, Datë. 12/07/2019
Nr. 98	Datë 21.06.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a për vitin 2019 dhe përditësimin të planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare.	Fletore Zyrtare me 101, Datë. 12/07/2019
Nr. 99	Datë 21.06.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me 101, Datë. 12/07/2019
Nr. 100	Datë 21.06.2019	Për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”.	Fletore Zyrtare me 101, Datë. 12/07/2019
Nr. 101			
Nr. 102	Datë 26.06.2019	Mbi miratimin e “Propozimit të të gjitha ost-ve të europës kontinentale për karakteristikat shtesë të rezervave të mbajtjes së frekuencës (FCR) në përputhje me nenin 154 (2) të rregullores së komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017 që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.	Fletore Zyrtare me 103, Datë. 17/07/2019
Nr. 103	Datë 26.06.2019	Mbi miratimin e transpozimit të rregullores 2017/459 të miratuar me vendimin nr.2018/06/PHGL-ENC “Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit”.	Fletore Zyrtare me 104, Datë. 18/07/2019
Nr. 104	Datë 26.06.2019	Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, “Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të ndryshuar.	Fletore Zyrtare me 103, Datë. 17/07/2019

Nr. 105	Datë 26.06.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k., në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me 103, Datë. 17/07/2019
Nr. 106	Datë 26.06.2019	“Mbi licencimin e shoqërisë “Sang 1” sh.p.k., në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike”.	Fletore Zyrtare me 103, Datë. 17/07/2019
Nr. 107	Datë 26.06.2019	“ Për një ndryshim në vendimin e bordit të Ere-s nr. 83, datë 31.05.2019, Mbi licencimin e shoqërisë “Sang 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Thirrë” me kapacitet të instaluar 1.820 MW”.	Fletore Zyrtare me 103, Datë. 17/07/2019
Nr. 108	Datë 26.06.2019	“Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Besta” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai “Kucova 2” me kapacitet të instaluar 2 MW”.	Fletore Zyrtare me 103, Datë. 17/07/2019
Nr. 109	Datë 01.07.2019	Mbi Një Ndryshim në Vendimin Bordit të ERE Nr.207 datë 18.12.2017 “Për Miratimin e Rregullores për Kriteret Standarte të Cilësisë së Shërbimit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”	Fletore Zyrtare me 140, Datë. 17/10/2019
Nr. 110			
Nr. 111	Datë 10.07.2019	“ Vendim Nr. 111 datë 10.07.2019, Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin qershor 2019”	Fletore Zyrtare me 103, Datë. 17/07/2019
Nr. 112	Datë 22.07.2019	Vendim Nr. 112, datë, 22.07.2019, “Mbi modifikimin e Licences se shoqerise “Henz Energy” sh.p.k, nr.158, seria PV12K, te miratuar me vendimin e bordit te komisionerve te ERE-s nr.65, datë 28.05.2012 , per prodhimin e energjise elektrike nga HECET:Darsi 1 me kapacitet 2240 kW, Darsi 2 me kapacitet 7633 KW, Darsi 3 me kapacitet 1066 KW, me kapaciete total 10939 KW”	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019
Nr. 113	Datë 22.07.2019	Vendim Nr. 113, datë, 22.07.2019, “Mbi fillimin e procedurës për licensimin e shoqerise ‘IRARBA ENERGGJI’ sh.p.k, ne veprimtarine e prodhimit te energjise elektrike nga Hec ‘SHËNGJUN’” me kapacitet të instaluar 2040 KW”.	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019
Nr. 114	Datë 22.07.2019	Vendim Nr. 114, datë, 22.07.2019, “Mbi Liçencimin e Shoqërisë, “S.P.E GJADËR” Sh.p.k , në Veprimtarinë e Prodhimit të Energjisë Elektrike, nga HEC GJADËR Nr.1/1, Me Kapacitet të Instaluar 2134 KW , HEC GJADËR Nr. ½ , me Kapacitet të instaluar 4406 KW, HEC GJADËR Nr.2 me Kapacitet të instaluar 2983	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019

		KW, HEC GJADËR Nr.3 me Kapacitet të të instaluar 3874 KW, HEC GJADËR Nr.4 “	
Nr. 115	Datë 22.07.2019	Vendim Nr. 115, datë, 22.07.2019 “Një Ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE Nr. 265 datë 20.12..2018, Për Liçencimin e Shoqërisë “BE-IS-ENERGY “ Sh.p.k , në Veprimtarinë e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-ET , “ Kalivar 1” me Fuqi Të Instaluar 1475 KW, Hydrocentrali “Kalivarë 2“ , me Fuqi të Instaluar 526 KW , Hydrocentrali “Kalivarë 3 “me Fuqi të Instaluar 3321 KW dhe “Kalivarë 4“, me Fuqi të Instaluar 275 KW , Me Fuqi Totale të instaluar 5597 KW”	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019
Nr. 116	Datë 22.07.2019	Vendim Nr.116, datë, 22.07.2019 “Mbi miratimin e ‘Propozimit të tët gjithë OST-ve për një metodologji të përbashket të rjetit në perputhje me nenin 17 të rregullores së komisionit (BE) 2012/1222 të datës 24 korrik 2015, që percakton një udhëzës mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve”.	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019
Nr. 117	Datë 22.07.2019	Vendim Nr.117, datë, 22.07.2019 “Mbi miratimin e një ndryshimi në “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së Energjisë Elektrike ndërmjet OSHEE Sh.a dhe furnizuesve të Energjise Elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Ere-s nr.24, datë 15.02.2019. i ndryshuar me vendimi nr.58, datë 15.04.2019”.	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019
Nr. 118	Datë 22.07.2019	Vendim Nr.118, datë, 22.07.2019, “Mbi fillimin e Procedurave për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjise Elektrike”.	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019
Nr. 119	Datë 22.07.2019	Vendim Nr.119, datë, 22.07.2019, “Mbi Fillimin e Procedurave për Rinovimin e Liçencës së Shoqërisë “GSA” Sh.p.k në Veprimtarinë e Furnzimit të Energjisë Elektrike”.	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019
Nr. 120	Datë 22.07.2019	Vendim Nr.120, datë, 22.07.2019 “Mbi fillimin e Procedures për Liçensimin e Shoqërisë “Enesco Trading (ALBANIA)” Sh.p.k në Veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike”.	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019
Nr. 121	Datë 22.07.2019	Vendim Nr.121, datë, 22.07.2019, “ Mbi kërkesën e Shoqërisë “SPAHIU GJANÇ” Sh.p.k për dhënien e Autorizimit nga ana ERE-s, për ndryshimin e Ortakëve të Shoqërisë “SPAHIU GJANÇ” Sh.p.k, ndërmjet shitjes së 100% të kuoatave të kapitalit, tek Shoqëria ‘ Hidro Invest’ Sh.p.k”.	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019

Nr. 122	Datë 29.07.2019	Vendim Nr.122, datë, 29.07.2019, “Miratimin e Draft Kontratës ndërmjet “KESH SH.A” dhe OSHEE SH.A/OSSH, Për Shit-Blerjen e Sasisë së tepërt të Energjisë Elektrike, që rezulton pas Përbushjes së Kërkesës së Klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal me Qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e Shpërndarjes , për periudhën kohore 01.01.2019- 31.12.2019”	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019
Nr. 123	Datë 29.07.2019	Vendim Nr.123, datë, 29.07.2019, “Fillimin e Proçedurës për Shqyrtimin e Kërkesës së OSHEE SH.A për një ndryshim në “Rregulloren për Proçedurat e Blerjes së Energjisë Elektrike për mbulimin e Humbjeve në Rrjetet e Shpërndarjes dhe të Transmetimit dhe për Blerjen e Energjisë Elektrike për të Siguruar Përbushjen e Detyrimeve të Shërbimit Publik”	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019
Nr. 124			-
Nr. 125			-
Nr. 126	Datë 08.08.2019	Vendim Nr.126, datë, 08.08.2019, “Përcaktimin e Çmimit të Shitjes Së Energjisë Elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit Për Muajin Korrik 2019”	Fletore Zyrtare me 118, Datë.16/08/2019
Nr.127	Datë 13.08.2019	Vendim Nr. 127 date 13.08.2019”Mbi Rinovimin e Liçencës së Shoqërisë “GSA: SH.p.km me Nr. 246, Seria FK14, në Veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike të Miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr.102 datë 21.12.2009, Rinovuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE me Nr.84, Datë 16.09.2014”	Fletore Zyrtare me 120, Datë. 02/07/2019
Nr. 128	Datë 29.08.2019	Vendim nr.128 datë 29.08.2019, “Mbi fillimin e proçedurës për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Niçë”, me kapacitet të instaluar 1668 KW.	Fletore Zyrtare me 131, Datë. 24/09/2019
Nr. 129	Datë 29.08.2019	Vendim nr.129 datë 29.08.2019, “Mbi fillimin e proçedurës për licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji”, sh.a, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.	Fletore Zyrtare me 131, Datë. 24/09/2019
Nr. 130	Datë 29.08.2019	Vendim nr.130 datë 29.08.2019,”Mbi fillimin e proçedurës për licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji”, Sh.a në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, për një afat 5 (pesë)-vjeçar.	Fletore Zyrtare me 131, Datë. 24/09/2019

Nr. 131	Datë 29.08.2019	Vendim nr.131 datë 29.08.2019, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Electral Batra HPP” në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”	Fletore Zyrtare me 131, Datë. 24/09/2019
Nr. 132	Datë 29.08.2019	Vendim nr.132 datë 29.08.2019, “Fillimin e Procedurës për Shqyrtimin e Miratimin e Draftit të Rregullores së Lidhjeve të Reja në Rrjetin e Gazit Natyror”	Fletore Zyrtare me 131, Datë. 24/09/2019
Nr. 133		Vendim i Brëndshëm	
Nr. 134	Datë 06.09.2019	Vendim nr. 134, datë 06.09.2019 , “Mbi refuzimin e e kërkesës së shoqërisë albpetrol Sh.a për licencim në aktivitetin e furnizimit me gaz natyror”;	Fletore Zyrtare me 131, Datë. 24/09/2019
Nr. 135	Datë 06.09.2019	Vendim nr. 135 datë 06.09.2019 “Mbi fillimin procedurës për licencimin e shoqërisë electral batra hpp sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Selita”, me kapacitet të instaluar 1798 KW, hec, “Frankthi” me kapacitet të instaluar 2129 KW, dhe hec “batra”, me kapacitet të instaluar 2411 KW, dhe me me kapacitet total të instaluar 6338 KW.	Fletore Zyrtare me 131, Datë. 24/09/2019
Nr. 136	Datë 06.09.2019	Vendim nr.136 datë 06.09.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë ensco trading (albania), në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike”.	Fletore Zyrtare me 131, Datë. 24/09/2019
Nr. 137	Datë 06.09.2019	Vendim nr.137 datë 06.09.2019, “Mbi kërkesën e ost sh.a , për disa ndryshime në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.	Fletore Zyrtare me 131, Datë. 24/09/2019
Nr. 138	Datë 16.09.2019	Vendim nr.138, datë 16.09.2019 “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin gusht 2019”	Fletore Zyrtare me 131, Datë. 24/09/2019
Nr. 139	Datë 24.09.2019	Vendim nr. 139, datë, 24.09.2019, “Mbi fillimin e procedurës për disa shtesa dhe ndryshime në	Fletore Zyrtare me 138,

		vendimin nr. 190, datë 23.11.2017, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror”;	Datë. 09/10/2019
Nr. 140	Datë 24.09.2019	Vendim nr.140, datë, 24.09.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Shëngjun” me kapacitet të instaluar, 2040 kW;	Fletore Zyrtare me 138, Datë. 09/10/2019
Nr. 141	Datë 24.09.2019	Vendim Nr.141, datë, 24.09.2019 , “Mbi licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.	Fletore Zyrtare me 138, Datë. 09/10/2019
Nr. 142	Datë 24.09.2019	Vendim Nr.142 datë, 24.09.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”;	Fletore Zyrtare me 138, Datë. 09/10/2019
Nr. 143	Datë 24.09.2019	Vendim Nr.143, datë, 24.09.2019, “ Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a, me nr. 274, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.35, datë 04.03.2015”.	Fletore Zyrtare me 138, Datë. 09/10/2019
Nr. 144			
Nr. 145			
Nr. 146	Datë 04.10.2019	Vendim nr. 146 datë 04.10.2019 “Mbi kërkesën e OSHEE për shtyrjen e periudhës tranzitore të vendosur me pikën 2 të vendimit nr. 46, dt 19.03.2019 të Bordit të ERE, deri në fund të vitit 2019”	Fletore Zyrtare me 145, Datë. 29/10/2019
Nr. 147	Datë 04.10.2019	Vendim nr. 147 datë 04.10.2019 “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë FSHU në veprimtarinë e Furnizimit të energjisë elektrike (Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqytjes)”	Fletore Zyrtare me 145, Datë. 29/10/2019
Nr. 148	Datë 04.10.2019	Vendim nr. 148 datë 04.10.2019 “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë OST për miratimin e disa shtesave në rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues”	Fletore Zyrtare me 145, Datë. 29/10/2019
Nr. 149			

Nr. 150	Datë 10.10.2019	Vendim nr.150 datë 10.10.2019 Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Shtator 2019.	Fletore Zyrtare me 142, Datë. 22/10/2019
Nr. 151	Datë 14.10.2019	Vendimi nr. 151 , datë 14.10.2019, “Mbi fillimin e procedurës për liçencimin e shoqërisë “Elva 2001”sh.a, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mivas” me kapacitet të instaluar 1940 kW”	Fletore Zyrtare me 148, Datë. 04/11/2019
Nr. 152	Datë 14.10.2019	Vendimi nr. 152, datë 14.10.2019, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në ‘Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016 i ndryshuar me vendimin nr. 177 datë 08.11.2016 të bordit të ERE-s, për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhues të energjisë elektrike nga dielli”. (Drejtorja e Tarifave dhe Çmimeve)”	Fletore Zyrtare me 148, Datë. 04/11/2019
Nr. 153	Datë 21.10.2019	Vendimi nr. 153, datë 21.10.2019, “Mbi liçencimin e shoqërisë “Electral Batra HPP”, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”	Fletore Zyrtare me 148, Datë. 04/11/2019
Nr. 154			
Nr. 155	Datë 29.10.2019	Vendimi nr.155, datë 29.10.2019, “Mbi fillimin e procedurave për rishikimin e Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me Vendimin nr. 201, datë 04.12.2017”	Fletore Zyrtare me 152, Datë, 13/11/2019
Nr. 156	Datë 29.10.2019	Vendimi nr. 156, datë 29.10.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike”	Fletore Zyrtare me 152, Datë, 13/11/2019
Nr. 157	Datë 29.10.2019	Vendimi nr. 157, datë 29.10.2019, “Mbi fillimin e procedurës për liçencimin e shoqërisë “HP Panarit” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Vile”	Fletore Zyrtare me 152, Datë, 13/11/2019
Nr. 158	Datë 29.10.2019	Vendimi nr. 158, datë 29.10.2019, “Mbi fillimin e procedurës për liçencimin e shoqërisë “Hec ARSTI”, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”	Fletore Zyrtare me 152, Datë, 13/11/2019
Nr. 159	Datë 29.10.2019	Vendimi nr.159, datë 29.10.2019, “Mbi rinovimin e liçencës së shoqërisë “Devoll Hydropower”, me nr. 274, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”	Fletore Zyrtare me 152, Datë, 13/11/2019
Nr. 160	Datë 29.10.2019	Vendimi nr.160, datë 29.10.2019, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hec Kabash Poroçan” , për lënien në hipotekë	Fletore Zyrtare me 152,

		dhe barrë të aseteve në favor të Intesa SanPaolo Bank”	Datë, 13/11/2019
Nr. 161	Datë 29.10.2019	Vendimi nr.161, datë 29.10.2019, Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Përparimi SK” , për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të Intesa SanPaolo Bank	Fletore Zyrtare me 152, Datë, 13/11/2019
Nr. 162	Datë 29.10.2019	Vendimi nr.161, datë 29.10.2019, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hec Lashkiza” , për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të Intesa SanPaolo Bank”	Fletore Zyrtare me 152, Datë, 13/11/2019
Nr. 163			
Nr. 164	Datë 04.11.2019	Vendimi Nr.164 datë 04.11.2019”Mbi rinovimin e liçencës së shoqërisë FSHU në veprimtarinë e furnizimit të Energjisë Elektrike”	Fletore Zyrtare me 156, Datë, 19/11/2019
Nr. 165	Datë 04.11.2019	Vendimi Nr.165 datë 04.11.2019, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së fundit për muajin Tetor 2019”	Fletore Zyrtare me 156, Datë, 19/11/2019
Nr. 166	Datë 04.11.2019	Vendimi Nr.166 datë 04.11.2019 “Mbi miratimin e “Rregullores mbi Sistemin e Njësuar të Llogarive për Shoqëritë e Rregulluara në Sektorin e Gazit Natyror”	Fletore Zyrtare me 156, Datë, 19/11/2019
Nr. 167	Datë 04.11.2019	Vendimi Nr.167 datë 04.11.2019, “Mbi Miratimin e draft kontrates për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike KESH/ SH.A., Aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga Shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE SH.A Për Furnizimin e Klientëve Fundorë për Periudhën Kohore 01.01.2019 – 31.12.2019”.	Fletore Zyrtare me 156, Datë, 19/11/2019
Nr. 168	Datë 04.11.2019	Vendimi Nr.168 datë 04.11.2019, “Mbi Fillimin e Procedurës për Miratimin e Kodit të Rrjetit që Harmonizon Strukturat Tarifore të Transmetimit të Gazit”	Fletore Zyrtare me 156, Datë, 19/11/2019
Nr. 169	Datë 07.11.2019	Vendimi Nr.169 datë 07.11.2019,”Mbi fillimin e procedurës për liçencimin e shoqërisë “Kroi Mbret Energji “, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”	Fletore Zyrtare me 158, Datë, 25/11/2019
Nr. 170	Datë 07.11.2019	Vendimi Nr.170 datë 07.11.2019 ,“Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Sa’Ga’Mat” për lënien peng të aseteve të luajtshme të ardhshme apo të tashme dhe vendosjen e hipotekës mbi asetet e paluajtshme që	Fletore Zyrtare me 158, Datë, 19/11/2019

		do ti përkasin Hec-ve “German 1” dhe “German 2, në favor të bankës Intesa San Paolo”	
Nr. 171	Datë 07.11.2019	Vendimi Nr.171 datë 07.11.2019, “Lidhur me kërkesën e konçesionarit “Wonder” sh.p.k, për transferimin e plotë të liçencës së shoqërisë konçesionare “Energio-Sas”, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Sasaj”, tek shoqëria “Hydropower-SAS” sh.p.k.	Fletore Zyrtare me 158, Datë, 25/11/2019
Nr. 172	Datë 07.11.2019	Vendimi Nr.172 datë 07.11.2019, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e liçencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania”, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë Elektrike”	Fletore Zyrtare me 158, Datë, 25/11/2019
Nr. 173	Datë 07.11.2019	Vendimi Nr.173 datë 07.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë E-Vento Albania për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, dt. 17.07.2008, i ndryshuar	Fletore Zyrtare me 158, Datë, 25/11/2019
Nr. 174	Datë 07.11.2019	Vendimi Nr.174 datë 07.11.2019, “Mbi fillimin e procedurës për liçencimin e shoqërisë Axpo Albania në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”	Fletore Zyrtare me 158, Datë, 25/11/2019
Nr. 175	Datë 14.11.2019	Vendimi Nr.175 datë 14.11.2019, “Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.	Fletore Zyrtare me 165, Datë, 05/12/2019
Nr. 176	Datë 14.11.2019	Vendimi Nr.176 datë 14.11.2019 “Mbi miratimin e rregulloreve të lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror”	Fletore Zyrtare me 165, Datë, 05/12/2019
Nr. 177	Datë 14.11.2019	Vendimi Nr.177 datë 14.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për shitjen e kuotave të shoqërisë Smart Watt sh.p.k tek shoqëria “ETS” sh.p.k.	Fletore Zyrtare me 165, Datë, 05/12/2019
Nr. 178	Datë 14.11.2019	Vendimi Nr.178 datë 07.11.2019, “Mbi fillimin e procedurës për liçencimin e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”	Fletore Zyrtare me 165, Datë, 05/12/2019
Nr. 179	Datë 20.11.2019	Vendimi Nr.179 datë 20.11.2019, “Për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë Albpetrol, në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror	Fletore Zyrtare me 167, Datë, 06/12/2019
Nr. 180	Datë 20.11.2019	Vendimi Nr.180 datë 20.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë Hera shpk për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007”, i ndryshuar	Fletore Zyrtare me 167, Datë, 06/12/2019

Nr. 181	Datë 20.11.2019	Vendimi Nr.181 datë 20.11.2019, Mbi kërkesën e shoqërisë Alb Wind Energy shpk për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 13, datë 28.01.2008, i ndryshuar	Fletore Zyrtare me 167, Datë, 06/12/2019
Nr. 182	Datë 20.11.2019	Vendimi Nr.182 datë 20.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë Albanian Green Energy shpk për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 89, datë 06.08.2008”, i ndryshuar	Fletore Zyrtare me 167, Datë, 06/12/2019
Nr. 183	Datë 20.11.2019	Vendimi Nr.183 datë 20.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë Bio Power Green Energy shpk për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 06.08.2008”, i ndryshuar	Fletore Zyrtare me 167, Datë, 06/12/2019
Nr. 184	Datë 20.11.2019	Vendimi Nr.184 datë 20.11.2019, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores për burimet dytësore të energjisë elektrike”	Fletore Zyrtare me 167, Datë, 06/12/2019
Nr. 185	Datë 20.11.2019	Vendimi Nr.185 datë 20.11.2019, “Mbi fillimin e procedurës për Miratimin e kritereve për të vendosur Kufizime sipas Kërkesave për lidhjen e Moduleve të Gjenerimit”	Fletore Zyrtare me 167, Datë, 06/12/2019
Nr. 186	Datë 25.11.2019	Vendimi Nr.186 datë 20.11.2019, Mbi fillimin e procedurës për miratimin e draft “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”	
Nr. 187	Datë 25.11.2019	Vendimi Nr.187 datë 20.11.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “MP-Hec”, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Niçë” me kapacitet të instaluar 2270 KW”	
Nr. 188	Datë 25.11.2019	Vendimi Nr.188 datë,20.11.2019Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k, Nr. 262 Seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 7 datë 02.02.2015”	
Nr. 189	Datë 25.11.2019	Vendimi Nr.189 datë, 20.11.2019 , “Mbi fillim procedure për licencimin e shoqërisë “Kalisi Hydropower” Sh.p.k , në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC-ET “Veleshica1”, me Kapacitet të instaluar 5801 KW dhe “Veleshica 2” ”, me Kapacitet të instaluar 8116 KW, Me Kapacitet Total të Instaluar 13917 KW”	
Nr. 190	Datë 25.11.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë Albgaz sh.a, për licencim në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror	
Nr. 191	Datë 25.11.2019		

Nr. 192	Datë 02.12.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike	
Nr. 193	Datë 02.12.2019	Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2MW dhe era me fuqi të instaluar deri në 3MW për vitin 2019	
Nr. 194	Datë 03.12.2019	Opinion i ERE-s për Kërkesën e Ost Sh.a, Për Dhënie në Përdorim të një pjese të infrastrukturës së Fibrës Optike.	
Nr. 195	Datë 12.12.2019	Vendimi Nr. 195 datë 12.12.2019 “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga FMF për muajin Nëntor 2019”	
Nr. 196	Datë 12.12.2019	Vendimi Nr. 196 datë 12.12.2019 “Mbi kërkesën e KESH SH.A për rishikimin e vendimit nr. 167, dt. 04.11.2019 “Mbi miratimin e draft kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike”	
Nr. 197	Datë 12.12.2019	Vendimi Nr. 197 datë 12.12.2019 “Mbi kërkesën e OSHEE SH.A për rishikimin e vendimit nr. 167, dt. 04.11.2019 “Mbi miratimin e draft kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike”	
Nr. 198	Datë 12.12.2019	Vendimi Nr. 198 datë 12.12.2019 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020”	
Nr. 199	Datë 12.12.2019	Vendimi Nr. 199 datë 12.12.2019 “Mbi Shtyerjen e Fuqisë Juridike të vendimit të Bordit të ERE, nr. 268 datë 21.12.2018, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të Tensionit”	
Nr. 200	Datë 12.12.2019	Vendimi Nr. 200 datë 12.12.2019 “Mbi Shtyerjen e Fuqisë Juridike të vendimit të Bordit të ERE, nr. 268 datë 21.12.2018, për çmimet me pakicë për klientët Fundorë që shërbehen nga Furnizuesi I Shërbimit Universal”	
Nr. 201	Datë 12.12.2019	Vendimi Nr. 201 datë 12.12.2019 “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE, nr.8 datë 17.01.2019, “Mbi Çmimin vjetor të Blerjes së Energjisë Elektrike , që do tu paguhet Prodhuesëve Ekzistues me përparësi të Energjisë Elektrike për vitin 2019”	
Nr. 202	Datë 12.12.2019	Vendimi Nr. 202 datë 12.12.2019 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Draft rregullores së profileve të standardizuara të ngarkesës”	

Nr. 203	Datë 12.12.2019	Vendimi Nr. 203 datë 12.12.2019 “Mbi miratimin e rregullave per monitorimin e tregut të Energjisë Elektrike”	
Nr. 204	Datë 12.12.2019	Vendimi Nr. 204 datë 12.12.2019 “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania”, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”	
Nr. 205	Datë 12.12.2019		
Nr. 206	Datë 16.12.2019	Vendimi Nr. 206 datë 16.12.2019 Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 60, datë 15.04.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a.” për vitin 2020	
Nr. 207	Datë 16.12.2019	Vendimi Nr. 207 datë 16.12.2019 “Mbi kërkesën e Shoqërisë së OST sh.a, për një ndryshim në vendimin e ERE nr. 43, datë 15.03.2017, mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST SH.A , në përputhje me nenin 54 , pika 6 , të Ligjit Nr. 43/2015 “ Për Sektorin e Energjisë Elektrike “, dhe Nenin 9 pika 6 të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”.	
Nr. 208	Datë 16.12.2019	Vendimi Nr. 208 datë 16.12.2019 Mbi kërkesën e shoqërisë “Wenerg” sh.a, për barrësim të aseteve në favor të “OTP Albania” sh.a, për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të Hec-it “Dardha 1”.	
Nr. 209	Datë 16.12.2019	Vendimi Nr. 209 datë 16.12.2019 Mbi Kërkesën e OST SH.A për disa ndryshime ne vendimin e ERE-s nr. 2017, datë 18.12.2017 (Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë”	
Nr. 210	Datë 18.12.2019	Vendimi Nr. 210 datë 18.12.2019 Në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Wonder” sh.p.k dhe kërkesën e shoqërisë “Hydropower-SAS” sh.p.k, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE nr. 171, datë 07.11.2019”	
Nr. 211	Datë 18.12.2019	Vendimi Nr. 211 datë 18.12.2019 “Mbi shtyrjen e periudhës tranzitore për bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes se Energjise Elektrike sh.a (OSHEE sh.a), tek shoqëria Operatori i Sistemit te Shpërndarjes" sh.a (O.S.SH sh.a); Licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe	

		detyrimet të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a), tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a (FSHU sh.a)"	
Nr. 212	Datë 18.12.2019	Vendimi Nr. 212 datë 18.12.2019 "Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2019"	
Nr. 213	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 213 datë 20.12.2019 "Mbi miratimin e marrëveshjes për bashkëpunimin midis ERE DHE ZRRE Kosovë"	
Nr. 214	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 214 datë 20.12.2019 "Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik"	
Nr. 215	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 215 datë 20.12.2019 Mbi rishikimin e rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike	
Nr. 216	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 216 datë 20.12.2019 "Mbi licencimin e AXPO Albania në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike"	
Nr. 217	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 217 datë 20.12.2019 "Mbi licencimin e shoqërisë "Elva 2001" në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike"	
Nr. 218	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 218 datë 20.12.2019 Mbi licencimin e shoqërisë "Hec Arsti" sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec "Arsti"	
Nr. 219	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 219 datë 20.12.2019 "Mbi licensimin e shoqërisë Hydropower Panarit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Vile".	
Nr. 220	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 220 datë 20.12.2019 "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 187 datë 10.11.2017, "Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror", i ndryshuar me vendimin me nr. 261, datë 19.12.2018 dhe vendimin nr. 36, datë 04.03.2019, dhe një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 188 datë 10.11.2017, "Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror" i ndryshuar me vendimin nr. 262, datë 19.12.2018 dhe vendimin nr. 37, datë 04.03.2019"	

Nr. 221	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 221 datë 20.12.2019 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE nr. 63, dt. 23.04.2019, “Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 179, dt. 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë Albgaz sh.a, të ndryshuar”	
Nr. 222	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 222 datë 20.12.2019 “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k, Nr. 262, Seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”	
Nr. 223	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 223 datë 20.12.2019 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hydropower Elektrik” sh.p.k, për rinovimin e licencës, me nr. 268, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë të klientëve të kualifikuar, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 20, datë 11.02.2015”	
Nr. 224	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 224 datë 20.12.2019 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k, për rinovimin e licencës me nr. 266, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë të klientëve të kualifikuar, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 18, datë 11.02.2015”	
Nr. 225	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 225 datë 20.12.2019 Mbi kërkesën e shoqërisë “SA’GA-Mat” sh.p.k. për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 254, seria T14P, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.103, datë 07.11.2014, për një afat 30 vjeçar”	
Nr. 226	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 226 datë 20.12.2019 Informacion shtesë mbi kërkesën e shoqërisë ERS-08, shtyrje afati vendimi nr. 63, dt 13.06.2008, i ndryshuar”.	
Nr. 227	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 227 datë 20.12.2019 “Mbi shqyrtimin për miratimin e planit të Investimeve për vitin 2019 dhe përditësimin e planit të Zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare 2018-2022, të shoqërisë OSHEE sh.a”	
Nr. 228	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 228 datë 20.12.2019 Mbi shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2019 dhe atë të përditësuar 10-vjeçar 2015-2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST	
Nr. 229	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 229 datë 20.12.2019 Mbi miratimin e rregullores “Për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”	

Nr. 230	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 230 datë 20.12.2019 “Mbi miratimin e kontratës për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, të lidhur ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a dhe shoqërisë “Albpetrol” për vitin 2019”	
Nr. 231	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 231 datë 20.12.2019 “Për miratimin e “Kodit të rjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit”	
Nr. 232	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 232 datë 20.12.2019 “Mbi miratimin e “Metodologjisë së përlogaritjes së rimbursimit të dëmit ekonomik nga operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes”	
Nr. 233	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 233 datë 20.12.2019 “Mbi miratimin e rishikimit të “Metodologjisë të përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me Vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, të ndryshuar me Vendimin nr. 144, datë 25.06.2018”	
Nr. 234	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 234 datë 20.12.2019 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes “, miratuar me vendimin nr. 177, datë 08.11.2016 të Bordit të ERE-s, për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhues të energjisë elektrike nga dielli”	
Nr. 235	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 235 datë 20.12.2019 “Mbi fillimin e procedurave për miratimin e “Strategjisë për infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë elektrike”	
Nr. 236	Datë 20.12.2019	Vendimi Nr. 236 datë 20.12.2019 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Kodit të rjetit të transmetimit të gazit natyror”	
Nr. 237	Datë 23.12.2019	Vendimi Nr. 237 datë 23.12.2019 “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW dhe era me fuqi të instaluar deri 3 MW për vitin 2018”	
Nr. 238	Datë 23.12.2019	Vendimi Nr. 238 datë 23.12.2019 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k, për rishikimin e vendimit Nr. 170, datë 07.11.2019, të ERE-s”	
Nr. 239	Datë 23.12.2019	Vendimi Nr. 239 datë 23.12.2019 “Mbi rishikimin e vendimit Nr. 114, datë 22.07.2019 mbi licencimin shoqërisë “S.P.E Gjadër” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”	

Nr. 240	Datë 23.12.2019	Vendimi Nr.240, datë 23.12.2019 Mbi fillim procedure për “Kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së operatorit të tregut të energjisë elektrike (NEMO).	
---------	-----------------	---	--